

Dr Arjana Llano (Kasaj)

MANUAL PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI DHE GJUHA E URREJTJES

Raste praktike nga Gjykatat dhe Komisioneri
Për Mbrojtjen nga Diskriminimic

MANUAL FOR PROTECTION AGAINST DISCRIMINATION AND HATE SPEECH

Practical cases from the Courts and the Commissioner
for Protection from Discrimination





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË FAKULTETI I SHKENCAVE
HUMANE DEPARTAMENTI I DREJTËSISË

DR Arjana (KASAJ*) Llano

**MANUAL PËR MBROJTJEN NGA
DISKRIMINIMI DHE GJUHA E URREJTJES**

Raste praktike nga Gjykatat dhe Komisioneri
Për Mbrojtjen nga Diskriminimi

**MANUAL FOR PROTECTION AGAINST
DISCRIMINATION AND HATE SPEECH**

Practical cases from the Courts and the Commissioner
for Protection from Discrimination

UDC 343.4

DOI 10.29013/MMDGU.LlanoA.315.2025

ISBN 978-9928-812-26-1

Recensioni:

Blerina Muskaj

Redaktor gjuhësor:

Prof. As. dr. Gladiola Elezi (Durmishaj)

*UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE FAKULTETI I
SHKENCAVE HUMANE DEPARTAMENTI I DREJTËSISË*

Arjana (KASAJ*) Llano

**MANUAL PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI DHE GJUHA E
URREJTJES.** Raste praktike nga Gjykatat dhe Komisioneri Për Mbrojtjen
nga Diskriminimi – Praha : Premier Publishing s.r.o. 2025. – 315 p.

Qëllimi i këtij punimi është të pasqyrojë format e diskriminimit dhe të gjuhës së urrejtjes, aktorët e saj, faktorët që e shkaktojnë, pasqyrimi i akteve kombëtare dhe ndërkombëtare, që sigurojnë mbrojtjen e shoqërisë nga diskriminimi dhe gjuha e urrejtjes. Gjithashtu, të nxjerrë problematikat aktuale dhe masat që duhen ndërmarrë për parandalimin e saj. E gjithë shoqëria dhe komuniteti, institucionet duhet të reagojnë, duke respektuar parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit në shoqëri.

Shpresoj që ky manual t'i shërbejë shoqërisë në të cilën jetojmë dhe punojmë.

Subscribe to print 10/21/2025. Format 60 84/16.

Offset Paper. TimesNewRoman. Pec. liter. 11.

Typeset in Premier Publishing s.r.o. Praha, Czech Republic.

Printed by Premier Publishing s.r.o.

Praha 8 – Karlín, Lyčkovo nám. 508/7, PSČ 18600, Czech Republic

pub@ppublishing.org, ppublishing.org

ISBN 978-9928-812-26-1

© Arjana (KASAJ*) Llano

© Premier Publishing Praha, 2025.

Parathënie

Iu drejtohem lexuesve të këtij manuali.

Arsyeja kryesore që më nxiti të shkruaj këtë manual është diskriminimi dhe gjuha e urrejtjes, e përhapur në media në politikë, në komunitet. Në një shoqëri demokratike gjuha e urrejtjes dhe diskriminimi janë të papranueshme. Lufta ndaj tyre duhet të jetë faktor vendimtar. Liria e mendimit dhe e shprehjes është në të vërtetë gur themeli i të drejtave të njeriut dhe shtylla e shoqërisë së lirë dhe demokratike. Liria e shprehjes është e garantuar, por kjo liri ka dhe kufizimet e saj.

Qëllimi i këtij punimi është të pasqyrojë format e diskriminimit dhe të gjuhës së urrejtjes, aktorët e saj, faktorët që e shkaktojnë, pasqyrimi i akteve kombëtare dhe ndërkombëtare, që sigurojnë mbrojtjen e shoqërisë nga diskriminimi dhe gjuha e urrejtjes. Gjithashtu, të nxjerrë problematikat aktuale dhe masat që duhen ndërmarrë për parandalimin e saj. E gjithë shoqëria dhe komuniteti, institucionet duhet të reagojnë, duke respektuar parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit në shoqëri.

Metodologjia: Për shkrimin e këtij manuali kam përdorur metodën cilësore dhe sasiore, metodën interpretuese, metodën historike dhe atë krahasuese me legjislacionin e vendeve të tjera.

Ndalimi i gjuhës së urrejtjes në mediat audiovizive dhe mediave sociale duhet të jetë një nga prioritetet bazë. Retorika e armiqësisë dhe urrejtja e përhapur në mediat sociale dhe mesazhet e çastit cenojnë kohezionin social të qytetarëve, pjellë mosbesimi dhe intoleranca mbjell panik, provokon njerëzit ndaj veprimeve të paligjshme, duke krijuar terren për konflikt. Ndalimi i gjuhës së urrejtjes në politikë, media duhet të jetë në fokus të ndryshimeve. Organet bazë për mbrojtjen nga diskriminimi duhet të bëhen funksionale, duke mbrojtur individet, që janë objekt i gjuhës së urrejtjes. Kjo është një domosdoshmëri në një

shoqëri demokratike dhe në një shtet të së drejtës. Mosmarrja e masave mbrojtëse ndaj individëve, që është objekt i gjuhës së urrejtjes, mund të shkaktojë trauma dhe pasoja psikologjike të pariparueshme. Shpresoj që ky manual t'i shërbejë shoqërisë në të cilën jetojmë dhe punojmë.

Lexim të këndshëm lexuesve!

Autorja

Parathënie	3
Struktura	
Seksioni I	
KREU I	9
LIRIA E SHPREHJES	9
1.1-Liria e shprehjes dhe kufizimet e saj	
1.2 Roli i mediave në lirinë e shprehjes dhe të drejtën e informimit	16
1.3 Respektimi i parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit si element thelbësor në shtetin e së drejtës	19
KREU II	32
DISKRIMINIMI	
2.1 Historiku i lindjes së diskriminimit në shoqëri	32
2.2 Kuptimi dhe llojet e diskriminimit	32
2.3 Barazia gjinore dhe mosdiskriminimi në media	34
2.4 Shkaqet e diskriminimit	34
KREU III	47
FORMAT E DISKRIMINIMIT	47
3.1 Dhuna fisnore dhe shtëpiake si forma të diskriminimit	47
3.2 Forma të tjera diskriminimi	53
3.3 Barazia gjinore në shoqëri	57
SEKSIONI II	
KREU IV	76
GJUHA E URREJTJES	76
4.1 Kuptimi i gjuhës së urrejtjes	76
4.2 Rekomandimi nr.15 i politikës së përgjithshme të ECRI-T për luftimin e gjuhës së urrejtjes	83
4.3 Përshkrimi i veprës penale për gjuhën e urrejtjes	

<i>dhe rregullimi ligjor</i>	84
<i>4.4 Kuptimi i gjuhës së urrejtjes</i>	87
<i>4.5 Si manifestohet gjuha e urrejtjes?</i>	90
<i>4.5.1 Fyerja</i>	92
<i>4.6 Diversiteti</i>	96
<i>4.7 Stereotipet dhe faktorët për formimin e gjuhës së urrejtjes</i>	96
<i>4.8 Kiberbulizmi</i>	99
 KREU V	 102
AKTORËT E GJUHËS SË URREJTJES	102
<i>5.1 Gjuha e urrejtjes nga politikanët</i>	102
<i>5.2 Aktorët e tjerë të gjuhës së urrejtjes</i>	112
<i>5.3 Gjuha e urrejtjes në diskursin mediatik dhe ndikimi që ka në shoqëri</i>	112
<i>5.4 Ndalimi i gjuhës së urrejtjes nga Kodi i Etikës së gazetarëve dhe ligjeve</i>	116
<i>5.4 Këshilli i Ankesave</i>	118
<i>5.5 Gjuha e urrejtjes në mediat sociale</i>	120
<i>5.6 Shpejtësia e përhapjes së dezinformimit</i>	126
 KREU VI	 129
FORMAT E GJUHËS SË URREJTJES	129
<i>6.1 Gjuha e urrejtjes ndaj emigrantëve, pakicave dhe besimeve fetare</i>	129
<i>6.2 Gjuha e urrejtjes në diskursin politik në mediat sociale</i>	132
<i>6.3 Format e gjuhës së urrejtjes</i>	133
<i>6.4 Shpifja si formë e gjuhës së urrejtjes ndaj gazetarëve</i>	137
<i>6.5 Mekanizma mbrojtës nga dhuna online</i>	141
<i>6.6 Diskriminimi dhe gjuha e urrejtjes për shkak të aftësisë së kufizuar</i>	144
<i>6.7 Gjuha e urrejtjes për personat e komunitetit LGBTI</i>	158
<i>6.8 Rregullimi sipas legjislacionit shqiptar për mosdiskriminimin e “klientit në nevojë”</i>	163
<i>6.9 Praktika e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi</i>	169

6.10 Pasojat e gjuhës së urrejtjes	171
6.11 Cili është roli i edukimit mediatik dhe informacionit?	175
6.12 Si funksionon UNESCO për të luftuar gjuhën e urrejtjes?	177
KREU VII	181
KRAHASIMI I LEGJISLACIONIT ME	
SHTETET E TJERA	181
7.1 Vështrimi krahasues	181
7.2 Vendime të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut	192
KREU VIII	198
AKTET KOMBETARE DHE NDËRKOMBËTARE	
PËR MBROJTJEN NGADISKRIMINIMI	
DHE GJUHA E URREJTJES	198
8.1 Aktet ndërkombëtare për mbrojtjen nga diskriminimi dhe gjuha e urrejtjes	198
8.2 Kodi i Sjelljes së BE për të luftuar gjuhën e paligjshme të urrejtjes	214
8.3 Standardet e Bashkimit Evropian	216
8.4 Legjislacioni shqiptar për mbrojtjen nga diskriminimi dhe gjuha e urrejtjes	218
KREU IX	223
ORGANET PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIM	223
9.1 Organi Kombëtar për mbrojtjen nga diskriminimi	223
9.2 Kompetencat e Komisionerit	225
9.3 Organet në Bashkimin Evropian për mbrojtjen nga diskriminimi	228
9.3.1 Insituti Evropian për Barazinë Gjinore	230
9.3.2 Rrjeti Evropian i Barazisë	233
9.3.3 Agjencia për të Drejtat Themelore (FRA) ²⁷	238
9.6 Mbrojtja që siguron Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut nga diskriminimi dhe gjuha e urrejtjes	239

KREU X	244
AKTORËT QË E LUFTOJNË GJUHËN E URREJTJES NË BALLKANIN PERËNDIMOR	244
10.1 Aktorët kryesorë institucionalë	244
10.2 Organet e barazisë të krijuara nga Direktiva për Barazinë Racore (2000/43/EC) (22)	245
10.3 Këshilli Kombëtar i Barazisë Gjinore	246
10.4 Mekanizmat vetërregullues të medias	246
10.5 Komisionet Qendrore të Zgjedhjeve	247
10.6 Roli aktual i OSHC-ve	249
10.7 Roli i OSCE ODIHRIT në gjuhën e urrejtjes	249
10.8 Masat që ka marrë Bashkimi Evropian kundër gjuhës së urrejtjes	250
 SEKSIONI III	
 KREU XI	244
MASAT QË KA MARRË BASHKIMI EVROPIAN DHE ATO QË DUHET TË MERREN PËR LUFTËN KUNDËR GJUHËS SË URREJTJES	252
11.1 Statistikat me të dhënat për gjuhën e urrejtjes nga media	252
11.2 Masat që duhen ndërmarrë kundër gjuhës së urrejtjes dhe diskriminimit	254
11.3 Masat dhe strategjitë për luftimin e gjuhës së urrejtjes në nivel evropian	255
11.4 Nismat kombëtare për luftën kundër gjuhës së urrejtjes	264
11.5 Rekomandimet	267

KREU I

LIRIA E SHPREHJES

1.1 Liria e shprehjes dhe kufizimet e saj

Themelet e lirisë së shprehjes i gjejmë në Amendamentin e Parë të Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Amendamenti i parë: Kongresi nuk do të nxjerrë asnjë ligj që respekton themelimin e fesë ose ndalon ushtrimin e lirë të tij ose shkurtimi i lirisë së fjalës, ose të shtypit, ose e drejta e njerëzve për t'u mbledhur në mënyrë paqësore dhe për t'i kërkuar Qeverisë për një korrigjim të ankesave¹ Sa i përket shekullit XX, afirmimi dhe rëndësia dramatike e lirisë së shprehjes, veçanërisht është potencuar pas traumave të mëdha shoqërore (në kohën midis dy luftërave botërore, Holokaustit, Luftës e Ftohtë, rënies së Murit të Berlinit). Në një numër të madh të punimeve shkencore, kushtuar kësaj të drejte, citohet mendimi i Xhon Stjurart Mil, i cili thotë: *“Liria e shprehjes na mbron nga pushteti i korruptuar dhe tirania. Kjo liri është një nga garancitë themelore për shoqëri të hapur dhe pluraliste.”*²

Lind pyetja. Sa e rëndësishme është liria e shprehjes?

Deri ku janë kufijtë e të lejueshmes së saj?

Sa është e lidhur me të drejtat e tjera?

Nuk mund të ketë dyshim se liria e shprehjes së bashku me të drejtën për të marrë dhe për të dhënë informacion, është një vlerë thelbësore e çdo shoqërie demokratike, që meritojnë mbrojtjen më të madhe ligjore. Si e tillë, ajo njihet dukshëm dhe ngulitur, pothuajse në

¹¹ “Amendamenti i Parë i Shteteve të Bashkuara të Amerikës”,

https://constitution.congress.gov/browse/essay/amdt1-9-1/ALDE_00000395/, aksesuar më 14.11.2023

² E. Mihajlova, J. Bačovska, T. Shekerxhiev, “Liria e shprehjes dhe gjuha e urrejtjes” Shkup, 2013 OSCE f.6

çdo të drejtë ndërkombëtare dhe rajonale.³ Në Projektin e të Drejtave Kushtetuese dhe të tjerët kundër Nigerisë, Komisioni Afrikan e njohu rëndësinë e së drejtës, kur ajo u shpreh se “liria e shprehjes është një bazë njerëzore e drejtë, jetike për zhvillimin personal dhe ndërgjegjen politike të një individi, dhe pjesëmarrjen në drejtimin e punëve publike të vendit të tij”. Përveç kësaj, në Gazi Suleiman kundër Sudanit, Komisioni tha se ishte “*një gur themeli i demokracisë dhe një nga mjetet për të siguruar respektimin e të gjitha të drejtave dhe lirive të njeriut.*” Gjykata e Lartë e Afrikës së Jugut komentoi se: “*liria e shprehjes është liri nga e cila varen të gjitha liritë e tjera, është liria pa të cilën të tjerët nuk do të kishin dëshirë të durojnë*”. Këto citate tregojnë arsyet e ndryshme pse liria e shprehjes është kaq e rëndësishme.⁴

*Liria e shprehjes është një nga të drejtat e njeriut e njohur dhe e sanksionuar nga Kushtetutat e gjithë botës demokratike. Liria e shprehjes është një e drejtë e garantuar, por kjo nuk është një garanci absolute, si të gjitha të drejtat e tjera kjo mund të kufizohet, por kufizimet nuk duhet t'i kalojnë ato të parashikuara në Kushtetutë dhe në Konventën Evropiane të Drejtave të Njeriut pasi Kushtetuta e ka thirrur Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut, dhe e ka bërë pjesë të sajën. Kufizimet e vendosura nuk duhet t'i kalojnë kufizimet e Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Liria e shprehjes është një nga shtyllat bazë të demokracisë. Shteti mund t'i përmirësojë të drejtat, por nuk mund të kufizojë më shumë se ato të vendosura në Konventë. Individët janë të lirë të shprehin idetë e tyre, pikëpamjet, opinionet, por kjo liri nuk është e pakufizuar, ata duhet të respektojnë të drejtat e personave të tjerë, dinjitetin.*⁵

³³ The Importance of Freedom of

Expression <https://www.southernafricalitigationcentre.org/wp-content/uploads/2017/08/Chapter-2.pdf>, aksesuar më 16.11.2023

^{44 44} The Importance of Freedom of

Expression <https://www.southernafricalitigationcentre.org/wp-content/uploads/2017/08/Chapter-2.pdf>, aksesuar më 16.11.2023

^{5 55} The Importance of Freedom of

Në disa raste tejkalohen kufijtë e lirisë së shprehjes. Personat me identitet më të fortë, personat më dominues në shoqëri, për shkak të pushtetit politik, social, ekonomik, mediatik, përdorin gjuhën e urrejtjes dhe diskriminimit ndaj personave më pak të favorizuar në shoqëri për shkak të gjinisë, të etnisë, të bindjeve politike, të gjendjes ekonomike, për shkak të pozitës së tyre sociale, kombësisë, të orientimit seksual, të përkatësië prindërore dhe për shkaqe të tjera. Liria e shprehjes nuk duhet shpërdoruar dhe nuk duhet të etiketohen persona të caktuar me gjuhën e urrejtjes dhe diskriminimit.

Nevoja për të ruajtur lirinë e shprehjes nga censura nga shtetet ose korporatat private, shpesh, thirret për të kundërshtuar përpjekjet, për të rregulluar shprehjen e urrejtjes, veçanërisht në internet⁶. Liria e mendimit dhe e shprehjes është në të vërtetë, gur themeli i të drejtave të njeriut dhe shtyllë e shoqërisë së lirë dhe demokratike. Këto liri mbështesin të drejta të tjera themelore, të tilla si: *tubimi paqësor, pjesëmarrja në çështjet publike dhe liria e fesë*.⁷ Është e pamohueshme që mediat dixhitale, përfshirë mediat sociale, kanë forcuar të drejtën për të kërkuar, marrë e dhënë informacion dhe ide. Prandaj, përpjekjet legjislative për të rregulluar shprehjen e lirë, ngrenë në mënyrë të habitshme shqetësimet se për të frenuar gjuhën e urrejtjes, mund të heshtin mospajtimin dhe opozitën. Për të kundërshtuar gjuhën e urrejtjes, Kombet e Bashkuara mbështesin fjalimin më pozitiv dhe respektin për lirinë e shprehjes si normë. Prandaj, çdo kufizim duhet të jetë një përjashtim dhe të synojë të parandalojë dëmin dhe të sigurojë barazi ose pjesëmarrjen publike të të gjithëve.

Krahas dispozitave përkatëse të ligjit ndërkombëtar për të drejtat e njeriut, Plani i Veprimit i OKB-së në Rabat, ofron udhëzime

Expression <https://www.southernafricalitigationcentre.org/wp-content/uploads/2017/08/Chapter-2.pdf>, aksesuar më 16.11.2023

⁶ UNITED NATIONS, Hate speech versus freedom of speech <https://www.un.org/en/hate-speech/understanding-hate-speech/hate-speech-versus-freedom-of-speech>, aksesuar më 14.11.2023

⁷ Po aty

kyçe për shtetet mbi dallimin midis lirisë së shprehjes dhe “nxitjes” (për diskriminim, armiqësi dhe dhunë), e cila është e ndaluar sipas ligjit penal. Përcaktimi se kur potenciali i dëmtimit është mjaft i lartë për të justifikuar ndalimin e të folurit, është ende subjekt i shumë debateve. Por shtetet mund të përdorin gjithashtu, mjete alternative si edukimi dhe promovimi i kundërmesazheve për të adresuar të gjithë spektrin e shprehjes së urrejtjes, si në internet ashtu edhe jashtë saj.⁸

Ushtrimi i të drejtës së lirisë së shprehjes kërkohet të bëhet brenda kontureve të kërkesave të parashikuara në nenet 15, 17, 35, 41 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pasi të drejtat themelore të njeriut janë të padhunueshme. Ato qëndrojnë në themel të të gjithë rendit juridik dhe mund të kufizohen vetëm me ligj. Në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, në nenin 22 të saj parashikohet:⁹.

1. *Liria e shprehjes është e garantuar.*
2. *Liria e shtypit, e radios dhe e televizionit është e garantuar.*
3. *Censura paraprake e mjeteve të komunikimit ndalohet.*
4. *Ligji mund të kërkojë dhënien e autorizimit për funksionimin e stacioneve të radios ose të televizionit.*

Gjatë interpretimit të nenit 10 të Konventës, Gjykata ka vendosur se “*liria e shprehjes përbën një prej bazave esenciale të shoqërisë (demokratike), një prej kushteve themelore për përparimin e tij dhe për zhvillimin e secilit njeri*”. Gjykata disa herë e ka potencuar rëndësinë e këtij neni, i cili nuk zbatohet vetëm për “*informata*” ose “*ide*”, që janë të zbatueshme ose konsiderohen si jo ofenduese apo indiferente, por edhe për ato që ofendojnë, shokojnë, ose shqetësojnë. Të tilla janë kërkesat për pluralizëm, tolerancë ose liri të mendimit, pa të cilat nuk ka “*shoqëri demokratike*”. Duke marrë parasysh gjithë sa u tha më lart,

⁸ UNITED NATIONSH United Nations Secretary-General António Guterres, May 2019, *ate speech versus freedom of speech* <https://www.un.org/en/hate-speech/understanding-hate-speech/hate-speech-versus-freedom-of-speech>, aksesuar më 14.11.2023

⁹ M. Lazarova Trajkovska, M. Zhesko, “*Analiza e praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut lidhur me gjuhën e urrejtjes dhe krimin e urrejtjes*”. Botim, 2021, f.7

askush nuk është i autorizuar të thirret në dispozitat e Konventës me qëllim për t'i dobësuar ose shkatërruar idealet dhe vlerat e një shoqërie demokratike. Prandaj, qëllimi i përgjithshëm i nenit 17 është parandalimi i grupeve totalitare ose ekstremiste që t'i shfrytëzojnë në interes të tyre parimet e theksuara në Konventë. Neni 17 është i lidhur edhe me konceptin e “*demokracisë, që është e aftë për t'u mbrojtur*”.¹⁰

Sipas Vendimit të GJK 16/2004, Liria e shprehjes përbën një nga gurët themelorë të shtetit demokratik. Pa garantimin e kësaj të drejte, nuk mund të bëhet fjalë për pluralizëm, tolerancë dhe krijim të vullnetit të lirë politik, aq të domosdoshëm për shoqërinë demokratike. Liria e shprehjes është gjithashtu, bazë dhe kusht i domosdoshëm paraprak për garantimin e një sërë të drejtave dhe lirive të tjera themelore. Dispozita e mësipërme e ligjit është në harmoni të plotë me parashikimet në Direktivën 95/46 të KE, ku parashikohet:

“Për përpunimin e të dhënave me karakter personal, që realizohen ekskluzivisht për qëllime gazetarie në kuadrin artistik ose në shprehjen letrare, vendet anëtare parashikojnë përjashtimet, ose devijimet nga dispozitat e kapitullit 4 dhe 6 vetëm në shkallën, që është e nevojshme në mënyrë që e drejta e jetës private të përshtatet me rregullat, që rregullojnë lirinë e të shprehurit”. Po kështu, kjo dispozitë është në harmoni dhe me nenin 10 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut ku parashikohet:

“1. Çdo person ka të drejtën e lirisë së shprehjes. Kjo e drejtë përfshin lirinë e opinionit dhe lirinë për të marrë a për të dhënë informacione ose mendime, pa ndërhyrjen e autoriteteve publike dhe pa marrë parasysh kufijtë. Ky nen nuk i ndalon Shtetet që të vendosin një regjim autorizimesh për institucionet e radiodifuzionit, të kinemasë, ose të televizionit.”¹¹ Ushtrimi i këtyre lirive, që përmban detyrime dhe

¹⁰¹⁰ M. Lazarova Trajkovska, M. Zhesko, “*Analiza e praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut lidhur me gjuhën e urrejtjes dhe krimin e urrejtjes*”. Botim, 2021, f.7

¹¹ M. Lazarova Trajkovska, M. Zhesko, “*Analiza e praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut lidhur me gjuhën e urrejtjes dhe krimin e urrejtjes*”. Botim, 2021, f.7

përgjegjësi, mund t'u nënshtrohet disa formaliteteve, kushteve, kufizimeve ose sanksioneve të parashikuara nga ligji, që në një shoqëri demokratike përbën masat e nevojshme për sigurimin kombëtar, integritetin territorial, ose sigurimin publik, për mbrojtjen e rendit dhe parandalimin e krimit, për ruajtjen e shëndetit, të moralit, për mbrojtjen e dinjitetit e të të drejtave të të tjerëve, për të ndaluar përhapjen informative konfidenciale, ose për të garantuar autoritetin dhe paanshmërinë e pushtetit gjyqësor.”¹²

Liria e shprehjes është një e drejtë e sanksionuar në shumë akte ndërkombëtare, duke filluar me Deklaratën Universale të Drejtave të Njeriut, Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, Karta e të Drejtave Themelore e Bashkimit Evropian, Konventa Amerikane e të Drejtave, Karta Afrikane e të Drejtave, më e rëndësishmja është Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut pasi ajo i garanton këto të drejta, duke pasur institucione të posaçme për garantimin e tyre. Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut e ka parashikuar lirinë e shprehjes në nenin 10 të saj.

Në paragrafin e pare, parashikohet liria e shprehjes së bashku me të drejtën e informimit. Në paragrafin e dytë, ajo parashikon kufizimet që i bëhen kësaj të drejte. Shprehimisht, në nenin 10 parashikohet: *“Çdokush ka të drejtën e lirisë së shprehjes. Kjo e drejtë përfshin lirinë e mendimit dhe lirinë për të marrë ose për të dhënë informacione dhe ide, pa ndërhyrjen e autoriteteve publike dhe pa marrë parasysh kufijtë.”*¹³ Ky nen nuk i ndalon shtetet që t'u kërkojnë ndërmarrjeve të transmetimit audioviziv, televiziv ose kinematografik të pajisen me

11

¹² M. Lazarova Trajkovska, M. Zhesko, “Analiza e praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut lidhur me gjuhën e urrejtjes dhe krimin e urrejtjes”. Botim, 2021, f.7

¹³ Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, ndryshuar me Protokollet Nr. 11, 14 dhe 15 shoqëruar nga Protokollet: Nr. 1, 4, 6, 7, 12, 13 dhe 16, Këshilli i Evropës https://www.echr.coe.int/documents/d/echr/convention_sqi

liçencë. Ushtrimi i këtyre lirive, që përmban detyrime dhe përgjegjësi, mund t'u nënshtrohet atyre formaliteteve, kushteve, kufizimeve ose sanksioneve të parashikuara me ligj dhe, që janë të nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë kombëtare, integritetit territorial ose sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit dhe parandalimin e krimit, për mbrojtjen e shëndetit, ose të moralit, për mbrojtjen e dinjitetit, ose të të drejtave të të tjerëve, për të ndaluar përhapjen e të dhënave konfidenciale, ose për të garantuar autoritetin dhe paanshmërinë e pushtetit gjyqësor”¹⁴. Këtyre kufizimeve të vendosura nuk duhet t'u shtohen kufizime të tjera nga ana e shtetit. Shteti në bazë të Kushtetutës ka parashikuar në nenin 17 kushtet, që duhet të plotësojnë kufizimet, aty është parashikuar se kufizimet mund të vendosen vetëm me ligj, për një interes publik ose për mbrojtjen e interesave të të tjerëve. Kufizimi duhet të jetë në përpjestim me gjendjen që e ka diktuar atë. Këto kufizime nuk duhet të çenojnë thelbin e të drejtave dhe lirive, dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën Evropiane të Drejtave të Njeriut¹⁵. Kur bëhen kufizimet, duhet respektuar parimi i proporcionalitetit.

Ndërhyrjet në të drejtën e lirisë së shprehjes duhet të jenë në raport me qëllimet, që kërkohen të arrihen. Është pranuar se liria e shprehjes shkon më tej sesa thjesht mbrojtja e tyre. E drejta e dikujt për të shprehur një mendim ose një fakt, mbron edhe të drejtën e të tjerëve për të dëgjuar atë mendim apo fakt. Gjykata Ndëramerikane e të Drejtave të Njeriut e ka bërë në mënyrë të përsëritur trajtimin e këtij aspekti të dyfishtë:¹⁶ “Kërkon, nga njëra anë që askush të mos kufizohet

¹⁴ Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, ndryshuar me Protokollet Nr. 11, 14 dhe 15 shoqëruar nga Protokollet: Nr. 1, 4, 6, 7, 12, 13 dhe 16, Këshilli i Evropës https://www.echr.coe.int/documents/d/echr/convention_sqi

¹⁵ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, <https://qbz.gov.al/preview/635d44bd-96ee-4bc5-8d93-d928cf6f2abd>, aksesuar më 15.11.2023

¹⁶ ¹⁶The Importance of Freedom of Expression <https://www.southernafricalitigationcentre.org/wp-content/uploads/2017/08/Chapter-2.pdf>, aksesuar më 16.11.2023

apo pengohet arbitrarisht në shprehjen e mendimeve të veta. Në këtë kuptim, është një e drejtë, që i takon secilit individualisht. Aspekti i dytë i tij, nga ana tjetër, lidhur me të drejtën e informimit, nënkupton një të drejtë kolektive për të marrë çdo lloj informacioni dhe për të pasur akses në mendimet e shprehura nga të tjerët”. Në një vendim të famshëm për lirinë e shtypit, Gjykata tha: “Kur liria e shprehjes cenohet, nuk është vetëm e drejta e atij individ [gazetari] që cenohet, por edhe e drejta e të gjithë të tjerëve për të ‘marrë’ informacione dhe ide.” Komisioni Afrikan citoi jurisprudencën e Gjykatës Ndëramerikane të të Drejtave të Njeriut në Zyrën Juridike të Ghazi Suleiman kundër Sudanit (II)49, ku Komisioni pranoi se: “Kur liria e shprehjes së një individ kufizohet në mënyrë të paligjshme, nuk është vetëm e drejta e atij individ që shkelet, por edhe e drejta e të gjithë të tjerëve për të ‘marrë’ informacione dhe ide”.¹⁷

1.2 Roli i mediave në lirinë e shprehjes dhe të drejtën e informimit

Çfarë roli kanë mediat në jetën e vendit?

Si duhet ta ushtrojnë veprimtarinë e tyre?

A ndëshkohet shkelja e Kodit të Etikës në media?

Mediat kanë një rol të madh në demokracinë e një vendi. Ato duhet ta ushtrojnë veprimtarinë e tyre në përputhje me Kushtetutën, me ligjet dhe me marrëveshjet ndërkombëtare, me Kodin e Etikës në media, me Kodin e transmetimit, me Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut, Konventën për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës. Mënyra se si mediat kryejnë detyrën e tyre, do të ketë një ndikim të rëndësishëm në zhvillimin e shoqërisë sonë demokratike.¹⁸ Nëse mediat janë të përpikta dhe të besueshme në përmbushjen e detyrimeve të tyre kushtetuese, ato do të fuqizojnë dhe forcojnë demokracinë tonë të re. Nëse lëkunden brenda, përmbushja e detyrave të tyre, synimet kushtetuese do të vihen në rrezik. Kështu Kushtetuta pohon dhe mbron mediat në kryerjen e

¹⁷The Importance of Freedom of

Expression <https://www.southernafricalitigationcentre.org/wp-content/uploads/2017/08/Chapter-2.pdf>, aksesuar më 16.11.2023

¹⁸ Po aty

detyrimeve të tyre ndaj shoqërisë më të gjerë”. GJEDNJ, në Thorgeirson kundër Islandës, zhvilloi një doktrinë, që fliste për rolin e rëndësishëm, që luajti media në të gjitha çështjet me rëndësi jo vetëm në politikë, por edhe në të tjera çështje me interes publik.

“Ndërsa shtypi nuk duhet të kapërcejë kufijtë e vendosur, ndër të tjera, për “mbrojtje të reputacionit të të tjerëve”, megjithatë i takon të japë informacione dhe ide për çështje me interes publik. Publiku, ka detyrën jo vetëm të dhënies së informacionit dhe ideve të tilla, por gjithashtu ka të drejtë edhe t’i marrë ato. Nëse do të ishte ndryshe, shtypi nuk do të ishte në gjendje të luante rolin e tij jetësor të “publikut, qen rojtar’.” Gjithashtu, në Castells kundër Spanjës pranohet: “*Liria e shtypit i ofron publikut një nga mjetet më të mira për të zbuluar, duke formuar një opinion për idetë dhe qëndrimet e liderëve të tyre politikë*”.¹⁹ Veçanërisht, u jep mundësi politikanëve të reflektojnë dhe komentojnë preokupimet e opinionit publik.²⁰ Në këtë mënyrë, u mundëson të gjithëve të marrin pjesë në debatin e lirë politik, që është në thelb të konceptit të një shoqërie demokratike.” Në McCarton Turkington Breen, (një firmë) kundër Times Newspapers Ltd, Mbretëria e Bashkuar, Dhoma e Lordëve vuri në dukje se, “[në] një shoqëri moderne, e të zhvilluar, është vetëm një pakicë e vogël e qytetarëve, të cilët mund të marrin pjesë drejtpërdrejt në diskutimet dhe vendimet, të cilat i japin formë jetës publike e shoqërisë së tyre. Kjo do të jetë në masë të madhe përmes mediave. Çfarë do të thotë kjo është se, nga e drejta për lirinë e shtypit nuk përfiton vetëm individi, gazetarët. Siç e kemi parë, është një aspekt i rëndësishëm i të drejtës, që merr publiku mesazhet, që komunikojnë gazetarët.”²¹ Raportimi për çështjet sociale. Shtypi, gjithashtu, duhet të jetë në gjendje të raportojë me saktësi mbi jetën

¹⁹ The Importance of Freedom of

Expression<https://www.southernafricalitigationcentre.org/wp-content/uploads/2017/08/Chapter-2.pdf>, aksesuar më 16.11.2023

²⁰ The Importance of Freedom of

Expression<https://www.southernafricalitigationcentre.org/wp-content/uploads/2017/08/Chapter-2.pdf>, aksesuar më 16.11.2023

²¹ Po aty

shoqërore të kombit. Kjo nënkupton mbulimin e ngjarjeve artistike, kulturore dhe ngjarjeve sportive, gjithashtu si prirje dhe zhvillime sociale që ndikojnë në jetën e përditshme të të gjithëve, duke përfshirë fëmijët, të rinjtë, të moshuarit dhe invalidët.²²

Shtypi si detektiv

Roli i detektivit është një shtesë kritike e rolit të shtypit si vëzhgues publik, megjithatë, këtu trajtohet veçmas për të theksuar dallimin ndërmjet raportimit për çështjet publike dhe hetimeve gazetareske për keqbrje në administrimin e punëve publike.

Roli i medias dhe liria e shtypit në shoqëri

Kur gazetarët janë të trajnuar mirë dhe kanë burime të besueshme informacioni, atëherë shtypi është në gjendje të hetojë keqbrjet nga zyrtarët publikë²³. Një keqbrje e tillë do të arrinte përfshirjen në kryerjen e mashtrimit ose përfshirjen në korrupsion për të devijuar dhe për të përfituar personalisht nga fondet publike ose burime të tjera publike. Ky rol, “*shtypi si detektiv*” demonstrohet kur shtypi mund të angazhojë në mënyrë të drejtë gazetarinë investigative afatgjatë. I detajuar dhe thelluar, ky lloj shtypi mund t’i raportojë publikut për keqbrje sistematike në shkallë të gjerë nga zyrtarë publikë (ose privatë), të cilët mund të përfshijnë nepotizëm, korrupsion, mashtrim ose lloje të tjera kriminaliteti. Këto ekspozime shpesh mbështeten në më shumë se një gazetar dhe kërkojnë publikimin ose burimin mediatik në tërësi (qoftë ai transmetim i drejtpërdrejtë ose në internet) për të ofruar burimet e nevojshme për ushtrimin hetimor. Një shembull i mirë ishte hetimi për të ashtuquajturën “*Kapja e Shtetit*” në Afrikën e Jugut nga ama Bhungane “Qendra për gazetari hulumtuese”, e cila rezultoi në ekspozimin e

²² The role of the media and press freedom in society

<https://www.kas.de/documents/285576/11521648/MLHSA+2021+-+1+The+role+of+the+media.pdf/f54a092e-1f2d-543d-291a-9603556b3773>

²³ The role of the media and press freedom in society

<https://www.kas.de/documents/285576/11521648/MLHSA+2021+-+1+The+role+of+the+media.pdf/f54a092e-1f2d-543d-291a-9603556b3773>

njohur si “Gupta Leaks”.²⁴ Mbulimi i Gupta Leaks, duke ekspozuar korrupsionin e nivelit të lartë, ka rezultuar me emërimin e disa komisioneve hetimore, puna e të cilëve është në vazhdim. Në shumë vende, aftësia dhe vullneti i shtypit për t’u angazhuar në hetim gazetaria, është vendimtare për të inkurajuar policinë dhe autoritetet e ndjekjes, për të vepruar kundër figurave publike të korruptuara edhe, nëse kjo ndodh vetëm si rezultat i pamasë i presionit që publiciteti i bën policisë dhe organeve të ndjekjes.

Shtypi si edukator publik

Shtypi, gjithashtu luan një rol të përgjithshëm edukues në shoqëri. Kjo mund të bëhet në disa nivele. ²⁵P.sh., në mbështetje të zhvillimit të fëmijërisë së hershme, transmetuesit shpesh transmetojnë materiale arsimore bazë që synojnë t’u mësojnë fëmijëve alfa- bast, ngjyra ose kafshë. Në mbështetje të arsimit të mesëm, mediat e shkruara ndonjëherë përfshijnë materiale edukative plotësuese për nxënësit e shkollës. Në mënyrë të ngjashme, transmetuesit munden dhe transmetojnë programe historike, shkencore apo edhe matematikore, që synojnë, gjithashtu nxënësit e shkollës. Megjithatë, arsimi është shumë më i gjerë sesa thjesht shkollimi formal dhe shtypi mund të luajë një rol të përgjithshëm edukativ.

Raportimi për çështjet sociale

Shtypi, gjithashtu duhet të jetë në gjendje të raportojë me saktësi mbi jetën shoqërore të kombit. Kjo nënkupton mbulimin e ngjarjeve artistike, kulturore dhe ngjarjeve sportive, gjithashtu si prirje dhe zhvillime sociale, që ndikojnë në jetën e përditshme të të gjithëve, duke përfshirë fëmijët, të rinjtë, të moshuarit dhe invalidët.

²⁴ The role of the media and press freedom in society

<https://www.kas.de/documents/285576/11521648/MLHSA+2021+-+1+The+role+of+the+media.pdf/f54a092e-1f2d-543d-291a-9603556b3773>

²⁵ The role of the media and press freedom in society

<https://www.kas.de/documents/285576/11521648/MLHSA+2021+-+1+The+role+of+the+media.pdf/f54a092e-1f2d-543d-291a-9603556b3773>

1.3 Respektimi i parimit të Barazisë dhe mosdiskriminimit si element thelbësor në shtetin e të së drejtës

Parimi i barazisë dhe mosdiskriminimit është një element i rëndësishëm i shtetit të së drejtës. Në shtetin e të drejtës respektohen dhe mbrohen të drejtat e njeriut. Shteti merr masa për t'i mbrojtur të drejtat e individëve brenda shtetit. Parimi barazisë nënkupton barazinë e shanceve dhe të mundësive. Ky parim ka lindur nga e drejta natyrore që të gjithë njerëzit lindin të barabartë, e ka origjinën nga ius naturale, ajo e ka prejardhjen hyjnore. Ndalimi i diskriminimit është ndër parimet më të rëndësishme sepse nëpërmjet zbatimit të tij, sigurohet trajtimi i barabartë i qenieve njerëzore pavarësisht nga çdo lloj statusi²⁶. Ky parim është shumë i rëndësishëm sepse së bashku me barazinë para ligjit dhe mbrojtjen e barabartë nga ligji, përbëjnë një parim themelor dhe të përgjithshëm, lidhur me mbrojtjen e të drejtave të njeriut.²⁷

Parimi i barazisë në Shqipëri u afirmua fillimisht në “Ligji Kushtetues” nr.7692, datë 01.03.1993, “*Për themelet të drejtat dhe liritë e njeriut*”, që parashikonte kushtetuesen e parë, themelet për ndërtimin e një të reje, demokratike dhe sociale, shteti ligjor.²⁸ Dispozita kushtetuese garanton se: “*Të gjithë janë të barabartë në ligj dhe para ligjit. Askush nuk duhet të diskriminohet në bazë të gjinisë, racës, etnisë, gjuhës, fesë, ekonomike ose statusit financiar, arsimimit ose statusit social, besimit politik, përkatësisë prindërore, apo ndonjë rrethane tjetër personale*”. Kjo, ndër vlerat dhe parimet themelore radhitet si parimi kushtetues, siç është respektimi dhe mbrojtja e dinjitetit njerëzor, të drejtat dhe liritë themelore. Kuptimin e duhur kushtetues, kufijtë dhe dimensionin e këtij parimi, ia dha kushtetuesja, jurisprudenca e viteve të para, ku thuhet se: “*...barazia në ligj dhe para ligjit nuk do të thotë se ka*

²⁶ J. Daci, “*Të Drejtat e Njeriut*”, botimi I,3 shtëpia botuese Julvin 2 Tiranë f.251

²⁷ Po aty

²⁸ KMD THE PRINCIPLE OF EQUALITY AND NON-DISCRIMINATION
ONSTITUTIONAL AND INTERNATIONAL PROTECTION OF THE PRINCIPLE
OF EQUALITY AND NON-DISCRIMINATIO, Analysis of Case Law 2013 - 2020
Tirana, March 2021 UNDP Austrian Development Cooperation f. 23,24

zgjidhje të barabartë për individë ose kategori personash, që janë objektivisht në kushte të ndryshme. Barazia në ligj dhe para ligjit presupozon barazinë e individëve, që janë në kushte të barabarta”. Parimet e barazisë dhe mosdiskriminimit janë gur themeli i demokracisë dhe në të vërtetë, ato mbushin dhe frymëzojnë tërë konceptin e të drejtave të njeriut. Ekziston një lidhje e drejtpërdrejtë ndërmjet parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit: ato përbëjnë dy anët e të njëjtës monedhë, ato janë forma pozitive dhe negative e të njëjtë parim, që do të thotë se dikush trajtohet në mënyrë të barabartë kur nuk është diskriminuar dhe, kur dikush është i diskriminuar, nuk trajtohet në mënyrë të barabartë. Shih vendimin nr.11, datë 27.08.1993 ku GJK vendosi rrëzimin e kërkesës.²⁹ Kjo e drejtë është sanksionuar në nenin 18 të Kushtetutës.

Në paragrafin e parë theksohet: *të gjithë janë të barabartë para ligjit* dhe në paragrafin e dytë theksohet: *askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore*. Askush nuk mund të diskriminohet për shkaqet e përmendura në paragrafin 2, nëse nuk ekziston një përligjje e arsyeshme dhe objektive. Sipas jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese Federale Gjermane thuhet: *“Parimi i barazisë nuk lejon që të njëjtat t’i trajtosh ndryshe dhe të ndryshmet në thelb t’i trajtosh njësoj”*.³⁰ Parimisht, është në diskrecionin e ligjvënësit, që të zgjedhë se cilat rrethana do të kenë pasoja juridike të njëjta me qëllim që t’i rregullojë ato njësoj nga pikëpamja juridike. Por këtë zgjedhje ligjvënësi duhet ta argumentojë në mënyrë të arsyeshme (BVerfGE 53, 313 (329). Fakti nëse, në raste të caktuara është respektuar apo jo në thelb parimi i barazisë, nuk mund të vlerësohet në mënyrë abstrakte dhe të përgjithshme, por duhet të shihet në lidhje me veçoritë dhe

²⁹ Shih vendimin nr.11, datë 27.08.1993 të Gjykatës Kushtetuese

³⁰ Vendimi i Gjykatës Kushtetuese Gjermane (vendimi (Beschluss) i Senatit të Dytë, datë 09.03.1994-2 BvL 43, 51, 63, 64, 70, 80/92, 2 BvR 2031/92), <https://www.kmd.al/wp-content/uploads/2023/04/Mendim-GJK.-VKM-nr.589.2022.-KMD.pdf>, aksesuar më 23.11.2023

karakteristikat e çështjes konkrete, që synohet të rregullohet”.³¹(vendim (Beschluss) i Senatit të Dytë, datë 09.03.1994 – 2 BvL 43, 51, 63, 64, 70, 80/92, 2 BvR 2031/92).

Respektimi i barazise dhe mosdiskriminimi janë parashikuar dhe te Marrëveshja e Stabilizim Asocimit ne nenin 46 paragrafi I pare parashikon shprehimisht Në përputhje me kushtet dhe modalitetet e zbatueshme në çdo Shtet Anëtar:

– trajtimi i akorduar punonjësve që janë shtetas shqiptarë të punësuar ligjërisht në territorin e një Shteti

Anëtar nuk përmban asnjë formë diskriminimi bazuar në kombësi, për sa u përket kushteve të punës,shpërblimit apo shkarkimit nga puna, krahasuar këto me shtetasit e tij;³²

Per rendesine e madhe qe paraqet mosdiskriminimi ne shtetin e se drejtes ai eshte bere pjese dhe e Marrëveshjes se Stabilizim Asocimit.

Gjithashtu ne nenin 59 pika 3b parashikohet:

Me hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, të gjitha masat e njëanshme si dhe pengesat administrative, teknike dhe të tjera të cilat mund të kenë efekte kufizuese apo diskriminuese në ofrimin e lirë të shërbimeve në transportin detar ndërkombëtar³³

Gjithashtu ne nenin 77 te kesaj Marrëveshje Parashikohet :

^{31 31} Vendimi i Gjykatës Kushtetuese Gjermane (vendimi (Beschluss) i Senatit të Dytë, datë 09.03.1994-2 BvL 43, 51, 63, 64, 70, 80/92, 2 BvR 2031/92), <https://www.kmd.al/wp-content/uploads/2023/04/Mendim-GJK.-VKM-nr.589.2022.-KMD.pdf>, aksesuar më 23.11.2023

³² Ligj nr.9590 datë 27.7.2006 Për ratifikimin e “Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Europiane e shteteve të tyre anëtare FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare www.legislacionishqiptar.gov.a

³³ Po aty neni 59 pika 3 b

Kushtet e punës dhe mundësitë të barabarta
Shqipëria do të harmonizojë në mënyrë progresive legjislacionin e saj me atë të Komunitetit në fushën e kushteve të punës, veçanërisht të shëndetit dhe sigurisë në punë, dhe mundësive të barabarta.³⁴

Gjithashtu neni NENI 100 parashikon:

Arsimi dhe trajnimi

Palët bashkëpunojnë me synim ngritjen e nivelit të arsimit të përgjithshëm dhe arsimit dhe trajnimit profesional në Shqipëri, ashtu si edhe të politikave për rininë dhe punës me rininë. Një nga përparësitë për sistemin e arsimit të lartë është arritja e objektivave të Deklaratës së Bolonjës. Palët bashkëpunojnë gjithashtu për të garantuar që aksesin në të gjitha nivelet e arsimit dhe trajnimit në Shqipëri të mos i nënshtrohet diskriminimit në bazë të gjinisë, ngjyrës, origjinës etnike ose fesë³⁵.

Të bën përshtypje fokusi i lartë i neneve që parashikojnë mosdiskriminimin.

Respektimi i parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit duhet të fillojë që në hapat e para të hartimit të ligjeve dhe të pasojë me fazat e tjera të zbatimit të ligjeve në marrjen e vendimeve. Trajtim i barabartë, është thelbi i respektimit të dinjitetit të njeriut. Cenimi i dinjitetit dhe diskriminimi janë të papranueshme në shoqëritë demokratike.³⁶ Parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit e ka parshikuar dhe Kodi i Procedurave Administrative në nenin 17.

³⁴ Po aty neni 77

³⁵ Ligj nr.9590 datë 27.7.2006 Për ratifikimin e “Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Europiane e shteteve të tyre anëtare FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare www.legjislacionishqiptar.gov.a neni 100
<https://www.dap.gov.al/publikime/dokumenta-strategjik/61-marreveshja-e-stabilizim-asociimit>

³⁶The Right to Equality and Non-discrimination

<https://www.humanrights.is/en/human-rights-education-project/human-rights-concepts-ideas-and-fora/substantive-human-rights/the-right-to-equality-and-non-discrimination> , aksesuar më 22.11.2023

Parimi i barazisë dhe i mosdiskriminimit

1. Organi publik ushtron veprimtarinë e tij në përputhje me parimin e barazisë.

2. Palët, që janë në situata të njëjta objektive, trajtohen në të njëjtën mënyrë. Në raste të veçanta, kur bëhet një trajtim i diferencuar, ky trajtim duhet të justifikohet vetëm nga karakteristikat objektive, që lidhen me rastin e veçantë.

3. Organi publik, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij, shmang çdo diskriminim për shkak të gjinisë, racës, ngjyrës, etnisë, shtetësisë, gjuhës, identitetit gjinor, orientimit seksual, bindjeve politike, fetare ose filozofike, gjendjes ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzënisë, përkatësisë prindërore, përgjegjësisë prindërore, moshës, gjendjes familjare ose martesore, gjendjes civile, vendbanimit, gjendjes shëndetësore, predispozicioneve gjenetike, aftësisë së kufizuar, përkatësisë në një grup të veçantë ose për çdo shkak tjetër.³⁷ Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë e parashikon si vepër penale shkeljen e barazisë së shtetasve gjatë ushtrimit të funksioneve shtetërore, pikërisht në nenin 253:³⁸

Shkelja e barazisë së shtetasve

Kryerja për shkak të detyrës e në ushtrim të saj, nga ana e punonjësit me funksion shtetëror apo në shërbim publik, të dallimeve mbi bazë *origjine, orientimi seksual ose identiteti gjinor, gjendjes shëndetësore, bindjeve fetare, politike, të veprimtarisë sindikale ose për shkak të përkatësisë në një etni, komb, race. apo fe të caktuar*, që konsiston në krijimin e privilegjeve të padrejta, ose në refuzimin e një të drejte, ose përfitimi që buron nga ligji, dënohet me gjobë ose me burgim deri në pesë vjet.³⁹

³⁷ Ligj-2015-04-30-44, Kodi i Procedurave Administrative, neni 17

<https://qbz.gov.al/preview/de7df9ee-7c2e-440a-9f46-1929531dc7d1>

³⁸ Kodi Penal I Republikës së Shqipërisë neni 253

Interpretime të Gjykatës Kushtetuese për parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit

Vendim nr. 48 datë 15.11.2013 (V-48/13 i Gjykatës Kushtetuese)

Gjykata, nëpërmjet jurisprudencës së saj, në disa vendime ka interpretuar nenin 18 të Kushtetutës, si dhe ka theksuar se parimi i barazisë synon që të gjithë të jenë të barabartë në/përpara ligjit, jo vetëm në të drejtat themelore të parashikuara në Kushtetutë, por edhe në të drejtat e tjera ligjore.⁴⁰ Konkretisht, ajo është shprehur se: *“Barazia në ligj dhe para ligjit nuk do të thotë që të ketë zgjidhje të njëllajta për individë ose kategori personash, që janë në kushte objektivisht të ndryshme. Barazia para ligjit dhe në ligj presupozon barazinë e individëve, që janë në kushte të barabarta”*, si dhe *“Vetëm në raste përjashtimore dhe për shkaqe të arsyeshme e objektive mund të përliqet trajtimi i ndryshëm i kategorive të caktuara, që përfitojnë nga kjo e drejtë”*, (shih vendimet nr.34, datë 20.12.2005; nr.39, datë 16.10.2007; nr.4, datë 12.02.2010, të Gjykatës Kushtetuese).⁴¹ Gjykata rikonsideron se organi ligjvënës është i detyruar t’i përmbahet këtij parimi kur bëhet fjalë për *“barazinë në ligj”*. Në lidhje me mosdiskriminimin, ajo ka përcaktuar disa standarde, me anë të të cilave ka synuar të vlerësojë nëse një ligj është diskriminues në termat e nenit 18 të Kushtetutës. Kështu, Gjykata shqyrton nëse ligji ka përcaktuar trajtim të diferencuar të subjekteve dhe në rast se po, a ka qenë diferencimi i përligjur, dhe për një arsye objektive. Kjo përligjje vlerësohet e lidhur me qëllimet dhe efektet e masave të marra. Gjithashtu, nuk mjafton vetëm diferencimi i përligjur, por edhe që mjeti i përzgjedhur për arritjen e qëllimit të ligjvënësit të jetë i arsyeshëm dhe i përshtatshëm. Nga ana tjetër, parimi i barazisë nuk e ndalon trajtimin e diferencuar, prandaj Gjykata, në rast

⁴⁰ Vendim nr. 48 datë 15.11.2013 (V-48/13 i Gjykatës Kushtetuese, <https://www.kmd.al/wp-content/uploads/2021/04/Vendim-i-Gjykatës-Kushtetuese-48-2013..pdf>

⁴¹ Vendim nr. 48 datë 15.11.2013 (V-48/13 i Gjykatës Kushtetuese, <https://www.kmd.al/wp-content/uploads/2021/04/Vendim-i-Gjykatës-Kushtetuese-48-2013..pdf>., aksesuar më 22.11.2023

trajtimi të njëjtë të subjekteve, shqyrton nëse ligji duhet të kishte pasur diferencim mbi një arsye legjitime dhe objektive pasi ato (subjektet) paraqiten me specifika faktike të ndryshme.

Gjykata konstaton se Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi e konkretizon nenin 18 të Kushtetutës, pra respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me *gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë*, ose me çdo shkak tjetër. Po sipas këtij ligji, parimi i barazisë nënkupton:

- a) barazi përpara ligjit dhe mbrojtje të barabartë nga ligji;
- b) barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat, për të gëzuar liritë dhe për të marrë pjesë në jetën publike;
- c) mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje, që nxit diskriminimin.⁴²

Një përkufizim i dobishëm i mosdiskriminimit përmbahet në Nenin 1(1) të ILO 111, i cili parashikon se diskriminimi përfshin: “*Çdo dallim, përjashtim ose preferencë e bërë në bazë të racës, ngjyrës, seksit, fesë, opinionit politik, origjinës kombëtare ose origjinën sociale, e cila ka efektin e anulimit ose dëmtimit të barazisë së mundësive ose trajtimit në punësim ose profesion*”⁴³. [?].» Kështu, e drejta për trajtim të barabartë kërkon që të gjithë personat të trajtohen në mënyrë të barabartë para ligjit, pa diskriminim. Parimi i barazisë dhe mosdiskriminimit

⁴² Po aty⁴² Vendim nr. 48 datë 15.11.2013 (V-48/13 i Gjykatës Kushtetuese, <https://www.kmd.al/wp-content/uploads/2021/04/Vendim-i-Gjykatës-Kushtetuese-48-2013..pdf>., aksesuar më 22.11.2023

⁴³ ⁴³⁴³ The Right to Equality and Non-discrimination, <https://www.humanrights.is/en/human-rights-education-project/human-rights-concepts-ideas-and-fora/substantive-human-rights/the-right-to-equality-and-non-discrimination>, aksesuar më 22.11.2023

garanton që personat në rrethana të barabarta trajtohen në mënyrë të barabartë në ligj dhe praktikë. Megjithatë, është e rëndësishme të theksohet se jo çdo dallim në trajtim do të çojë në diskriminim. Në të drejtën e përgjithshme ndërkombëtare, shkelja e parimit të mosdiskriminimit lind nëse:

- a) rastet e barabarta trajtohen në mënyrë të ndryshme;
- b) një ndryshim në trajtim nuk ka një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm;
- c) nëse nuk ka proporcionalitet ndërmjet qëllimit të kërkuar dhe mjeteve të përdorura.

Këto kërkesa janë përcaktuar shprehimisht nga organet ndërkombëtare mbikëqyrëse të të drejtave të njeriut, duke përfshirë Gjykatën Evropiane (shih, p.sh.: Marckx kundër Belgjikës), Gjykatën Ndëramerikane (shih, p.sh.: Opinion Këshillimor Nr. 4, para. 57) dhe Komiteti i të Drejtave të Njeriut (shih, p. sh.: Komenti i Përgjithshëm 18, para.13 dhe Jacobs kundër Belgjikës). Parimi i barazisë në rrethana të caktuara mund të kërkojë që shteti të ndërmarrë veprime afirmative në mënyrë që të zvogëlojë ose eliminojë kushtet, që shkaktojnë ose ndihmojnë në vazhdimësinë e diskriminimit. Komiteti për të Drejtat e Njeriut e ka shprehur qartë këtë detyrim në Komentin e Përgjithshëm dhe Komiteti për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore shpesh i referohet detyrës për të ndërmarrë veprime afirmative në vëzhgimet e tij përfundimtare.⁴⁴

Kuadri ligjor për mbrojtjen kundër diskriminimit

“Kuadri ligjor për mbrojtjen kundër diskriminimit” paraqet një pasqyrë të plotë të kuadrit ligjor, që zbaton parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit. Nëpërmjet një qasjeje pothuajse shteruese, ky seksion sjell në vëmendje tërësinë e atyre ligjeve, objekti dhe qëllimi i

⁴⁴⁴⁴ The Right to Equality and Non-discrimination,
<https://www.humanrights.is/en/human-rights-education-project/human-rights-concepts-ideas-and-fora/substantive-human-rights/the-right-to-equality-and-non-discrimination>, aksesuar më 22.11.2023

të cilave është i ndërlidhur me ato të ligjit “Për mbrojtjen nga Diskriminimi”⁴⁵. Niveli i ndërlidhjes, ndërveprimit dhe harmonizimi i ligjeve, që veprojnë në këtë fushë konfirmon nevojën jetike për një mbrojtje të gjerë dhe gjithëpërfshirëse të viktimave të diskriminimit. Legjislacioni është, përgjithësisht i përafëruar me Direktivën dhe ofron trajtime teorike që reflektojnë praktikën më të mira ndërkombëtare si në bazat ashtu edhe në format e mbrojtura për diskriminim. Prandaj, Kodi i Punës dhe Kodi i Procedurave Administrative janë të harmonizuara me LPD në aspektin e shpërndarjes të barrës së provës, ndërsa Kodi i Procedurës Civile ende ndjek një qasje të ndryshme, duke zhvendosur barrën e provat për paditësin, duke krijuar në këtë mënyrë probleme në praktikë aplikimi nga gjykatat. Ligjet e veçanta procedurale dhe materiale sanksionojnë angazhimin për të garantuar dinjitetin njerëzor, si vlerë themelore për zhvillimin e shoqërive.⁴⁶ Shkelja e barazisë së qytetarëve dënohet me Kodin Penal (neni 253) nëse kryhet me një funksionar, që mban një funksion shtetëror ose shërbim publik të kryer për shkak të zotësisë së tij, gjatë ushtrimit të tij, kur diskriminimi është bazuar në origjinën, seksin, orientimin seksual ose identitetin gjinor, shëndetin, bindjet fetare ose politike, veprimtarinë sindikale ose për shkak të përkatësisë në një grup të caktuar etnik, komb, racë ose fe, që konsiston në krijimin e privilegjeve të padrejta, ose në refuzimin e një të drejte, a përfitimin që rrjedh nga ligji.⁴⁷

Çështjet themelore të barazisë rregullohen në fusha të tilla si punësimi, arsimi dhe shërbime të tilla, si: *kujdesi shëndetësor, sigurimet shoqërore, sociale strehimin* etj. Ligjet garantojnë barazi gjinore në jetën publike të barabartë, mbrojtjen dhe trajtimin e grave dhe burrave, mundësi të barabarta dhe mundësi për *ushtrimin e të drejtave të tyre, si dhe pjesëmarrjen e kontributin në avancimin e të gjitha fushave të jetës*

⁴⁵ THE PRINCIPLE OF EQUALITY AND NON-DISCRIMINATION, Analysis of Case Law 2013 - 2020 Tirana, March 2021, UNDP Austrian, pg.15,16

⁴⁶ Po aty

⁴⁷ THE PRINCIPLE OF EQUALITY AND NON-DISCRIMINATION Analysis of Case Law

2013 - 2020 Tirana, March 2021, UNDP Austrian, pg.15,16

sociale, mbrojtjen e të punësuarve dhe të vetëpunësuarve, familjarët dhe bashkëjetuesit, fëmijët, personat me aftësi të kufizuar, personat me aftësi të kufizuar në punë, të verbërit, paraplegjikët dhe tetraplegjikët, të miturit në konflikt me ligjin, të burgosurit dhe të paraburgosurit, azilkërkues të mitur, të pashoqëruar, minoritete kombëtare, sinjalizuesve. Disa ligje parashikojnë detyrime shtetërore në ndërmarrjen e veprimeve pozitive, të cilat njohin trajtimin e ndryshëm të kategorive të caktuara si e vetmja mënyrë për të barazuar pabarazitë.⁴⁸

KMD në ballafaqimi me gjykatat ndër vite, duke evidentuar si çështje kyçe në vijim: *-Bazat e diskriminimit duke theksuar interpretimet qasjet dhe tendencat e gjykatave*

Qëllimi është që të identifikohen bazat e mbrojtura për të cilat pretendohen, zakonisht sjelljet diskriminuese dhe pozitat e gjykatave në kontekstin e brendshëm ligjor si dhe në kuadrin e KEDNJ, Ligji i BE-së dhe jurisprudenca e GJEDNJ dhe GJED.⁴⁹

-Format e diskriminimit, duke theksuar kuptimin e drejtpërdrejtë, format indirekte ose të shumëfishta të diskriminimit dhe të tyre, aplikim në praktikë.

Qëllimi është, të identifikohet nëse gjykatat arrijnë të kapërcejnë vështirësitë e pranuar ndërkombëtarisht në lidhje me probabilitetin, veçanërisht të diskriminimit indirekt, i cili paraqet specifika për shkak të neutralitetit të dukshëm të normave apo situatave faktike që e shkaktojnë atë.

-Barra e provës, duke identifikuar se si koncepti i zhvendosjes së barrës së provës kuptohet dhe sa shpesh zbatohet në praktikën gjyqësore.⁵⁰

⁴⁸ THE PRINCIPLE OF EQUALITY AND NON-DISCRIMINATION Analysis of Case Law

2013 - 2020 Tirana, March 2021, UNDP Austrian, pg.15,16

⁴⁹ Komisioner për Mbrojtjen nga Diskriminimi

⁵⁰ Po aty

Qëllimi është, të identifikohet diferenca në vlerësimin e gjykatave, në lidhje me provueshmërinë e prezumimit të diskriminimit, duke pasur parasysh vështirësinë që ka ankuesi, që ka dëshmuar diskriminim.

-Caktimi i kompensimit/ dëmshpërblimit, duke identifikuar kriteret mbi të cilat bazohet gjykata në vlerësimin e shumës së kompensimit, baza ligjore mbi të cilën pretendohet për pronë dhe bazohet dëmi jopasuror organi i cili është i detyruar për të kompensuar etj.

Qëllimi është të përcaktohet nëse dëmshpërblimi vlerësohet në bazë të pranisë së një shtese dëmi kontraktual, ose një dëm që kufizohet në dispozitat të Kodit të Punës, ose çdo qasje tjetër të kombinuar. Qëllimi i ligjit kundër diskriminimit është t'u mundësojë të gjithë individëve një shans të barabartë dhe të drejtë për të pasur akses në mundësitë e disponueshme në një shoqëri.⁵¹ Kjo do të thotë që individët ose grupet e individëve, që janë në situata të krahasueshme nuk duhet të trajtohen në mënyrë më pak të favorshme, thjesht për shkak të një karakteristike të veçantë, si: *gjinia, origjina racore ose etnike, feja ose besimi, paaftësia, mosha ose orientimi seksual*. Traktati për Funksimin e Bashkimit Evropian (TFEU) ndalon diskriminimin në bazë të kombësisë.⁵² Ai, gjithashtu, i mundëson Këshillit të Bashkimit Evropian të ndërmarrë veprimet e duhura për të luftuar *diskriminimin në bazë të seksit, origjinës racore ose etnike, fesë ose besimit, paaftësisë, moshës ose orientimit seksual*. Në këtë çështje, Këshilli duhet të veprojë njëzëri dhe pasi të ketë marrë pëlqimin e Parlamentit Evropian. Megjithatë, në fushën specifike të trajtimit të barabartë dhe mundësive të barabarta për burrat dhe gratë, zbatohet procedura e zakonshme legjislativë, e cila nuk kërkon unanimitet, por vetëm shumicë të cilësuar (neni 157 TFEU).

⁵¹ <https://eur-lex.europa.eu/EN/legal-content/glossary/non-discrimination-the-principle-of.html>, aksesur më 22.01.2023

⁵² ⁵² <https://eur-lex.europa.eu/EN/legal-content/glossary/non-discrimination-the-principle-of.html>, aksesur më 22.01.2023

Diskriminimi, në bazë të kombësisë ka qenë gjithmonë i ndaluar nga traktatet e Bashkimit Evropian (BE), ashtu si edhe diskriminimi në bazë të gjinisë në kontekstin e punësimit. Arsyet e tjera të diskriminimit u përmendën për herë të parë në vitin 1997, me nënshkrimin e Traktatit të Amsterdimit. Në vitin 2000, u miratuan dy direktiva: Direktiva Për Barazinë në Punësim (Direktiva 2000/78/EC), e cila ndalon diskriminimin në bazë të orientimit seksual, besimit fetar, moshës dhe paaftësisë në fushën e punësimit;⁵³ Direktiva e Barazisë Racore (Direktiva 2000/43/KE), e cila ndalon diskriminimin në bazë të racës ose përkatësisë etnike, përsëri në fushën e punësimit, por edhe në fusha të tilla, si: *arsimi, mbrojtja sociale, duke përfshirë sigurimin social dhe kujdesin shëndetësor, avantazhet sociale, aksesin dhe furnizimin e mallrave e të shërbimeve, duke përfshirë strehimin*. Këto direktiva zbatohen për të gjithë shtetasit të BE-së dhe për personat pa shtetësi, por nuk mbulojnë dallimet e trajtimit, bazuar në statusin e tyre ligjor dhe në shtetësinë. Legjislacioni i BE-së, gjithashtu mbron njerëzit nga diskriminimi. Në vitin 2009, Traktati i Lisbonës prezantoi një klauzolë horizontale me synimin për të integruar luftën kundër diskriminimit në të gjitha politikat dhe masat e BE-së (neni 10 TFEU). Të gjithë personat kanë të drejtën e rekursit gjyqësor në rastet e diskriminimit të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, veçanërisht në rastet kur ndodhen në situata të krahasueshme, por që trajtohen ndryshe, pa një justifikim objektiv dhe legjitim. Viktimat e diskriminimit mund të kërkojnë gjithashtu, ndihmë nga *organet kombëtare të barazisë*, të cilat janë institucione publike të ngritura në të gjithë BE-në për të promovuar barazinë dhe për të trajtuar diskriminimin.⁵⁴ Baza për të arritur trajtim të barabartë dhe barazi thelbësore për fëmijët, është nevoja për të parë mundësinë e çdo fëmije për të gëzuar të drejtat dhe zhvillimin e tij plotësisht dhe pa disavantazhe në krahasim me fëmijët e tjerë. Kjo kërkon që fëmijët të mbrohen veçanërisht nga diskriminimi indirekt pasi

⁵³ <https://eur-lex.europa.eu/EN/legal-content/glossary/non-discrimination-the-principle-of.html>, aksesur më 22.01.2023

⁵⁴ <https://eur-lex.europa.eu/EN/legal-content/glossary/non-discrimination-the-principle-of.html>, aksesur më 22.01.2023

çdo fëmijë ka nevojat e tij specifike dhe unike, që duhet të merren parasysh.⁵⁵

⁵⁵ <https://www.humanium.org/en/the-principle-of-non-discrimination/>

KREU II

DISKRIMINIMI

2.1 Historiku i lindjes së diskriminimit në shoqëri

Diskriminimi ka ekzistuar qysh herët në historinë e njerëzimit. Sa i vjetër është si fenomen, po aq i larmishëm është në shumëllojshmërinë e shfaqjes së tij. Sigurisht, ato që e ngritën dukshëm këtë fenomen si një problem në shumë plane të politikave sociale, qenë lëvizjet e shekullit XX. Pas mbarimit të Luftës së Dytë Botërore, nën dritën e zhvillimit të përgjithshëm shoqëror, u vu re se diskriminimi ishte një ndër shkaqet kryesore, si pasojë e të cilit individët nuk gëzonin dot plotësisht të drejtat dhe liritë e tyre themelore. Kur dëgjojmë fjalën “diskriminim”, shpeshherë bëjmë lidhjen me trajtim jo të barabartë në familje e shoqëri të grave dhe vajzave, të të miturve dhe të moshuarve, trajtim jo të pëlqyeshëm që u bëhet komuniteteve, si atij rom, egjiptian, LGBT2, në raport me persona të tjerë.⁵⁶ Konkretisht, si në Shqipëri, ashtu si edhe kudo në botë, ka shumë individë e grupe individësh, që diskriminohen për arsye të shumëllojshme. Klima sociale, politike dhe akademike ndikon në rritjen apo në uljen e tendencave për shfaqjen e sjelljeve diskriminuese në një shoqëri të caktuar si dhe në mungesën e kohezionit social dhe të kujdesit për të gjitha grupet apo shtresat e një shoqërie të caktuar, cilado qoftë.⁵⁷

^{56 56} A. Kasaj Llano, “*Shteti i së Drejtës në Shqipëri*”, Hamilton, Kanada, mars 2023, f.50

⁵⁷ A. Kasaj Llano, “*Shteti i së Drejtës në Shqipëri*”, Hamilton, Kanada, mars 2023, f.50

2.2 Kuptimi dhe Llojet e diskriminimit

“Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën a bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themeloretë njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi.⁵⁸ Diskriminim i drejtpërdrejtë” është ajo formë diskriminimi, që ndodh kur një person ose grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, ose një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji.⁵⁹

“Diskriminim ndërsektorial”, është ajo formë diskriminimi në të cilën disa shkaqe veprojnë dhe bashkëveprojnë me njëra-tjetrën në të njëjtën kohë, në mënyrë të tillë që ato të jenë të pandashme dhe të prodhojnë forma të veçanta të diskriminimit.

“Diskriminim për shkak të shoqërimit”, është ajo formë diskriminimi, që ndodh kur ka një dallim, kufizim ose preferencë për arsye të shoqërimit me persona, që u përkasin grupeve të përmendura në nenin 1 të këtij ligji, si dhe për shkak të supozimit për një shoqërim të tillë.

“Diskriminim i shumëfishtë”, është ajo formë diskriminimi, që ndodh kur një person ose grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër ose një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në dy ose më shumë shkaqe, që veprojnë veçmas.

^{58 58} Ligj Nr. 10 221, datë 04.02.2010, Për mbrojtjen nga diskriminimi (Ndryshuar me Ligjin Nr. 124/2020), (I përditësuar), <https://www.kmd.al/wp-content/uploads/2021/05/2.pdf>, aksesuar më 31.1.2024

⁵⁹ Ligj Nr. 10 221, datë 04.02.2010, Për mbrojtjen nga diskriminimi (Ndryshuar me Ligjin Nr. 124/2020), (I përditësuar), <https://www.kmd.al/wp-content/uploads/2021/05/2.pdf>, aksesuar më 31.1.2024

“Diskriminim strukturor”, është ajo formë diskriminimi, që u referohet rregullave, normave, praktikave, modeleve të qëndrimeve dhe sjelljeve në institucione dhe në struktura të tjera shoqërore, që në mënyrë të vetëdijshme ose të pavetëdijshme paraqesin pengesa për grupet ose individët për të pasur të njëjta të drejta dhe mundësi si të tjerët dhe që kontribuojnë në rezultate më pak të favorshme për ta në raport me të tjerët.

“Diskriminim i tërthortë”, është ajo formë diskriminimi, që ndodh kur një dispozitë, kriter ose praktikë, e paanshme në dukje, do ta vinte një person ose grup personash në kushte më pak të favorshme për shkaqet e parashtruara në nenin 1 të këtij ligji, në raport me një tjetër person ose grup personash, kur ajo dispozitë, kriter a praktikë nuk justifikohet objektivisht nga një synim i ligjshëm ose, kur mjetet e arritjes së këtij synimi nuk janë të përshtatshme, ose nuk janë të domosdoshme dhe në përpjesëtim të drejtë me gjendjen që e ka shkaktuar atë.⁶⁰

2.3 Barazia gjinore dhe mosdiskriminimi në media

Media ndihmon në rritjen e vetëdijes së përgjithshme për barazinë e femrave dhe të meshkujve:

- a) përmes raportimit jodiskriminues mbi baza gjinore;
- b) përmes përdorimit të terminologjisë neutrale në aspektin gjinor;
- c) përmes shmangies së stereotipave gjinorë në veprimtarinë e vet.

2. Ndalohet transmetimi, botimi dhe publikimi i materialeve dhe i informacioneve, që përmbajnë apo nënkuptojnë dallime poshtëruese apo fyese, përjashtime apo kufizime të njëjës prej gjinive, në bazë të diskriminimit për shkak të gjinisë.⁶¹

⁶⁰ ⁶⁰ Ligj Nr. 10 221, datë 04.02.2010, Për Mbrojtjen nga Diskriminimi, (Ndryshuar me Ligjin Nr. 124/2020), (I përditësuar) <https://www.kmd.al/wp-content/uploads/2021/05/2.pdf>, aksesuar më 31.1.2024

⁶¹ Ligj Nr.9970, datë 24.7.2008 Për barazinë gjinore në Shqipëri

2.4 Shkaqet e diskriminimit

*Me fjalë të tjera, diskriminimi është trajtim i pabarabartë i të barabartëve dhe trajtim i barabartë i pabarazive.*⁶² **Disa nga shkaqet e diskriminimit po I paraqes si me poshtë:**

1. Bindja politike, shpesh është arsye për trajtim diskriminues dhe përfshin qoftë mbajtjen apo mosmbajtjen e saj, si edhe shprehjen e pikëpamjeve ose anëtarësinë në organizata politike, parti politike.

Shembull: “Diskriminimi për shkak të bindjeve politike”, është rasti kur një person largohet nga puna për shkaqe, që nuk lidhen me aftësitë dhe sjelljen e tij apo me kërkesat operacionale të ndërmarrjes, kur një person nuk punësohet edhe pse është më i kualifikuar se kandidatët e tjerë, kur një punonjësi i mohohet e drejta për të avancuar në karrierë, për shkak të anëtarësisë në një parti politike, shprehjes së bindjeve politike, në mënyrë individuale ose kolektive, pa qenë e nevojshme që të jetë anëtar i partisë politike.

2. “Diskriminimi për shkak të aftësisë së kufizuar”, mund të ndodhë ndaj një personi, që është me aftësi të kufizuara (fizike, mendore, intelektuale, ndijore) ose ka qenë me aftësi të kufizuara në të shkuarën, që ka predispozicion për të qenë me aftësi të kufizuara në të ardhmen, ose që prezumohet se është me aftësi të kufizuara⁶³.

Shembull: Diskriminimi për këtë shkak ndodh në rastin kur një fëmijë me aftësi të kufizuara, nuk pranohet në çerdhe, kopësht ose shkollë, ose nuk i sigurohet mësuesi ndihmës, pra nuk sigurohet arsimi gjithëpërfshirës, kur mohohet përshtatja e arsyeshme (një punonjëse largohet nga puna për shkak se i kërkoi punëdhënësit fleksibilitet në orare për shkak se duhet të kujdesej për fëmijën e saj me aftësi të kufizuar, kur mungesa e një rampe i mohon të drejtën një personi në karrige me rrota që të marrë shërbimin në një qendër shëndetësore); nuk ofrohet informacion në gjuhën e shenjave për personat me vështirësi në

⁶² Komisioneri Për Mbrojtjen nga Diskriminimi, shkaqet e diskriminimit, <https://www.kmd.al/shkaqet-e-diskriminimit/>, aksesuar më 17.11.2023

⁶³ Komisioneri Për Mbrojtjen nga Diskriminimi, shkaqet e diskriminimit, <https://www.kmd.al/shkaqet-e-diskriminimit/>, aksesuar më 17.11.2023

dëgjim, ose që nuk dëgjojnë, në gjuhën *Brail*, ose në formate të përshtatura apo audio për personat me vështirësi shikimi a plotësisht të verbër, formate të përshtatura/të thjeshtëzuara për personat me aftësi të kufizuar të shëndetit mendor dhe të intelektit/zhvillimit.⁶⁴

3. “Diskriminim për shkak të gjendjes shëndetësore”, është trajtimi ndryshe që i bëhet një personi dhe ky trajtim lidhet me gjendjen e tij shëndetësore.

Shembull: Diskriminimi për këtë shkak ndodh në rastin kur një personi i refuzohet të ndjekë arsimin për faktin se është bartës i një sëmundjeje, ose kur një person largohet nga puna pasi, për shkak të gjendjes së tij shëndetësore është i detyruar që mungojë në punë, (mbështetur në raportet e lëshuara nga mjekët) apo, kur nuk i ofrohen në kohë dhe në mënyrë efikase barnat e rimbursueshme nga shteti.⁶⁵

4. “Bindja fetare”, mbulon shprehjen e besimit fetar ose besimin e zgjedhur nga individ, përfshirë edhe mosshprehjen e besimit, të cilat mund të manifestohen privatisht, ose publikisht *në vende kulti, rite dhe mësimet fetare.*

Shembull: Diskriminimi për shkak të bindjeve fetare, është rasti kur shkolla nuk lejon që një vajzë që mban shami, të ndjekë arsimin me justifikimin se arsimi është laik, kur një mjek refuzon të punojë me një infermiere dhe nuk pranon që të punojnë së bashku, për shkak se ajo është praktikante e një feje të caktuar.

5. “Vendbanimi”, presupozon se ushtrimi i të drejtave nuk mund të kushtëzohet ose të varet nga vendbanimi i tanishëm, ose i mëparshëm i një individ. Kështu, një individ nuk mund të diskriminohet për shkak se jeton ose është regjistruar në një zonë urbane apo rurale, në një vendbanim formal ose jo, apo nëse ka një stil jetese si nomad a sedentar. Diferencat ndërmjet rajoneve duhet të eliminohen në praktikë,

⁶⁴ Komisioneri Për Mbrojtjen nga Diskriminimi, shkaqet e diskriminimit, <https://www.kmd.al/shkaqet-e-diskriminimit/>, aksesuar më 17.11.2023

⁶⁵ Komisioneri Për Mbrojtjen nga Diskriminimi, shkaqet e diskriminimit, <https://www.kmd.al/shkaqet-e-diskriminimit/>, aksesuar më 17.11.2023

duke siguruar një dysHEME standardesh të një shpërndarjeje të barabartë për të gjitha shërbimet publike.⁶⁶

Shembull: Diskriminim për shkak të vendbanimit, është rasti kur fëmijëve, që mësojnë në një shkollë, e cila ndodhet në një zonë të thellë rurale, iu ofrohet arsim i një standardi inferior si për sa u përket kushteve fizike të shkollës, ashtu edhe cilësisë së mësimdhënies, ose kur një personi apo grupi personash, për shkak të zonës në të cilën banojnë, nuk u ofrohen shërbimet publike të ujit të pijshëm nga ana e autoriteteve vendore.

6. “Diskriminimi për shkak të gjinisë”, është një nga shkaqet e diskriminimit më të përhapur në shoqëri dhe lidhet kryesisht, me trajtimin ndryshe të një individi apo grupi individësh vetëm për faktin se i përkasin një gjinie të caktuar. Edhe pse diskriminimi gjinor i referohet të dy gjinive, femër dhe mashkull, në të vërtetë, në pjesën më të madhe të rasteve, diskriminimi gjinor prek gruan në të gjitha fushat e jetës. Në këtë kontekst, shkak i gjinisë lidhet edhe me shkakun e diskriminimit prej *shtatëzanisë*.⁶⁷ “Një shoqëri e cila vlerëson barazinë gjinore si kusht të domosdoshëm drejt zhvillimit të qendrueshëm social, ekonomik e politik të vendit,⁶⁸ ku askush nuk mbetet pas, si dhe që mbështetet në parimin e tolerancës zero kundër praktikave të dëmshme, dhunës me bazë gjinore e dhunës në familje, duke ndëshkuar dhunuesit dhe, duke mbrojtur, rehabilituar e riintegruar personat e dhunuar”.⁶⁹

Raste praktike nga Gjykata Evropiane e Drejtësisë
Çështja C-450/93Eckhard Kalanke kundër Freie Hansestadt Bremen,
Referenca për një vendim parapraknga Bundesarbeitsgericht)
(Trajtim i barabartë për burrat dhe gratë - Direktiva 76/207/EEC, - Neni 2(4), - Promovim -

⁶⁶ Po aty

⁶⁷ Strategjinë Kombëtare të Barazisë Gjinore 2021-2030
<https://www.konsultimipublik.gov.al/>, aksesuar më 22.11.2023

⁶⁸ Strategjinë Kombëtare të Barazisë Gjinore 2021-2030
<https://www.konsultimipublik.gov.al/>, aksesuar më 22.11.2023

⁶⁹ Strategjinë Kombëtare të Barazisë Gjinore 2021-2030
<https://www.konsultimipublik.gov.al/>, aksesuar më 22.11.2023

Kandidatët e kualifikuar në mënyrë të barabartë të gjinive të ndryshme, -Prioritet i dhënë grave)⁷⁰ Opinioni i Avokatit të Përgjithshëm Tesaro, dorëzuar më 6 prill 1995, I - 3053

Aktgjykimi i Gjykatës, 17 tetor 1995, I - 3069

Përmbledhje e Aktgjykimit

Politika Sociale - Burrat dhe gratë punëtore, - Qasja në punësim dhe kushtet e punës - Trajtim i barabartë - Shmangiet - Masat për promovimin e mundësive të barabarta midis burrave dhe grave

Fushëveprimi - Dispozita kombëtare, e cila favorizon automatikisht gratë e kualifikuara në mënyrë të njëjlojtë, të cilat të konkurojnë me burrat për promovim, në rastet kur gratë janë pak të përfaqësuara - E palejueshme. (Direktiva e Këshillit 76/1207, Nen. 2(1) dhe (4))

Neni 2 (1) dhe (4) i Direktivës së Këshillit 76/207 mbi zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë për burrat dhe gratë përsa i përket qasjes në punësim, trajnimet profesionale dhe promovimin.

Kushtet e punës përjashtojnë rregullat kombëtare, ku kandidatëve të gjinive të ndryshme në listën e ngushtë për promovimin, që janë të kualifikuar në mënyrë të barabartë, automatikisht u japin përparësi grave në sektorë, ku këto të fundit janë të nënpërfaqësuara. Nënpërfaqësimi konsiderohet se ekziston kur gratë nuk përbëjnë së paku gjysmën e stafit në grupet përkatëse të personelit ose në nivelet e funksionit të parashikuara në organikë.

Neni 2 (4) i kësaj Direktive, i cili duhet të interpretohet në mënyrë strikte dhe që siguron se direktiva jepet pa paragjykim për masat, për promovimin e mundësive të barabarta për burrat dhe gratë në veçanti, duke hequr pabarazitë ekzistuese, të cilat ndikojnë në mundësitë e grave. Kjo Directive është në mënyrë specifike dhe projektohet ekskluzivisht për të lejuar masat, të cilat edhe pse me sa duket çojnë në diskriminim për shkak të gjinisë, në të vërtetë kanë për qëllim eliminimin ose reduktimin e rasteve aktuale të pabarazisë mes meshkujve dhe femrave,

⁷⁰ Çështja C-450/93 Eckhard Kalanke kundër Freie Hansestadt Bremen (Referenca për një vendim paraprak nga Bundesarbeitsgericht), <https://kmd.al/wp-content/uploads/2018/05/1524742443-PERMBLEDHJE-KALANKE-Shqip.pdf>, aksesuar më 23.11.2023

të cilat mund të ekzistojnë në realitetin e jetës shoqërore. Në këtë mënyrë, lejohen masa kombëtare në lidhje me qasjen në punësim, duke përfshirë promovimin, të cilat u japin një avantazh të veçantë grave me qëllim përmirësimin e aftësive të tyre për të konkurruar në tregun e punës dhe, për të ndjekur një karrierë në mënyrë të barabartë me burrat. Një rregull kombëtar, i cili u garanton grave pritoritet absolut dhe të pakushtëzuar për caktim ose promovim, nuk është masë e një lloji të tillë, duke qenë se shkon përtej promovimit të mundësive të barabarta për rezultatin, barazinë e përfaqësimit, i cili mund të arrihet vetëm duke e ofruar një barazi të tillë⁷¹

Shembull: Diskriminimi gjinor kundër një gruaje do të ndodhte në qoftë se ajo refuzohet për një punë sepse punëdhënësi mendon se mund të mbetet shtatzënë, ose përmes pagesës së një punonjësi mashkull, me një pagë më të lartë për të bërë të njëjtën punë. Diskriminimi gjinor ndaj një burri do të ndodhte, vetëm nëse femrat do të punësoheshin si punëtorë socialë, sepse ato ishin perceptuar të kishin më shumë ndjeshmëri, ose kur një punonjësi të gjinisë mashkull, i mohohet e drejta për të marrë lejen e lindjes, krahasimisht me punonjëset femra të së njëjtës kompani.⁷²

Shembull në lidhje me shtatzaninë: është rasti kur një punëmarrës, largohet nga puna gjatë lejes së lindjes ose nuk pranohet në një pozicion pune edhe pse plotëson të gjitha kriteret e punësimit, vetëm se punëdhënësi ka informacion se punëmarrësja është shtatzënë; ose mosmarrja në punë e një gruaje, sepse në të ardhmen ajo mund të jetë shtatzënë, bazuar në presupozimin se nuk do t'i përkushtohet punës aq kohë sa një burrë.⁷³

⁷¹Çështja C-450/93 Eckhard Kalanke kundër Freie Hansestadt Bremen (Referenca për një vendim paraprak nga Bundesarbeitsgericht), <https://kmd.al/wp-content/uploads/2018/05/1524742443-PERMBLEDHJE-KALANKE-Shqip.pdf>, aksesuar më 23.11.2023

⁷² Komisioneri Për mbrojtjen nga diskriminimi, shkaqet e diskriminimit, <https://www.kmd.al/shkaqet-e-diskriminimit/>, aksesuar më 17.11.2023

⁷³ ⁷³ Komisioneri Për mbrojtjen nga diskriminimi, shkaqet e diskriminimit, <https://www.kmd.al/shkaqet-e-diskriminimit/>, aksesuar më 17.11.2023

7. Nocioni “racë”, i ka rrënjët në idenë e klasifikimit biologjik të qenieve njerëzore në nënspecie sipas tipareve morfologjike, si ngjyra e lëkurës apo karakteristikat e fytyrës. Dokumentet ligjore të BE-së dhe ato ndërkombëtare përdorin nocionin e diskriminimit racor, ndërkohë që kundërshtojnë në mënyrë eksplicite nocionin e racave të veçanta njerëzore. Ndalimi i diskriminimit në bazë të origjinës racore ose etnike mund të mbulojë, gjithashtu diskriminimin bazuar në ngjyrën, prejardhjen ose origjinën kombëtare. Ky shkak lidhet shpesh edhe me shkakun tjetër të parashikuar që është ai i “ngjyrës”. Në Shqipëri, diskriminimi për shkak të racës është lidhur, kryesisht me komunitetet rome dhe egjiptiane.⁷⁴

Shembull: “Diskriminimi për shkak të racës”, ndodh në rastin kur një grup personash, në lagjen “X”, e cila banohet në shumicë nga anëtarë të komunitetit rom, nuk përfitojnë investime publike në sigurimin e ujit të pijshëm, kanalizime, ndriçim publik, etj., nga ana e autoriteteve vendore, krahasuar me pjesën tjetër të qytetit, për shkak të racës.

Shembull: Punonjësit e sigurisë të një diskoteke nuk i lejojnë klientët egjiptianë të hyjnë në lokal, me arsyetimin që nevojitet rezervim paraprak, ndërsa klientëve të tjerë të lokalit nuk u kërkohet rezervimi paraprak.

Shembull: Diskriminimi racial bëhet kur dikujt i refuzohet punësimi, marrja me qira e apartamenteve ose hyrja në një bar për shkak të ngjyrës së tij ose të saj.

8. Etnia është e lidhur me një popull a me një komb të caktuar, ose me grupe shoqërore të shenjuara nga kombësi apo shtetësi e përbashkët, lidhje fisnore, besim fetar, gjuhë e përbashkët, ose prejardhje kulturore dhe tradicionale⁷⁵. Për shkak të këtyre rrethanave personale, individë dhe grupe individësh mund të përballen me diskriminim si në sferën private, ashtu edhe atë publike, në ushtrimin e të drejtave të tyre.

⁷⁴ ⁷⁴ Komisioneri Për mbrojtjen nga diskriminimi, shkaqet e diskriminimit, <https://www.kmd.al/shkaqet-e-diskriminimit/> , aksesuar më 17.11.2023

⁷⁵ Komisioneri Për mbrojtjen nga diskriminimi, shkaqet e diskriminimit, <https://www.kmd.al/shkaqet-e-diskriminimit/> , aksesuar më 17.11.2023

Shembull: Diskriminimi për shkak të etnisë ndodh në rastin kur një person që i përket një minoriteti të caktuar në Shqipëri, nuk përzgjidhet për të ushtruar profesionin e mësueses për shkak të etnisë⁷⁶. Të drejtat e pakicave përkundër mbrojtjes nga diskriminimi në të drejtën dhe praktikën Ndërkombëtare⁷⁷ Në të drejtën dhe praktikën ndërkombëtare si dhe në literaturën akademike, flitet për mbrojtjen e pakicave, kjo themelohet në dy shtylla. Është e rëndësishme që praktikuesit të kenë parasysh dallimet mes këtyre dy shtyllave, që të mund të kuptohet në mënyrë të drejtë, e drejta ndërkombëtare dhe praktika. Për këtë arsye janë paraqitur shkurtimisht dallimet më poshtë.

Njëra shtyllë, është shtylla e mosdiskriminimit, e cila përfshin gëzimin e të drejtave të njeriut dhe të barazisë para ligjit pa diskriminim, si dhe aplikimi i masave afirmative dhe pozitive të veprimit për arritje të barazisë materiale. Tjetra, është shtylla e identitetit, e cila përmban të drejtat e identitetit të pakicave, të cilat kanë për qëllim t'u mundësojnë pakicave kushtet e nevojitura për ta kaluar, mirëmbajtur dhe zhvilluar kulturën e tyre dhe elementet esenciale të identitetit të tyre të etnisë. Kjo gjë është e identifikueshme p.sh.: nga mbiemri i aplikantes.⁷⁸

9. Gjuha: Diskriminimi për shkak të gjuhës ose dialekteve shpesh lidhet ngushtë me trajtimin e pabarabartë në bazë të origjinës kombëtare ose etnike.⁷⁹ Barrierat gjuhësore mund të pengojnë gëzimin e shumë të drejtave të njeriut, përfshirë të drejtën për pjesëmarrje në jetën kulturore apo të drejtën për proces të rregullt ligjor. Për këtë arsye, informacionet për shërbimet dhe të mirat publike duhet të jenë, për aq sa është e mundur, në gjuhët e folura nga pakicat. Shtetet duhet të

^{76 76} Komisioneri Për mbrojtjen nga diskriminimi, shkaqet e diskriminimit, <https://www.kmd.al/shkaqet-e-diskriminimit/> , aksesuar më 17.11.2023

⁷⁷ B. Kotevska, “*Udhëzues mbi bazat e diskriminimit*”, OSCE, Shkup, f.23, <https://www.osce.org/files/f/documents/4/2/117992.pdf>, aksesuar më 18.11.2023

⁷⁸ Po aty

^{79 79} Komisioneri Për mbrojtjen nga diskriminimi, shkaqet e diskriminimit, <https://www.kmd.al/shkaqet-e-diskriminimit/> , aksesuar më 17.11.2023

garantojnë që çdo kërkesë gjuhësore, që lidhet me punën dhe arsimin të jetë e bazuar në kritere të arsyeshme dhe objektive.⁸⁰

Shembull: Diskriminimi për shkak të gjuhës mund të ndodhë në rastin kur një personi nuk i caktohet një përkthyes në gjuhën që ai kupton në procedurat gjyqësore.

10. Identiteti gjinor lidhet me përvojën individuale e të brendshme të ndjerë të një personi në lidhje me gjininë, e cila mund të korrespondojë ose jo me gjininë e caktuar me lindjen e tij, duke përfshirë ndjenjën personale të trupit, (që mund të përfshijë, nëse zgjidhet lirisht, ndryshimin e pamjes ose funksionit trupor me anë të mjeteve mjekësore, kirurgjikale ose mjeteve të tjera), dhe shprehje të tjera të gjinisë, duke përfshirë veshjen, të folurën dhe sjelljen.

11. Orientimi seksual nënkupton një tërheqje të vazhdueshme, emocionale dhe seksuale, ndaj personave të një seksi të caktuar. Sipas orientimit seksual, ekzistojnë persona, të cilët i tërheq seksi i kundërt (persona heteroseksuale), persona, të cilët i tërheq seksi i njëjtë (persona homoseksuale), si dhe personat të cilët i tërheqin të dy seksat (persona biseksuale). Krahas këtyre orientimeve, ekzistojnë edhe persona transeksuale, interseksuale dhe aseksuale. Për të gjithë këta persona përdoret shkurtesa e pranuar ndërkombëtarisht LGBTIQ.

Shembull: Diskriminimi për shkak të orientimit seksual lidhet me rastin kur dikush punon në një kompani normalisht, por kur për një arsye merret vesh që është homoseksual hiqet nga puna ose kryhen veprime nga ana e punëdhënësit në mënyrë që të krijojë një ambjent shqetësues, të pasigurtë apo armiqësor, që detyrojnë personin të largohet nga puna.⁸¹

Në *Identoba v. Gjeorgjia* (2015), trembëdhjetë aplikantë individualë pretenduan se autoritetet kishin dështuar t'i mbrojnë ata nga sulmet e dhunshme në kontekstin e një demonstrate paqësore në Tbilisi në maj, 2012 për të shënuar Ditën ndërkombëtare kundër homofobisë

⁸⁰ Komisioneri Për Mbrojtjen nga Diskriminimi, shkaqet e diskriminimit, <https://www.kmd.al/shkaqet-e-diskriminimit/>, aksesuar më 17.11.2023

⁸¹ Po aty

(IDAHO).⁸² Autoritetet u raportuan, gjithashtu se nuk kishin arritur të hetonin në mënyrë efektive incidentin dhe motivin e tij të mundshëm diskriminues. Duke konkluduar se kishte një shkelje të nenit 3, të lexuar në lidhje me nenin 14, Gjykata iu referua qëndrimeve të përhapura negative kundër anëtarëve të komunitetit LGBTI në disa pjesë të shoqërisë gjeorgjiane siç detajohet në raporte të ndryshme, veçanërisht nga Komisioneri i KIE, për Të drejtat e Njeriut. Ai iu referua edhe paralajmërimeve të bëra nga organizatorët e marshimit në polici për mundësinë e konflikteve. Për më tepër, Gjykata vuri në dukje se autoritetet gjeorgjiane nuk arritën të hetojnë motivin homofobik të sulmit, pavarësisht nga legjislacioni i saj kombëtar, që parashikon se diskriminimi në bazë të orientimit seksual dhe identitetit gjinor duhet të trajtohet si një rrethanë rënduese. Dështimi i autoriteteve për të kryer një hetim në kohë dhe objektiv për sulmet ndaj komunitetit LGBT, në rastin e Identoba u referua përsëri në një rast kur demonstruesit LGBTI, që morën pjesë në demonstratën e IDAHO vitin e ardhshëm, u sulmuan nga një turmë (shih Grupi Mbështetës i Iniciativave të Grave dhe të tjerët v. Gjeorgjia (2021)

Gjykata konkludoi për shkeljen e nenit 3 në lidhje me nenin 14 si dhe shkeljen e nenit 11 për mosmarrjen e masave për të mbrojtur demonstruesit LGBT nga turma, që brohoriste fyerje homofobike dhe kërcënime fizike, pavarësisht se ishte e vetëdijshme për rreziqet, që lidheshin me eventin.⁸³ Më tej, Gjykata shpjegoi se nuk mund të përjashtonte mundësinë që shkalla e paprecedentë e dhunës, të ishte ndikuar nga dështimi i autoriteteve për të kryer një hetim në kohë dhe

⁸² RAPORTI KOMBËTAR, KRIMET E URREJTJES DHE INCIDENTE TË TJERA ME MOTIVIM TË URREJTJES KUNDËR PERSONAVE LGBTI NË SHQIPËRI Analiza tematike të zbatimit të Rekomandimit CM/Rec (2010)5 të Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare të Këshillit të Evropës mbi masat për të luftuar diskriminimin në bazë të orientimit seksual ose identitetit gjinor, MARS 2023

⁸³ Po aty

objektiv mbi sulmet ndaj komunitetit LGBTI gjatë ngjarjes së vitit të kaluar, që ishte objekt i gjykimit të saj në Identoba v. Gjeorgjia.⁸⁴

12. Gjendja ekonomike si shkak i ndaluar diskriminimi, është një koncept i gjerë, por kryesisht, lidhet me individë, grupe individësh apo grupe shoqërorë, të cilët janë në pamundësi ekonomike për të përballuar një jetesë dinjitoze dhe kjo pamundësi reflekton në shumë fusha të jetës, në pamundësi shoqërore, arsimore, intelektuale, materiale, kulturore deri dhe ekzistenciale.

Shembull: Diskriminim për shkak të gjendjes ekonomike, është rasti kur një student edhe pse ka aftësi shumë të mira për të studiuar, nuk ka mundësi ekonomike për të përballuar kostot e studimit, nuk i ofrohen mjetet e duhura nga shteti për të vazhduar normalisht arsimin e tij.

13. Gjendja arsimore si shkak diskriminimi, nënkupton nivelin individual të arsimimit, arritjet në arsim, aftësitë, certifikatat dhe mundësitë në lidhje me arsimin, të cilat një person posedon.⁸⁵

Shembull: Diskriminimi për shkak të gjendjes arsimore, mund të paraqitet si vendosje e kriterëve për nivelin e arsimit, për të aplikuar për një vend të caktuar pune, i cili nuk është i arsyeshëm dhe i arsyetuar (për shembull, kërkimi i arsimimit të lartë për vendin e punës sanitar); ose rasti kur një person ka mbaruar arsimin e lartë 4-vjeçar dhe nuk pranohet të aplikojë, ose s’kualifikohet pasi shpallja parashikon arsimin 3+2; po ashtu, kur vendoset kriter punësimi, arsimi i mbaruar në një universitet të caktuar, pa ndonjë arsye objektive, duke përjashtuar aplikantë, që janë arsimuar në universitete tjera.⁸⁶

⁸⁴ RAPORTI KOMBËTAR, KRIMET E URREJTJES DHE INCIDENTE TË TJERA ME MOTIVIM TË URREJTJES KUNDËR PERSONAVE LGBTI NË SHQIPËRI, Analiza tematike të zbatimit të Rekomandimit CM/Rec, (2010)5 të Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare të Këshillit të Evropës mbi masat për të luftuar diskriminimin në bazë të orientimit seksual ose identitetit gjinor, mars, 2023

⁸⁵ Komisioneri për mbrojtjen nga diskriminimi, shkaqet e diskriminimit, <https://www.kmd.al/shkaqet-e-diskriminimit/>, aksesuar më. 17.11.2023

⁸⁶ Komisioneri për mbrojtjen nga diskriminimi, shkaqet e diskriminimit, <https://www.kmd.al/shkaqet-e-diskriminimit/>, aksesuar më 17.11.2023

14. Gjendja shoqërore është baza për mbrojtje, e cila lidhet me origjinën e personit, lidhshmërinë e tij me ndonjë profesion të caktuar, me statusin e tanishëm ose të mëparshëm të një të burgosuri, emigranti, të një të sëmuri në institucion psikiatrik etj. Gjendja shoqërore i referohet dhe ndonjë tipari personal i cili ka, ose supozohet se ka statusin në shoqëri që mund t'i përkasë një grupi të caktuar shoqëror. Ky kriter mbron personat, që janë të pafavorizuar për shkak të pozitës së tyre socioekonomike në shoqëri.⁸⁷

Shembull: Një person, i cili më parë ka qenë i dënuar, edhe krahas posedimit të kualifikimeve të përshtatshme dhe lejes së punës, nuk punësohet vetëm për shkak të statusit të tij të mëhershëm si ish i dënuar, paçka se ligji nuk e pengon dhe pa arsyetim për këtë; një trajtim të ndryshëm gjatë qasjes në mallra dhe shërbime, varësisht nga pamja fizike ose veshja, përmes të cilave një person lidhet me një status të caktuar shoqëror.

15. Moshë i referohet përjashtimit për arsyen e të qenit në një moshë të caktuar ose brenda një grupi moshe, ose të qenit i ri apo i moshuar.

Shembull: Diskriminimi për shkak të moshës, është rasti kur një person i moshës 35 vjeç, nuk lejohet të konkurojë dhe s'kualifikohet, për shkak se publikimi për vendin e punës kërkon që aplikanti të ketë moshën deri në 30 vjeç, pa ndonjë arsye objektive.

Shembull: Një punëdhënës kërkon nga një agjenci të zgjedhë vetëm aplikantët nën 30 vjeç për një punë; një bankë refuzon të japë një kartë krediti për njerëzit mbi 70 vjeç; një pronar refuzon të japë me qira banesën e tij për njerëzit nën 30 vjeç; një punonjësi i refuzohet trajnimi sepse është shumë afër pensionit.⁸⁸

16. Gjendja familjare ose martesore ka të bëjë me marrëdhëniet martesore, farefisnore ose prindërore, të cilat një person i ka me persona tjerë. Gjendja familjare ose martesore mund të ndryshojë

⁸⁷ Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, shkaqet e diskriminimit, <https://www.kmd.al/shkaqet-e-diskriminimit/>, aksesuar më 17.11.202

⁸⁸ Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, shkaqet e diskriminimit, <https://www.kmd.al/shkaqet-e-diskriminimit/>, aksesuar më 17.11.2023

ndërmjet individëve, pasi ata mund të jenë të martuar ose jo, në një marrëdhënie de facto ose në një marrëdhënie, që nuk e njeh ligji, të divorcuar ose të ve, jetojnë në një familje të zgjeruar, ose kanë përgjegjësi të ndryshme për fëmijët dhe personat e varur, ose një numër të caktuar fëmijësh.⁸⁹Në këtë kuptim, konsiderohet edhe shkaku i lidhur me *gjendjen civile*.

Shembull: Një organizatë siguron banesa për punonjësit e saj të martuar, por jo për të tjerët ose, kur një punëdhënës bën dallimin midis grave, që adoptojnë mbiemrat e burrave të tyre dhe grave, që nuk e bëjnë këtë; ose, kur një punëmarrëse largohet nga puna për shkak se është kryefamiljare dhe nënë e shumë fëmijëve.

17. Përkatësia prindërore nënvizon faktin se diskriminimi mund të ndodhë kundrejt një personi, duke e identifikuar atë me prindërit e tij/saj apo me statusin e prindërve të tij. Për këtë arsye, dikush diskriminohet jo për një shkak të mbartur nga ai vetë, por për një shkak që identifikohet me përkatësinë e tij prindërore. Këtu përfshihet edhe prejardhja, veçanërisht lidhur me përkatësinë në një shtresë sociale apo çdo lloj statusi të trashëguar.⁹⁰

Shembull: Diskriminim për shkak të përkatësisë prindërore, është rasti kur një person nuk lejohet të kandidojë për një funksion publik pasi babai i tij/saj ka qenë kriminel lufte.

18. Përgjegjësia prindërore lidhet me tërësinë e të drejtave dhe detyrave, që kanë prindërit me qëllim që të sigurojnë mirëqenien emocionale, sociale dhe materiale të fëmijës, duke u kujdesur për të, duke mbajtur raporte vetjake me të, duke i siguruar atij mirërritjen, edukimin, arsimimin, përfaqësimin ligjor dhe administrimin e pasurive të tij. Ky shkak nënvizon faktin se dallimet në trajtim nuk duhen bërë ndaj fëmijëve të lindur jashtë martese, të lindur nga prindër pa shtetësi apo atyre që janë birësuar.

⁸⁹ Po aty

⁹⁰ Komisioneri për mbrojtjen nga diskriminimi, shkaqet e diskriminimit, <https://www.kmd.al/shkaqet-e-diskriminimit/>, aksesuar më 17.11.2023

19. Predispozicioni gjenetik është një shkak diskriminimi, që lidhet me një person, i cili ka të trashëguar një veçanti të dukshme apo të padukshme dhe që jo domosdoshmërisht klasifikohet si një sëmundje apo aftësi e kufizuar.

Shembull: Diskriminimi për shkak të predispozicionit gjenetik, ndodh në rastin kur një person trajtohet ndryshe nga punëdhënësi ose kompania e sigurimeve sepse ka një trashëgimi gjenetike, që shkakton ose rrit rrezikun e një problemi të trashëguar; ose kur dikush trajtohet ndryshe për shkak të një problematike në të folur apo në qëndrim, dhe për këtë arsye përjashtohet nga mundësia për t'u punësuar.

2. Termi “**çdo shkak tjetër**” nënvizon idenë se lista e shkaqeve nuk është shteruese pasi natyra e diskriminimit ndryshon sipas kontekstit dhe zhvillohet me kohë.⁹¹

⁹¹ Po aty ⁹¹ Komisioneri për mbrojtjen nga diskriminimi, shkaqet e diskriminimit, <https://www.kmd.al/shkaqet-e-diskriminimit/>, aksesuar më 17.11.2023

KREU III

FORMAT E DISKRIMINIMIT

3.1 Dhuna fisnore dhe shtëpiake si forma të diskriminimit

Dhuna familjare është njëra nga format e diskriminimit në bazë të gjinisë dhe fisit, nëse ekziston mbrojtja⁹² joefektive e shtetit për viktimat e dhunës shtëpiake, shoqëruar me mungesën e masave përkatëse dhe/ose aplikimin e tyre, gjë kjo, gjatë së cilës merret parasysh dhe sjellja e personave kompetentë ndaj rasteve të dhunës shtëpiake.⁹³ Opuz kundër Turqisë është një rast i këtillë. Aplikuesja dhe nëna e saj gjatë kohës kishin qenë viktimat të dhunës shtëpiake, për të cilën disa herë kishin denoncuar në polici, dhe në rrjedhë e sipër kishin qenë dhe disa procedura penale kundër bashkëshortit të aplikueses.⁹⁴ Pas disa kohe, kjo dhunë kishte rezultuar me vdekjen e nënës së aplikueses, e cila kishte qenë e gjuajtur nga burri i saj.

Duke marrë parasysh argumentet nga e drejta dhe praktika ndërkombëtare, raportet nga organizata joqeveritare, lidhur me dhunën shtëpiake, veprimin e policisë, dhe dëshmitë statistikore, GjEDN-ja kishte vërtetuar thyerjen e nenit 14, e në lidhje me nenet 2 dhe 3. Gjykata kishte theksuar obligimin pozitiv të shtetit për të luftuar dhunën shtëpiake, megjithatë jo vetëm përmes ligjeve, por edhe në praktikë. GjEDN-ja pretendon se diskriminimi nuk kishte qenë pjesë vetëm e ligdhënies, por dhe e praktikës së përgjithshme të institucioneve kompetente (trajtimi i grave në stacionet policore, kur do të denonconin dhunë shtëpiake), si dhe pasiviteti gjyqësor në dhënien e mbrojtjes efektive të viktimave (edhe pse pa qëllim të drejtpërdrejtë). Dhe

⁹² B. Kotevska “Udhëzues mbi bazat e diskriminimit”, OSCE, Shkup, f. 19
<https://www.osce.org/files/f/documents/4/2/117992.pdf>, aksesuar më 18.11.2023

^{93 93} B. Kotevska “Udhëzues mbi bazat e diskriminimit”, OSCE, Shkup, f. 19

⁹⁴ Po aty, f.19

KEDKG-ja kishte shqyrtuar dhunën shtëpiake si formë të diskriminimit. Në A.T. kundër Hungarisë, Komiteti kishte vërtetuar se shteti kishte bërë diskriminim me atë që kishte dështuar ta mbrojë aplikuesen në mënyrë efektive, madje pas denoncimit katërvjeçar të dhunës⁹⁵. Mekanizmi i koordinuar i referimit të rasteve të dhunës në familje, duhet të jetë më proaktiv në adresimin e problematikave të konstatuara pranë autoriteteve përgjegjëse.⁹⁶

4. Rekomandohet Këshilli i Lartë Gjyqësor, që të udhëzojë gjykatat, që brenda 24 orëve nga shpallja e vendimit për lëshimin e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes (UMM) ose urdhrit të mbrojtjes (UM), viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare, të pajiset me shkurtimin e vendimit/dispozitiv të gjykatës, me qëllim shmangien e vonesave deri në zbardhjen e plotë të vendimit gjyqësor.⁹⁷

Në Republikën e Shqipërisë vepron ligji, LIGJ Nr. 9669, datë 18.12.2006

Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare, (Ndryshuar me ligjin nr. 9914, datë 12.05.2008, nr. 10 329, datë 30.9.2010, nr. 47/2018, datë 23.7.2018, nr. 125/2020, datë 15.10.2020, i përditësuar.

Ky ligj ka për qëllim:

Parandalimin dhe reduktimin e dhunës në familje në të gjitha format e saj, me anë të masave të përshtatshme ligjore dhe të masave të tjera të nevojshme.

Garantimin e mbrojtjes me masa ligjore dhe me masa të tjera të nevojshme të pjesëtarëve të familjes, të cilët janë viktimat e dhunës në familje, duke u kushtuar vëmendje të veçantë grave, vajzave, fëmijëve, të moshuarve dhe personave me aftësi të kufizuara, subjekt i këtij ligji,

⁹⁵ Po aty, f.19

⁹⁶ ⁹⁶ Rapori vjetor për mbrojtjen nga diskriminimi, 2022. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi., f.67 https://www.kmd.al/wp-content/uploads/2023/03/Raporti-KMD-2022_compressed.pdf, aksesuar më 5.2.2022

⁹⁷ Rapori vjetor për mbrojtjen nga diskriminimi, 2022. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi., f.67 https://www.kmd.al/wp-content/uploads/2023/03/Raporti-KMD-2022_compressed.pdf, aksesuar më 5.2.2022

sipas neni 3 të tij. Kuvendi i Shqipërisë, më datë 4.12.2017, miratoi Rezolutën “Për dënimin e dhunës ndaj grave e vajzave dhe rritjen e efektshmërisë së mekanizmave ligjorë për parandalimin e saj”. Rezoluta ka konstatuar nevojën për thjeshtimin e procedurave gjyqësore, për shqyrtimin dhe lëshimin e urdhrit të mbrojtjes, dhe ndjekjen efikase të ekzekutimit të tij, duke parashikuar në çdo rast vijimin e procesit gjyqësor, pavarësisht tërheqjes së mëvonshme të viktimës, si dhe ngritjen

e një mekanizmi eficient të mbikëqyrjes së veprimtarisë së organeve gjyqësore në proceset gjyqësore të dhunës në familje.

VKM-ja nr. 327, datë 2.6.2021, “Për mekanizmin e bashkërendimit të punës ndërmjet autoriteteve përgjegjëse, për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare si dhe procedimin e tij, për mbështetjen e rehabilitimin e viktimave të dhunës”.⁹⁸ “Bashkërendimi i institucioneve për menazhimin e rasteve të dhunës në familje”⁹⁹ Ka shume gra dhe vajza, që janë objekt i dhunës në familje. “Dhunë”, është çdo veprim ose mosveprim i një personi ndaj një personi tjetër, që sjell si pasojë cenim të integritetit fizik, moral, psikologjik, , social, ekonomik.

“Dhunë në familje”, është çdo akt dhune, i përcaktuar sipas pikës 1, të këtij neni, që ndodh brenda familjes ose njësisë shtëpiake, ushtruar ndërmjet pjesëtarëve të familjes, përcaktuar në pikën 7, të këtij neni, që janë ose kanë qenë në marrëdhënie familjare, pavarësisht nga fakti nëse dhunuesi ndan ose ka ndarë të njëjtën banesë me viktimën. “Dhunues” është çdo person i dyshuar dhe/ose i paditur për ushtrimin e dhunës në marrëdhëniet familjare përpara organeve kompetente.¹⁰⁰

⁹⁸ A. Mandro, (Neni 2, 3, 3/1, 4, 9, 11, 13, 15, 18), A. Anastasi, (Neni 1, 10, 12, 13/1, 20, 21, 22, 23, 24), M. Semini (Neni 5, 6, 7, 7/1, 8, 14, 16, 17, 19), Komentari i ligjit për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare, botuar në dhjetor 2021, Tiranë

⁹⁹ Po aty

¹⁰⁰ Ligj Nr. 9669, datë 18.12.2006, Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare, (Ndryshuar me ligjin nr. 9914, datë 12.05.2008, nr. 10 329, datë 30.09.2010, nr. 47/2018, datë 23.07.2018, nr. 125/2020, datë 15.10.2020, i përditësuar, neni 3

Lloji më i zakonshëm i dhunës në familje është kontrolli i sjelljes kur burri ose partneri bëhet xheloz, ose zemërohet nëse gruaja bisedon me burra të tjerë. Rreth 41 % e grave e kanë përjetuar atë, rreth 25 % e përjetojnë aktualisht ¹⁰¹

Lloji i dytë më i zakonshëm i dhunës në familje, është dhuna psikologjike. Rreth 31 % e grave e kanë përjetuar atë dhe rreth 20 % e përjetojnë aktualisht. Format më të zakonshme janë ato, kur gratë përjetojnë fyerje nga burri ose partneri, duke i bërë ato të ndihen keq për veten e tyre (rreth 25 % ndonjëherë, 14 % aktualisht) dhe, duke u folur në një mënyrë që i bën ato të ndihen naive dhe pa vlerë (rreth 19 % ndonjëherë, 10 % aktualisht).

Lloji i tretë më i zakonshëm i dhunës në familje, është dhuna fizike. Rreth 18 % e grave të moshës 18-74 vjeç e kanë përjetuar atë ndonjëherë dhe rreth 7 % aktualisht, kanë përvojë një ose më shumë nga 11 llojet e ndryshme të dhunës fizike në martesë. Gratë me shumë gjasa do të qëllloheshin me shpullë nga partnerët e tyre, por disa gra përjetuan tërheqjen nga flokët, ose u janë hedhur objekte që mund t'i lëndonin. Disa gra përjetojnë dhunë më të rëndë si shkelmimi, rrachja ose goditja me grushta, ose diçka tjetër që mund t'i dëmtojë ato. ¹⁰² Urdhri i mbrojtjes ose urdhri i menjëhershëm i mbrojtjes, i nxjerrë me vendim gjykatë, është zgjidhja në raste të tilla.

Aktet ndërkombëtare kundër dhunës në familje.

Këshilli i Evropës, Konventa e Këshillit të Evropës Për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës Kundër Grave dhe Dhunës në Familje, CETS nr. 210, 2011. ¹⁰³

¹⁰¹ INSTAT Statistika, Dhuna ndaj grave dhe vajzave në Shqipëri, <https://www.instat.gov.al/al/statistikat-n%C3%AB-shkolla/dhuna-ndaj-grave-dhe-vajzave-n%C3%AB-shqip%C3%ABri>, aksesuar më 16.02.2024

¹⁰² INSTAT, Statistika, Dhuna ndaj grave dhe vajzave në Shqipëri, <https://www.instat.gov.al/al/statistikat-n%C3%AB-shkolla/dhuna-ndaj-grave-dhe-vajzave-n%C3%AB-shqip%C3%ABri>, aksesuar më 16.02.2024

¹⁰³ Konventa e Këshillit të Europës për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje, Stamboll, 11. V.201, <https://rm.coe.int/168046246b>, aksesuar më 16.02.2024

Konventa dënon të gjitha format e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje;

Duke pranuar se realizimi i barazisë de jure dhe de facto midis burrave dhe grave është një element kyç në parandalimin e dhunës kundër grave.¹⁰⁴ Kjo Konventë zbatohet për të gjitha format e dhunës kundër grave, duke përfshirë dhunën në familje, e cila prek gratë në mënyrë disproporcionale. Qëllimet e kësaj Konvente janë:

a. mbrojtja e grave nga të gjitha format e dhunës dhe parandalimi, ndjekja penale dhe eliminimi i dhunës kundër grave dhe dhunës në familje;

b. kontributi ndaj eliminimit të të gjitha formave të diskriminimit kundër grave dhe promovimi i barazisë thelbësore midis burrave dhe grave, duke përfshirë mënyrat me anë të fuqizimit të grave;

c. hartimi i një kuadri gjithëpërfshirës politikash dhe masash për mbrojtjen, dhe ndihmën për të gjitha viktimat e dhunës kundër grave e asaj në familje;

d. nxitja e bashkëpunimit ndërkombëtar, me synim eliminimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje; e ofrimi i mbështetjes dhe ndihmës për organizatat dhe agjencitë e zbatimit të ligjit për të bashkëpunuar në mënyrë efektive, me qëllim miratimin e një përqasjeje të integruar për të eliminuar dhunën kundër grave dhe dhunën në familje.¹⁰⁵

Kodi Penal në Republikën e Shqipërisë ka parashikuar dispozitën për dhunën në familje.

Neni 130/a

Dhuna në familje

Rrahja, si dhe çdo vepër tjetër dhune fizike, psikologjike, ndaj personit që është bashkëshort, ish-bashkëshort, bashkëjetues apo ish-bashkëjetues, gjini e afërt (të paralindur, të paslindur, vëllezër, motra,

¹⁰⁴ Konventa e Këshillit të Europës për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje, Stamboll, 11. V.201, <https://rm.coe.int/168046246b>, aksesuar më 16.02.2024

¹⁰⁵ Konventa e Këshillit të Europës për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje, Stamboll, 11. V.2011, <https://rm.coe.int/168046246b>, aksesuar më 16.02.2024

ungjër, emta, nipër, mbesa, fëmijë të vëllezërve dhe të motrave) ose krushqi e afërt (vjahërr, vjahërrë, dhëndër, nuse, kunat/ë, thjeshtri, thjeshtira, njerku e njerka), ose në lidhje apo ish-lidhje intime me autorin e veprës penale, me pasojë cenimin e integritetit fizik, psiko-social dhe ekonomik të tij, dënohet me burgim deri në tre vjet.¹⁰⁶

Kanosja serioze për vrasje ose plagosje të rëndë ndaj personit, që është bashkëshort, ish-bashkëshort, bashkëjetues apo ish-bashkëjetues, gjini e afërt (të paralindur, të paslindur, vëllezër, motra, ungjër, emta, nipër, mbesa, fëmijë të vëllezërve dhe të motrave), ose krushqi e afërt (vjahërr, vjahërrë, dhëndër, nuse, kunat/ë, thjeshtri, thjeshtira, njerku e njerka), ose në lidhje apo ish-lidhje intime me autorin e veprës penale, me pasojë cenimin e integritetit psikik të tij, dënohet me burgim deri në katër vjet.

Plagosja e kryer me dashje ndaj personit, që është bashkëshort, ish-bashkëshort, bashkëjetues apo ish-bashkëjetues, gjini e afërt (të paralindur, të paslindur, vëllezër, motra, ungjër, emta, nipër, mbesa, fëmijë të vëllezërve dhe të motrave), ose krushqi e afërt (vjahërr, vjahërrë, dhëndër, nuse, kunat/ë, thjeshtri, thjeshtira, njerku e njerka), ose në lidhje apo ish-lidhje intime me autorin e veprës penale, që ka shkaktuar paaftësi të përkohshme në punë më tepër se nëntë ditë, dënohet me

¹⁰⁶ Ligj Nr. 7895, datë 27.01.1995, Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë.

(Ndryshuar me: ligjet nr. 8175, datë 23.12.1996; nr. 8204, datë 10.04.1997; nr. 8279, datë 15.01.1998; nr. 8733, datë 24.01.2001; nr. 9017, datë 06.03.2003; nr. 9030, datë 13.03.2003; nr. 9086, datë 19.06.2003; nr. 9188, datë 12.02.2004; nr. 9275, datë 16.09.2004; nr. 9686, datë 26.02.2007; nr. 9859, datë 21.01.2008; nr. 10023, datë 27.11.2008; nr. 23/2012, datë 01.03.2012; nr. 144, datë 02.05.2013; nr. 98, datë 31.07.2014; nr. 176/2014, datë 18.12.2014; nr. 135/2015, datë 05.12.2015; nr. 82/2016, datë 25.07.2016; nr. 36/2017, datë 30.03.2017; nr. 89/2017, datë 22.05.2017; nr. 44/2019, datë 18.07.2019, nr. 35/2020, datë 16.04.2020, nr. 146/2020, datë 17.12.2020; nr. 43/2021, datë 23.03.2021; vendimet e Gjykatës Kushtetuese: nr. 13, datë 29.05.1997; nr. 46, datë 28.08.1997; nr. 58, datë 05.12.1997; nr. 65, datë 10.12.1999; nr. 11, datë 02.04.2008; nr. 19, datë 01.06.2011; nr. 47, datë 26.07.2012; nr. 9, datë 26.2.2016; nr. 24, datë 4.5.2021, i përditësuar <https://qbz.gov.al/preview/a2b117e6-69b2-4355-aa49-78967c31bf4d>

burgim deri në pesë vjet. Po këto vepra, të kryera në mënyrë të përsëritur, ose në praninë e fëmijëve, dënohen nga një deri në pesë vjet burgim¹⁰⁷.

3.2 Forma të tjera diskriminimi

Një nga format e diskriminimit, është dhe “Diskriminim i shumëfishtë”. Ky lloj diskriminimi, është ajo formë, që ndodh kur një person ose grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër ose një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në dy ose më shumë shkaqe, që veprojnë veçmas¹⁰⁸. Ky lloj diskriminimi është më i rrezikshëm për shoqërinë njerëzore pasi personat diskriminohen për shkaqe nga më të ndryshmet. Të tilla diskriminime kanë ndodhur në komunitetin rom apo në atë egjiptian. Nuk trajtohen në mënyrë të barabartë me anëtarët e tjerë të shoqërisë, çka përbën cenimin e dinjitetit personal të këtyre personave pasi ata nuk duhet trajtohen ndryshe nga të tjerët. Ka pasur raste të caktuara ku ata kanë bërë dhe ankesë te Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka dalë me një vendim, në mbrojtje të këtyre grupeve. Roli i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka qenë shumë aktiv, ai ka dhënë një numër të madh vendimesh, ka ndërmarrë fushata sensibilizuese në shoqëri për mbrojtjen nga diskriminimi. Megjithë rolin e ndjeshëm të Komisionerit, diskriminimi mbetet një problem në shoqërinë shqiptare.

Një rast ka qenë në vendimin e Komisionerit NR.10, datë 23.5.2022, diskriminimi në formën e gjuhës së urrëjtjes për shkak të racës së pakicës kombëtare rome nga ana e opinionistit A.M, në emisionin e televizionit Vizion Plus. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Komisioneri vendosi: ¹⁰⁹

¹⁰⁷ Po aty

¹⁰⁸ Ligj Nr. 10 221, datë 04.02.2010, Për mbrojtjen nga diskriminimi 1 (Ndryshuar me Ligjin Nr. 124/2020), (I përditësuar, <https://www.kmd.al/wp-content/uploads/2021/05/2.pdf>, aksesuar më 18.11.2023

¹⁰⁹ Rasti i marrë nga vendimet e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

1. Konstatimin e diskriminimit, për shkak të racës, në formën e gjuhës së urrejtjes, të pakicës kombëtare rome, nga ana e z. A.M., si pasojë e përdorimit të gjuhës së urrejtjes ndaj pakicës kombëtare rome, në Emisionin Spot LIGHT, të datës 21.01.2022, në televizionin Vizion Plus.

2. Konstatimin e diskriminimit, për shkak të racës, në formën e gjuhës së urrejtjes, të pakicës kombëtare rome, nga ana e Televizionit Vizion Plus, si pasojë e mosmbajtjes së një qëndrimi kritik ndaj gjuhës së urrejtjes së përdorur nga z. A.M., në emisionin Spot LIGHT, për mosdistançimin në mënyrë publike nga përdorimi i saj, si dhe për përdorimin e gjuhës së urrejtjes ndaj pakicës kombëtare rome, në titullin e emisionit Spot LIGHT, të publikuar në faqen www.youtube.com.

3. Referuar pikave 1 dhe 2 të këtij Vendimi, z. A.M. dhe Televizioni Vizion Plus të shprehen me deklarata publike (verbale apo të shkruara), me anë të së cilave të kërkojnë falje ndaj pakicës kombëtare rome.

4. Referuar pikës 2 të këtij Vendimi, Televizioni Vizion Plus të marrë masa të menjëherëshme për të ndryshuar titullin e emisionit Spot LIGHT, të datës 21.01.2022, si dhe eliminimin/mbulimin e frazës diskriminuese të përdorur nga z. A.M., në përmbajtjen e këtij emisioni, të publikuar në faqen www.youtube.com, brenda 5 (pesë) diteve nga marrja dijeni mbi këtë vendim, duke shmangur përdorimin e gjuhës së urrejtjes ndaj pakicës kombëtare rome¹¹⁰

vendimi GJEDNJA X dhe të tjerët kundër Shqipërisë. 31 maj 2022.

https://www.kmd.al/wp-content/uploads/2022/06/Vendim-nr.-100-datë-23.05.2022-Rrjeti-i-Organizatave-RIE-kundër-Vizion-Plus-TV-dhe-opinionistit-A.M.-Diskriminim_gjuhë-urrejtjeje.pdf, aksesuar, më 18.11.2023

¹¹⁰ Rasti i marrë nga vendimet e Komisionerit për mbrojtjen nga diskriminimi, https://www.kmd.al/wp-content/uploads/2022/06/Vendim-nr.-100-datë-23.05.2022-Rrjeti-i-Organizatave-RIE-kundër-Vizion-Plus-TV-dhe-opinionistit-A.M.-Diskriminim_gjuhë-urrejtjeje.pdf, aksesuar më 18.11.2023

Çështja X dhe të tjerët kundër Shqipërisë (Kërkesat Nr. 73548/17 dhe Nr. 45521/19)

Kërkuesit jetojnë në Korçë, një qytet në juglindje të Shqipërisë me 76. 000 banorë. Sipas të dhënave të qeverisë lokale, gjatë vitit akademik 2018/19, në sistemin e detyruar arsimor të këtij qyteti, u regjistruan rreth 1200 fëmijë romë dhe egjiptianë.¹¹¹ Gjatë viteve akademike 2012/19, nxënësit romë dhe egjiptianë në shkollën fillore “Naim Frashëri”, në Korçë, përbënin rreth 89% deri në 100% të nxënësve në shkollë. Në vitin 2012, qeveria kishte zbatuar një program për ndihmën ushqimore sipas të cilit, nxënësit që ndiqnin atë shkollë, përfitonin pako me ushqime, me qëllimin që të rriteshin normat e frekuentimit të shkollës nga fëmijët e atyre komuniteteve. Kërkuesit fëmijë ndiqnin të njëjtën shkollë.

Në një rekomandim të përgjithshëm të datës 11 shtator 2014, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi (“Komisioneri” ose “Komisioneri kundër Diskriminimit”), një organ i brendshëm, i themeluar sipas ligjit për mbrojtjen ndaj diskriminimit (Ligji Nr. 10 221, i datës 04 shkurt 2010), i rekomandoi Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve (“Ministria”) të mbante në konsideratë raportin midis nxënësve romë/egjiptianë dhe të tjerë në shkollë, si dhe të merrte masa për të shmangur krijimin e shkollave, që ndiqeshin vetëm nga nxënësit e këtyre komuniteteve romë dhe egjiptian.

Gjykata ka theksuar:

Ndalimin e diskriminimit. Moszbatimi i masave të menjëhershme dhe të detajuara kundër segregimit/veçimit në një shkollë fillore, e cila frekuentohet pothuajse ekskluzivisht nga fëmijët e komunitetit rom dhe egjiptian. Asnjë justifikim objektiv dhe i arsyeshëm.

Masa individuale. Shtetit të paditur i kërkohet që të marrë masa për t’i dhënë fund diskriminimit. Në këtë linjë, gjykata ka parashikuar se diskriminimi nënkupton trajtimin në mënyrë të ndryshme, pa një

¹¹¹ Komisioneri për mbrojtjen nga Diskriminimi, <https://www.kmd.al/vendime-te-gjednj/>, Çështja X dhe të tjerët kundër Shqipërisë, (Kërkesat Nr. 73548/17 dhe Nr. 45521/19, <https://www.kmd.al/vendime-te-gjednj/>, aksesuar më 18.11.2023

justifikim objektiv dhe të arsyeshëm të personave në situata të ngjashme.¹¹² Megjithatë, neni 14 nuk e ndalon një shtet anëtar të trajtojë grupe të ndryshme në mënyrë të ndryshme, për të korrigjuar “pabarazitë faktike” midis tyre; në të vërtetë në rrethana të caktuara, dështimi për të korrigjuar barazinë me anë të një trajtimi ndryshe, në vetvete mund të shkaktojë shkelje të nenit 14 (shih Horváth dhe Kiss kundër Hungarisë, Nr. 11146/11, §101, 29 janar 2013).

Gjithashtu, gjykata është e mendimit se bashkekzistenca e anëtarëve të shoqërisë pa veçim racial, është një vlerë themelore e shoqërive demokratike (shih Vona kundër Hungarisë, nr. 35943/10, §57, GJEDNJ 2013). Në lidhje me aspektin e veçimit të shkollës, gjykata ka miratuar një sërë vendimesh, të cilat kanë të bëjnë me kontekste të ndryshme. Çështja e D.H., dhe të Tjerët kundër Republikës së Çekisë ([DHM]), Nr. 57325/00, GJEDNJ 2007-IV) kishte të bënte me një situatë, ku praktika mbarëkombëtare e vendosjes së numrit jopërpjesëtimor të fëmijëve romë në shkollat për nxënësit me vështirësi në të mësuar, shkaktonte diskriminim sipas origjinës etnike të kërkuesve. Në çështjen Oršuš dhe të Tjerët kundër Kroacisë ([DHM]), Nr. 15766/03, GJEDNJ 2010, kërkuesit ishin shtetas kroatë me origjinë etnike rome, të cilët herë pas here ishin vendosur në klasa të veçanta vetëm me nxënës romë gjatë arsimimit të tyre, me arsyen se ata nuk zotëronin mjaftueshëm gjuhën kroate. Gjykata konstatoi një shkelje të ndalimit të diskriminimit për faktin se midis të tjerash, autoritetet nuk kishin marrë hapat e nevojshëm për të siguruar progresin e shpejtë të kërkuesve në mësimin e gjuhës dhe integrimin e tyre në klasa të përziera.¹¹³

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut e ka elaboruar rast pas rasti parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit në shoqëri, po kështu

¹¹² Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, <https://www.kmd.al/vendime-te-gjednj/>, Çështja X dhe të tjerët kundër Shqipërisë, (Kërkesat Nr. 73548/17 dhe Nr. 45521/19,

<https://www.kmd.al/vendime-te-gjednj/>, aksesuar më 18.11.2023

¹¹³ Komisioneri për mbrojtjen nga diskriminimi, <https://www.kmd.al/vendime-te-gjednj/>, Çështja X dhe të tjerët kundër Shqipërisë, (Kërkesat Nr. 73548/17 dhe Nr. 45521/19, <https://www.kmd.al/vendime-te-gjednj/>, aksesuar më 18.11.2023

dhe Gj E.D. Grupet në pozita të dobëta kundrejt diskriminimit përbëhen nga njerëz, të cilët për shkak të karakteristikave të përbashkëta, kanë probabilitet më të madh për t'u diskriminuar nga pjesa tjetër e shoqërisë. Në vlerësimin e karakteristikave të përbashkëta rol të rëndësishëm luajnë ¹¹⁴ faktorët ekonomikë, socialë dhe politikë, jo të favorshëm. Grupet e dobëta janë përkufizuar edhe si grupe sociale, të cilat kanë nevojë për mbrojtje të veçantë shoqërore e ligjore. Të drejtat dhe interesat e tyre janë lehtësisht të cënueshme dhe, parë në këndvështrimin e statusit shoqëror, ata janë të ndërruar nga të tjerët. Në varësi të kushteve social-ekonomike e politike të një vendi si dhe nivelit të zhvillimit të tij, përkufizimi i grupeve të dobëta ndryshon nga shteti në shtet. Megjithatë, disa nga karakteristikat më të spikatura të tyre janë: *mosha, gjinia, përkatësia etnike, statusi social, fizik ose shëndetësor, orientimi seksual* etj. ¹¹⁵

3.3 Barazia Gjinore në shoqëri

Respektimi i barazisë gjinore në shoqëri është i domosdoshëm në një shoqëri demokratike. Barazia gjinore është e mbrojtur me ligj. Në Shqipëri vepron ligji për barazinë gjinore, për të garantuar barazinë midis burrave dhe grave në shoqëri, barazi në shance dhe në mundësi. Ky ligj rregullon çështjet themelore të barazisë gjinore në jetën publike, të mbrojtjes dhe trajtimit të barabartë të grave e burrave, për mundësitë dhe

¹¹⁴ Përgatitën: Znj. Vjollca Meçaj, Juriste (KShH) Znj. Erida Skëndaj, Juriste (KShH) Znj. Klejda Ngjela, Sociologe (KShH) “*Barazia dhe ndalimi i diskriminimit në këndvështrimin social*”, Tiranë, Prill 2011, f.9 Komiteti Shqiptar i Helsinkit, https://ahc.org.al/wp-content/uploads/2017/04/barazia_dhe_ndalimi_i_diskriminimit_Manual_OJF.pdf, aksesuar më 18.11.2023

¹¹⁵ Përgatitën: Znj. Vjollca Meçaj, Juriste (KShH) Znj. Erida Skëndaj, Juriste (KShH) Znj. Klejda Ngjela, Sociologe (K Sh H) “*Barazia dhe ndalimi i diskriminimit në këndvështrimin social*”, Tiranë, Prill 2011, f.9 Komiteti Shqiptar i Helsinkit, https://ahc.org.al/wp-content/uploads/2017/04/barazia_dhe_ndalimi_i_diskriminimit_Manual_OJF.pdf, aksesuar më 18.11.2023

shancet e barabarta për ushtrimin e të drejtave, si dhe për pjesëmarrjen e ndihmesën e tyre në zhvillimin e të gjitha fushave të jetës shoqërore.¹¹⁶

Qëllimi i këtij ligji është:

- a) të sigurojë mbrojtje efikase nga diskriminimi për shkak të gjinisë dhe nga çdo formë sjelljeje, që nxit diskriminimin për shkak të gjinisë;
- b) të përcaktojë masa për garantimin e mundësive të barabarta ndërmjet grave e burrave, për të eliminuar diskriminimin e bazuar në gjini, në çfarëdo forme me të cilën shfaqet;
- c) të përcaktojë përgjegjësitë e autoriteteve shtetërore, qendrore dhe vendore, për të hartuar dhe zbatuar aktet normative, si dhe politikat që mbështesin zhvillimin dhe nxitjen e barazisë gjinore në shoqëri.¹¹⁷

“Barazi gjinore”, është pjesëmarrja e barabartë e femrave dhe e meshkujve në të gjithat fushat e jetës, pozita e barabartë ndërmjet tyre, mundësi e shanse të barabarta, për të gëzuar të drejtat dhe për të përmbushur detyrimet në shoqëri, duke përfituar njëloj nga arritjet e zhvillimit të saj.

“Integrim gjinor”, është procesi që zhvillohet ndërmjet femrave dhe meshkujve, si një proces që nuk i përket vetëm njërës gjini si grup i veçuar, por shoqërisë në tërësi. Si i tillë, integrimi gjinor është rruga për arritjen e barazisë gjinore në shoqëri, nëpërmjet përfshirjes së perspektivës së secilës nga gjinitë në të gjitha proceset ligjvënëse, politikëbërëse, planifikuese, zbatuese e monitoruese. Përveç ligjit për barazinë gjinore, ka dhe ligje të tjera.

Ligji nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” u është vënë detyrim kryetareve /kryetarëve të bashkive që në emërimet e zëvendëskryetareve/kryetarëve të bashkive dhe emërimet e administratoreve/administratorëve të njësive administrative, të zbatojnë dhe respektojnë barazinë gjinore.¹¹⁸ Për të ndjekur ndryshimet demokratike, parlamentet duheshin të ndryshonin kulturën,

¹¹⁶ LIGJ Nr.9970, datë 24.07.2008 Për barazinë gjinore në shoqëri

¹¹⁷ LIGJ Nr.9970, datë 24.07.2008 Për barazinë gjinore në shoqëri

¹¹⁸ Strategjia kombëtare për barazinë gjinore, 2021-2030, miratuar me VKM 400, datë 30.06.2021 f.18, qershor 2021, <https://awenetwork.org/media/646208786d90c.pdf>, aksesuar më 06.02.2024

infrastrukturën dhe rregullat e tyre, për të qenë në gjendje t'i përgjigjen numrit në rritje të grave e nevojës për një punë më të balancuar, si dhe ekuilibër familjar për gratë dhe burrat në parlament. Së bashku me institucionet, organizatat dhe kompanitë tjera, parlamentet kanë pranuar këtë realitet të ri dhe kanë ndërmarrë hapa serioz transformues dhe reformues për t'u siguruar që legjislativi të bëhet një mjedis më i ndjeshëm ndaj gjinive.¹¹⁹

Ligji nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, parashikon për herë të parë detyrimin e subjekteve zgjedhore për të respektuar barazinë gjinore.

Ligji nr. 101/2020, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, u përfshi koncepti i “gjinisë së nënpërfaqësuar” (gjinia metradicionalisht numrin më të vogël të anëtareve/anëtarëve në kuvend ose, sipas rastit, në këshillat vendorë në rang vendi), si dhe u saktësuan përcaktimet mbi lirinë zgjedhore dhe barazinë gjinore në nenin 4 të këtij Kodi.

Ligji Nr. 57/2016, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin Nr.9936, datë 26.06.2008,“Për menazhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, përfshin për herë të parë konceptin e buxhetimit të përgjigjshëm gjinor në menazhimin e sistemit buxhetor, duke shtuar si parim të funksionimit të tij respektimin e barazisë gjinore, ku burri dhe gruaja gëzojnë mundësi dhe akses të barabartë në të drejta dhe përfitime të të njëjtës natyrë. Ndërsa Ligji Nr. 68/2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ka krijuar mundësitë për përfshirjen e efektshme të buxhetimit të përgjigjshëm gjinor, në të gjitha fazat e ciklit të menazhimit financiar vendor (programimi i buxhetit vjetor dhe afatmesëm, monitorimi dhe raportimi, vlerësimi dhe auditimi). Ndër të tjera, ky ligj synon të sigurojë që nëpërmjet krijimit

¹¹⁹Sasha Gavriç, Rezart Mehmed, Misioni i OSBE-së në Shkup, Eva Jovanova, Simona Sardeliç, Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut, Barazia gjinore ka rëndësi! Doracak për deputetët dhe personelin parlamentar mbi barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave, Misioni i OSBE-së në Shkup, 2020 f.30

dhe shpërndarjes së burimeve financiare të njërive të vetëqeverisjes vendore të përshpejtohet dhe realizohet barazia gjinore.¹²⁰

Ligji nr.7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar me ligjin nr. 136/2015, ku theksohen ndër të tjera: trajtimi i punëmarrëseve/punëmarrësve pa diskriminim,¹²¹ marrja e masave të përkohshme dhe të veçanta nga punëdhënësi/punëdhënësjë, të cilat synojnë përshpejtimin e vendosjes reale të barazisë në ushtrimin e të drejtës për punësim dhe profesion kur mungesa e barazisë është shkaktuar nga diskriminimi për çdo shkak të përmendur në nenin 9 të Kodit të Punës, si dhe ndërprerja e kësaj mase sapo të jenë arritur objektivat e trajtimit dhe ofrimit të mundësive të barabarta.

Ligji Nr. 93/2014, “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuar”, përcakton të drejtat thelbësore, që lidhen me përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuar me qëllim garantimin e mundësive dhe kushteve të barabarta të tyre me të tjerët. Ndër parimet bazë të këtij ligji është dhe barazia gjinore, i cili siguron që gratë me aftësi të kufizuar të kenë mundësi të barabarta si burrat me aftësi të kufizuar, për të përfituar të drejtat e garantuara nga ky ligj.

Ligji 47/2018, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9669, datë 18.12.2006, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”,¹²² përmbushi rekomandimet e dhëna nga Komiteti CEDAW (2016) dhe nga GREVIO (2017). Nëpërmjet ndryshimeve të bëra, u forcuan masat mbrojtëse dhe procedurale për një përgjigje më efektive ndaj dhunës

¹²⁰ Strategjia kombëtare për barazinë gjinore, 2021-2030, miratuar me VKM 400, datë 30.06.2021, f.18, qershor 2021, <https://awenetwork.org/media/646208786d90c.pdf>, aksesuar më 06.02.2024

¹²¹ Strategjia kombëtare për barazinë gjinore, 2021-2030, miratuar me VKM 400, datë 30.06.2021, qershor 2021, f.11,12, <https://awenetwork.org/media/646208786d90c.pdf>, aksesuar më 06.02.2024

¹²² ¹²² Strategjia kombëtare për barazinë gjinore, 2021-2030, miratuar me VKM 400, datë 30.06.2021, qershor 2021, f.11,12, <https://awenetwork.org/media/646208786d90c.pdf>, aksesuar më 06.02.2024

në familje dhe mbrojtjes së viktimave, përmes lëshimit të Urdhrit për masat paraprake të mbrojtjes së menjëhershme.

Ndërsa, me ndryshimet e bëra nëpërmjet Ligjit 125/2020, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9669, datë 18.12.2006, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, përcaktohen masat për largimin menjëherë të dhunuesit nga banesa nëpërmjet UMPMM nga Policia e shtetit, apo nëpërmjet UMM/UM, të lëshuar nga Gjykata për atë afat kohor, që përcaktohet në këto urdhëra, programet specifike të rehabilitimit për dhunuesit, krijimi i regjistrisë të UMM/UM-ve, etj. Lidhur ngushtësisht me zbatimin e këtij Ligji është edhe Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 334, datë 17.2.2011 “Për mekanizmin e bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit të tij”, i cili po rishikohet.¹²³

Ligji nr. 221 datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar. Sipas këtij ligji, askush nuk mund të diskriminohet për shkak të *gjinisë, racës, ngjyrës, etnisë, gjuhës, identitetit gjinor, orientimit seksual, bindjeve politike, fetare ose filozofike, gjendjes ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzënisë, përkatësisë prindërore, përgjegjësisë prindërore, moshës, gjendjes familjare ose martesore, gjendjes civile, vendbanimit, gjendjes shëndetësore, predispozicionit gjenetik, aftësisë së kufizuar, përkatësisë në një grup të veçantë*, ose për çdo shkak tjetër.¹²⁴ Edhe ky ligj është përmirësuar me Ligjin 124/2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr.221/04.02.2010 për mbrojtjen nga diskriminimi”, ku ndër të tjera saktësohet më tej objekti i këtij ligji, shtohen përkufizimet, duke theksuar gjuhën e urrejtjes, jepet përkufizim për format e rënda të diskriminimit, etj.¹²⁵ Ligji nr. 69/2012

¹²³ Po aty.

¹²⁴ Strategjia kombëtare për barazinë gjinore, 2021-2030, miratuar me VKM 400, datë 30.06.2021, qershor 2021 f.11,12, <https://awenetwork.org/media/646208786d90c.pdf>, aksesuar më 06.02.2024

¹²⁵ ¹²⁵ Strategjia kombëtare për barazinë gjinore, 2021-2030, miratuar me VKM 400, datë 30.06.2021, qershor 2021, f.11,12, <https://awenetwork.org/media/646208786d90c.pdf>, aksesuar më 06.02.2024

“Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ku në pikën 3 të nenit 6, parashikohet se: “Në sistemin arsimor parauniversitar, nxënëseve/nxënësve dhe punonjëseve/punonjësve, u ofrohet mbrojtje nga çdo formë veprimi ose mosveprimi, që mund t’u shkaktojë diskriminim, dhunë, keqtrajtim ose dëm moral”.

Gjatë periudhës 2016-2020 janë miratuar apo përmirësuar edhe një sërë ligjesh të tjera, ku është theksuar parimi i barazisë gjinore apo mbrojtja nga dhuna dhe diskriminimi, siç mund të përmendim:

Ligji 121/2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, ku parimi i mosdiskriminimit për një tërësi shkaqesh, duke filluar nga gjinia, renditet ndër parimet bazë për ofrimin e shërbimeve. Ligji, gjithashtu parashikon ofrimin e shërbimeve të specializuara për gratë dhe vajzat e dhunuara ose të trafikuar, për gratë dhe vajzat shtatzëna, ose prind i vetëm me fëmijë deri në 1 vjeç etj.

Ligji 65/2016, “Për ndërmarrjet sociale në Republikën e Shqipërisë”, që ndër të tjera, synon punësimin e personave të pafavorizuar në tregun e punës, si: personat që trajtohen me ndihmë ekonomike, personat me aftësi të kufizuar, jetimet/jetimet, gratë viktime të dhunës.

Ligji 111/2018, “Për kadastrën”, që gjithashtu, rregullon çështjet e barazisë gjinore, lidhur me regjistrimin e pasurisë së bashkësisë ligjore.

Ligji nr. 75/2019, “Për rininë”, konkretisht pika 1 e nenit 3, parashikon se: “Mbështetja dhe fuqizimi i të rejave/rinjve bazohet në parimet e mëposhtme: a) parimin e barazisë dhe të mosdiskriminimit, të sanksionuara nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.”¹²⁶

Ligji 65/2016, “Për ndërmarrjet sociale në Republikën e Shqipërisë”, që ndër të tjera, synon punësimin e personave të pafavorizuar në tregun e punës, si: personat që trajtohen me ndihmë

¹²⁶ Strategjia kombëtare për barazinë gjinore, 2021-2030, miratuar me VKM 400, datë 30.06.2021, qershor 2021 f.11,12, <https://awenetwork.org/media/646208786d90c.pdf>, aksesuar më 06.02.2024

ekonomike, personat me aftësi të kufizuar, jetimet/jetimët, gratë viktimë të dhunës dhe trafikimit etj.

Ligji 97/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, që përmirëson qasjen e viktimave në informacion përmes vendosjes së një koordinatori/koordinatoreje për marrëdhëniet me publikun në secilën prokurori, përgjegjës/përgjegjëse për informimin e viktimave.

Ligji 18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, ku barazia dhe mosdiskriminimi përmenden që në parimet e përgjithshme të tij. Ligji përcakton se *çfarë do të thotë mbrojtje e fëmijës, duke qartësuar “masat e mbrojtjes”*, që mund të aplikojnë punonjësit/punonjëset kur konstatojnë raste të fëmijëve në situatë të pasigurt për shkak të dhunës, abuzimit, neglizhimit apo shfrytëzimit. Për herë të parë parashikohet mbrojtja e fëmijëve në situatë rruge apo, që punojnë/shfrytëzohen për punë, po ashtu sigurohet mbrojtja kundrejt formave të ndryshme ndaj adresimit të dhunës ndaj fëmijëve, si bulizmi, dhuna në shkollë, në familje, abuzimi seksual, shfrytëzimi ekonomik, siguria e fëmijëve në internet, fëmijët e pashoqëruar ose viktimë të trafikimit etj.¹²⁷

Ligji 37/2017, “Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur”, që garanton një kornizë ligjore për drejtësinë penale për fëmijët, promovon riintegrimin e fëmijës në konflikt me ligjin, mbrojtjen e të drejtave të fëmijës viktimë dhe/ose dëshmitar i veprës penale dhe parandalon riviktimizimin/viktimizimin dytësor të fëmijës, që ka qenë më parë viktimë e një vepre penale.¹²⁸

Ligji 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, që ndër të tjera, garanton ndihmë juridike falas për kategori të veçanta: viktimë të dhunës në familje, trafikimit të qenieve njerëzore, të

¹²⁷ Strategjia kombëtare për barazinë gjinore, 2021-2030, miratuar me VKM 400, datë 30.06.2021, qershor 2021 f.11,12, <https://awenetwork.org/media/646208786d90c.pdf>, aksesuar më 06.02.2024

¹²⁸ . Strategjia kombëtare për barazinë gjinore, 2021-2030, miratuar me VKM 400, datë 30.06.2021, qershor 2021 f.11,12, <https://awenetwork.org/media/646208786d90c.pdf>, aksesuar më 06.02.2024

mitur/mitura në konflikt me ligjin, fëmijë në institucionet e përkujdesjes shoqërore, persona, të cilëve u është cënauar e drejta nëpërmjet një veprimi ose mosveprimi që përbën diskriminim etj.

*Ligji 35/2017, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7905, datë 21.03.1995, “Kodi i Procedurës Penale”, i ndryshuar, ku parashikohen dispozita të reja ligjore, që përmirësojnë ndjeshëm pozitën e viktimës në çështjet penale, si dhe të drejta proceduriale të posaçme për viktimën e mitur, të abuzuar seksualisht dhe viktimën e trafikimit të qenieve njerëzore.*¹²⁹

Ligji 70/2017, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.10192, datë 03.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese ndaj pronës”, ku parashikohet se dispozitat e tij zbatohen për pasuritë e personave, që zotërohen plotësisht ose pjesërisht, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, mbi të cilët ekziston dyshimi i arsyeshëm, për kryerjen e veprave penale lidhur me trafikimin e të rriturave/rriturve dhe të miturave/miturve. Ky ligj përcakton krijimin e një fondi të posaçëm për parandalimin e krimit të organizuar, për të cilin përdoren si burim pasuritë e sekuestruara dhe të konfiskuara (me vendimin e Gjykatës). Fondi i veçantë është caktuar për qëllime sociale, duke përfshirë rehabilitimin dhe integrimin e viktimave të trafikimit.

Ligji nr. 79/2017, “Për sportin”, i ndryshuar ku pika 3 e nenit 5 të këtij ligji parashikon se: “Ndalohet diskriminimi në veprimtaritë sportive për shkaqe, si bindjet politike a fetare, raca, etnia, gjuha, gjinia, orientimi seksual, gjendja ekonomike ose shoqërore.”

Ligji 22/2018, “Për strehimin social”, ku theksohet parimi i mosdiskriminimit, për planifikimin, pajisjen, shpërndarjen dhe menazhimin e strehimit për grupet sociale në nevojë për strehim. Nga programi i banesave të specializuara përfitojnë shtresat vunerabël, përfshirë viktimat e trafikimit, dhunës në familje dhe vajzat nëna.

¹²⁹ Strategjia kombëtare për barazinë gjinore, 2021-2030, miratuar me VKM 400, datë 30.06.2021, qershor 2021 f.11,12, <https://awenetwork.org/media/646208786d90c.pdf>, aksesuar më 06.02.2024

*Ligji 110/2018, “Për noterinë”, që fuqizon pavarësinë ekonomike të gruas dhe është garant kryesor i të drejtave pronësore të saj, duke sjellë risi në çështjet e rregullimit të barazisë gjinore në aspektin e mbrojtjes së pasurive.*¹³⁰

Ligji 111/2018 “Për kadastrën”, që gjithashtu, rregullon çështjet e barazisë gjinore, lidhur me regjistrimin e pasurisë së bashkësisë ligjore.

*Ligji 15/2019, “Për nxitjen e punësimit”, ku viktimat e mundshme të trafikimit, dhunës me bazë gjinore, dhunës në familje apo nënat nën moshën 18 vjeç, specifikohen tek grupet e veçanta të punëkërkueseve/punëkërkuësve të disavantazhuar në tregun e punës, të cilat/cilët përfitojnë nga shërbimet dhe programet e nxitjes së punësimit.*¹³¹

Ligji 57/2019, “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, ku përcaktohen si përfituese/përfitues të ndihmës ekonomike, ndër të tjera viktimat e trafikimit pas daljes nga institucionet e përkujdesjes shoqërore, deri në çastin e punësimit të tyre, si dhe viktimat e dhunës në familje, për periudhën e vlefshmërisë së urdhrit të mbrojtjes ose urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes, të cilat nuk trajtohen në institucionet e përkujdesjes shoqërore.

Ligji 34/2019, “Për administrimin e pasurive të sekuestruara e të konfiskuara”, ku theksohet mirëadministrimi dhe përdorimi eficient, efektiv dhe ekonomik i pasurive të sekuestruara e konfiskuara nga organet e drejtësisë dhe pasurive të sekuestruara me urdhër të ministrit përgjegjës për financat, rikthimi në komunitet i pasurive të fituara në mënyrë të paligjshme dhe kompensimi financiar i viktimave të krimit.

¹³⁰ “Strategjia kombëtare për barazinë gjinore”, 2021-2030, miratuar me VKM 400, datë 30.06.2021, qershor 2021, f.11,12, <https://awenetwork.org/media/646208786d90c.pdf>, aksesuar më 06.02.2024

¹³¹ Po aty. ¹³¹ “Strategjia kombëtare për barazinë gjinore”, 2021-2030, miratuar me VKM 400, datë 30.06.2021, qershor 2021, f.11,12, <https://awenetwork.org/media/646208786d90c.pdf>, aksesuar më 06.02.2024

¹³². Masa të përkohshme përfshijnë kuotat për të arritur përfaqësim të barabartë gjinor, rritjen e pjesëmarrjes së gjinisë më pak të përfaqësuar në vendimmarrje dhe në jetën publike, fuqizimin ekonomik dhe të pozitës së personave të secilës gjini në fushën e punës, përmirësimin në mënyrë të barabartë të nivelit arsimor, si dhe masa të tjera në çdo fushë, ku personat e njëjës gjini nuk gëzojnë pozitë të barabartë me personat e gjinisë tjetër. Faktorët që pengojnë pjesëmarrjen e grave në vendimmarrje, u referohet paragjyqimeve. Diferencat gjinore në preceptimin e gruas politikane, mund të jenë të lidhura me natyrën patriarkale të shoqërisë shqiptare. Statistikat flasin për një diskriminim të dukshëm të grave dhe vajzave në tregun e punës, në sistemin e pagave dhe në pjesëmarrjen në pronën private. Për sa i përket dhunimit të grave brenda familjes, vazhdon të mbetet një nga tematikat më problematike në Shqipëri.¹³³ Dhuna me bazë gjinore vazhdon të mbetet problematike në shoqëri. Duhet të ndërmerren fushata ndërgjegjësuere për ndaljen e dhunës ndaj grave. Steriotimet negative ndaj seksit femër janë të pranishme në të gjitha sferat e punësimit.

Femrat dhunohen në ambjentet universitare në rrugë kur shkojnë, në ambjentet shoqerore kolektive, në ambjentet akademike, në parlament, këto janë të papranueshme në një shoqëri njerezore demokratike të zhvilluar. Duhet të rriten masat ndëshkuese ndaj personave që janë subjekte të diskriminimit. Duhet të bëhen fushata ndërgjegjësuere në shoqëri për parandalimin e fenomeneve të tilla. Institucioni bazë kundër diskriminimit është Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ai duhet të marrë një rol aktiv për mbrojtjen e individëve që janë objekt i diskriminimit. Mediat duhet të luajnë një rol aktiv për fuqizimin e rolit të Grave dhe vajzave në jetën publike.

¹³² Po aty. ¹³² “Strategjia kombëtare për barazinë gjinore”, 2021-2030, miratuar me VKM 400, datë 30.06.2021, qershor 2021, f.11,12, <https://awenetwork.org/media/646208786d90c.pdf>, aksesuar më 06.02.2024

¹³³ Arjana Llano, “Të Drejtat e Grave në Shqipëri”, Pavarësia Scienific Journal ISSN 2304-2664, mars 2018, f.140

Pjesëmarrja e grave në tregun e punës

Problem kyç për të kuptuar është se ku qëndrojnë gratë në tregun e punës¹³⁴. Prandaj, kjo pjesë ofron një përmbledhje të pjesëmarrjes së grave në tregun e punës të BE-së, duke marrë parasysh evoluimin e shkallës së punësimit sipas gjinisë gjatë pesëmbëdhjetë viteve të fundit, shpërndarja e punës me kohë të pjesshme kontratat midis grave dhe burrave, si dhe arsyet e zgjedhjes së një pune me kohë të pjesshme. Informacioni që vijon, është marrë nga faqja e internetit të Zyrës së Eurostatit, pjesë e statistikave të Departamentit të Bashkimit Evropian. Faqja e internetit e Eurostat ofron të dhëna të përshtatura nga Anketa e Fuqisë Punëtore të Bashkimit Evropian (BE-AFP), që kryhet nga statistikat kombëtare në institutet në të gjithë Evropën. Anketa e fuqisë punëtore të Bashkimit Evropian (EU-AFP) jep shifra për karakteristikat e tregut të punës, si normat e punësimit dhe të papunësisë, orët e punës dhe pasiviteti, si dhe karakteristikat socio-demografike, si mosha, seksi dhe vendi të vendbanimit.

Sipas Eurostat, të dhënat janë përfaqësuese për një popullsi të moshuar ndërmjet 15 dhe 74 vjeç (në Spanjë, Itali, Mbretërinë e Bashkuar dhe Islandë, gama e popullsisë është nga 16 deri në 74 vjeç). Për më tepër, saktësia e të dhënave mund të konsiderohet e lartë. Shkalla e punësimit Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD), përcakton shkallën e punësimit si më poshtë: Një masë në të cilën përdoren burimet e disponueshme të punës (njerëzit e disponueshëm për të punuar).¹³⁵ Ato llogariten si raport i të punësuarve ndaj popullsisë në moshë pune. Normat e punësimit janë të ndjeshme ndaj ciklit ekonomik, por në terma afatgjatë ato ndikohen ndjeshëm nga qeveritë, nga arsimi i lartë dhe politikat e mbështetjes së të ardhurave

¹³⁴Zyrës së Eurostatit, statistikore departamenti i Bashkimit Evropian,
https://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/index.php?title=Eurostat_and_the_European_Statistical_System

¹³⁵ ¹³⁵Zyrës së Eurostatit, statistikore departamenti i Bashkimit Evropian,
https://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/index.php?title=Eurostat_and_the_European_Statistical_System

dhe nga politikat që lehtësojnë punësimin e grave dhe grupet e pafavorizuara.

Nga përkufizimi i mëparshëm, është e rëndësishme të theksohet roli i rëndësishëm i qeverive që luajnë në përmirësimin e pjesëmarrjes së femrave në tregjet e punës, si dhe ndikimin që kanë politika për punësimin e grave. Këto politika publike përfshijnë pushimin e lehonisë, mbështetje për kujdesin ndaj fëmijëve dhe rregulloret për kushtet e punës.. Për momentin, grafiku 1, më poshtë, tregon evoluimin e shkallës së punësimit sipas gjinisë në përqindje terma, nga viti 2005 deri në vitin 2020. Duke parë grafikun, mund të vlerësohet se gratë kanë rritur pjesëmarrjen e tyre në tregjet e punës, por meshkujt ende dominojnë skenën. Deri në fund të vitit 2020, shkalla e punësimit të grave ishte 66,8 për qind, ndërsa ajo e burrave ishte 78,1 për qind. Ndërsa gjatë pesëmbëdhjetë viteve të fundit shkalla e punësimit të femrave është rritur rreth 8.2 për qind pikë, shkalla e punësimit të meshkujve është luhatur rreth 76 për qind, duke mos treguar asgjë të veçantë. Pavarësisht përmirësimit të vogël që mund të shoqërohet me shkallën e punësimit të grave gjatë pesëmbëdhjetë viteve të fundit, duke parë grafikun ka dëshmi për mbizotërimin e burra në tregjet e punës.¹³⁶ Kjo lidhet me praninë e fortë të patriarkatit në ato shoqëri e sheh figurën e një njeriu si person autoritar në të gjitha aspektet e ndryshme të jetës, dhe rrjedhimisht çon në struktura dhe mjedise diskriminuese për gratë. Për më tepër, gratë kanë më shumë gjasa të përballet me kushte të pasigurta pune për shkak të kompensimit më të vogël financiar, mungesës së Mbrotjes sindikatale dhe më pak mundësi që lidhen me tejkalimin e detyrimeve familjare (Të rinjtë, 2010). Sidoqoftë, termi punë e pasigurt përdoret për t'iu referuar një pune që paguhet dobët, të pasigurt dhe të paaftë për të mbështetur familjet. Kështu, kjo krijon kushtet që gratë ose të lënë punën, ose të zgjedhin të punojnë pjesërisht.¹³⁷

¹³⁶Zyra statistikore e Eurostatit, departamenti i Bashkimit Evropian, https://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/statistikore/index.php?title=Eurostat_and_the_European_Statistical_System

¹³⁷ Zyra statistikore e Eurostatit, departamenti i Bashkimit Evropian, <https://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/statistikore>

Në të vërtetë, sipas Komisionit Evropian (2020) gratë fitojnë 14.1 për qind më pak në orë në krahasim me meshkujt. Në veçanti, për çdo 1 euro që fiton një burrë, një grua fiton 86 cent. Kjo do të thotë që një grua punon për rreth dy javë falas në krahasim me një burrë, për më tepër, ajo fiton më pak në orë edhe për të njëjtën punë, pavarësisht nëse puna konsiderohet punë me aftësi të larta si menazher, ose punë me aftësi të ulëta si shitës (Komisioni Evropian, 2020).¹³⁸ Të papunë ose të pambrojtur Gratë që duan të punojnë e kanë më të vështirë të gjejnë një punë sesa burrat. Ky problem është veçanërisht i theksuar në Afrikën Veriore dhe Shtetet Arabe, ku shkalla e papunësisë për gratë tejkalon 20%. Ndërsa punësimi i pambrojtur është i përhapur si për gratë ashtu edhe për burrat, gratë priren të jenë të mbipërfaqësuar në lloje të caktuara të punëve të cënueshme: burrat kanë më shumë gjasa të punojnë në punë për llogari të tyre, ndërsa gratë kanë më shumë gjasa të ndihmojnë në familjet e tyre ose në bizneset e të afërmeve.¹³⁹

Pra, pabarazia midis grave dhe burrave është e dukshme dhe pozita diskriminuese ndaj saj. Gjykata kushtetuese në një vendim të saj ndër të tjera ka theksuar: *“Gjykata konstaton se Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi e konkretizon nenin 18 të Kushtetutës, pra respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimin në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”*¹⁴⁰ Po sipas këtij ligji, parimi i barazisë nënkupton:

/index.php?title=Eurostat_and_the_European_Statistical_System

¹³⁸ Po aty

¹³⁹ [ILOhttps://www.ilo.org/infostories/en-GB/Stories/Employment/barriers-women#unemployed-vulnerable](https://www.ilo.org/infostories/en-GB/Stories/Employment/barriers-women#unemployed-vulnerable), aksesuar më 25.11.2023

¹⁴⁰ Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, Vendim nr. 48, datë 15.11.2013(V-48/13)<https://www.kmd.al/wp-content/uploads/2021/04/Vendim-i-Gjykatës-Kushtetuese-48-2013.pdf>, aksesuar më 25.11.2023

a) barazi përpara ligjit dhe mbrojtje të barabartë nga ligji; b) barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat, për të gëzuar liritë dhe për të marrë pjesë në jetën publike; c) mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin, (neni 1 dhe 2) i Ligjit”¹⁴¹.

3.4 Direktiva (BE) 2022/2381 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit Për Përmirësimin e Ekuilibrit Gjnjor

(1) Sipas nenit 2 të Traktatit për Bashkimin Evropian (TEU), barazia është një vlerë themeluese e Bashkimit dhe është e përbashkët për Shtetet Anëtare në një shoqëri në të cilën mbizotëron barazia midis grave dhe burrave.¹⁴² Sipas nenit 3(3) TEU, Bashkimi ka detyrë të promovojë barazinë midis grave dhe burrave. (2) Neni 157(3) i Traktatit për Funksonimin e Bashkimit Evropian (TFEU) i jep BE-së Parlamentit dhe Këshillit kompetencën për të miratuar masa për të siguruar zbatimin e parimit të barazisë mundësitë dhe trajtimi i barabartë i burrave dhe grave në çështjet e punësimit dhe profesionit. (3) Me synimin për të siguruar barazi të plotë në praktikë midis burrave dhe grave në jetën e punës, neni 157(4) TFBE lejon veprimin pozitiv duke lejuar Shtetet Anëtare të mbajnë ose miratojnë masa që parashikojnë avantazhe specifike për ta bërë më të lehtë për seksin e nënpërfaqësuar të ndjekë

¹⁴¹ Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, Vendim nr. 48 datë 15.11.2013(V-48/13)<https://www.kmd.al/wp-aksesuarne25.11.2023content/uploads/2021/04/Vendim-i-Gjykates-Kushtetuese-48-2013..pdf> aksesuar më

¹⁴² DIRECTIVE (EU) 2022/2381, OF THE EUROPEAN PARLIAMENT AND OF THE COUNCIL, of 23 November 2022, on improving the gender balance among directors of listed companies and related measures, <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:32022L2381>, aksesuar më 25.11.2023.

një aktivitet profesional ose për të parandaluar ose kompensuar për disavantazhet në karrierën profesionale.¹⁴³

Neni 23 i Kartës së të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian ("Karta") parashikon që barazia midis grave dhe burrave duhet të sigurohet në të gjitha fushat dhe se parimi i barazisë nuk mund të pengojë ruajtjen ose miratimin e masave, që parashikojnë avantazhe specifike në favor të seksit të nënpërfaqësuar. (4) Karta Evropiane e të Drejtave Sociale, e cila u shpall bashkërisht nga Parlamenti Evropian, Këshilli dhe Komisioni në vitin 2017, përfshin ndër parimet e tij barazinë e trajtimit dhe mundësive ndërmjet grave dhe burrat, duke përfshirë pjesëmarrjen në tregun e punës, termat dhe kushtet e punësimit dhe karrierës në progresion. (5) Arritja e barazisë gjinore në vendin e punës kërkon një qasje gjithëpërfshirëse, e cila përfshin edhe nxitjen në vendimmarrjen e balancuar gjinore brenda kompanitve në të gjitha nivelet, si dhe mbyllja e hendekut gjinor të pagave.¹⁴⁴

Sigurimi i barazisë në vendin e punës është gjithashtu një parakusht kryesor për uljen e varfërisë tek gratë. Rekomandimi i Këshillit 84/635/KEE (4) rekomandoi që Shtetet Anëtare të ndërmarrin hapa për të siguruar që veprimi pozitive përfshin, për aq sa është e mundur, veprime që kanë të bëjnë me pjesëmarrjen aktive të grave në vendimmarrje. Rekomandimi i Këshillit 96/694/KE (5) rekomandoi që Shtetet Anëtare të inkurajojnë sektorin privat rritjen e pranisë së grave në të gjitha nivelet e vendimmarrjes, veçanërisht me adoptimin, ose

¹⁴³ DIRECTIVE (EU) 2022/2381 OF THE EUROPEAN PARLIAMENT AND OF THE COUNCIL,

of 23 November 2022, on improving the gender balance among directors of listed companies and related measures,
<https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:32022L2381>,
aksesuar më 25.11.2023.

¹⁴⁴ DIRECTIVE (EU) 2022/2381, OF THE EUROPEAN PARLIAMENT AND OF THE COUNCIL, of 23 November 2022, on improving the gender balance among directors of listed companies and related measures,
<https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:32022L2381>,
aksesuar më 25.11.2023.

brenda kornizën e planeve të barazisë dhe programeve të veprimit pozitiv. (7) Kjo direktivë synon të sigurojë zbatimin e parimit të mundësive të barabarta ndërmjet grave dhe burrave dhe arritjen e një përfaqësimi të balancuar gjinor në pozitat e larta drejtuese duke krijuar një grup të kërkesat procedurale në lidhje me përzgjedhjen e kandidatëve për emërim ose zgjedhje në postet e drejtorit bazuar në transparencë dhe merita. (8) Në vitet e fundit Komisioni ka paraqitur disa raporte, duke bërë një pasqyrë të situatës në lidhje me barazinë gjinore në vendimmarrjen ekonomike. Ajo ka inkurajuar kompanitë e listuara të rrisin numrin e anëtarëve të seksit të nënpërfaqësuar në bordet e tyre me anë të masave vetërregulluese dhe për të bërë konkrete angazhimet vullnetare në këtë drejtim. Në komunikimin e tij të datës 5 mars 2010, të titulluar: *“Një angazhim i forcuar për barazinë ndërmjet grave dhe burrave”*.

Komisioni nënvizoi se gratë ende nuk e kanë akses të plotë në ndarjen e pushtetit dhe vendimmarrje në jetën politike dhe ekonomike dhe në atë publike dhe private sektorëve dhe ripohoi angazhimin e saj për të përdorur fuqitë e saj për të ndjekur një përfaqësim më të drejtë të grave dhe burrave në pozicionet e pushtetit në jetën publike dhe në ekonomi.¹⁴⁵ Përmirësimi i ekuilibrit gjinor në vendimmarrje ishte një nga prioritetet e përcaktuara nga Komisioni në komunikatën e tij të datës 21 shtator 2010 me titull “Strategjia për barazi ndërmjet femra dhe meshkuj 2010-2015”¹⁴⁶ Ligji për barazinë gjinore duhet të jetë i përafëruar me Direktivat e Bashkimit Evropian për Barazinë Gjinore .Ky ligj është nxjerr në vitin 2008 dhe ka nevojë për ndryshime dhe përmirësime. Në shtetin e së Dejtës merren masa për përafrimin e legjislacionit me atë të Bashkimit Evropian, kjo rrjedh nga Marrëveshja e Stabilizim Asociimit.

Strategjia e Barazisë Gjinore 2020-2025 Strategjia e BE-së për Barazinë Gjinore përmbush angazhimin e Komisionit von der Leyen për

¹⁴⁵ ¹⁴⁵ Po aty <https://op.europa.eu/en/publication-detail/-/publication/c58de824-e42a-48ce-8d36-a16f30ef701b/language-en>

¹⁴⁶ Po aty <https://op.europa.eu/en/publication-detail/-/publication/c58de824-e42a-48ce-8d36-a16f30ef701b/language-en>

arritjen e një Unioni të Barazisë. Strategjia paraqet objektivat dhe veprimet e politikave për të bërë përparim të rëndësishëm deri në vitin 2025 drejt një Evrope të barabartë gjinore¹⁴⁷. Qëllimi është një bashkim ku gratë dhe burrat, vajzat dhe djemtë, në të gjithë diversitetin e tyre, janë të lirë të ndjekin rrugën e tyre të zgjedhur në jetë, të kenë mundësi të barabarta për të lulëzuar dhe mund të marrin pjesë në mënyrë të barabartë dhe të udhëheqin shoqërinë tonë evropiane. Objektivat kryesore janë t'i jepet fund dhunës me bazë gjinore; stereotipe sfiduese gjinore; mbyllja e hendeqeve gjinore në tregun e punës; arritjen e pjesëmarrjes së barabartë në sektorë të ndryshëm të ekonomisë; adresimi i hendekut gjinor të pagave dhe pensione; mbyllja e hendekut të kujdesit gjinor dhe arritja e ekuilibrit gjinor në vendimmarrje dhe në politikë.¹⁴⁸ Strategjia ndjek një qasje të dyfishtë të integritetit gjinor të kombinuar me veprime të synuara dhe ndërsektorialiteti është një parim horizontal për zbatimin e saj. Ndërsa Strategjia fokusohet në veprimet brenda BE-së, ajo është koherente me politikën e jashtme të BE-së për barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave. Si një nga rezultatet e para të Strategjisë, Komisioni propozoi masa të detyrueshme të transparencës së pagave më 4 mars 2021.

Direktiva për Transparencën e Pagave u miratua në maj 2023. Rregullat e reja do të ndihmojnë për të siguruar që parimi i pagës së barabartë për punë ose punë të barabartë me vlerë të barabartë, të sanksionuar në Traktat që nga viti 1957, më në fund bëhet realitet në terren. Më 8 mars 2022, Komisioni Evropian miratoi një propozim të ri në mbarë BE-në për një direktivë për të luftuar dhunën ndaj grave dhe dhunën në familje. Bashkëligjvënësit arritën marrëveshje politike më 6 shkurt 2024 për këtë propozim. Direktiva është instrumenti i parë ligjor gjithëpërfshirës në nivel të BE-së për të trajtuar dhunën ndaj grave, e

¹⁴⁷ Gender Equality Strategy 2020-2025 https://commission.europa.eu/strategy-and-policy/policies/justice-and-fundamental-rights/gender-equality/gender-equality-strategy_en

¹⁴⁸ ¹⁴⁸ Gender Equality Strategy 2020-2025 https://commission.europa.eu/strategy-and-policy/policies/justice-and-fundamental-rights/gender-equality/gender-equality-strategy_en

cila është ende shumë e përhapur. Ai kriminalizon forma të caktuara të dhunës fizike, si offline ashtu edhe online. Direktiva parashikon gjithashtu masa gjithëpërfshirëse për mbrojtjen e viktimave, aksesin në drejtësi dhe mbështetje, të tilla si strehimoret, qendrat e krizave dhe linjat e ndihmës.¹⁴⁹ Një tjetër arritje historike është Direktiva për balancën gjinore në bordet e korporatave, e cila synon të përmirësojë balancën gjinore në pozicionet vendimmarrëse të korporatave në kompanitë më të mëdha të listuara në BE. Pas 10 vitesh negociatash, Direktiva u miratua përfundimisht më 22 nëntor 2022¹⁵⁰. Ky ligj i ri i BE-së do të ndihmojë në thyerjen e tavanit prej xhami në bordet e kompanive të listuara dhe do t'u japë shumë grave të kualifikuara për punët kryesore një shans real për t'i marrë ato.

Që nga gushti 2022, filluan të zbatohen të drejtat e reja në mbarë BE-në për balancimin e punës dhe jetës për prindërit dhe kujdestarët. Në shtator 2022, Komisioni prezantoi Strategjinë Evropiane të Kujdesit, të lidhur me objektivat e reja për edukimin dhe kujdesin në fëmijërinë e hershme për të rritur pjesëmarrjen e grave në tregun e punës. Komisioni Evropian nisi një fushatë për të sfiduar stereotipet gjinore, më 8 mars 2023. Fushata #EndGenderStereotypes, e shpërndarë gjatë gjithë vitit 2023, trajtoi stereotipet gjinore që prekin si burrat ashtu edhe gratë në sfera të ndryshme të jetës, duke përfshirë zgjedhjet e karrierës, ndarjen e përgjegjësisë të kujdesit dhe vendimmarrjen¹⁵¹. Në tetor 2023, Komisioni u bë palë e Konventës së Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje - Konventa e Stambollit. BE-ja tani është e detyruar nga standarde

¹⁴⁹ ¹⁴⁹ Gender Equality Strategy 2020-2025 https://commission.europa.eu/strategy-and-policy/policies/justice-and-fundamental-rights/gender-equality/gender-equality-strategy_en

¹⁵⁰ Gender Equality Strategy 2020-2025 https://commission.europa.eu/strategy-and-policy/policies/justice-and-fundamental-rights/gender-equality/gender-equality-strategy_en

¹⁵¹ Gender Equality Strategy 2020-2025 https://commission.europa.eu/strategy-and-policy/policies/justice-and-fundamental-rights/gender-equality/gender-equality-strategy_en

ambicioze dhe gjithëpërfshirëse për të parandaluar dhe luftuar dhunën ndaj grave në fushën e bashkëpunimit gjyqësor në çështjet penale, azilin dhe moskthimin dhe në lidhje me administratën e saj publike. Kjo përfshin financimin, politikat dhe masat legjislative.

Në vjeshtën e vitit 2023, Komisioni krijoi një rrjet të BE-së për parandalimin e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje. Rrjeti ofron hapësirën për Shtetet Anëtare dhe palët e interesuara për të diskutuar çështje të reja dhe në zhvillim të parandalimit të dhunës, shkëmbimit të njohurive dhe praktikave të mira.¹⁵²

Strategjia Kombëtare për barazinë gjinore ka përcaktuar objektivat për arritjen e barazisë:

- T'u jepet fund kudo të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave dhe vajzave.¹⁵³
- Të eliminohen të gjitha format e dhunës ndaj grave dhe vajzave në sferën publike dhe private.
- Të eliminohen të gjitha praktikat e dëmshme siç janë martesat e fëmijëve, martesat në moshë të hershme, martesat e detyruara dhe gjymtimi gjenital femëror.
- Të njihet dhe të vlerësohet kujdesi dhe puna shtëpiake pa pagesë, përmes dhënies së shërbimeve publike, infrastrukturës dhe politikave të mbrojtjes sociale dhe përkrahjes së përgjegjësisë të përbashkëta brenda shtëpisë dhe familjes, në përputhje me praktikat kombëtare.
- Të sigurohet pjesëmarrja e plotë dhe efektive e grave, dhënia e mundësive të barabarta për udhëheqjen e tyre në të gjitha nivelet e vendimmarrjes në jetën politike, ekonomike dhe publike.
- Të ndërmerren reforma për t'i dhënë grave të drejta të barabarta mbi burimet ekonomike, të drejta pronësie dhe kontrolli mbi tokën dhe forma

¹⁵² Gender Equality Strategy 2020-2025 https://commission.europa.eu/strategy-and-policy/policies/justice-and-fundamental-rights/gender-equality/gender-equality-strategy_en

¹⁵³ “Strategjia kombëtare për barazinë gjinore”, 2021-2030, miratuar me VKM 400, datë 30.06.2021, qershor 2021, f.11,12, <https://awenetwork.org/media/646208786d90c.pdf>, aksesuar më 06.02.2024

të tjera të pronësisë, të shërbimeve financiare, të trashëgimisë dhe burimeve natyrore, në përputhje me ligjet kombëtare.

- Të përkrahet fuqizimi i grave duke rritur përdorimin e teknologjisë, në veçanti teknologjinë e informacionit dhe të komunikimit.

- Të miratohen dhe të forcohen politikat e shëndosha dhe legjislacioni i zbatueshëm në përkrahjen e barazisë gjinore dhe fuqizimin e të gjitha grave dhe vajzave në të gjitha nivelet.¹⁵⁴

¹⁵⁴ Po aty “*Strategjia kombëtare për barazinë gjinore*”, 2021-2030, miratuar me VKM 400, datë 30.06.2021, qershor 2021, f.11,12,
<https://awenetwork.org/media/646208786d90c.pdf>, aksesuar më 06.02.2024

KREU IV

GJUHA E URREJTJES

4.1 Kuptimi i gjuhës së urrejtjes

“Gjuha e urrejtjes” është çdo formë e shprehjes në publik, me çdo mjet, gjuha e promovimit, nxitjes së denigrimit, urrejtjes ose shpifjes, çdo shqetësim, fyerje, stereotip negativ, stigmatizim, ose kërcënim ndaj një personi ose grupi personash, si dhe çdo justifikim i të gjitha formave të shprehjes e bazuar në një listë joshteruese të shkaqeve¹⁵⁵ Në mënyrë më gjithëpërfshirëse, Kombet e Bashkuara e përkufizojnë gjuhën e urrejtjes si: *“Çdo lloj komunikimi verbal, me shkrim apo sjellje, që sulmon, ose përdor gjuhë përçmuese, apo diskriminuese ndaj një personi, ose grupi për shkak të asaj se kush janë, ose ndryshe, për shkak të fesë, etnisë, kombësisë, racës, ngjyrës, prejardhjes, gjinisë, ose faktorëve të tjerë të identitetit. Kjo shpesh e ka zanafillën në nxitjen e denigrimit dhe shkakton intolerancë e urrejtje, dhe në rrethana të caktuara mund të jetë poshtëruese ose përçarëse.”*¹⁵⁶

Ndikimi i gjuhës së urrejtjes dhe intolerancës sot ka marrë përmasa mbresëlënëse. Edhe ndikimi shkatërrues është rritur pjesërisht nga përdorimi i të rejave të teknologjisë e informacionit.¹⁵⁷ Retorika e

¹⁵⁵ Ligj Nr. 10 221, datë 04.02.2010, Për mbrojtjen nga diskriminimi, (Ndryshuar me Ligjin Nr. 124/2020) neni 3 pika 8.

¹⁵⁶ Manual për monitorimin e gjuhës së urrejtjes dhe diskriminimit me bazë gjinore në Shqipëri, prodhuar nga Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, © Prezenca e OSBE-së në Shqipëri, 2021, përgatitur nga: Viacheslav Likhachev-Pjesa I Iris Luarasi,- Pjesa II, <https://www.kmd.al/wp-content/uploads/2022/02/Toolkit-ALBANIAN.pdf>.

¹⁵⁷ FROM HATE SPEECH TO NON-VIOLENT COMMUNICATION Ismanov, A., Kupueva, N., Stanaliev, G.,

armiqësisë, urrejtja e përhapur në mediat sociale dhe mesazhet e çastit çënojnë kohezionin social të qytetarëve, krijojnë mosbesim dhe intolerancë, mbjellin panik, provokojnë njerëzit ndaj veprimeve të paligjshme, duke krijuar terren për konflikt tensioni. Paqartësia e statusit ligjor të gjuhës së urrejtjes është përdorur si çënim i lirisë së shprehjes kundër disidentëve dhe kundërshtarëve. Në të njëjtën kohë, ka pasur pak përgjigje apo edhe injorancë të rasteve reale të gjuhës së urrejtjes, duke gjeneruar dhunë dhe diskriminim ndaj shtresave vulnerabël të shoqërisë. E gjithë kjo, shkakton zhgënjim në shoqëri kështu që ka më shumë thirrje për të kufizuar këtë apo atë platformë online ose qasje plotësisht të ngushtë në të. Kështu, lufta kundër nxitjes së urrejtjes, ngushton faktet e manifestimit të gjuhës së urrejtjes në drejtim të kufizimit të aktiviteteve të platformave online. Kodi Penal përmban sanksione ndaj nxitjes së urrejtjeve.

Neni 265 Nxitja e urrejtjes ose grindjeve (Ndryshuar me ligjin nr. 144, datë 02.05.2013)

Nxitja e urrejtjes dhe e grindjeve për shkak të racës, etnisë, fesë ose orientimit seksual, si dhe përgatitja, përhapja ose ruajtja, me qëllim përhapjen e shkrimeve me përmbajtje të tillë, kryer me çdo mjet ose formë, dënohet me burgim nga dy deri në dhjetë vjet.¹⁵⁸

Toktogulova, M., Turdubaeva E, 2023© Prevention Media, Association of Communicators with the support of UNDP in the Kyrgyz Republic в КР, 2023 UNDP.

¹⁵⁸ Ligj Nr. 7895, datë 27.01.1995, Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, (Ndryshuar me: ligjet nr. 8175, datë 23.12.1996; nr. 8204, datë 10.4.1997; nr. 8279, datë 15.01.1998; nr. 8733, datë 24.01.2001; nr. 9017, datë 6.03.2003; nr. 9030, datë 13.03.2003; nr. 9086, datë 19.06.2003; nr. 9188, datë 12.02.2004; nr. 9275, datë 16.09.2004; nr. 9686, datë 26.02.2007; nr. 9859, datë 21.01.2008; nr. 10 023, datë 27.11.2008; nr. 23/2012, datë 01.03.2012; nr. 144, datë 02.05.2013; nr. 98, datë 31.7.2014; nr. 176/2014, datë 18.12.2014; nr. 135/2015, datë 05.12.2015; nr. 82/2016, datë 25.07.2016; nr. 36/2017, datë 30.03.2017; nr. 89/2017, datë 22.5.2017; nr. 44/2019, datë 18.7.2019, nr. 35/2020, datë 16.04.2020, nr. 146/2020, datë 17.12.2020; nr. 43/2021, datë 23.03.2021;

Vendimet e Gjykatës Kushtetuese: nr. 13, datë 29.05.1997; nr. 46, datë 28.08.1997; nr. 58, datë 05.12.1997; nr. 65, datë 10.12.1999; nr. 11, datë 02.04.2008; nr. 19, datë 01.06.2011; nr. 47, datë 26.07.2012; nr. 9, datë 26.02.2016;

Thirrja për urrejtje nacionale (Shtuar fjalë me ligjin nr. 144, datë 02.05.2013)

Vënia në rrezik e paqes publike, duke bërë thirrje për urrejtje kundër pjesëve të popullsisë, duke i fyer ose shpifur për to, duke kërkuar përdorimin e dhunës, ose të veprimeve arbitrare kundër tyre, dënohet me burgim nga dy deri në tetë vjet.¹⁵⁹

Në Strategjinë dhe Planin e Veprimit të OKB-së për Luftimin e Urrejtjes, Fjalimi i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së, António Guterres thekson se: *“luftimi i gjuhës së urrejtjes nuk nënkupton kufizimin ose ndalimin e lirisë së fjalës*¹⁶⁰ Dragoti u shpreh se gjuha e urrejtjes është shumë e thjeshtë për shqiptarët dhe e trashëguar nga kultura patriarkale, nga mungesa e kulturës, nga fakti i të qenit të paorganizuar etj. Stresi, sipas tij, është motivues i jashtëzakonshëm për gjuhën e urrejtjes. *“Gjuha e urrejtjes është shumë e thjeshtë për ne shqiptarët. Ushtrojmë një lloj presioni ndaj tjetrit. Agresiviteti për ne ka qenë mekanizëm mbrojtës për të mbijetuar në një vend pa të ardhur të sigurt, nën presionin e fqinjëve. Një gjuhë e tillë urrejtjeje trashëgohet dhe në kulturën patriarkale. Fakti që jemi të paorganizuar, jemi rastësorë në shumë aspekte. Ne shqiptarët gjenerojmë emocione pa kufi. Mungesa e kulturës të jep lirinë e shprehjes pa kufi. Pas viteve ’90, njerëzit ishin të liruar në të gjitha aspektet. Një njeri pa kufi është inekzistent në thelb”, - shprehet Dragoti*¹⁶¹.

nr. 24, datë 04.05.202, <https://qbz.gov.al/preview/a2b117e6-69b2-4355-aa49-78967c31bf4d1>, aksesuar më 20.02.2024.

¹⁵⁹ Po aty

¹⁶⁰ FROM HATE SPEECH TO NON-VIOLENT COMMUNICATION Ismanov, A., Kupueva, N., Stanaliev, G.,

Toktogulova, M., Turdubaeva E, 2023, ©Prevention Media, Association of Communicators with the support of UNDP in the Kyrgyz Republic в КР, 2023 UNDP.

¹⁶¹ *Gjuha e urrejtjes*/Dragoti, E. në “Jetë Shqiptare”: Shkak, mungesa e kulturës kulturës <https://lajme.rts.al/artikull/gjuha-e-urrejtjes-sociologu-dragoti-ne-jete-shqiptare-shkak-mungesa-e-kulturës>

Gjuha e urrejtjes është e përhapur gjerësisht, por lë për të dëshiruar kur përdoret nga politika dhe nga media.¹⁶² Media e ka të ndaluar të përdorë gjuhën e urrejtjes, kjo e sanksionuar nga ligji për mediat audiovizive nga Kodi i Etikës në Medias I 2018. Pozitiv është fakti që për shumicën e gazetarëve të medias audiovizive, gjuha e urrejtjes nuk është fenomen i panjohur. Nga gazetarët e anketuar, 36% e tyre shprehen se kanë shumë njohuri mbi gjuhën e urrejtjes, 28% pak dhe 36 % disa njohuri, ndonëse më shumë se gjysma e tyre nuk janë në gjendje të japin një përkufizim. Megjithatë, vlen të theksohet se ende nuk ka një përkufizim të gjithëpranuar nga studiuesit se çfarë është gjuha e urrejtjes, ndërsa universiteti është burimi kryesor i njohurive të gazetarëve mbi gjuhën e urrejtjes; vetëm 22% e të anketuarve shprehen se njohuritë i kanë marrë në median ku punojnë dhe 19% në trajnime të ndryshme¹⁶³.

Politika prodhon më shumë gjuhë urrejtjeje në media, por ky fakt nuk përjashton rolin e gazetarëve si një hallkë e rëndësishme në parandalimin dhe kufizimin e shfaqjes së këtij fenomeni. Gazetarët duhet të jenë më të vëmendshëm dhe selektiv në informacionin që përçojnë, pavarësisht burimit. Për të frenuar gjuhën e urrejtjes, nevojitet funksionimi i bordeve të etikës si një instrument vetërregullues i medias.¹⁶⁴ -Rritja e ndërgjegjësimit dhe edukimit të gazetarëve nëpërmjet trajnimeve të ndryshme shfaqet si domosdoshmëri. - Gjithashtu, kërkohet përmirësimi i mëtejshëm i kurrikulës mësimore në universitet në lëndët që trajtojnë këtë dukuri, si psh. tek Etika e Medias (module të veçanta) etj. Si reflektim i ndryshimeve të shpejta në mjedisin mediatik. Krahas rritjes së ndërgjegjësimit të gazetarëve, nevojitet zhvillimi i studimeve të mëtejshme, ku fokusi të mos jetë

¹⁶² ¹⁶² “Gjuha e urrejtjes në mediat audiovizive”, Studime dhe analiza të prezantuara në Tryezën e Rrumbullakët, organizuar nga Këshilli i Ankesave pranë AMA-s, Loreta Axhami, Gjuha e urrejtjes dhe profesionalizmi i gazetarëve f.6

¹⁶³ “Gjuha e urrejtjes në mediat audiovizive”, Studime dhe analiza të prezantuara në Tryezën e Rrumbullakët, organizuar nga Këshilli i Ankesave pranë AMA-s, Loreta Axhami, Gjuha e urrejtjes dhe profesionalizmi i gazetarëve f.6

¹⁶⁴ Po aty f.9

vetëm tek gazetarët, por edhe tek audiencat në kushtet kur ka një rritje të interaktivitetit mes medias dhe audiencës.¹⁶⁵

Kodi më i ri i 2018-s thekson: “*Media duhet të mos botojë materiale që nxisin urrejtje apo dhunë ndaj individëve mbi bazën e racës, fesë, kombësisë, ngjyrës, origjinës etnike, anëtarësisë, gjinisë, orientimit seksual, statusit civil, paafhtësisë, sëmundjes apo moshës*”¹⁶⁶. Ky parim plotësohet më tej, më në detaje, me përcaktimet e tjera lidhur me ndërhyrjet në jetën private, nxitjen e krimit, dhunës apo me mbrojtjen e fëmijëve dhe personave me aftësi të kufizuara. (IShM, Kodi i Etikës së Gazetarit, 2018) Pavarësisht faktit se sa influencë kanë kodet në punën e përditshme të stafëve redaktuese dhe ç’rrugë duhet të ndiqet për rritjen e efikasitetit të tyre në praktikë, mediat tona audiovizive kanë ditur ta shmangin gjuhën e urrejtjes, që fare natyrshëm nxit krimin, dhunën kurse rastet e veçuara që përmendëm më sipër, janë të kufizuara, sporadike dhe jo vazhdimësi e qëllimshme e shndërruar në një linjë editoriale.

Përveç Kodit Penal, ndalimi i gjuhës së urrejtjes është përfshirë në Ligjin për mediat audiovizive, nga rrjedh edhe Kodi i Transmetimit. Ka dy nene në këtë ligj, që përcaktojnë në mënyrë rigorozë detyrimet dhe kufizimet për operatorët radiotelevizivë; neni 32 dhe 76, sipas të cilëve: “*OSHMA-të nuk transmetojnë programe me përmbajtje që të nxitin urrejtjen mbi baza racore, gjinie, fetare, etnike, kombëtare dhe çdo formë tjetër diskriminimi*”. Të mirëpërcaktuara këto ndalime i ka edhe Kodi i Transmetimit, “gardian” i të cilit është Këshilli i Ankesave.¹⁶⁷ Kodi ynë Penal ka dispozita të veçanta kushtuar gjuhës së urrejtjes, të zbatueshme njëllë për të gjithë qytetarët, pra edhe për njerëzit e medias. Neni 265 i tij thekson shprehimisht: “*Nxitja e urrejtjes*

¹⁶⁵ Po aty f. 9

¹⁶⁶ GJUHA E URREJTJES NË MEDIAT AUDIOVIZIVE Studime dhe analiza të prezantuara në Tryezën e Rrumbullaktë, organizuar nga Këshilli i Ankesave pranë AMA-s, më 14.11.2018 f.14

¹⁶⁷ GJUHA E URREJTJES NË MEDIAT AUDIOVIZIVE Studime dhe analiza të prezantuara në Tryezën e Rrumbullaktë, organizuar nga Këshilli i Ankesave pranë AMA-s, më 14.11.2018 f.3, Gentian Sala.

dhe e grindjeve për shkak të racës, etnisë, fesë ose orientimit seksual, si dhe përgatitja, përhapja ose ruajtja, me qëllim përhapjen e shkrimeve me përmbajtje të tillë, kryer me çdo mjet ose formë, dënohet me burgim nga dy deri në dhjetë vjet". Ndërkaq, duhet theksuar se liria e fjalës nuk bie ndesh me sistemin ligjor, me çështjen e mbrojtjes së ligjeve.¹⁶⁸ Kur ligji apo një ndjekje penale nuk japin shpjegime të argumentuara se ku qëndron "nxitja nga fjalët e artikuluar publikisht apo nga përmbajtjet e hedhura në qarkullim", vetëm atëherë mund të thuhet se i është hapur rruga shkeljes flagrante të të drejtave të njeriut.¹⁶⁹

Vepra penale kryhet me veprime aktive të natyrës nxitëse, nëpërmjet të cilave arrihet të motivohet një person për të urreyer ose për t'u grindur me një person tjetër, që ka një përkatësi tjetër etnike, raciale, fetare. Në një kuptim të përgjithshëm, me fjalën *nxitje* do të kuptojmë ato veprime dhe fjalë të përdorura, të cilat ndikojnë që dikush tjetër ia shton dëshirën dikujt, për të kryer një vepër, duke bërë që të kryhet sa më shpejt. Nxitja arrihet me mjete dhe forma të ndryshme pa kufizim. Autori, nëpërmjet fjalëve dhe shprehjeve nxitëse, mundohet të drejtojë sjelljen e personit tjetër që të urrejë një person, që nuk ka atë përkatësi, për motive race pse i përket një race tjetër, që e konsiderojnë inferior me racën e tyre.¹⁷⁰

Politika prodhon më shumë gjuhë urrejtje në media, por ky fakt nuk përjashton rolin e gazetarëve si një hallkë e rëndësishme në parandalimin dhe kufizimin e shfaqjes së këtij fenomeni¹⁷¹. Gazetarët

¹⁶⁸ Po aty

¹⁶⁹ GJUHA E URREJTJES NË MEDIAT AUDIOVIZIVE Studime dhe analiza të prezantuara në Tryezën e Rrumbullaktë, organizuar nga Këshilli i Ankesave pranë AMA-s, më 14.11.2018 f.13

¹⁷⁰ Delo Meçani, E Drejta Penale Pjesa e posaçme Nentor 2017 Shtëpia boruese Europrint f.594,595

¹⁷¹ ¹⁷¹ GJUHA E URREJTJES NË MEDIAT AUDIOVIZIVE Studime dhe analiza të prezantuara në Tryezën e Rrumbullaktë, organizuar nga Këshilli i Ankesave pranë AMA-s, më 14.11.2018 f.13

duhet të jenë më të vëmendshëm dhe selektiv në informacionin që përçojnë, pavarësisht burimit.

-Për të frenuar gjuhën e urrejtjes nevojitet ngritja dhe funksionimi i bordeve të etikës si një instrument vetërregullues i medias.

-Rritja e ndërgjegjësimit dhe edukimit të gazetarëve nëpërmjet trajnimeve të ndryshme shfaqet si domosdoshmëri.

-Gjithashtu, kërkohet përmirësimi i mëtejshëm i kurrikulës mësimore në universitet në lëndët që trajtojnë këtë dukuri, si psh. tek Etika e medias (module të veçanta) etj. si reflektim i ndryshimeve të shpejta në mjedisin mediatik.

-Krahas rritjes së ndërgjegjësimit të gazetarëve nevojitet zhvillimi i studimeve të mëtejshme, ku fokusi të mos jetë vetëm tek gazetarët, por edhe tek audienatën kushtet kur ka një rritje të interaktivitetit mes medias dhe audiencës¹⁷² Stereotipet me bazë gjinore përbëjnë ndër shkeljet më flagrante të etikës së informacionit dhe komunikimit në media. Si përkufizime stilistike gjuhësore, stereotipet që lidhen me gratë dhe vajzat, të përdorura në medime masive sikurse është televizioni, kanë ndikim të drejtpërdrejtë në ngritjen e një opinionit të caktuar publik lidhur me statusin dhe të drejtat e grave.¹⁷³ Ekranit televiziv, edhe pse në konkurrencë të ashpër me magjinë e internetit mban ende supremacinë e informimit dhe edukimit publik, dhe kjo ndihet më së shumti në komunitetet lokale. Televizioni, sipas studiuesve të komunikimit dhe shkencave sociale, duke vënë në pah elementë të semantikës me përmbajtje paragjyquese ndikon drejtpërsëdrejti në sjellje dhe vlerësime të ndryshme sociale. *Sipas kërkimeve shkencore, stereotipet dhe diskriminimet mes dy gjinive në përmbajtjet mediatike kanë ardhur duke*

¹⁷² GJUHA E URREJTJES NË MEDIAT AUDIOVIZIVE Studime dhe analiza të prezantuara në Tryezën e Rrumbullaktë, organizuar nga Këshilli i Ankesave pranë AMA-s, më 14.11.2018 f.13 f.9

¹⁷³ Po aty GJUHA E URREJTJES NË MEDIAT AUDIOVIZIVE Studime dhe analiza të prezantuara në Tryezën e Rrumbullaktë, organizuar nga Këshilli i Ankesave pranë AMA-s, më 14.11.2018 f.13 f.21

*u shtuar e, për rrjedhojë, edhe impaktet e këtyre modeleve në shoqëri paraqesin rrezik në rritje.*¹⁷⁴

Një tjetër nen në Kodin Penal, që ka parashikuar si vepër penale thirrjen për urrejtje nacionale

Neni 266

Thirrja për urrejtje nacionale (Shtuar fjalë me ligjin nr. 144, datë 2.5.2013)

Vënia në rrezik e paqes publike duke bërë thirrje për urrejtje kundër pjesëve të popullsisë, duke i fyer ose shpifur për to, duke kërkuar përdorimin e dhunës ose të veprimeve arbitrare kundër tyre, dënohet me burgim nga dy deri në tetë vjet¹⁷⁵ Në një shoqëri demokratike është e ndaluar thirrja për urrejtje, individët duhet të jetojnë pa u shqetësuar, të gëzojnë të drejtat dhe liritë pa u shqetësuar dhe të jetojnë në harmoni dhe në paqe. Një grupim njerëzish që ushtrojnë ndikim të shumë njerëz, duke i trajtuar ata në mënyrë poshtëruese.¹⁷⁶ Fyerjet, shpifjet janë nga më të ndryshmet, të tilla që ulin dinjitetin e kësaj pjese, i prek si komunitet, duke u atribuar cilësi negative, përbuzëse, fjalë që përbëjnë shkak për përjashtim apo poshtërim. Ndërsa nëpërmjet fjalëve shpifëse u adresohen për cilësi negative që ata nuk i kanë, për kryerjen e një veprimi të padenjë, për sjellje që nuk janë të vërteta, por të sajara nga autori i veprës me efekte paragjyquese negative.¹⁷⁷

4.2 Rekomandimi Nr.15 i Politikës së Përgjithshme të ECRI-t për Luftimin e Gjuhës së Urrejtjes, Miratuar më 8 dhjetor 2015

Gjuha e urrejtjes për qëllimin e Rekomandimit nënkupton përdorimin e një ose më shumë formave të veçanta të shprehjes,

¹⁷⁴ Po aty f.21

¹⁷⁵ Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, 2021, <https://qbz.gov.al/preview/a2b117e6-69b2-4355-aa49-78967c31bf4d..>, aksesuar më 23.11.2023

¹⁷⁶ D. Meçani E Drejta Penale, Pjesa e posaçme, Nëntor 2017, Shtëpia botuese Europrint f.601

¹⁷⁷ Po aty.

përkatësisht avokimin, promovimin ose nxitjen e denigrimit, urrejtjes apo përgojimit të një personi ose grupi personash, si dhe çdo ngacmim, fyerje, stereotipizim negativ, stigmatizim, ose kërcënim i një personi, personave të tillë, dhe çdo justifikim të të gjitha këtyre formave të shprehjes, që bazohen në një listë joshteruese të karakteristikave personale, apo statusit, që përfshin “racën”, ngjyrën, gjuhën, fenë, besimin, kombësinë, ose prejardhjen kombëtare, apo etnike si dhe prejardhjen prindërore, moshën, aftësinë e kufizuar, seksin, gjininë, identitetin gjinor dhe orientimin seksual.¹⁷⁸ Pra gjuha e urrejtjes shprehet në format e veçanta të shprehjes, format e gjuhës së urrejtjes mund të jenë joshteruese.

Rekomandimi i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës 97(20) Për “Gjuhën e Urrejtjes”, e përkufizon si në vijim: “termi, gjuhë e urrejtjes duhet të kuptohet si përmbledhje e të gjitha formave të shprehjes që shpërndahen, nxisin, promovojnë ose justifikojnë urrejtjen racore, ksenofobinë, antisemitizmin ose format e tjera të urrejtjes, bazuar në mungesën e tolerancës, duke përfshirë: jotolerancën e shprehur nga nacionalizmi agresiv ose etnocentrizmi, diskriminim dhe armiqësinë ndaj minoriteteve, emigrantëve dhe njerëzve me origjinë migratore”. Ky rekomandim reforohet, kryesisht për gjuhën e urrejtjes, ndaj minoriteteve dhe emigrantëve. Vitet e fundit është vënë re një numër i madh personash që emigrojnë, për shkaqe të ndryshme ekonomike, sociale, politike. Do të ishte e padrejtë që ndaj emigrantëve të përdoret gjuha e urrejtjes, veçimi i tyre, diskriminimi në vendet në të cilët ata ndodhen. Kjo vlen dhe për minoritetet.

¹⁷⁸“Rekomandimi Nr.15 i politikës së përgjithshme të ECRI-t për luftimin e gjuhës së urrejtjes”, Miratuar më 8 dhjetor 2015, STRASBURG, 21 mars 2016, CRI (2016)15., Version albanaise Albanian version European Commission, Concil Europe, publikuar nga: Komisioni Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës (ECRI), Këshilli i Evropës, 2016., shtypur në Strasburg, <https://rm.coe.int/ecri-general-policy-recommendation-no-15-on-combating-hate-speech-alba/16809eb58e>

4.3 Përshkrimi i veprës dhe rregullimi ligjor

Gjuhë e urrejtjes, është çdo fjalë e shkruar, shqiptuar që degradon, poshtëron ose përhap urrejtje për një grup njerëzish, ose një bashkësi, që perceptohet si “ndryshe” për shkak të karakteristikave të saj, dhe nxit urrejtjen ekzistuese përmes ligjërimit publik, duke e zhvilluar, fuqizuar dhe thelluar¹⁷⁹. Komentet në mediat online dhe rrjetet sociale, fjalimet publike dhe deklaratat e udhëheqësve politikë/religjiozë, organizatat e djathta, materialet e shtypura, grafitet etj., janë të gjitha forma të fjalimit publik, që mund të nxisin dhe/ose të bëjnë thirrje të drejtpërdrejtë për dhunë ndaj “të tjerëve” ose “të ndryshmëve”, ose për t’i përbuzur ata për shkak të të qenit ndryshe. Nxitja e urrejtjes, ashtu si dhe gjuha e urrejtjes, nuk ka përkufizim të posaçëm në ligjet në fuqi në Shqipëri. Një pengesë serioze në praktikë e përbën mungesa e përkufizimeve të koncepteve kyçe, përkufizimi i “urrejtjes”, “nxitjes/përhapjes”, “mosmarrëveshjes” dhe “intolerancës”, si elemente themelore të këtyre veprave penale.

Kodi Penal Shqiptar nuk ka ndonjë përkufizim të gjuhës së urrejtjes, por mund të procedojë në kuadër të veprës penale, të ngjalljes së urrejtjes kombëtare, racore e të besimit, mosmarrëveshjeve dhe intolerancës. Kështu, sipas nenit 265 të Kodit Penal, “nxitja e urrejtjes ose grindjeve për shkak të racës, etnisë, fesë ose orientimit seksual si dhe përgatitja, përhapja ose ruajtja, me qëllim përhapjen e shkrimeve me përmbajtje të tillë, kryer me çdo mjet ose formë, dënohet me burgim nga dy deri në dhjetë vjet.” Po kështu, “vënia në rrezik e paqes publike, duke bërë thirrje për urrejtje kundër pjesëve të popullsisë, duke i fyer ose shpifur për to, duke kërkuar përdorimin e dhunës ose të veprimeve

¹⁷⁹ Lejla Gaçanica dhe Marija Arnautović, “*Mekanizma mbrojtës nga dhuna online*”

Manual për gazetarë, Albanian Media Institute Instituti Shqiptar i Medias

Manuali është një përshtatje nga Instituti Shqiptar i Medias për kontekstin shqiptar të manualit “Mbrotje nga Sulmet online: Manual për gazetarët nga Lejla Gaçanica dhe Marija Arnautović (Mediacentar Sarajevo, 2018).”, f.20

arbitrare kundër tyre, dënohet me burgim nga dy deri në tetë vjet”, sipas nenit 266, i cili mbulon thirrjen për urrejtje nacionale.¹⁸⁰

Ndërkohë, Kodi i Etikës i Gazetarit, paralajmëron kundër botimit të informacionit apo pamjeve që nxisin gjuhën e urrejtjes. *“Media duhet të mos botojë materiale, që nxisin urrejtje apo dhunë ndaj individëve mbi bazën e racës, fesë, kombësisë, ngjyrës, origjinës etnike, anëtarësisë, gjinisë, orientimit seksual, statusit civil, paaftësisë, sëmundjes apo moshës.”*¹⁸¹ Po kështu, ai thotë se “çdo botim duhet të mos specifikojë origjinën, etnicitetin, kombësinë, racën, fenë apo orientimin seksual të një grupi apo individ, përveç rasteve kur gjykohej e rëndësishme dhe e nevojshme për të kuptuar më mirë faktet dhe opinionet e paraqitura në publikim.” Ankesat për gjuhën e urrejtjes në media ose në internet, mund t’i paraqiten Këshillit Shqiptar të Medias. Sidoqoftë, kjo organizatë nuk ka mekanizma për të vendosur sanksione mbi ata që shkelin parimin që ndalohej me ligj, pasi nuk është një organ kolegjal i redaksive të mediave. Me fjalë të tjera, Këshilli Shqiptar i Mediave mund të shqyrtojë rastin kur i paraqitet një ankesë, ta trajtojë problemin dhe të bëjë rekomandimet e duhura, por ai vetë nuk mund të ndërmarrë kurrfarë sanksioni dhe vendimet nuk janë detyruese për mediat. Veç kësaj Këshilli nuk ka kompetencë të shqyrtojë përmbajtjen e atyre që publikohen në rrjetet sociale. Me iniciativë të Komisionit European katër ndërmarrje të mëdha të IT-së

(Facebook, Microsoft, Twitter dhe YouTube), në vitin 2016 paraqitën Kodin e sjelljes në luftë kundër gjuhës së paligjshme të urrejtjes në internet, si përgjigje ndaj përhapjes gjithnjë e më shumë të gjuhës së urrejtjes raciste dhe ksenofobe në internet. Kodit iu bashkuan edhe Instagram dhe Google +, dhe të gjithë nënshkruesit premtuan se në

¹⁸⁰ L. Gačanica dhe M. Arnautović Mekanizma mbrojtës nga dhuna online Manual për gazetarë, Albanian Media Institute, Instituti Shqiptar i Medias, Manuali është një përshtatje nga Instituti Shqiptar i Medias, për kontekstin shqiptar të manualit “Mbrojtje nga Sulmet online: Manual për gazetarët nga L. Gačanica dhe M. Arnautović (Mediacentar Sarajevo, 2018)”, f.,20, 21

¹⁸¹ Po aty

harkun e 24 orëve do të shqyrtojnë çdo denoncim për përdorimin e gjuhës së urrejtjes në internet.

Si mund të dallohet gjuha e urrejtjes?

- Thirrje e hapur për dhunë në platformat online, komentet, statuset.

- Nxitja, inkurajimi i urrejtjes.¹⁸²

- Më shpesh manifestohet përmes çështjeve nacionale, fyerjeve të besimit, mohimi i krimeve, afirmimi i doktrinës totalitare, politikave të ndryshme dhe orientimit seksual.

- Është e rëndësishme që të bëhet dallimi midis gjuhës së urrejtjes nga shpifja, fyerjet, ngacimimet, kërcënimet: gjuha e urrejtjes është publike; element bazë dhe kyç i gjuhës së urrejtjes është fyerja/shpifja, e megjithatë thirrja ose nxitja për urrejtje ndaj një grupi shoqëror, është i mundur edhe pa fyerje/shpifje; fenomen shoqëruar i gjuhës së urrejtjes është edhe kërcënim, edhe pse nuk është e thënë medoemos.

- Gjuha e urrejtjes i drejtohet një grupi njerëzish (vulnerabël), por jo individëve (në dallim nga fyerjet e zakonshme ose shpifjet që sulmojnë dinjitetin e individit, gjuha e urrejtjes ka të bëjë dhe i drejtohet një grupi të caktuar njerëzish).

- Bindës është ai që ka një qëndrim të caktuar përkundrejt grupeve të caktuara shoqërore dhe dëshiron që këtë qëndrim t'ua imponojë edhe të tjerëve.

- Gjuha e urrejtjes mund të bëhet bazë për lloje të ndryshme diskriminimi, por edhe ajo vetëm mund të jetë një lloj praktike diskriminuese, për shembull, në rast kur shprehet si ngacmim.

- Gjuha e urrejtjes inkurajon dhunën ndaj njerëzve.¹⁸³

¹⁸² L. Gačanica dhe M. Arnautović Mekanizma mbrojtës nga dhuna online Manual për gazetarë Albanian Media Institute Instituti Shqiptar i Medias Manuali është një përshtatje nga Instituti Shqiptar i Medias për kontekstin shqiptar i manualit “Mbrojtje nga Sulmet online: Manual për gazetarët nga L. Gačanica dhe M. Arnautović (Mediacentar Sarajevo, 2018),” f.22

¹⁸³ L. Gačanica dhe M. Arnautović Mekanizma mbrojtës nga dhuna online Manual për gazetarë Albanian Media Institute Instituti Shqiptar i Medias Manuali është një përshtatje nga Instituti Shqiptar i Medias për kontekstin shqiptar i manualit “Mbrojtje

4.4 Si mund të dallohet gjuha e urrejtjes

Gjuha e urrejtjes

Gjuha e urrejtjes përfshin çdo shprehje publike që përhap, nxit, promovon ose justifikon urrejtjen, diskriminimin ose armiqësinë ndaj një grupi të caktuar¹⁸⁴. Ajo është e rrezikshme, as nuk kontribuon në rritjen e klimës së intolerancës ndaj grupeve të caktuara. Sulmet verbale mund të shndërrohen në sulme fizike. Sipas Komisionit Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës, 205 gjuhë të urrejtjes do të kuptohen si promovim ose nxitje, në çfarëdo forme, e denigrim, urrejtje ose fyerje të një personi ose grupi personash, si dhe të kujtdo ngacmimi, fyerje, stereotipi negativ, stigmatizimi ose kërcënimi, në lidhje me një person ose grup personash, si dhe arsyetimi i llojeve të tilla të shprehjes: GJEDNJ, 97 Anëtarë të Kongregacionit të Dëshmitarëve të Jehovait të Gldanit dhe 4 të tjerë kundër Gjeorgjisë, Nr 71156/01, 3 maj 2007.¹⁸⁵ Gjuha e urrejtjes është në Kategoritë e diskriminimit. Gjuha e urrejtjes mund të marrë, gjithashtu formën e mohimit publik, banalizimit ose justifikimit të krimeve kundër njerëzimit, ose krimet e luftës, dhe glorifikimit të personave të dënuar për kryerjen e krimeve të tilla.

Krimi i urrejtjes dhe gjuha e urrejtjes kanë të njëjtin synim për të minuar dinjitetin dhe vlerat e një qenieje njerëzore, që i përkasin një grupi të caktuar. Megjithatë, ndryshe nga urrejtja krimi, gjuha e urrejtjes jo gjithmonë duhet të përbëjë vepër penale. Sipas KEDNJ, ekziston praktika gjyqësore e GJEDNJ-së për gjuhën e urrejtjes, duke përfshirë *gjuhën e urrejtjes* në internet, e cila përfshin balancimin e të drejtave të ndryshme: ndalimi i diskriminimit, e drejta për jetë private dhe liria e

nga Sulmet online: Manual për gazetarët nga L. Gačanica dhe M. Arnautović (Mediacentar Sarajevo, 2018),” f.22

¹⁸⁴ Handbook on European non-discrimination law 2018, edition European Union FRA Agency for Fundamental Rights and Council of Europe, 2018 Luxembourg: Publications Office of the European Union ISBN 978-92-871-9851-8 pg.86,87,88

¹⁸⁵ Handbook on European non-discrimination law 2018, edition European Union FRA Agency for Fundamental Rights and Council of Europe, 2018, Luxembourg: Publications Office of the European Union ISBN 978-92-871-9851-8 pg.86,87,88

shprehjes. Në shembujt e mëposhtëm, GJEDNJ konfirmoi se parimi i jodiskriminimit mund të kufizojë gëzimin e të drejtave të tjera. Shembull: Në M'Bala kundër Francës, kërkuesi ishte një komedian, dënua për shprehje të pikëpamjeve negacioniste dhe antisemitike gjatë një shfaqjeje live. Ai pretendoi se ky dënim kishte shkelur lirinë e tij të shprehjes. GJEDNJ konstatoi se shprehja e urrejtjes dhe antisemitizmit, si dhe mbështetja për mohimin e Holokaustit, nuk mund të binin në mbrojtje të Nenti 10 i KEDNJ-së. Gjykata, gjithashtu konstatoi se kërkuesi "kishte kërkuar për të shmangur nenin 10 nga qëllimi i tij real, duke përdorur të drejtën e tij për lirinë e shprehjes për skajet, që ishin të papajtueshme me shkronjën dhe frymën e Konventës e cila, nëse pranohet, do të kontribuonte në shkatërrimin e të drejtave dhe lirive të Konventës". Ankesa e tij u shpall e papranueshme.¹⁸⁶

Shembull: Në Vejdeland dhe të tjerët kundër Suedisë, 208 aplikantë ishin të dënua për qarkullimin e fletëpalosjeve homofobike në një shkollë. GJEDNJ-ja u shpreh kështu; ndërhyrja në lirinë e tyre të shprehjes kishte qenë e nevojshme një shoqëri demokratike për shkak të mbrojtjes së reputacionit dhe të drejtave të të tjerëve, dhe si e tillë nuk kishte pasur shkelje të nenit 10 të KEDNJ. Shembull: Në Karaahmed kundër Bullgarisë, kërkuesi kishte marrë pjesë në një Sofje, xhamia për faljen e rregullt të xhumasë. Në të njëjtën ditë, rreth 150 mbështetës të një partie politike të djathtë erdhën për të protestuar kundër zhurmës, që dilte nga altoparlantët në xhami gjatë ezanit. Ata bëritën, aty ofenduan besimtarët e mbledhur dhe hodhën vezë e gurë. Një përleshje pasoi mes disa demonstruesve dhe adhuresve kur i pari instaloi altoparlantët e tyre në çatinë e xhamisë për të mbuluar tingullin e lutjeve dhe ky i fundit tentoi t'i largonte ato. Dështimi nga autoritetet vendase për të vendosur një ekuilibër të duhur në masat e tyre për të garantuar ushtrimin efektiv dhe paqësor të të drejtave të demonstruesve, të drejtat e aplikantit dhe adhuresve të tjerë për t'u lutur së bashku, si dhe dështimin e tyre të

¹⁸⁶ Handbook on European non-discrimination law 2018, edition European Union FRA Agency for Fundamental Rights and Council of Europe, 2018, Luxembourg: Publications Office of the European Union ISBN 978-92-871-9851-8 pg.86,87,88

mëvonshëm.¹⁸⁷ Për t'iu përgjigjur siç duhet atyre ngjarjeve dhe veçanërisht për gjuhën e urrejtjes, do të thoshte se shteti nuk kishte respektuar detyrimet e saj pozitive, sipas nenit 9 (liria e fesë) të KEDNJ. Komentet e përdoruesve të palëve të treta, janë në formë të gjuhës së urrejtjes dhe janë të drejtpërdrejta kërcënimet ndaj integritetit fizik të individëve. Shtetet anëtare mund të kenë të drejtë të vendosin përgjegjësi për portalet e lajmeve në internet nëse nuk marrin masa për heqjen e këtyre komenteve, qartazi të paligjshme pa vonesë, edhe pa njoftim nga të dyshuarit viktimë ose nga palët e treta. Shembull: Në Delfi AS kundër Estonisë, 210 kompania ankuese zotëronte një prej këtyre portaleve më të mëdha të lajmeve në internet në Estoni.¹⁸⁸

Çfarë është gjuha e urrejtjes?

Në gjuhën e përbashkët, “gjuha e urrejtjes” i referohet diskursit fyes, që synon një grup ose një individ të bazuar në karakteristika të qenësishme (si raca, feja ose gjinia) dhe që mund të kërcënojë paqen sociale.¹⁸⁹ Për të siguruar një kornizë të unifikuar për Kombet e Bashkuara, për të adresuar çështjen në nivel global, Strategjia dhe Plani i Veprimit i OKB-së për Gjuhën e Urrejtjes e përkufizon gjuhën e urrejtjes si: *“çdo lloj komunikimi në të folur, me shkrim ose sjellje, që sulmon ose përdor gjuhë poshtëruese ose diskriminuese. duke iu referuar një personi ose një grupi në bazë të asaj se kush janë ata, me fjalë të tjera, bazuar në fenë, përkatësinë etnike, kombësinë, racën, ngjyrën, prejardhjen, gjininë ose një faktor tjetër identiteti.”* Megjithatë, deri më sot nuk ka një përkufizim universal të gjuhës së urrejtjes sipas ligjit ndërkombëtar për të drejtat e njeriut. Koncepti është ende në

¹⁸⁷ Po aty

¹⁸⁸ Handbook on European non-discrimination law 2018, edition European Union FRA Agency for Fundamental Rights and Council of Europe, 2018, Luxembourg: Publications Office of the European Union ISBN 978-92-871-9851-8 pg.86,87,88

¹⁸⁹ ¹⁸⁹ United National <https://www.un.org/en/hate-speech/understanding-hate-speech/what-is-hate-speech>, aksesuar më 30.01.2024

diskutim, veçanërisht në lidhje me lirinë e mendimit dhe të shprehjes, mosdiskriminimin dhe barazinë.¹⁹⁰

4.5 Si manifestohet gjuha e urrejtjes?

Gjuha e urrejtjes manifestohet me sharje, fyerje, përndjekje, shpifje, kërcënime, prishje të imazhit të reputacionit publik, veçim social, përbuzje, sharje me zhargon rruge, dhunë psikologjike. Organizata Ndërkombëtare Për të Drejtat e Njeriut e përkufizon gjuhën e urrejtjes si çdo manifestim të urrejtjes diskriminuese ndaj njerëzve, bazuar në aspekt të veçantë të identitetit të tyre¹⁹¹. Urrëjtja diskriminuese është një ndjenjë e fortë dhe irracionale e armiqësisë ndaj një personi ose grup njerëzish për shkak të asaj që ata janë, bazuar në një karakteristikë identifikuese të njohur nga ligji ndërkombëtar për të drejtat e njeriut. Gjuha e urrejtjes është komunikim diskriminues në çdo format, që synon poshtërimin, fyerjen, agresion mbi etnik, fetar, gjinor, baza gjinore, racore, sociale. Gjuha e urrejtjes shoqërohet gjithmonë me kontekstin, i cili varet nga vendosja, grupi i synuar dhe folësi, siç detajohet në Planin e Veprimit të Rabatit. Për të përcaktuar gjuhën e urrejtjes, nevojitet që komponentë të ndryshëm të merren parasysh, duke përfshirë përmbajtjen e shprehjes, tonin (e shkruar ose të folur), (individual dhe kolektiv) qëllimet dhe pasojat e mundshme ose ndikim. Nuk ka një përkufizim të qartë ligjor të gjuhës së urrejtjes në legjislationin e vendeve të Azisë Qendrore. Në Kirgistan, Uzbekistan, Kazakistan dhe Taxhikistan më shpesh, legjislationi i përmbahet artikullit përkatës në Kodin Penal.

Në Kirgistan, neni 330 i Kodit Penal të Republikës së Kirgistanit, theksi vihet në veprimet e synuara “*Nxitja racore, etnike, kombëtare, fetare ose ndërrajonale urrejtje (përçarje), poshtërim i*

¹⁹⁰ United National <https://www.un.org/en/hate-speech/understanding-hate-speech/what-is-hate-speech>, aksesuar më 30.01.2024

¹⁹¹ Ismanov, A., Kupueva, N., Stanalieva, G., Toktogulova, M., Turdubaeva E FROM HATE SPEECH TO NON-VIOLENT COMMUNICATION. – B.: 2023, 120 pg.9,10, Communicators with the support of UNDP in the Kyrgyz Republic в KP, 2023

*dinjitetit kombëtar, po ashtu si propagandë e ekskluzivitetit, epërsisë apo inferioritetit të qytetarëve në bazë të qëndrimit të tyre ndaj fesë, kombësisë ose racës, së kryer publikisht, ose duke përdorur mediat, si dhe nëpërmjet internetit*¹⁹².

Në Kazakistan, neni 174 fokusohet në “veprime të qëllimshme, që synojnë nxitjen sociale, kombëtare, fisnore, racore, urrejtje klasore apo fetare”, si dhe mbi “propagandën e ekskluzivitetit, epërsisë apo inferioritetit të qytetarëve”, mbi arsyet e treguara në fillim.

Në Uzbekistan, neni 156 i Kodit Penal të Republikës së Uzbekistanit thekson: “veprime poshtëruese, të qëllimshme të nderit dhe dinjitetit kombëtar, fyejnë ndjenjat e qytetarëve në lidhje me fenë e tyre ose bindjet ateiste.” Uzbekistani është shteti i vetëm në Azinë Qendrore, i cili i referohet Kodit Penal për paligjshmërinë e përndjekjes së personave që mbajnë athei.¹⁹³ Krijimi i një imazhi negativ të një etnie të caktuar ose grupi tjetër. 2. Përmendja e emrit të një grupi vulnerabël në kontekst përçmues. 3. Deklarata për inferioritetin e një grupi të caktuar, i përmendur në një kontekst poshtërues. 4. Citimi ose publikimi i deklaratave ksenofobike tekste të këtij lloji pa një koment të përshtatshëm, që bën dallimin midis opinionëve të autorit të deklaratës dhe gazetarit, ndarja e hapësirës në gazetë, koha e transmetimit për propagandë nacionaliste, pa koment editorial apo polemika të tjera.¹⁹⁴

4.5.1 Fyerja

Teksti i Konventës nuk e përkufizon konceptin e “fyerjes” e as Gjykata nuk ka qenë e prirur ta bëjë këtë. Është më e përshtatshme që vetë nocioni të përkufizohet në legjislacionin kombëtar edhe pse, jo të

¹⁹² ¹⁹² Ismanov, A., Kupueva, N., Stanaliev, G., Toktogulova, M., Turdubaeva E FROM HATE SPEECH TO NON-VIOLENT COMMUNICATION. – B.: 2023. – 120 pg,9,10 Communicators with the support of UNDP in the Kyrgyz Republic в KP, 2023

¹⁹³ Ismanov, A., Kupueva, N., Stanaliev, G., Toktogulova, M., Turdubaeva E FROM HATE SPEECH TO NON-VIOLENT COMMUNICATION. – B.: 2023. – 120 pg,9,10 Communicators with the support of UNDP in the Kyrgyz Republic в KP, 2023

¹⁹⁴ Po aty f.14,15

gjitha juridiksionet kanë zgjedhur ta bëjnë këtë”.¹⁹⁵ Në thelb, fyerja është një keqbërje civile (një padrejtësi a shkelje), e kryer nga një individ kundër tjetrit apo të tjerëve, përfshirë në disa rrethana një “subjekt juridik”.¹⁹⁶ Natyra e keqbërjes është efekti negativ apo dëmi kundrejt emrit të mirë ose reputacionit të personit. Reputacioni nuk ka të bëjë me vetëvlerësimin, por më tepër me vlerësimin që kanë të tjerët për dikë. Kështu, akti i fyerjes ka të bëjë me dhënien e deklaratave të rreme ose të pavërteta rreth një personi tjetër, që ka për qëllim të dëmtojë reputacionin e tij/saj në sytë e pjesëtarëve të arsyeshëm të shoqërisë. Deklaratat mund të jenë një akuzë, një pohim, sulm verbal ose formë tjetër fjalësh, ose veprimi. Kjo deklaratë mund të bëhet me gojë apo me shkrim; mund të marrë formën e figurave pamore, tingujve, gjesteve dhe çdo metode tjetër, që ka kuptim; mund të jetë një deklaratë, që transmetohet në radio ose televizion, apo botohet në internet, ose mund të jetë komunikim elektronik. Kështu, në themel të fyerjes qëndron dëmtimi i reputacionit. Një deklaratë në çdo kuptim të mësipërm, mund të jetë e rëndë ose poshtëruese, por nuk përbën fyerje nëse është e vërtetë pasi personi ka të drejtën e reputacionit, që mbështetet mbi të vërtetën.

Deklarata do të përbëjë fyerje vetëm nëse është pohim i rremë faktesh rreth një personi tjetër, pasi vetëm akuzat ose pohimet e rreme apo të pavërteta, e dëmtojnë reputacionin, që personi meriton të gëzojë mes të ngjashmëve ose komunitetit të tij. Në disa rrethana të kufizuara, një koment që nuk mund të mbështetet nga fakte ose nuk mbështetet në mënyrë të arsyeshme në fakte, mund të përbëjë gjithashtu, fyerje.

¹⁹⁵ Tarlach McGonagle në bashkëpunim me Marie McGonagle dhe Ronan Ó Fathaigh, “Liria e shprehjes dhe fyerja”, Një studim i jurisprudencës së Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, Reinforcing Judicial Expertise on Freedom of Expression and the Media in South-East Europe (JUFREX) Këshilli i Evropës, qershor 2018 f.15,16 ISBN 978-9928-260-12-3

¹⁹⁶ Tarlach McGonagle në bashkëpunim me Marie McGonagle dhe Ronan Ó Fathaigh, “Liria e shprehjes dhe fyerja”, Një studim i jurisprudencës së Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, Reinforcing Judicial Expertise on Freedom of Expression and the Media in South-East Europe (JUFREX) Këshilli i Evropës, qershor 2018 f.15,16 ISBN 978-9928-260-12-3

Gjykata i ka cekur këto çështje, mes të tjerash, në vendimin e saj në çështjen: “*Reznik kundër Rusisë*”, e cila ishte rezultat i një procesi gjyqësor për fyerje kundër kryetarit të Dhomës së Avokatisë të qytetit të Moskës:

Ndërhyrja në të drejtën e lirisë së shprehjes të jetë në përpjesëtim me qëllimin e ligjshëm të mbrojtjes së reputacionit të të tjerëve, ekzistenca e një lidhjeje objektive midis deklaratës së kundërshtuar dhe personit, që padit për fyerje, është element i nevojshëm.¹⁹⁷ Hamendjet personale ose perceptimet subjektive të një botimi si fyes, nuk mjaftojnë për të përcaktuar se personi është prekur drejtpërdrejt nga botimi.¹⁹⁸ Duhet të ketë diçka në rrethanat e një çështjeje të caktuar për ta bërë lexuesin e zakonshëm të mendojë se deklarata ka pasqyrim të drejtpërdrejtë te ankimuesi individual, ose se ai ka qenë në shënjestër të kritikës.¹⁹⁹ Këto parime gjejnë zbatim edhe në sferën e transmetimit në televizion dhe radio (§ 45). Zakonisht, fyerja ka të bëjë vetëm me reputacionin personal ose individual, por ligji për fyerje mund të mbulojë edhe deklarata të tilla, që bëhen rreth “personave juridikë”, domethënë subjektet që kanë status juridik, si shoqëritë tregtare dhe korporatat, çka krijon mundësinë që ata të padisin ose të paditen. Në disa raste, një grup i vogël njerëzish, si bordi i shoqërisë

¹⁹⁷ ¹⁹⁷ Tarlach McGonagle në bashkëpunim me Marie McGonagle dhe Ronan Ó Fathaigh, “Liria e shprehjes dhe fyerja”, Një studim i jurisprudencës së Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, Reinforcing Judicial Expertise on Freedom of Expression and the Media in South-East Europe (JUFREX) Këshilli i Evropës, qershor 2018 f.15,16 ISBN 978-9928-260-12-3

¹⁹⁸ Tarlach McGonagle në bashkëpunim me Marie McGonagle dhe Ronan Ó Fathaigh, “Liria e shprehjes dhe fyerja” Një studim i jurisprudencës së Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, Reinforcing Judicial Expertise on Freedom of Expression and the Media in South-East Europe (JUFREX), Këshilli i Evropës, qershor 2018, f.15,16, ISBN 978-9928-260-12-3

¹⁹⁹ Tarlach McGonagle në bashkëpunim me Marie McGonagle dhe Ronan Ó Fathaigh LIRIA E SHPREHJES DHE FYERJA Një studim i jurisprudences së Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut Reinforcing Judicial Expertise on Freedom of Expression and the Media in South-East Europe (JUFREX) Këshilli i Evropës, qershor 2018, f.17 ISBN 978-9928-260-12-3

tregtare apo drejtuesit e një organizate mund të padisin për fyerje, edhe pse përmenden si grup vetëm në rrethanat kur secili prej tyre, edhe pa emër, është i identifikueshëm në mënyrë të arsyeshme nga të tjerët, që i njohin, shprehur më përgjithësisht, nga pjesëtarët e arsyeshëm të shoqërisë. Në çështjen: “*Reznik kundër Rusisë*”, Gjykata i kushtoi rëndësi faktit se paditësit nuk ishin përmendur në deklaratat e aplikantëve; ata ishin të identifikueshëm vetëm përmes filmimit të përzgjedhur nga redaktori i programit televiziv për të prezantuar debatin e drejtpërdrejtë në të cilin merrte pjesë aplikanti dhe përmes mediave të tjera. Gjykata u shpreh se “shkalla e përgjegjësisë së aplikantit për fyerjen, nuk duhet të shkojë përtej fjalëve të tij” (§ 45). ë Një përpjekje për të siguruar arsyeshmërinë është që të tjerët në fjalë duhet të jenë anëtarë të arsyeshëm të shoqërisë kur përcaktohet se ç’lloj shprehjeje ndikon negativisht në reputacionin e dikujt. Kjo kërkon të shmangë respektimin e tepruar të reputacionit në kurriz të lirisë së shprehjes²⁰⁰.

Dallimi midis fyerjes penale dhe civile është thelbësor për lirinë e shprehjes për shkak të efektit frenues të ligjeve, që e bëjnë fyerjen vepër penale. Edhe pse nivelet e tepruara ose të paparashikuara të dëmshpërblimeve (kompensimit) në çështjet civile, mund të kenë gjithashtu, efekt frenues mbi lirinë e shprehjes, dhënia e dënimeve penale (gjoba dhe/ose dënim me burg), ose kërcënim me ndjekje penale, mund të kenë efekte edhe më të mëdha frenuese.²⁰¹

Në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë parashikohen nene të posaçme për fyerjen:

Neni 119/b

Fyerja me motive racizmi ose ksenofobie nëpërmjet sistemit kompjuterik. (Shtuar me ligjin nr. 10 023, datë 27.11.2008).

²⁰⁰ Po aty

²⁰¹ Lejla Gaçanica dhe Marija Arnautoviç Mekanizma mbrojtës nga dhuna online Manual për gazetarë Regional Platform for Advocating Media Freedom and Journalists’ Safety Albanian Media Institute Instituti Shqiptar i Medias Albania Mediacenter Sarajevo, 2018

Fyerja e qëllimshme publike, nëpërmjet sistemit kompjuterik, që i bëhet një personi për shkak të përkatësisë etnike, kombësisë, racës apo fesë, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy vjet²⁰²

neni 118

Shpërndarja e materialeve raciste ose ksenofobike nëpërmjet sistemit kompjuterik

(Shtuar me ligjin nr. 10 023, datë 27.11.2008).

Ofrimi në publik ose shpërndarja e qëllimshme e publikut nëpërmjet sistemeve kompjuterike, e materialeve me përmbajtje raciste, ose ksenofobike përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë, ose me burgim deri në dy vjet.

Neni 120

Shpifja

(Ndryshuar paragrafi i dytë me ligjin nr. 8733, datë 24.1.2001; ndryshuar me ligjin nr. 23/2012, datë 1.3.2012).

Përhapja e qëllimshme e thënieve si dhe çdo informacion tjetër, duke e ditur se janë të rreme, që

²⁰² Ligj Nr. 7895, datë 27.01.1995 Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë (Ndryshuar me: ligjet nr. 8175, datë 23.12.1996; nr. 8204, datë 10.04.1997; nr. 8279, datë 15.01.1998; nr. 8733, datë 24.01.2001; nr. 9017, datë 06.03.2003; nr. 9030, datë 13.03.2003; nr. 9086, datë 19.06.2003; nr. 9188, datë 12.02.2004; nr. 9275, datë 16.09.2004; nr. 9686, datë 26.02.2007; nr. 9859, datë 21.01.2008; nr. 10 023, datë 27.11.2008; nr. 23/2012, datë 01.03.2012; nr. 144, datë 02.05.2013; nr. 98, datë 31.07.2014; nr. 176/2014, datë 18.12.2014; nr. 135/2015, datë 05.12.2015; nr. 82/2016, datë 25.07.2016; nr. 36/2017, datë 30.03.2017; nr. 89/2017, datë 22.05.2017; nr. 44/2019, datë 18.07.2019, nr. 35/2020, datë 16.04.2020, nr. 146/2020, datë 17.12.2020; nr. 43/2021, datë 23.03.2021; vendimet e Gjykatës Kushtetuese: nr. 13, datë 29.05.1997; nr. 46, datë 28.08.1997; nr. 58, datë 05.12.1997; nr. 65, datë 10.12.1999; nr. 11, datë 02.04.2008; nr. 19, datë 01.06.2011; nr. 47, datë 26.07.2012; nr. 9, datë 26.02.2016; nr. 24, datë 4.5.2021 <https://qbz.gov.al/preview/a2b117e6-69b2-4355-aa49-78967c31bf4d> aksesuar me 6.2.2024

cënojnë nderin dhe dinjitetin e personit, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë nga pesëdhjetë mijë gjer në një milion e pesëqind mijë lekë. Po kjo vepër, kur kryhet botërisht, në dëm të disa personave ose më shumë se një herë, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë nga pesëdhjetë mijë gjer në tre milionë lekë.²⁰³

4.6 Diversiteti

Diversiteti në kontekstin e një organizate, është përkushtimi për të njohur dhe vlerësuar karakteristikat e ndryshme, që e bëjnë një individ unik në një mjedis, që promovon dhe feston arritjet individuale dhe kolektive²⁰⁴ Diversiteti lidhet me çdo gjë, që na bën të ndryshëm nga të tjerët: mosha, raca, gjinia, orientimi seksual, gjendja ekonomike apo sociale, besimi fetar, përkatësia politike, aftësitë mendore e fizike, arsimi, gjuha, familja, gjendja civile. Të gjitha këto krijojnë personin, por edhe përcaktojnë në cilin grup ky person merr pjesë si dhe kulturën dominuese të këtij grupi. Një person mund të jetë pjesë e më shumë se një grupi, secili prej të cilëve ka një kulturë të caktuar. Gjithashtu, në praktikë secili grup mendon se kultura e vetë është më superiore dhe se gjithmonë ka të drejtë. Diversiteti nuk lidhet me faktin nëse një person është më i mirë se tjetri, por me pranimin dhe respektimin e ndryshimeve e diferencave të të tjerëve dhe kuturave të tyre.²⁰⁵

²⁰³ po aty

²⁰⁴ S. Anagnosti, E. Zoti, Manual për punonjësën e Policisë së Shtetit Shqiptar, ISBN 978-92-9235-244-8, shtypur në: Albdesign, Botuar nga Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, 2013, f.7 OSCE

²⁰⁵ S. Anagnosti, E. Zoti, Manual për punonjësën e Policisë së Shtetit Shqiptar, ISBN, 978-92-9235-244-8, shtypur në: Albdesign., botuar nga Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, 2013, f.7, OSCE

4.7 Stereotipet dhe faktorët për formimin e Gjuhës së urrejtjes

Stereotipi: të krijosh një ide të përgjithshme për njerëzit, vetëm në bazë të karakteristikave, që i bëjnë ata të ndryshëm nga ne. Paragjykim, do të thotë të kesh gjykime negative mbi të tjerët vetëm se ata janë të ndryshëm nga ti.²⁰⁶

Barazia dhe diversiteti

Shpesh, mospranimi i të veçantave të të tjerëve dhe i diversitetit çon në krijimin e stereotipeve. Stereotipi “*është besimi i caktuar dhe i përgjithësuar në lidhje me një grup të caktuar apo një klasë njerëzish*”. Disavantazhi i stereotipit, është se i bën njerëzit të mos marrin parasysh ndryshimet dhe diferencat mes individëve, pra duke i bërë të mendojnë se ata kanë karakteristika apo sjellje të caktuara, të cilat jo detyrimisht janë të vërteta, vetëm se ata individë bëjnë pjesë në një grup kulturor të caktuar. Stereotipimi të bën të krijosh përshtypje të gabuar, bazuar në besime të përgjithshme, por të paprovuara. Shembuj stereotipesh negativë mund të jenë:

- Romët e kanë mendjen për aheng;
- Gratë në polici janë vetëm për punë zyre;
- Personat me aftësi të kufizuar nuk janë as për vete.²⁰⁷

Përgjithësime të këtij lloji janë të rrezikshme, pasi bazuar në to, njeriu mund të marrë vendime të gabuara. Stereotipimi i grupeve apo individëve shpesh sjell paragjykimin e tyre. Paragjykimi është mospëlqimi i të tjerëve, bazuar mbi përgjithësime dhe gjykime negative. Kjo lidhet me një mënyrë të menduari ku marrim si të mirëqenë që grupe të caktuara kanë karakteristika të caktuara dhe sillemi (zakonisht negativisht), duke i bërë vlerësimet tona në bazë të këtyre karakteristikave, pa vlerësuar realisht nëse ato ekzistojnë.

²⁰⁶ Anagnosti, E. Zoti, Manual për punonjësin e Policisë së Shtetit Shqiptar, ISBN, 978-92-9235-244-8, shtypur në: Albdesign., botuar nga Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, 2013, f.8,9, OSCE

²⁰⁷ Po aty.

Shembuj paragjykimi janë: Në jetën e përditshme, në të folurit publik, apo në komentet tona ose postime në mediat sociale, duke ndarë gjithashtu çdo informacion, ka raste kur lejojmë shprehje që reflektojnë stereotipet, që janë formuar prej kohësh në shoqërinë tonë: banorët e këtij rajoni janë të tillë”, “dhe këta janë kështu”, “gratë në politikë nuk kanë çfarë të bëjnë” etj.²⁰⁸

Le të ndalemi në ato raste ku gjuha e urrejtjes manifestohet në mënyrë të pandërgjegjshme, domethënë jo me qëllim, por në bazë të stereotipeve. Mund të përdorim gjuhën e urrejtjes me qëllimin për t'i bërë njerëzit të qeshin ose pa ndonjë qëllim të keq, pa e vënë re atë. Siç tregon ky shembull, ndonjëherë është e vështirë të përcaktojmë se si lejohet gjuha e urrejtjes. Duke e përdorur madje me qëllime të mira, për hir të një shakaje, duke përfshirë në mënyrë joverbale, pra pa ndihmën e fjalëve, si p.sh.: shprehjet e fytyrës ose gjestet, mund të mërzitim dikë, ta ofendojmë, të mërzitim ose t'i bëjmë a ndjenja e urrejtjes. Gjuha e urrejtjes lind mbi bazën e stereotipeve sepse stereotipet janë koncepte të qëndrueshme. Stereotipet në njerëzit nuk shfaqen në një ditë, ata formohen në një mënyrë evolucionare.²⁰⁹

Edicioni online Super. Një sondazh mbi tema: “Si i shikoni kryefamiljarët, që nuk mund të bëjnë asgjë?” Duke publikuar disa nga opinionet të lexuesve të tyre, të cilat përmbajnë gjykime vlerash rreth meshkujve, bazuar në stereotipet gjinore. Deklarata të tilla bazohen në një stereotip pozitiv: “burri fiton; i fortë; udhëheqës; i pavarur nga të tjerët”, po ashtu: mos merrni parasysh faktorë të tillë si socio-gjendja ekonomike në vend, papunësia, paga e ulët. Stereotipet, pavarësisht nga

²⁰⁸ Ismanov, A., Kupueva, N., Stanaliev, G., Toktogulova, M., Turdubaeva E FROM HATE SPEECH TO NON-VIOLENT COMMUNICATION. – B.: 2023. – 120 pg26,27, Communicators with the support of UNDP in the Kyrgyz Republic в KP, 2023

²⁰⁹ Ismanov, A., Kupueva, N., Stanaliev, G., Toktogulova, M., Turdubaeva E FROM HATE SPEECH TO NON-VIOLENT COMMUNICATION. – B.: 2023. – 120 pg30,31, Communicators with the support of UNDP in the Kyrgyz Republic в KP, 2023

retorika e tyre, pengojnë analizën e situatës reale, duke përforcuar karakteristikat negative. Në këtë drejtim, përdorimi i gjuhës së urrejtjes nga publiku dhe figurat politike janë të një rëndësie të veçantë; ata shtojnë mosmarrëveshjet në shoqëri, duke krijuar një situatë të rrezikshme kur personat e nxitur prej tyre, mund të kryejnë veprime të paligjshme. Figurat publike dhe politike duhet të jenë më shumë të vëmendshme ndaj retorikës dhe kontekstit të tyre, të tregojnë më shumë ndjeshmëri duke iu dhënë kuptim të gjitha nuancave të situatave të ndryshme.

Si shembull, marrim parasysh rastin e një përlëshjeje verbale mes deputetëve në një mbledhje të Komisionit Parlamentar për thesarin dhe politikën fiskale. Kur parlamentarët hynë në një konflikt verbal për shkak të të folurit të zgjatur të njërit prej tyre. Deputetët shkëmbyen vërejtje për secilin rast, bazuar në stereotipe gjinore.²¹⁰

4.8 Kiberbulizimi

Urrejtja kibernetike, forma online e gjuhës së urrejtjes dhe ngacmimi kibernetik nuk është e njëjta gjë, pasi synon grupe të caktuara në bazë të karakteristikave të përbashkëta, kjo e fundit synon individët, zakonisht brenda një mjedisi të caktuar të komunitetit. të dyja janë padyshim të ndërthurura në mendjen e të rinjve²¹¹. *“Bullizmi mund të përkufizohet si “një lloj i dëmshëm sjelljeje, që përsëritet me kalimin e kohës dhe ndodh në mes të marrëdhënieve ndërpersonale të karakterizuara nga pabarazitë e fuqisë”.* (Olweus 1999: 25) Ngacmimi, është kur njerëzit me qëllim përdorin fjalë ose veprime në mënyrë të

²¹⁰ 210210 Ismanov, A., Kupueva, N., Stanalieva, G., Toktogulova, M., Turdubaeva E FROM HATE SPEECH TO NON-VIOLENT COMMUNICATION. – B.: 2023. – 120 pg26,27, Communicators with the support of UNDP in the Kyrgyz Republic в KP, 2023

²¹¹ Ismanov, A., Kupueva, N., Stanalieva, G., Toktogulova, M., Turdubaeva E FROM HATE SPEECH TO NON-VIOLENT COMMUNICATION. – B.: 2023. – 120 pg30,31, Communicators with the support of UNDP in the Kyrgyz Republic в KP, 2023

përsëritur kundër një individi ose një grupi për të shkaktuar dëm fizik, social dhe/ose psikologjik²¹². Ata zakonisht duan ta bëjnë personin të ndihet më pak i fuqishëm ose i pafuqishëm. Ngacmimi mund të ndodhë kudo, në shkollë, në punë, në shtëpi, në internet ose me mesazhe me tekst, ose email. Ngacmimi mund të vijë në forma të ndryshme, të cilat të gjitha së bashku shkaktojnë shqetësim e dhimbje për personin që po ngacmohet. Bullizmi është sjellje që përsëritet dhe synon të shkaktojë dëm psikologjik, social ose fizik. Ai mund të jetë i dëmshëm për shëndetin mendor, vetëvlerësimin dhe marrëdhëniet shoqërore. Njerëzit që ngacmohen, shpesh kanë vetëbesim të ulët²¹³ Ngacmimi kibernetik i ngjan ngacmimit sepse është gjithashtu i qëllimshëm, agresiv, dhe përsëritës me kalimin e kohës, por me disa veçori që e bëjnë të dallueshëm ata, që merren me të në mënyrë elektronike.²¹⁴

Disa nga të rinjtë e intervistuar besojnë se postimi i komenteve anonime në internet, i lejon njerëzit të shprehin hapur intolerancën, të refuzojnë dallimet dhe përqafojnë mjedisin social, pa racizmin kufizimet që ekzistojnë në komunikimin offline.²¹⁵ (Assimakopoulos et.al., 2017) Hulumtimet aktuale kanë treguar se nuk ka asnjë profil të vetëm të një urrejtësi ose ngacmuesi kibernetik pas maskës së anonimitetit. Ndërsa ka grupe të organizuara, që kërkojnë të promovojnë urrejtje në internet. Më së shumti, rastet e njerëzve që mbulohen me urrejtje ose postimet diskriminuese trolling, nuk janë të lidhura me lëvizjet ideologjike haptazi intolerante, (krh. Isasi dhe Juanatey 2016) por janë përdorues, që thjesht, nuk e kuptojnë ndikimin e mundshëm të

²¹² <https://www.healthdirect.gov.au/bullying> aksesaur me 10.4.2024

²¹³ <https://www.healthdirect.gov.au/bullying> aksesaur me 10.4.2024

²¹⁴ Ismanov, A., Kupueva, N., Stanaliev, G., Toktogulova, M., Turdubaeva E FROM HATE SPEECH TO NON-VIOLENT COMMUNICATION. – B.: 2023. – 120 pg30,31, Communicators with the support of UNDP in the Kyrgyz Republic в KP, 2023

²¹⁵ Ismanov, A., Kupueva, N., Stanaliev, G., Toktogulova, M., Turdubaeva E FROM HATE SPEECH TO NON-VIOLENT COMMUNICATION. – B.: 2023. – 120 pg30,31, Communicators with the support of UNDP in the Kyrgyz Republic в KP, 2023

dixhitalit të tyre, aktivitetet dhe pasojat, që mund të kenë në botën jashtë linje. (krh. Stein 2016). Urrejtja ndaj grupeve të caktuara, që qëndron në themel të urrejtjes së të folurit, si në internet ashtu edhe jashtë linje, mund të vetëshfaqet gjithashtu, në forma të tjera të shprehjes së dhunës dhe intolerancës, siç është bullizmi (kibernetik). Në ato përvojat personale, disa nga të intervistuarit tanë kanë treguar se Gjuha e urrejtjes është e lidhur ngushtë me përvojën e ngacmimi (kibernetik), dhe në veçanti, identitetin e një personi përdoret shpesh si armë nga kriminelët për të kryer ngacmim (kibernetik). Për shkak të natyrës së tij globale, interneti është bërë një hapësirë për të dy shprehjet dhe përhapja e ideve, e besimeve intolerante (Isasi dhe Huanatei, 2016), duke ofruar mjete shtesë për të ndihmuar në mbrojtjen dhe promovimin e diskriminimit, i cili potencialisht mund të çojë edhe në krim të urrejtjes. Qëndrime të tilla dhe shprehjet hedhin poshtë dallimet, synojnë të privojnë individët, duke mohuar dhe duke sulmuar identitetin e tyre. Gjuha e lehtë e urrejtjes, shpërndarë në internet mund të jetë shkatërruese me efekte në rendin shoqëror, duke ndikuar negativisht edhe tek ata, që mbrojnë lirinë, tolerancën dhe jo diskriminimi në shoqëritë tona të hapura.²¹⁶

Llojet e bullizmit

Ekzistojnë tri lloje të bullizmit:²¹⁷

Ngacmim verbal, është të thuash ose të shkruash gjëra të çuditshme. Ngacmimi verbal përfshin: Ngacmim, thirrje me emër, komente të papërshtatshme seksuale, tallje, kërcënim për të shkaktuar dëm.

Ngacmim social, i referuar ndonjëherë si ngacmim relacional, përfshin dëmtimin e reputacionit ose marrëdhënieve të dikujt. Ngacmimi social përfshin: lënien e dikujt jashtë, qëllimisht, p.sh.: “*t’u thuash*

²¹⁶ Ismanov, A., Kupueva, N., Stanalieva, G., Toktogulova, M., Turdubaeva, E FROM HATE SPEECH TO NON-VIOLENT COMMUNICATION. – Б.: 2023. – 120, pg 30,31, Communicators with the support of UNDP in the Kyrgyz Republic в КР, 2023

²¹⁷ What Is Bullying, <https://www.stopbullying.gov/bullying/what-is-bullying#types>, aksesuar më 10.4.2024

fëmijëve të tjerë të mos jenë miq me dikë. Përhapja e thashethemeve për dikë. Të turpërosh dikë në publik”.

*Ngacmimi fizik, përfshin lëndimin e trupit së një personi. Ngacmimi fizik përfshin: Goditje, shkelm, shtypje, pështyrje, kërcim, shtytje, marrja ose thyerja e gjërave të dikujt, bërja e gjesteve të këqija ose të vrazhda me duar. Ku dhe kur ndodh ngacmimi? Ngacmimi mund të ndodhë gjatë ose pas orëve të shkollës. Ndërsa shumica e bullizmit të raportuar ndodhin në ndërtesën e shkollës. Një përqindje e konsiderueshme ndodh edhe në vende si në shesh lojërash ose autobus. Mund të ndodhë gjithashtu duke udhëtuar për në ose nga shkolla, në lagjen e të rinjve ose në internet.*²¹⁸

²¹⁸ What Is Bullying, <https://www.stopbullying.gov/bullying/what-is-bullying#types>, aksesuar më 10.4.2024

KREU V

AKTOREËT E GJUHËS SË URREJTJES

5.1 Gjuha e urrejtjes nga politikanët

Gjuha e urrejtjes rëndomtë përhapet dhe nga politikanët

Përhapja e gjuhës së urrejtjes, motivuar politikisht ndaj politikanëve rivalë, është rritur me shpejtësi në Pakistan.²¹⁹ Megjithatë, literatura mbi gjuhën e urrejtjes politike dhe lidhjen e saj me ideologjitë ekstreme, është e nënteorizuar në kontekstin pakistanez. Të dhënat u bazuan në fjalimet publike të dy politikanëve kryesorë, pakistanezë dhe komentet e partizanëve të disponueshme në YouTube. Gjetjet zbulojnë se politikanët zakonisht, shfrytëzojnë kategori diskursive, të tilla si thirrja e emrave, metaforat fyese dhe sarkazma, në gjuhën e tyre të urrejtjes për të dehumanizuar, tallur dhe kërcënuar rivalët e tyre. Shkeljet e tyre dhe kjo lloj urrejtjeje shfaqin ideologji ekstreme, si polarizimi, intoleranca, kërcënimi dhe dhuna. Ata përdorin epitetet e urrejtjes.²²⁰

Fushata e partive politike për zgjedhjet parlamentare të 25 Prillit 2021 në Shqipëri, po monitorohej nga disa institucione të pavarura dhe organizata të shoqërisë civile, lidhur me përdorimin e gjuhës së urrejtjes dhe denigrimit. Aleanca kundër Gjuhës së urrejtjes dhe Këshilli shqiptar i Medias konstatojnë se ka një tejkalim të gjuhës politike, në denigrim,

²¹⁹M. Shaban, R. Shafiq, “*The role of political hate speech in promoting extreme ideologies and manipulating public discourse for social approval in Pakistan*”, Article, 01.02. 2024, International Social Science Journal

²²⁰M. Shaban, R. Shafiq, “*The role of political hate speech in promoting extreme ideologies and manipulating public discourse for social approval in Pakistan*”, Article, 01.02. 2024, International Social Science Journal

përçarje dhe fyerje publike. Duke shigjetuar, më së shumti përfaqësues të shumicës qeverisëse për përdorimin e saj, drejtues të aleancës thonë se një gjuhë e tillë është vënë re në disa raste dhe në kundërpërgjigjet e kundërshtarëve politikë. Shqetësuese, për Aleancën kundër Gjuhës së urrejtjes, mbetet denigrimi i grave.²²¹ Në Shqipëri ka një shqetësim qytetar në rritje mbi gjuhën e urrejtjes, që përdorin partitë politike. Kjo ka nxitur përfaqësues të disa institucioneve të pavarura dhe organizata të shoqërisë civile që me ndihmën e Këshillit të Europës, të monitorojnë fushatën zgjedhore për zgjedhjet parlamentare të 25 prillit. Ata kanë hartuar një Kod Etik, që është firmosur nga partitë kryesore, i cili synon të parandalojë dhe të evidentojë përdorimin e retorikës së urrejtjes dhe të denigrimit nga subjektet zgjedhore dhe kandidatët e tyre.

*“Akuzat e papabaza e fjalimet ofenduese nuk është se janë të pazakonshme gjatë fushatave zgjedhore, dhe gazetarët nuk duhet t’i publikojnë pa i mundësuar komentet tjetër gjë, që t’i lejojnë apo të japin përgjigje përkatëse”.*²²² Vetëm me një gazetari të përgjegjshme ndaj votuesve të mirëinformuar, mund të marrin vendime lirisht. Paanshmëria dhe balancimi janë aspekte të rëndësishme të përgjegjësisë gazetareske. *“Çdo lajm nuk mund të jetë çdoherë njëlloj i balancuar, megjithatë paanshmëria dhe balancimi midis partive dhe kandidatëve oponentë mund të gjitha lajmet e numrit të madh të tyre, të cilat do të publikohen ose transmetohen gjatë gjithë procesit zgjedhor. Gazetarët nuk duhet të kenë qëndrim arbitrar ndaj asnjë kandidati”.*²²³ Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Avokati i Popullit dhe Këshilli Shqiptar i Medias, që përbëjnë Aleancën kundër Gjuhës së urrejtjes, mbështetur nga KQZ dhe AMA, konstatojnë disa problematika.

“Vihet re një gjuhë e papërshtatshme, që përdoret nga eksponentët politikë, nga forca të ndryshme politike, që është shqetësuese sepse në pjesën më të madhe adresohet tek grupet më të

²²¹ <https://www.zeriamerikes.com/a/5858813.html>, aksesuar më 19.01.2023

²²² N. Selmani, E. Ahme, *“Manuali i gazetarëve për ndjekjen e zgjedhjeve”*, Aspekte etike dhe juridike, Botimi i dytë i plotësuar, Fondacioni Konrad Adenauer, në Republikën e Maqedonisë., Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë

²²³ Po aty.

pamundura dhe më vulnerabël në shoqërinë tonë. Kemi parasysh këtu, personat me aftësi të kufizuar, gratë, komunitetet rome dhe egjiptiane. Ndoshta jo e përkufizueshme në terma konkretë si gjuhë urrejtjeje, por gjithsesi një lloj tejkalimi i përdorimit të gjuhës dhe një papërshtatshmëri, e cila në këndvështrimin tonë është e evitueshme nga eksponentë të ndryshëm”. “Në fakt, spoti ishte shumë shqetësues e përmban problematika në dy nivele. Problematika e parë është vënia në fokus të këtij spoti me konotacion negativt një problem shëndetësor. Në asnjë rast, një gjë e tillë nuk duhet të bëhet. E dyta, ka të bëjë me stigmatizimin e një grupi të tërë shoqëror, duke u pretenduar se personat e moshës së tretë, nuk duhet të luajnë një rol aktiv në vendimmarrjet politike në Shqipëri.”²²⁴

Gjuha e urrejtjes në Parlament është një akt i turpshëm, i kryer nga ana e deputetëve, ku me zhargon vulgar rruge i drejtohen njëritjetrit, fyejnë deputetët. Ky fenomen ka qenë i përhapur shumë kohët e fundit në Shqipëri, duke krijuar një situatë të papranueshme, e cila kërkon marrjen e masave, që Rregullorja e Parlamentit të vendosë sanksione ndaj këtyre deputetëve në mënyrë që këto akte të turpshme mos të përsëriten në Parlament. Parlamenti është foltorja e elitës dhe nuk duhet pranuar gjuha me zhargon vulgar rruge. Ndezja e flakadanëve në parlament është akt i turpshëm. Duke pranuar që përdorimi i gjuhës së urrejtjes mund të pasqyrojë apo të promovojë supozimin e pajustificuar se personi, që shpërndan këtë gjuhë, është në njëfarë mënyre superior ndaj një personi apo grupit të personave të shënjestruar²²⁵;

Kodi i Sjelljes së Deputetit përcakton se:

Deputeti, gjatë ushtrimit të mandatit, shfaq standardet më të larta të sjelljes së qytetëruar, dinjitoze dhe të etikës parlamentare

²²⁴ <https://www.zeriamerikes.com/a/5858813.html>, aksesuar më 19.01.2023

²²⁵ “Rekomandimi Nr. 15 i Politikës së përgjithshme të ECRI-T, për luftimin e gjuhës së urrejtjes, miratuar më 8 dhjetor 2015, CRI (2016)15”, Version albanaise Albanian version, <https://rm.coe.int/ecri-general-policy-recommendation-no-15-on-combating-hate-speech-alba/16809eb58e>

korrekte.²²⁶ Deputeti përfshin dhe trajton pa diskriminim dhe me humanizëm, shqetësimet e nevojat e zgjedhësve, që përfaqëson në diskutimet e debatet në seancë plenare dhe në komisionet parlamentare, në shqyrtimin dhe miratimin e dokumenteve parlamentare e planeve të veprimit si dhe në aktet ligjore që miraton.

Gjuha joparlamentare dhe diskriminuese:

1. Përdorimi në Kuvend i gjuhës së pahijshme, fyese ose kërcënuese, ofendimet dhe sulmet fizike, personale, janë rreptësisht të ndaluara.

2. Deputetët i ndalohej:

a) të përdorë një gjuhë e një mënyrë të shprehuri, e cila nxit urrejtjen në bazë të racës, gjinisë, moshës, origjinës kombëtare, përkatësisë etnike, besimit fetar, prejardhjes sociale, aftësisë së kufizuar, gjendjes ekonomike, arsimore, shoqërore ose shëndetësore, gjendjes civile, familjare ose martesore, orientimit seksual, identitetit gjinor, përgjegjësisë prindërore, predispozicionit gjenetik, përkatësisë në një grup të veçantë ose për çdo shkak tjetër;

b) të shfaqë forma diskriminimi dhe stereotipizimi në komunikimin e përditshëm, në fjalime politike, në veprimtari parlamentare ose jashtëparlamentare ku merr pjesë.²²⁷

Dhuna ndaj grave në politikë

Studimi shqyrton dhunën ndaj grave në politikë dhe paraqet një sërë sugjerimesh për aktorë të ndryshëm se çfarë duhet të bëhet për të trajtuar këtë fenomen. Studimi është kryer nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) në Shqipëri dhe është realizuar në partneritet me Avokatin e Popullit. Avokati i Popullit dhe Komisioneri

²²⁶ Vendim, Nr. 61/2018, PËR MIRATIMIN E KODIT TË SJELLJES SË DEPUTETIT TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, neni 5 dhe 6, <https://kuvendiwebfiles.blob.core.windows.net/webfiles/Kodi%20i%20Sjelljes.pdf>, aksesuar më 16.02.2024

²²⁷ Vendim, Nr. 61/2018, PËR MIRATIMIN E KODIT TË SJELLJES SË DEPUTETIT TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, neni 5 dhe 6, <https://kuvendiwebfiles.blob.core.windows.net/webfiles/Kodi%20i%20Sjelljes.pdf>, aksesuar më 16.2.2024, <https://kuvendiwebfiles.blob.core.windows.net/webfiles/Kodi%20i%20Sjelljes.pdf>.

për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi në kuadër të Programit të Përbashkët të Kombeve të Bashkuara, United Nations Albania, “T’i japim fund dhunës ndaj grave në Shqipëri”, financuar nga Qeveria e Suedisë Embassy of Sweden in Tirana.

Studimi nxjerr në pah se:

Gratë në politikë përjetojnë forma të ndryshme të dhunës si përçmim, gjuhë ofenduese apo fyerje, ndërprerje të fjalës, kërcënime, akuza të rreme në media, ngacmime seksuale, refuzim të aksesit në financat e partisë. Gratë hiqen nga listat e kandidatëve të partisë, shkarkimin apo kërcënimin për shkarkim, hiqen nga puna, ngritja e akuzave të rreme, thashethemeve të natyrës seksuale dhe injorimin gjatë takimeve politike. Studimi tregon se gratë, të cilat synojnë të avancojnë në karrierën e tyre politike, hasin pengesa nga drejtuesit e partisë.²²⁸ Raporti thekson nevojën e përmirësimit të kuadrit ligjor, i cili duhet të mundësojë parandalimin dhe mbrojtjen efektive të grave e vajzave nga të gjitha format e dhunës me bazë gjinore. Partitë politike dhe drejtuesit e tyre, duhet të punojnë për demokratizimin e jetës brenda partive, për të krijuar një mjedis të shëndetshëm, larg çdo forme dhune, që mundëson përparimin e grave në politikë dhe vendimmarrje. Organet shtetërore dhe joshetërore inkurajohen të jenë pro-aktive në denoncimin e të gjitha rasteve të dhunës ndaj grave në politikë. Organizatat e shoqërisë civile (OSHC) dhe media luajnë një rol kyç në advokim për një pjesëmarrje të qenësishme të grave në politikë, dhe ndërgjegjësim kundër stereotipave gjinorë.²²⁹ A duam që vendi të eci përpara të fillojme me mbrojtjen e grave të diskriminuara në të gjitha sferat e jetës. Gratë janë një forcë e madhe e shoqërisë njerezore, një pjesë e tyre janë me potenciale të larta. Nga studimet e kryera rrëzohet se gratë janë me pak të korruptueshme se meshkujt.

²²⁸https://www.kmd.al/wp-content/uploads/2023/03/Raporti-KMD-2022_compressed.pdf, aksesuar më 21.01.2023

²²⁹ https://www.kmd.al/wp-content/uploads/2023/03/Raporti-KMD-2022_compressed.pdf, aksesuar më 21.01.2023

Rregullorja e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë

Kjo Rregullore ka parashikuar si masë disiplinore rastin kur deputeti përdor gjuhën joparlamentare dhe diskriminuese si më poshtë:

Neni 64

Masa disiplinore e “tërheqjes së vëmendjes”

1. Masa disiplinore e “tërheqjes së vëmendjes” jepet në rastet kur:

- a) deputeti përdor gjuhë joparlamentare, diskriminuese ose kryen veprime të tjera, të parashikuara në nenin 6, të Kodit të Sjelljes;*
- b) nuk paraqitet me veshje zyrtare, ose kryen një nga veprimet e parashikuara në paragrafët 2 dhe 3, të nenit 8 të Kodit të Sjelljes;*
- c) me sjelljen e tij, pengon zhvillimin e seancës plenare ose cënon rregullin.²³⁰*

Gjithashtu, në një nen tjetër të rregullores theksohet:

Neni 89

3. Kryetari i Kuvendit ka të drejtë të mos pranojë pyetje, interpelanca ose mocione, që janë formuluar me fjalë të pahijshme, paraqiten çështje që nuk janë nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave, cenojnë nderin, jetën private ose personalitetin e një individi, ose institucionin, janë në kundërshtim me Rregulloren e Kuvendit, ose pyetje dhe interpelanca, që janë konsumuar më parë, gjithashtu mocione, që janë diskutuar, ose janë marrë vendime për të njëjtin motiv brenda sesionit²³¹

²³⁰ Rregullorja e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, Botim i Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, Tiranë, 2024 f.67

<https://kuvendiwebfiles.blob.core.windows.net/webfiles/RregullorjaeKuvenditeperditesuar.pdf>, aksesar më 15.03.2024

²³¹ Rregullorja e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, Botim i Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, Tiranë, 2024 f.67,

<https://kuvendiwebfiles.blob.core.windows.net/webfiles/RregullorjaeKuvenditeperditesuar.pdf> aksesar më 15.3.2024 neni 89 paragrafi 3 f.102

Gjithashtu, në një nen tjetër të Rregullores parashikohet si masë disiplinore kur fyen, përdor dhunë, kërcënon sanksion, me përjashtim nga seanca plenare nga 10,30,60 ditë dhe konkretisht:

Neni 65/1 65

Masë disiplinore, “përjashtim nga pjesëmarrja në komisione dhe/ose në seancë plenare deri në 10 ditë, 30 ditë ose 60 ditë.

1. Masë disiplinore, “përjashtim nga pjesëmarrja në komisione dhe/ose në seancë plenare deri në 10 ditë”, i jepet deputetit:

a) kur edhe pas tërheqjes së vëmendjes e dhënies së vërejtjes nga drejtuesi i seancës/mbledhjes, bën thirrje për përdorim dhune, pengon zhvillimin e rregullt të seancës plenare/ mbledhjes së komisionit, shkakton kaos në seancë plenare/ komision, fyen, kërcënon ose dhunon deputetët e tjerë, drejtuesin e seancës, anëtarët e Këshillit të Ministrave, të ftuarit ose persona të tjerë, apo përdor fjalë fyese për Presidentin e Republikës, Kryeministrin ose institucione të tjera shtetërore.²³²

Gjuha e urrejtjes gjatë fushatave zgjedhore ndikon dhe dekurajon qytetarët të votojnë, marginalizon dhe nxit urrejtje ndërmjet grupeve të ndryshme të qytetarëve. Prandaj, shoqëria civile dhe media kanë një rol të rëndësishëm në promovimin e respektit, ndalimin e gjuhës së urrejtjes, diskriminimit, dekurajimin e partive politike dhe kandidatëve nga përdorimi i gjuhës së urrejtjes.²³³ Liria e shprehjes është e sanksionuar në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe mbron qytetarët nga ndërhyrja në të drejtën e tyre, për të shprehur lirisht mendimet e tyre. Kjo liri është thelbësore kur bëhet fjalë për procesin zgjedhor, megjithatë nuk duhet të shkaktojë gjuhë të urrejtjes, që do të

²³² Po aty f.80

²³³ Improving ethical standards of the electoral campaign in Albania and the responsibility of media to fight use of hate speech <https://www.coe.int/en/web/inclusion-and-antidiscrimination/-/improving-ethical-standards-of-the-electoral-campaig>

dëmtonte procesin zgjedhor, duke ndotur fushatën dhe debatin politik të nevojshëm, që votuesit të bëjnë një zgjedhje të informuar.²³⁴

Në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë është sanksionuar se: *“Partitë politike ose organizatat e tjera, programet, veprimtaria e të cilave mbështeten në metoda totalitariste, që nxisin dhe përkrahin urrejtjen racore, fetare krahinore ose etnike, që përdorin dhunën për marrjen e pushtetit, ose për të ndikuar në jetën politike shtetërore, si dhe ato me karakter të fshehtë janë të ndaluara sipas ligjit”*.²³⁵

Përveç Kushtetutës është parashikuar dhe në Ligjin për Partitë Politike, Nr. 8580, datë 17.02.2000, i përditësuar. Në të parashikohet:

“Ndalohet regjistrimi i një partie në rastet kur: d) në dokumentet e themelimit të saj shprehet nxitja dhe përkrahja e urrejtjes racore fetare, krahinore ose etnike”.²³⁶ Partitë politike dhe kandidatët, si dhe njerëzit që punojnë për ta, duhet të refuzojnë programet, dhe fushatat e tyre, të përdorin gjuhë diskriminuese ose të propozojnë politika dhe ligje diskriminuese, të shprehin, ose mbështesin ide a teori të superioritetit të një grupi personash, bazuar në racën, origjinën etnike, fenë, gjininë, moshën, orientimin seksual, identitetin gjinor, aftësinë e kufizuar, si edhe karakteristikat të tjera personale të mbrojtura apo një kombinim të tyre”.²³⁷ Organet mediatike, në mbulimin e fushatave zgjedhore nga ana e tyre, duhet të refuzojnë të përdorin apo

²³⁴ Po aty

²³⁵ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 9, (Ndryshuar me ligjet: nr. 9675, datë 13.01.2007; nr. 9904, datë 21.04.2008; nr. 88/2012, datë 18.09.2012; nr. 137/2015, datë 17.12.2015; nr. 76/2016, datë 22.07.2016; nr. 115/2020, datë 30.07.2020; nr. 16/2022, datë 10.02.2022, <https://qbz.gov.al/preview/635d44bd-96ee-4bc5-8d93-d928cf6f2abd>, aksesuar më 23.1.2024

²³⁶ Ligj, Nr. 8580, datë 17.02.2000, *“Për Partitë politike”*, (ndryshuar me ligjet: nr. 9452, datë 02.02.2006, nr.10 374, datë 10.02.2011, nr.17/2014 dhe nr. 90/2017, datë 22.05.2017, nr. 135/2020, datë 16.11.2020; shfuqizuar një fjalë me vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 33, datë 09.05.2001), (i përditësuar, 2017) neni 7 pika d, <https://qbz.gov.al/eli/ligj/2000/02/17/8580>, aksesuar më 23.1.2024

²³⁷ Komisioneri Për Mbrojtjen nga diskriminimi, *“Rekomandim mbi luftën kundër diskriminimit dhe Gjuhës së urrejtjes në fushata zgjedhore”*, Equinet, Rrjeti European i Organeve të Barazisë, aksesuar më 1.2.2024

të mbështetin gjuhën diskriminuese, apo politika, ide dhe teori të superioritetit të një grupi personash, bazuar në racën, origjinën etnike, fenë, gjininë, moshën, orientimin seksual, identitetin gjinor, aftësinë e kufizuar dhe karakteristika të tjera personale të mbrojtura, apo një kombinim të tyre. Raportimet mbi këto çështje dhe pasqyrimet e deklaratave në fushata zgjedhore, duhet të bëhen në mënyrë të përgjegjshme, me shpjegimet e duhura si edhe reflektime kritike mbi kontekstin në të cilin janë thënë.²³⁸ Partitë politike duhet të marrin në konsideratë zbatimin e praktikave dhe politikave për të arritur në listat e tyre zgjedhore një përfaqësim, i cili pasqyron diversitetin e njerëzve në shoqëri, në të gjitha nivelet, madje edhe në rastet kur mungon një detyrim i shprehur ligjor për ta bërë një gjë të tillë.²³⁹

Gjatë dekadës së fundit, Kosova përballët me rritje të gjuhës së urrejtjes në diskursin e saj politik me politikanët, që përdorin gjuhë përçarëse dhe diskriminuese për të arritur qëllimet e tyre. Gjuha e urrejtjes është formë e dhunës verbale dhe i tillë konsiderohet cildo veprim, që sulmon një person ose një grup personash në bazë të racës, përkatësisë etnike, fetare, politike, paaftësisë apo orientimit seksual.²⁴⁰ Ajo nuk duhet të zërë vend në një shoqëri demokratike dhe duhet të dënohet nga të gjithë anëtarët e partive politike, pavarësisht dallimeve ideologjike. Fatkeqësisht, kemi qenë dëshmitarë të normalizimit të gjuhës së urrejtjes ndër vite në Kosovë, derisa kjo dukuri rrezikon të polarizojë shoqërinë dhe të nxisë dhunë. Intensiteti i përdorimit të kësaj gjuhe shtohet dukshëm, para dhe gjatë fushatave zgjedhore. Padyshim, me mbi 96% qasje në internet, siç tregojnë të dhënat e Agjencisë së Statistikave të Kosovës, ndër mënyrat më të përshtatshme dhe efektive për të arritur deri te publiku, janë rrjetet sociale.²⁴¹

²³⁸ Po aty

²³⁹ Po aty

²⁴⁰ Demokraci për Zhvillim, <https://d4d-ks.org/editorial/gjuha-e-urrejtjes-tek-të-rinjtë-e-partive-politike-sa-është-duke-u-luftuar-kjo-dukuri/>, aksesuar më 19.01.2023

²⁴¹ ²⁴¹ Demokraci për Zhvillim, <https://d4d-ks.org/editorial/gjuha-e-urrejtjes-tek-të-rinjtë-e-partive-politike-sa-është-duke-u-luftuar-kjo-dukuri/>, aksesuar më 19.01.2023

Në shtator të vitit 2021, pak para zgjedhjeve lokale, me iniciativë të Institutit “*Demokraci për Zhvillim*” (D4D), ishte nënshkruar Deklarata e Mirësjelljes nga disa organizata të shoqërisë civile, partitë politike dhe mediat, me zotimin se palët do të përmbaheshin nga diskursi negativ në rrjete sociale. Mirëpo, këtij zotimi nuk iu ishin përmbajtur plotësisht partitë politike.²⁴² Ka qenë D4D-ja, ajo që gjatë dy raundeve të zgjedhjeve ka bërë monitorimin e rrjeteve sociale dhe nga analizimi i mbi 6 mijë artikujve, janë konstatuar 198 shkelje të Deklaratës së Mirësjelljes, më së shumti në “Facebook”, e ku dominuese ka qenë gjuha e urrejtjes. Pra, komunikimi politik rezulton të jetë ndër burimet kryesore të gjuhës së urrejtjes. Liderët politikë nuk janë të vetëdijshëm mjaftueshëm për përgjegjësinë që bart fjala e tyre dhe përdorimi i gjuhës së urrejtjes, sidomos në rrjetet sociale, të cilat në pamundësi të një vetëkontrolli të mirëfilltë, shërbejnë si çerdhe për përhapjen e kësaj gjuhe. Rrjedhimisht, shembulli i të vjetërve prek edhe të rinjtë e partive politike, të cilët në fakt, nuk kanë ndërmarrë ndonjë iniciativë për të ndryshuar situatën. Ata duhet të dalin nga zona komode dhe të nisin përpjekjet për të ndikuar në uljen e përdorimit të gjuhës së urrejtjes, qoftë edhe duke u përballur me elitat partiake, praktikuese të kësaj dukurie. Aktivistët e rinj duhet të jenë insitues që komisionet disiplinore brenda partive, të kryejnë funksionin e tyre për të nxjerrë para përgjegjësisë përdoruesit e gjuhës së urrejtjes. Po ashtu, forumet rinore duhet të marrin iniciativa për të propozuar miratimin e instrumenteve vetërregulluese nga partitë si Kodet e Sjelljes dhe Kodet Etike, që përdorimin e gjuhës së urrejtjes nga anëtarët e tyre ta ndalojnë.²⁴³

Është e rëndësishme të kuptojmë se gjuha e urrejtjes nuk është vetëm një çështje morale, por edhe ligjore. Në Kosovë, si dhe në shumë vende të tjera, gjuha e urrejtjes është e ndaluar me ligj dhe konsiderohet si një formë e diskriminimit dhe e shkeljes së të drejtave të njeriut. Përveç Kushtetutës, korniza ligjore e Kosovës, e cila përfshin dispozita

²⁴² ²⁴² ²⁴² Demokraci për Zhvillim, <https://d4d-ks.org/editorial/gjuha-e-urrejtjes-tek-të-rinjtë-e-partive-politike-sa-është-duke-u-luftuar-kjo-dukuri/>, aksesuar më 19.01.2023

²⁴³ Demokraci për Zhvillim, <https://d4d-ks.org/editorial/gjuha-e-urrejtjes-tek-të-rinjtë-e-partive-politike-sa-është-duke-u-luftuar-kjo-dukuri/>, aksesuar më 19.01.2023

mbi gjuhën e urrejtjes, përmban Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Kodin Penal, si dhe Legjislacionin e Mediave.²⁴⁴ Pavarësisht dispozitave të bollshme ligjore, mungon efikasiteti i institucioneve të drejtësisë në sanksionimin e gjuhës së urrejtjes. Në këtë mënyrë, krijohet hapësirë për përhapjen e mëtejshme të kësaj dukurie, që mund të sjellë pasoja shkatërruese, duke krijuar klimë frike dhe mosbesimi në shoqëri.

5.2Aktorët e tjerë të gjuhës së urrejtjes

Kur bëhet fjalë për gjuhën e urrejtjes dhe diskriminuese për këtë kategori, mbizotërojnë gazetarët/mediat, të ndjekur nga individët (nëpërmjet komenteve), politikanët, personazhët publikë.²⁴⁵ Mediat dhe gazetarët, pavarësisht se nuk janë autorë të gjuhës së urrejtjes dhe diskriminuese, bëhen pjesë e saj duke riprodhuar ato që kanë thënë të tjerët pa e filtruar atë. Media nxjerr në pah diskursin e gjuhës së urrejtjes dhe diskriminuese, duke publikuar tituj për klikime dhe sensacionalë, që në shumicën e rasteve, frymëzojnë komente më gjuhë urrejtjeje nga lexuesit, të cilat nuk filtrohen, pavarësisht nga gjuha e urrejtjes që përmbajnë.²⁴⁶ Titujt për klikime karremi, përmbajtja e dezinformimeve dhe e gjuhës së urrejtjes në to për të terhequr lexuesit dhe për të denigruar individë të caktuar.

²⁴⁴ Demokraci për Zhvillim, <https://d4d-ks.org/editorial/gjuha-e-urrejtjes-tek-te-rinjte-e-partive-politike-sa-eshte-duke-u-luftuar-kjo-dukuri/>, aksesuar më 19.01.2023

²⁴⁵ ²⁴⁵ D. Hysa, K. Lani, Raport, Monitorimi për Gjuhën e urrejtjes në Shqipëri, Instituti Shqiptar i Media 2022, <https://www.institutemedia.org/wp-content/uploads/2022/07/Raport-Monitorimi-per-CC%88r-gjuh%C3%88n-e-urrejtjes-ne-CC%88-Shqip%C3%88ri.pdf>

²⁴⁶ D. Hysa, K. Lani, Raport, Monitorimi për Gjuhën e urrejtjes në Shqipëri, Instituti Shqiptar i Media 2022, <https://www.institutemedia.org/wp-content/uploads/2022/07/Raport-Monitorimi-per-CC%88r-gjuh%C3%88n-e-urrejtjes-ne-CC%88-Shqip%C3%88ri.pdf>

5.3Gjuha e urrejtjes në diskursin mediatik dhe ndikimi që ka në shoqëri

Që në fillim të kësaj analize, duhet theksuar se: “*të vlerësosh një sjellje të përgjegjshme etike si kufi të censures, është një absurditet. Etika nuk është censurë*”²⁴⁷. Etika mbron dhe pasqyron botën e vlerave, dhe kryesisht vlerat dhe dinjitetin njerëzor. Janë të rrallë ata studiues, që do ta kundërshtonin lirinë e medias, por, nga ana tjetër kjo liri nuk do të thotë se vetë media, mund dhe duhet të përjashtohet nga përgjegjësia që ka. Nuk ekziston asnjë lloj lirie, përfshirë këtu edhe lirinë e shprehjes që të jetë absolute. “Ajo kufizohet nga detyra, nga ligji, për të respektuar dinjitetin e të tjerëve dhe lirinë e tyre legjitime. Nuk duhet të shkruhen, të krijohen dhe të transmetohen programe nëse ato dëmtojnë të vërtetën: jo vetëm të vërtetën faktike që përcillet, por edhe “*të vërtetat rreth një qenieje njerëzore*”, dinjitetit të një personi në të gjitha dimensionet.”²⁴⁸ Media shqiptare reflekton thuajse të gjitha problematikat e lartpërmendura. Pozitiv është fakti që për shumicën e gazetarëve të medias audiovizive, gjuha e urrejtjes nuk është fenomen i panjohur. Nga gazetarët e anketuar, 36% e tyre shprehen se kanë shumë njohuri mbi gjuhën e urrejtjes, 28% pak dhe 36 % disa njohuri, ndonëse më shumë se gjysma e tyre nuk janë në gjendje të japin një përkufizim. Megjithatë, vlen të theksohet se ende nuk ka një përkufizim të gjithëpranuar nga studiuesit, se çfarë është gjuha e urrejtjes, ndërsa universiteti është burimi kryesor i njohurive të gazetarëve mbi gjuhën e urrejtjes; vetëm 22% e të anketuarve shprehen se njohuritë i kanë marrë në median ku punojnë dhe 19% në trajnime të ndryshme²⁴⁹.

²⁴⁷ “Gjuha e urrejtjes në mediat audiovizive”, Studime dhe analiza të prezantuara në Tryezën e Rrumbullakët, organizuar nga Këshilli i Ankesave, pranë AMA-s, R. Capuri, “Liria e shprehjes përballë gjuhës së urrejtjes” 14.11.2018 <https://ama.gov.al/wp-content/uploads/2019/09/HATE-SPEECH-1.pdf>

²⁴⁸ Po aty

²⁴⁹ “Gjuha e urrejtjes në mediat audiovizive”, Studime dhe analiza të prezantuara në Tryezën e Rrumbullakët, organizuar nga Këshilli i Ankesave, pranë AMA-s, L. Axhami “Gjuha e urrejtjes dhe profesionalizmi i gazetarëve”, f.6

Politika prodhon më shumë gjuhë urrejtjeje në media, por ky fakt nuk përjashton rolin e gazetarëve si një hallkë të rëndësishme në parandalimin dhe kufizimin e shfaqjes së këtij fenomeni. Gazetarët duhet të jenë më të vëmendshëm dhe selektiv në informacionin që përçojnë, pavarësisht burimit. Për të frenuar gjuhën e urrejtjes nevojitet funksionimi i bordeve të etikës si një instrument vetërregullues i medias.²⁵⁰ Rritja e ndërgjegjësimit dhe edukimit të gazetarëve nëpërmjet trajnimeve të ndryshme shfaqet si domosdoshmëri. Gjithashtu, kërkohet përmirësimi i mëtejshëm i kurrikulës mësimore në universitet në lëndët, që trajtojnë këtë dukuri, si p.sh.: tek Etika e medias (module të veçanta) etj., si reflektim i ndryshimeve të shpejta në mjedisin mediatik. Krahas rritjes së ndërgjegjësimit të gazetarëve, nevojitet zhvillimi i studimeve të mëtejshme ku fokusi nuk mbetet vetëm te gazetarët, por edhe tek audiencat në kushtet kur ka një rritje të interaktivitetit mes medias dhe audiencës.²⁵¹

Kodi ynë Penal ka dispozita të veçanta kushtuar gjuhës së urrejtjes, të zbatueshme njëloj për të gjithë qytetarët, pra edhe për njerëzit e medias.

Neni 265 i tij, thekson shprehimisht: “*Nxitja e urrejtjes dhe e grindjeve, për shkak të racës, etnisë, fesë ose orientimit seksual, si dhe përgatitja, përhapja, ose ruajtja, me qëllim përhapjen e shkrimeve me përmbajtje të tillë, kryer me çdo mjet ose formë, dënohet me burgim nga dy deri në dhjetë vjet*”. Ndërkaq, duhet theksuar se liria e fjalës nuk bie ndesh me sistemin ligjor, me çështjen e mbrojtjes së ligjeve. Kur ligji apo një ndjekje penale, nuk japin shpjegime të argumentuara se ku qëndron “*nxitja nga fjalët e artikuluar publikisht apo nga përmbajtjet*

²⁵⁰ Po aty, “*Gjuha e urrejtjes në mediat audiovizive*”, Studime dhe analiza të prezantuara në Tryezën e Rrumbullakët, organizuar nga Këshilli i Ankesave, pranë AMA-s, L. Axhami “*Gjuha e urrejtjes dhe profesionalizmi i gazetarëve f. 9*

²⁵¹ Po aty, “*Gjuha e urrejtjes në mediat audiovizive*”, Studime dhe analiza të prezantuara në Tryezën e Rrumbullakët, organizuar nga Këshilli i Ankesave, pranë AMA-s, L. Axhami “*Gjuha e urrejtjes dhe profesionalizmi i gazetarëve f.9*

e hedhura në qarkullim”, vetëm atëherë mund të thuhet se i është hapur rruga, shkeljes flagrante të të drejtave të njeriut.²⁵²

Megjithatë, rastet e veçuara të pas 1990-s, në shtypin e shkruar dhe në transmetimet e RTSH apo kanaleve private televizive në vitet 2000, si dhe kontaktet e gjera me forume e organizata mediatike ndërkombëtare, kanë influencuar në hartimin e kodeve etike, ku shprehimisht gjuha e urrejtjes është cilësuar e papranueshme dhe e dënueshme nga aspekti i etikës profesionale.

Konkretisht, Kodi më i ri i 2018-s thekson: *“Media duhet të mos botojë materiale që nxisin urrejtje apo dhunë ndaj individëve mbi bazën e racës, fesë, kombësisë, ngjyrës, origjinës etnike, anëtarësisë, gjinisë, orientimit seksual, statusit civil, paaftësisë, sëmundjes apo moshës. Ky parim plotësohet më tej, më në detaje, me përcaktimet e tjera lidhur me ndërhyrjet në jetën private, nxitjen e krimit, dhunës apo me mbrojtjen e fëmijëve dhe personave me aftësi të kufizuar”*.²⁵³ (ISHM, Kodi i Etikës së Gazetarit, 2018)

Stereotipet me bazë gjinore përbëjnë ndër shkeljet më flagrante të etikës së informacionit dhe komunikimit në media. Si përkufizime stilistike gjuhësore, stereotipet që lidhen me gratë dhe vajzat, të përdorura në medime masive sikurse është televizioni, kanë ndikim të drejtpërdrejtë në ngritjen e një opinioni të caktuar publik, lidhur me statusin dhe të drejtat e grave.²⁵⁴ Ekranit televiziv edhe pse në konkurrencë të ashpër me magjinë e internetit, mban ende supremacinë e informimit dhe edukimit publik dhe kjo, ndihet më së shumti, në komunitetet lokale. Televizioni, sipas studiuesve të komunikimit dhe shkencave sociale, duke vënë në pah elemente të semantikës me përmbajtje paragjyquese, ndikon drejtpërdrejt në sjelljet dhe vlerësimet e ndryshme sociale. *“Sipas kërkimeve shkencore, stereotipet dhe diskriminimet mes dy gjinive në përmbajtjet mediatike kanë ardhur duke*

²⁵² Po aty, *“Gjuha e urrejtjes në mediat audiovizive”*, Studime dhe analiza të prezantuar në Tryezën e Rrumbullakët, organizuar nga Këshilli i Ankesave, pranë AMA-s, L. Axhami *“Gjuha e urrejtjes dhe profesionalizmi i gazetarëve f.13*

²⁵³ Po aty, f. 14

²⁵⁴ Po aty, f.21

*u shtuar e, për rrjedhojë, edhe impaktet e këtyre modeleve në shoqëri paraqesin rrezik në rritje”.*²⁵⁵ De juro, fenomeni i stereotipeve përballet me norma dhe sanksione të parashikuara nga Kodi i Transmetimit, që burojnë prej ligjit për transmetimet audiovizive. Normimi që parashikon ndalimin e këtij fenomeni dhe të tjerë, që lidhen me diskriminimin dhe gjuhën e urrejtjes, përmbledhen tek disa nene të Kodit të Transmetimit. Ky Kod orienton qartazi mediat audiovizive në transmetimet e tyre për të respektuar të drejtat e njeriut:

- a) përmes raportimit jodiskriminues të gazetarit mbi baza gjinore;
- b) përmes përdorimit të terminologjisë neutrale në aspektin gjinor;
- c) përmes respektimit të parimeve të privatësisë dhe ruajtjes së konfidencialitetit (mbrojtja e të dhënave personale).²⁵⁶

Parimi i mosdiskriminimit është parashikuar dhe te Ligji për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë ku shprehimisht, sanksionohet veprimtaria e transmetimeve audiovizive, e cila garanton parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit gjinor, ndalimit të seksizmit në media dhe përfaqësimit gjinor në median audiovizive në përputhje me legjislacionin në fuqi.²⁵⁷

5.4 Ndalimi i gjuhës së urrejtjes nga Kodi Etikës së gazetarëve dhe ligjeve

Kodi i Etikës në Media përmban parimet bazë të etikës dhe të sjelljes së gazetarëve në përputhje me të. Gazetarët që nuk veprojnë në përputhje me Kodin e Etikës, nuk janë gazetarë profesionistë, s’ka asgjë të përbashkët midis gazetarisë etike dhe asaj joetike. Në Kodin e ri të Etikës, është e ndaluar gjuha e urrejtjes, nga gazetarët dhe nga media. Media nuk duhet të përdorë pushtetin e saj mediatik për të diskriminuar, fyer, sharë, shpifur, kërcënuar individët e thjeshtë, që nuk kanë pushtet

²⁵⁵ Po aty, f.21

²⁵⁶ Po aty, f.9

²⁵⁷ Ligj., Nr. 97/2013 Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë 1 (ndryshuar me ligjin nr. 22/20162, datë 10.03.2016, vendim i Gjykatës Kushtetuese, nr. 56, datë 27.07.2016, ligj nr. 91/2017, datë 22.05.2017, nr. 30/2023, datë 13.04.2023) (i përditësuar)

dhe që janë të pambrojtur. Kjo është e papranueshme në një shoqëri demokratike që vepron në bazë të ligjeve. Këta lloj gazetarësh dhe këto lloje mediash, që përdorin presione të tilla, nuk i interesojnë shoqërisë. Konkretisht, Kodi më i ri i Etikës, në Median e 2018-s thekson: “*Media duhet të mos botojë materiale që nxisin urrejtje apo dhunë ndaj individëve mbi bazën e racës, fesë, kombësisë, ngjyrës, origjinës etnike, anëtarësisë, gjinisë, orientimit seksual, statusit civil, paafësisë, sëmundjes apo moshës*”.²⁵⁸

Një Kod tjetër që e ka të theksuar mosnxitjen e gjuhës së urrejtjes, është dhe Kodi i Transmetimit. Në Kodin e Transmetimit sanksionohet:

*“Transmetimet audiovizive nuk duhet të nxisin urrejtjen, intolerancën, diskriminimin ose të justifikojnë dhunën ndërmjet shtetasve. Veprimtaria e transmetimeve audiovizive respekton normat morale dhe etike të shoqërisë, si dhe kërkesat e deontologjisë së profesionit të gazetarit.*²⁵⁹

Media dhe gazetarët duhet të respektojnë nderin dhe reputacionin e individëve, që bëhen objekte të interesit të tyre profesional”.²⁶⁰ Çdo informacion i pasaktë apo i rremë që dëmton, qëllimisht, ose jo qëllimisht, imazhin dhe reputacionin e një personi tjetër, përbën cënim të dinjitetit njerëzor.

Gjithashtu, ligji për mediat audiovizive, i ndryshuar ka parashikuar ndalimin e diskriminimit si: “*Veprimtaria e transmetimeve audiovizive garanton parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit gjinor, ndalimit të seksizmit në media dhe përfaqësimit gjinor në median audiovizive në*

karakterizojmë si shkrim gjërash të pavërteta në portale ose rrjetet shoqërore kundër gazetarit me qëllim për të diskredituar punën e tij. Edhe pse gazetarët në rastin e shpifjes, më së shumti, gjenden në anën e të akuzuarit, shpifja jo rrallë përdoret edhe për t'i diskredituar vetë gazetarët. Nuk ka të dhëna statistikore mbi çështjet e shpifjeve kundër organeve të medias dhe gazetarëve. Po të kemi parasysh edhe vendimet e shumë gjykatave në vend për të fshehur identitetin e palëve të përfshira në procese gjyqësore, atëherë do të bëhet akoma edhe më e vështirë që të përcaktohet numri i saktë i këtyre çështjeve.

Ministria e Drejtësisë raporton të dhëna vjetore mbi numrin e përgjithshëm të çështjeve dhe dënimeve për shpifje, por jo të dhëna specifike për çështjet ndaj gazetarëve. Po kështu, procedurat në gjykatë merren dhe regjistrohen ashtu si të gjitha procedurat për shkaktim dëmi, pa bërë dallim nëse çështjet janë kundër medias apo gazetarëve. Në Shqipëri shpifja rregullohet me anë të Kodit Penal dhe Kodit Civil. Edhe pse reforma ligjore e miratuar në vitin 2012 bëri mjaft ndryshime në kuadrin ligjor për shpifjen dhe fyerjen, nuk u arrit deri në një dekriminalizim të plotë të tyre³¹⁴. Kështu, shpifja e cila rregullohet me nenin 120 të Kodit Penal, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë nga pesëdhjetë mijë gjer në një milion e pesëqind mijë lekë ose deri në tre milionë lekë nëse bëhet botërisht ose në mënyrë të përsëritur. Shpifja përkufizohet si *“përhapja e qëllimshme e thënieve, si dhe çdo informacion tjetër që dihet se janë të rreme, që cenojnë nderin dhe dinjitetin e personit.”*

Përsa i përket Kodit Civil, dëmi jopasuror (Neni 625), mendohet se ka ndodhur atëherë kur personi:

- Ka pësuar një dëmtim të shëndetit, të integritetit fizik ose psikik të tij;
- është cenuar nderi, personaliteti ose reputacioni i tij;
- është cenuar e drejta e emrit;
- është cenuar respektimi i jetës private;

³¹⁴ L. Gaçanica, M. Arnautović, *“Mekanizma mbrojtës nga dhuna online”* Manual për gazetarë, Regional Platform for Advocating Media Journalists' Safety, Albanian Media Institute, Instituti Shqiptar i Medias Albania Mediacenter, Sarajevo 2018, f.13,14

- është cenuar kujtimi i një të vdekuri. Në këtë rast, bashkëshorti i personit të vdekur ose të afërmit e tij deri në shkallë të dytë, mund të kërkojnë shpërblimin e dëmit jopasuror.³¹⁵ Ndryshimet e bëra në Kodin Civil në vitin 2012, përcaktuan një listë të gjatë kriteresh, që duheshin patur parasysh kur të vlerësohej përgjegjësia civile në lidhje me dëmtimin e nderit dhe reputacionit të një individi. “*Dispozitat e reja ligjore përcaktojnë 11 faktorë specifikë joshterues, që duhen marrë parasysh nga gjykatat për të përcaktuar përgjegjësinë*”.. përcaktues të rëndësishëm ligjorë lidhur me shpifjen: Në këto raste duhet të shikohet:

- nëse deklaratat në media janë paraqitur si fakt apo opinion;
- nëse janë të vërteta apo të rreme, nëse i referohen saktësisht thënieve të një pale të tretë;
- nëse kanë lidhje me një “*çështje me interes publik, persona në poste qeveritare, apo që konkurrojnë në zgjedhje*”;
- dhe nëse autori ka respektuar rregullat e etikës profesionale (p.sh.: në rastet e mediave dhe profesionistëve të fushës së informimit). Sidoqoftë, shoqatat që mbështetin lirinë e shprehjes, shprehin shqetësimin se pavarësisht listës së detajuar, që duhet të orientojë gjykatësit, gjykimet civile mbartin rrezikun e gjobave dhe penalizimeve më të larta, që mund të vendosen edhe në mënyrë arbitrare.³¹⁶ Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut ka mbajtur një qëndrim të prerë: askush nuk mund e duhet të pengohet të shprehë mendimet e veta. Shprehje mendimi është: këndvështrimi i një gazetari ose autori dhe kuptimi nga ana e tij e një fakti të caktuar. Kjo është diçka e ndryshme nga vetë fakti. (Liria e shprehjes, ligji për shpifjen nga mediat dhe gazetarët).³¹⁷

³¹⁵ L. Gaçanica, M. Arnautović, “*Mekanizma mbrojtës nga dhuna online*” Manual për gazetarë, Regional Platform for Advocating Media Journalists’ Safety, Albanian Media Institute, Instituti Shqiptar i Medias Albania Mediacenter, Sarajevo 2018, f.13,14

³¹⁶L. Gaçanica, M. Arnautović, “*Mekanizma mbrojtës nga dhuna online*” Manual për gazetarë, Regional Platform for Advocating Media Journalists’ Safety, Albanian Media Institute, Instituti Shqiptar i Medias Albania Mediacenter, Sarajevo 2018, f.13,14

³¹⁷ ³¹⁷ L. Gaçanica, M. Arnautović, “*Mekanizma mbrojtës nga dhuna online*” Manual për gazetarë, Regional Platform for Advocating Media Journalists’ Safety, Albanian Media Institute, Instituti Shqiptar i Medias Albania Mediacenter, Sarajevo 2018, f.13,14

- Gjykata e vlerëson masën e dënimit për çdo rast konkret. Kompensimi duhet të jetë në përpjesëtim me dëmin e bërë ndaj reputacionit të palës së dëmtuar dhe përcaktohet me qëllim të kompesimit të dëmit të kryer.

- Nuk ekziston më mbrojtja e posaçme për personat publikë në lidhje me shpifjen, por nuk ka as ndalesë të këtyre padive nga ana e personave apo zyrtarëve publikë.³¹⁸ Në paditë për shpifje, barra e provës i takon palës paditëse, pra ajo duhet që të demonstrojë vërtetësinë e padisë. Normalisht, kjo vlen edhe për shpifjet e kryera në hapësirën online. Vëmendja duhet të përqëndrohet në evidentimin e nevojshëm të burimit, të datës dhe atij që ka kryer aktin e shpifjes online.

Si ta dallojmë shpifjen?

Shpifja konsiston në dëmtimin që i bëhet reputacionit të dikujt përmes paraqitjes dhe transmetimit të fakteve të rreme, në lidhje me një person fizik ose juridik një pale të tretë, duke ditur se ky informacion është i rremë, dhe duke e përhapur qëllimisht atë. Fakt të pavërtetë mund të përbëjë përshkrimi, që i bëhet gazetarit (p. sh.: kriminel), të dhënat e pavërteta për gazetarin (për jetën private, arsimimin, bindjet politike, për pjesëmarrjen në luftë etj.), të dhënat e pavërteta për tekstin/ kontributin/ emisionin etj. Më lart, trajtuam fyerjen dhe ajo është e ngjashme me shpifjen. Por, cili është saktësisht ndryshimi midis një deklarate shpifëse dhe një fyerjeje? ³¹⁹ Fyerja është një vërejtje e vrazhdë ofenduese, që mund të jetë e vërtetë ose çështje opinioni, ndërsa një deklaratë shpifëse përmban një pohim të rremë fakti, që dëmton reputacionin e tjetrit. Megjithatë, fyerjet mund të kalojnë kufirin e shpifjes nëse ato përbëhen nga deklaratat të rreme, që dëmtojnë reputacionin e tjetrit, gazetari

³¹⁸ L. Gaçanica, M. Arnautović, “*Mekanizma mbrojtës nga dhuna online*”, Manual për gazetarë, Regional Platform for Advocating, Media Freedom and Journalists’ Safety Albanian Media Institute, Instituti Shqiptar i Medias, Albania Mediacenter, Sarajevo 2018, f.14,15

³¹⁹ What is the Difference Between an Insult and a Defamatory Statement? Updated September 28, 2023 - *Originally Published on March, 18 2022*, <https://www.minclaw.com/difference-defamation-insult/> , aksesuar më 06.02.2024

(financimin/sponsorizimin, shtrembërimin e qëllimit të përmbatjes/faktit etj.).³²⁰

6.5 Mekanizma mbrojtës nga dhuna online

Në epokën e sotme dixhitale, interneti është bërë një pjesë integrale e jetës sonë, duke ofruar mundësi të shumta për lidhje, shprehje dhe fuqizim.³²¹ Megjithatë, krahas përfitimeve të saj, bota në internet është e rrënuar edhe nga forma të ndryshme të dhunës dhe abuzimit, duke synuar veçanërisht gratë dhe vajzat. Dhuna me bazë gjinore në internet (OGBV) i referohet çdo akti të dëmshëm të kryer ndaj një individi, bazuar në gjininë e tij, duke përdorur platforma dixhitale për të kryer dhunë, ngacmim ose diskriminim. Ky blog synon të hedhë dritë mbi modelet e OGBV, ndikimet e saj të gjera dhe rëndësinë e mekanizmave të mbrojtjes në internet.³²²

Kuptimi i modeleve të OGBV

Dhuna në internet kundër grave dhe vajzave përfshin një gamë të gjerë sjelljesh, duke përfshirë, por pa u kufizuar në sulmet kibernetike, ndarjen jokonsensuale të imazheve intime (NCII) ', ngacmimet në internet, doksimi dhe gjuha e urrejtjes, ndër të tjera. Këto akte synojnë

³²⁰ What is the Difference Between an Insult and a Defamatory Statement? Updated September 28, 2023 - *Originally Published on March, 18 2022*,
<https://www.minclaw.com/difference-defamation-insult/> , aksesuar më 06.02.2024³²⁰

³²¹ Exploring the Patterns of Online Violence against Women and Girls; its Impacts and Online Protection Mechanisms,
<https://wougnet.org/exploring-the-patterns-of-online-violence-against-women-and-girls-its-impacts-and-online-protection-me>. <https://wougnet.org/exploring-the-patterns-of-online-violence-against-women-and-girls-its-impacts-and-online-protection-me>

³²² Exploring the Patterns of Online Violence against Women and Girls; its Impacts and Online Protection Mechanisms,
<https://wougnet.org/exploring-the-patterns-of-online-violence-against-women-and-girls-its-impacts-and-online-protection-me>. <https://wougnet.org/exploring-the-patterns-of-online-violence-against-women-and-girls-its-impacts-and-online-protection-me>

individë, bazuar në gjininë e tyre dhe e gjithë kjo, mundësohet nga anonimiteti dhe lehtësia që vjen me internetin.³²³ Këto lloje të dhunës i kanë rrënjët në pabarazinë gjinore dhe mosbalancimin e pushtetit pasi autorët kërkojnë të heshtin, frikësojnë dhe kontrollojnë gratë dhe vajzat. Akte të tilla mund të ndodhin në platformat e mediave sociale, aplikacionet e mesazheve, komunitetet e lojërave në internet ose çdo hapësirë tjetër në internet ku individët ndërveprojnë. Statusi i dhunës me bazë gjinore në internet po bëhet gjithnjë e më shumë një kërcënim për individët, veçanërisht gratë dhe vajzat, i cili shkel të drejtat e tyre si privatësia, liria e fjalës dhe aksesit në informacion, ndër të tjera. Kjo shkelje tenton të torturojë psikologjikisht viktimat e OGBV-së, duke çuar në ndjenjat e turpës, fajit, frikës, ankthit, depresionit dhe vetëcensurës nga hapësirat online ndër të tjera.

Ndikimet e OGBV në të drejtat dixhitale të grave dhe vajzave

Dhuna në internet tenton të ketë efekte të ndryshme te individët në mënyra të ndryshme; Efekti më i zakonshëm është trauma, e cila zakonisht rezulton në izolim social.³²⁴ Mund të shtypë të mbijetuarit nga ndërveprimet sociale, si në internet ashtu edhe jashtë linje. Ky lloj izolimi krijon një ndjenjë pafuqie tek gratë dhe vajzat. Sipas Quinta, dhuna në internet çon gjithashtu në *shqetësime psikologjike si ankthi, depresioni dhe çrregullimi i stresit post-traumatik (PTSD)*. Frika dhe poshtërimi i vazhdueshëm me të cilin përballen viktimat, ndikojnë në vetëvlerësimin dhe mirëqenien e tyre të përgjithshme. DHBGJ në

³²³ Exploring the Patterns of Online Violence against Women and Girls; its Impacts and Online Protection Mechanisms, <https://wougnnet.org/exploring-the-patterns-of-online-violence-against-women-and-girls-its-impacts-and-online-protection-me>. <https://wougnnet.org/exploring-the-patterns-of-online-violence-against-women-and-girls-its-impacts-and-online-protection-me>

³²⁴ Exploring the Patterns of Online Violence against Women and Girls; its Impacts and Online Protection Mechanisms <https://wougnnet.org/exploring-the-patterns-of-online-violence-against-women-and-girls-its-impacts-and-online-protection-me>, <https://wougnnet.org/exploring-the-patterns-of-online-violence-against-women-and-girls-its-impacts-and-online-protection-me>

internet izolon gratë dhe riafirmon normat patriarkale, që tentojnë t'i heshtin ato dhe të kufizojnë liritë e tyre. Kjo nga ana tjetër e shtrin pabarazinë gjinore në të gjitha hapësirat, duke u lënë grave më pak vende ku të drejtohen për mbështetje, praktikisht. Shumë gra po u bashkohen komuniteteve të mbyllura ose po largohen nga mediat sociale në vend që të angazhohen në hapësira publike për shkak të frikës nga tërheqja e dhunës. Sipas një studimi nga World Web Foundation, Afrika ka hende kun më të madh gjinor në lidhjen në internet me një mesatare kontinentale prej pothuajse 50%, gratë që largohen në mënyrë aktive nga bota online, kjo ndarje mund të përkeqësohet edhe më shumë. Çfarë duhet bërë? Për të trajtuar këtë çështje, është e rëndësishme të vendosen dhe të kuptohen mekanizmat e disponueshëm për të luftuar dhunën në internet ndaj grave dhe vajzave. Prandaj, duhet të ndërmerren strategji dhe iniciativa të ndryshme për të fuqizuar gratë dhe vajzat, duke krijuar një hapësirë dixhitale të sigurt dhe më gjithëpërfshirëse.³²⁵ Kompanitë e teknologjisë duhet të marrin drejtimin në luftën kundër dhunës në internet. Kjo për shkak se ata posedojnë mjete, platforma dhe burime për të krijuar hapësira dixhitale më të sigurta, veçanërisht për grupet e marginalizuara dhe të heshtura strukturore.³²⁶ Bashkëpunimi ndërmjet organizatave të shoqërisë civile dhe kompanive të teknologjisë përmirëson moderimin e përmbajtjes dhe zhvillon algoritme, që identifikojnë dhe heqin në mënyrë proaktive përmbajtjen abuzive. *“Ka nevojë që kompanitë e teknologjisë të modifikojnë rrjetet e tyre, duke siguruar që përdoruesit të përdorin verifikimin me dy hapa, llogaritë e sigurta të mediave sociale dhe shfletimin e sigurt,”* vëren Gole Andrew. Ekziston gjithashtu, nevoja për të rritur ndërgjegjësimin për dhunën në internet, ndikimin dhe pasojat e saj. Duke edukuar gratë, vajzat dhe

³²⁵ <https://wougn.net/exploring-the-patterns-of-online-violence-against-women-and-girls-its-impacts-and-online-protection-me>

³²⁶ Exploring the Patterns of Online Violence against Women and Girls; its Impacts and Online Protection Mechanisms <https://wougn.net/exploring-the-patterns-of-online-violence-against-women-and-girls-its-impacts-and-online-protection-me>, <https://wougn.net/exploring-the-patterns-of-online-violence-against-women-and-girls-its-impacts-and-online-protection-me>

shoqërinë në përgjithësi, ne mund të nxisim një kulturë të shkrim-leximit dixhital dhe të përgjigjeve³²⁷

- Fakti/informacioni/materiali i pavërtetë, që është transmetuar në një portal online dhe kjo gjë është bërë në një artikull, koment, reklamë. Po kështu, edhe nëse është publikuar në rrjetet sociale (Facebook, Twitter e kështu me radhë).

- Njoftimi i rremë i referohet një personi specifik me synimin për të dëmtuar reputacionin ose nderin e personit. Jo rrallë, kjo gjë shtrihet edhe te pjesëtarët e familjes së gazetarit, për çka është e nevojshme interpretimi i tekstit në tërësinë e vet (me fjalë të tjera, lidhjen me personin e caktuar për shkak të dëmit të kryer).

- Në teori shpifje përbën edhe dëmtimi i kryer në hapësirën online në qoftë se përmban elemente të pavërtetë.³²⁸

6.6 Diskriminimi dhe Gjuha e urrejtjes për shkak të aftësisë së kufizuar

Personat me aftësi të kufizuar përfshijnë individët me dëmtime fizike, mendore, intelektuale apo shqisore aftagjata, të cilët në ndërveprim me barriera të ndryshme, mund të pengojnë pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në shoqëri, njësoj si pjesa tjetër e shoqërisë.³²⁹ Personat me aftësi të kufizuar vazhdojnë të jenë të disavantazhuar në tregun e punës. Arsytet e disavantazheve mund të jenë të shumta. Fillojnë me arsimimin, trajnimin profesional, mungesën e përshtatshmërisë,

³²⁷ Exploring the Patterns of Online Violence against Women and Girls; its Impacts and Online Protection Mechanisms <https://wougn.net.org/exploring-the-patterns-of-online-violence-against-women-and-girls-its-impacts-and-online-protection-me>.
<https://wougn.net.org/exploring-the-patterns-of-online-violence-against-women-and-girls-its-impacts-and-online-protection-me>

³²⁸ Po aty

³²⁹ Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar dhe Protokolli Opsional New York, dhjetor 2006,
https://www.un.org/disabilities/documents/convention/crpd_albanian.pdf, aksesuar më 05.02.2024

mungesën në shërbime mbështetëse, deri te paragjykimet dhe diskriminimi. Diskriminimi vazhdon të mbetet një nga problemet dhe pengesat kryesore në realizimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuar në Shqipëri, veçanërisht të drejtës për punësim.³³⁰ Personat me aftësi të kufizuar përfaqësojnë sot 10% të popullsisë si dhe një audiencë prej më shumë se 50 milion njerëzish vetëm në vendet e Bashkimit Europian³³¹. Por edhe pse kemi të bëjmë me një treg potencialisht mjaft të fuqishëm, përsëri personat me aftësi të kufizuar janë gati të padukshëm në media, të harruar, por edhe kur flitet për ta ndodh shpesh, që mënyrat e trajtimit të problemeve janë fyese, diskriminuese, poshtëruese.

Mediat janë një instrument i rëndësishëm në krijimin e një mentaliteti e kulture të detyrueshme për t’u zbatuar nga të gjithë elementet e shoqërisë, janë gjithashtu një instrument i domosdoshëm për të ndryshuar qëndrimet, mentalitetet e shoqërisë, për të hedhur poshtë stereotipet, injorancën, paragjykimet.³³²

Duke dhënë një imazh të respektuar të personave me aftësi të kufizuar shtypi, televizioni, radiot e mjetet e tjera të informacionit mund të kontribuojnë në mënyrë aktive në integrimin e këtyre njerëzve në shoqëri.

E parë në këtë kuptim, respektimi i parimeve bazë deontologjike, respektimi i një kodi bazë etik – përbën jo vetëm një obligim profesional, por duhet të përbëjë një detyrim ligjor, shoqëror e moral³³³

Diskriminim i personave me aftësi të kufizuara” është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose parapëlqim për shkak të aftësisë së kufizuar, që

³³⁰ “Punëdhënësit, personat me aftësi të kufizuar dhe ligji për mbrojtjen nga diskriminimi”, Raport vëzhgimi, Tiranë 2012, botim i Fondacionit Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar f.7

https://adrf.al/images/publications/Diskriminimi_punësimi_shqip.pdf, aksesuar më 05.02.2024

³³¹ Kodi I Etikes në Media Per personat me aftesi te Kufizuara Albanian Insitut Media

³³² ³³² Kodi I Etikes në Media Per personat me aftesi te Kufizuara Albanian Insitut Media

³³³ Kodi I Etikes në Media Per personat me aftesi te Kufizuara Albanian Insitut Media

ka si qëllim ose pasojë pengimin apo bërjen të pamundur të ushtrimit, njëlloj si të tjerët, të të drejtave dhe lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë dhe legjislacioni në fuqi.³³⁴

Ligji për Nxitjen e Punësimit Nr. 7995, datë 20.09.1995

Qëllimi i Ligjit për Nxitjen e Punësimit është ndjekja e politikave aktive të përgjithshme për të mbështetur punësimin e plotë, produktiv dhe të zgjedhur lirisht. Personat me aftësi të kufizuar bëjnë pjesë në grupet e veçanta që trajton ky ligj.³³⁵ Një nga pyetjet e drejtuara punëdhënësve kishte të bënte me njohjen e Ligjit për Nxitjen e Punësimit. Ligji për Nxitjen e Punësimit vendos detyrimin mbi punëdhënësit, që kanë të punësuar mbi 24 persona, që të punësojnë një person me aftësi të kufizuar. Inspektorati Shtetëror i Punës është institucioni që kontrollon zbatimin e këtij detyrimi.³³⁶ Çdo punëdhënës, që ka të punësuar persona me aftësi të kufizuara, ka të drejtën për të kërkuar subvencionim nga zyra përkatëse e punësimit për përshtatjen e vendit të punës, në mënyrën më funksionale për punëmarrësin me aftësi të kufizuar. Gjithashtu, ligji parashikon se paga e punëmarrësit me aftësi të kufizuar përjashtohet nga taksa deri në një masë të përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave.

Njohjes më të mirë të legjislacionit për mbrojtjen nga diskriminimi dhe nxitjen e punëdhënësve për të punësuar persona me aftësi të kufizuar, në respekt të parimit të barazisë, të parashikuar në

³³⁴ Ligji PËR PËRFSHIRJEN DHE AKSESUESHMËRINË E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA 27.4.2014

³³⁵ ³³⁵ “Punëdhënësit, personat me aftësi të kufizuar dhe ligji për mbrojtjen nga diskriminimi”, Raport vëzhgimi, Tiranë 2012, botim i Fondacionit Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar , f.17

³³⁶

kuadrin ligjor. Për këtë, bazuar në rezultatet e këtij vëzhgimi rekomandohet:³³⁷

- rritja e ndërgjegjësimit mbi diskriminimin dhe dimensionin e efekteve negative që sjell diskriminimi në marrëdhëniet e punës;

- rritja e ndërgjegjësimit në drejtim të të kuptuarit të çështjeve të aftësisë së kufizuar dhe eliminimin e miteve apo opinioneve të gabuara në lidhje me punësimin e personave me aftësi të kufizuara;³³⁸

- promovim i Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi brenda komunitetit të punëdhënësve kryesisht, përmes prezantimit të praktikave të mirë dhe thyerjes së paragjyimeve;

- harmonizimi i politikave antidiskriminuese dhe nxitëse për punësimin e personave me aftësi të kufizuar në nivel institucional;

- politika më aktive nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi në drejtim të tregut të punës, duke pasur këtu parasysh që diskriminimi shfaqet më së shumti, në këtë fushë;

- politika më aktive të institucioneve qëndrore dhe rajonale në lidhje me diskriminimin në fushën e punësimit të personave me aftësi të kufizuara;

- punëdhënësit duhet të kenë politikat e veta antidiskriminuese dhe mbi të gjitha duhet t'i promovojnë këto politika, duke filluar nga menazherët, supervisorët direktë të punonjësve, stafeve rekrutuese, pranë sektorëve të burimeve njerëzore, pra të gjithë personelit, i cili bën vlerësime, rekrutime apo merr vendime të ndryshme për punonjësit;

- punëdhënësit duhet të kenë dhe të njohin procedurat, që duhet të ndjekin në mënyrë efektive rastet e diskriminimit në vendin e punës;

- sigurimi i trajnimeve për stafin në lidhje me diskriminimin në vendin e punës;

³³⁷337 “Punëdhënësit, personat me aftësi të kufizuar dhe ligji për mbrojtjen nga diskriminimi”, Raport vëzhgimi, Tiranë 2012, botim i Fondacionit Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar f. 34

³³⁸338 “Punëdhënësit, personat me aftësi të kufizuar dhe ligji për mbrojtjen nga diskriminimi”, Raport vëzhgimi, Tiranë 2012, botim i Fondacionit Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar f.7

https://adrf.al/images/publications/Diskriminimi_punësimi_shqip.pdf, aksesuar më 05.02.2024

-monitorimi i vazhdueshëm i zbatimit të politikave apo parimit të barazisë në vendin e punës.³³⁹

Gjatë vitit 2022, Komisioneri është shprehur me 38 vendime dhe 2 vendime me gjobë për moszbatim vendimi, mbi ankesat/çështjet ex-officio, ku është pretenduar diskriminim për shkak të aftësisë së kufizuar.³⁴⁰ Disa prej vendimeve të mësipërme janë dhënë edhe për shkaqe të tjera, të pretenduara në ankesat respektive. Në përfundim të shqyrtimit të çështjeve janë dhënë vendimet si më poshtë:³⁴¹

☐ 16 (gjashtëmbëdhjetë) vendime diskriminimi;

☐ 9 vendime mosdiskriminimi;

☐ 7 vendime mospranimi;

☐ 6 vendime ndërprerjeje të procedurave hetimore pasi është arritur efektiviteti dhe qëllimi, për të cilin kishte nisur procedura hetimore. Problematikat e hasura gjatë shqyrtimit të çështjeve ku pretendohet diskriminim për shkak të aftësisë së kufizuar, janë si vijojnë:

☐ Mungesa e aksesueshmërisë në objekte, që ofrojnë të mira dhe shërbime, si p.sh.:

Zyrat e Postës Shqiptare, TKOB, ndërtesat e bashkive, Banka dhe institucione fetare.

☐ Aksesueshmëria në linjat e transportit publik, në qendrat e votimit në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të vitit 2021 dhe në stadiumin Air Albania;

☐ Përfitimi i aftësisë së kufizuar nga KMCAP Epror.

Përfitimi i pagesës për personat e verbër për periudhën shtesë të studimeve në arsimin e lartë;

³³⁹ Po aty https://adrf.al/images/publications/Diskriminimi_punësimi_shqip.pdf, aksesuar më 05.02.2024

³⁴⁰ “Raporti për mbrojtjen nga diskriminimi”, 2022, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, f. 43,44 https://www.kmd.al/wp-content/uploads/2023/03/Raporti-KMD-2022_compressed.pdf.

³⁴¹ https://adrf.al/images/publications/Diskriminimi_punësimi_shqip.pdf, aksesuar më 05.02.2024

□ Refuzimi për të regjistruar në shkollat e arsimit profesional nxënësit me aftësi të kufizuara³⁴²

Ngjashëm, me personat e tjerë të diskriminuar në BE, personat me aftësi të kufizuara janë në rrezik më të madh për të qenë viktimë të gjuhës së urrejtjes dhe krimit të urrejtjes.³⁴³ Në përgjithësi, personat me aftësi të kufizuara, duke përfshirë gratë me aftësi të kufizuara, dhe personat me aftësi të kufizuara intelektuale dhe psikosociale, janë në rrezik më të lartë nga ngacmimi, dhuna dhe krimi, duke përfshirë edhe botën dixhitale. Të dhënat e fundit të publikuara nga Agjencia për të Drejtat Themelore të BE-së, zbuluan se 50% e personave me aftësi të kufizuara kanë raportuar se janë ngacmuar gjatë një periudhe 5-vjeçare (krahasuar me 37% të personave pa aftësi të kufizuara). Megjithatë, gjuha e urrejtjes lidhur me aftësinë e kufizuar dhe krimet e urrejtjes, nuk njihen dhe sanksionohen si të tilla nga të gjitha shtetet anëtare të BE-së dhe në ligjin e BE-së. Legjislacioni aktual i BE-së për gjuhën e urrejtjes dhe krimin e urrejtjes nuk do të mbulojë arsyet e aftësisë së kufizuar, moshën, gjininë dhe orientimin seksual. Komisioni Evropian aktualisht, po kryen dy konsultime mbi këtë temë, për të përfshirë potencialisht gjuhën e urrejtjes dhe krimin e urrejtjes në listën e krimeve të BE-së dhe për të shtuar arsye të reja.³⁴⁴

G.K. kundër Drejtorisë Arsimore Rajonale Korçë Vendim nr. 102, Datë 12.04.2018

Faktet: A.K është prindi i fëmijës G.K me aftësi të kufizuara, të vërtetuar me Vendim KMCAP-je. Fëmija është i regjistruar në klasën e parë dhe ndjek procesin mësimor pranë shkollës 9-vjeçare “Sevasti

³⁴² Raporti për mbrojtjen nga diskriminimi, 2022., Komisioneri për Mbrojtjen Nga Diskriminimi. f. 43 ,44 https://www.kmd.al/wp-content/uploads/2023/03/Raporti-KMD-2022_compressed.pdf,

³⁴³ <https://www.edf-feph.org/the-eu-must-combat-disability-hate-speech-and-hate-crime/>, aksesuar më 05.02.2024

³⁴⁴ <https://www.edf-feph.org/the-eu-must-combat-disability-hate-speech-and-hate-crime/>aksesuar, më.05.02.2024

Qirjazi”, Korçë. Prindërit e fëmijës, para dy muajve kanë paraqitur një kërkesë pranë shkollës dhe pranë DAR Korçë, ku kanë kërkuar mësues mbështetës për të birin, por nuk kanë marrë asnjë përgjigje³⁴⁵. Ankuesi kërkon nga KMD të ndërmerren masat e nevojshme nga ana e DAR Korçë, lidhur me caktimin e një mësuesi mbështetës, sipas përcaktimeve në Udhëzimin Nr. 38, datë 07.10.2014, “*Kriteret e mësuesit ndihmës dhe për nxënësit me aftësi të kufizuar në institucionet publike të arsimit parauniversitar*”. Drejtoria Rajonale Arsimore Korçë ka informuar Komisionerin se: “ Pas kontaktit me Komisionin e Vlerësimit të fëmijëve me aftësi të kufizuar ju bëjmë me dije se ky fëmijë është vlerësuar nga Komisioni në vitin 2015, periudhë në të cilën ai frekuentonte kopshtin.³⁴⁶ Në momentin e vlerësimit nga ana e këtij Komisioni fëmija nuk ka patur një vlerësim nga KMCAP dhe prindit të tij i është rekomanduar realizimi i këtij vlerësimi (KMCAP) me qëllim mundësinë e rishikimit të dytë nga ana e Komisionit. Paralelisht, fëmija është ndjekur me plan edukativ individual 1 në kopsht. Nga informacioni i marrë nga shkolla që frekuenton fëmija, ky raport vlerësimi është dorëzuar në muajin, shkurt 2018. Deri në këtë moment, Komisioni nuk ka marrë asnjë kërkesë për rivlerësim të fëmijës”. Legjislacioni shqiptar u ngarkon detyra të rëndësishme njërive arsimore vendore (DAR/ZA) dhe drejtuesve të institucioneve arsimore, lidhur me mënyrën, se si duhen asistuar dhe krijuar kushtet e nevojshme, të përshtatshme në mësimdhënie për nxënësit me aftësi të kufizuar. Qëllimi kryesor i këtij legjislacioni në tërësinë e tij, është krijimi i të gjitha kushteve të nevojshme, që këta fëmijë të mund të arsimohen njëloj si të gjithë fëmijët e tjerë si dhe, ajo që vlen të theksohet më tepër, është prioriteti i këtij legjislacioni për t’i përfshirë dhe integruar ata në institucionet

³⁴⁵ “Përmbledhje, e Vendimeve të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi për Aftësinë e Kufizuar”, Tiranë, Tetor 2020, f.9 SHDPAK

https://adrf.al/images/publications/PERMBLEDHJE_VENDIMESH_KOMISIONERIT_PER_RASTET_E_DISKRIMINIT.pdf

³⁴⁶https://adrf.al/images/publications/PERMBLEDHJE_VENDIMESH_KOMISIONERIT_PER_RASTET_E_DISKRIMINIT.pdf

arsimore të zakonshme. Ngritja e një komisioni për vlerësimin e nxënësve të tillë është detyrim konkret për drejtuesit e institucioneve arsimore të zakonshme. Mirëpo, sikundër rezultoi gjatë shqyrtimit të kësaj çështjeje, nuk u vu në dispozicion asnjë dokument a shkresë zyrtare nga institucionet arsimore. Gjithashtu, as nga ana e drejtorit të shkollës, nuk u bë e mundur një kërkesë me shkrim pranë DAR Korçë, për mësues ndihmës. Gjatë trajtimit të çështjes nuk u siguruan prova, që prindi të kishte paraqitur me shkrim një kërkesë të tillë, siç parashikohet në DN, por një fakt i tillë nuk shlyen nga detyrimi për sigurimin e mësuesit mbështetës, as DAR Korçë dhe, as shkollën 9-vjeçare “Sevasti Qirjazi”, Korçë. Referuar procesverbalit të mbajtur nga Komisioni multidisiplinar i DAR Korçë, ata kanë qenë në dijeni të faktit se fëmija vuan nga çrregullime të spektrit autik, që në periudhën kur ai ishte i regjistruar në arsimin parashkollor, në Kopshtin nr. 12, Korçë.³⁴⁷

Vendim i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut *Komunikimi Nr. 2/2010, 4 prill 2014 Liliane Gröninger*

Faktet e ngjarjes

Ankimuesja bëri një ankesë për diskriminim për shkak të aftësisë së kufizuar, në nëntor 2009, në zyrën e Shërbimit Specialist të Integritimit (Integration sfachdienst, IFD) dhe Zyrën e Integritimit të Këlnit nga Autoriteti Rajonal i Rhineland, në të cilin ajo raportoi “*diskriminimin ndaj personave me aftësi të kufizuar në integrimin e tyre në tregun e punës*”.³⁴⁸ Ankimesja pohon se gjatë takimit me përfaqësuesit e institucioneve, cilësuar më lart “diskriminimi u

³⁴⁷ *Përmbledhje, e Vendimeve të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi për Aftësinë e Kufizuar*, Tiranë, Tetor 2020, f.9 SHDPAK

https://adrf.al/images/publications/PERMBLEDHJE_VENDIMESH_KOMISIONERIT_PER_RASTET_E_DISKRIMINIT.pdf

³⁴⁸ “*Diskriminimi ndaj personave me aftësi të kufizuar*”, Përmbledhje e pikëpamjeve dhe vendimeve të Komitetit për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar dhe të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut Tiranë, Mars 2021, https://adrf.al/images/publications/permbledhja_web.pdf aksesuar më 05.02.2024

konfirmua pa mëdyshje” dhe se asaj iu tha se Autoriteti Rajonal nuk kishte mjete ligjore për të ndihmuar djalin e saj. Ankimuesja pohon se djali i saj nuk kishte akses në programet e përgjithshme profesionale të orientimit dhe trajnimit, si dhe ato të punësimit.³⁴⁹ Djali i saj ndiqet nga një logoped dhe një fizioterapist dhe luan pingpong për të ruajtur aftësitë e tij mendore dhe fizike dhe familja financon këto aktivitete. Në tetor-nëntor 2009, ai gjithashtu, ndoqi dhe përfundoi me sukses një kurs arkëtari profesional, por agjencia e punësimit refuzoi të siguronte mbështetje financiare, me argumentin se trajnimi nuk ishte efektiv nga pikëpamja e kostove financiare. Ankimuesja pretendon se procesi gjyqësor ka mbi tre vjet në Gjykatën Sociale të Këlnit. Në mars-prill 2010 dhe prill-maj 2011, djali i ankimueses përfundoi një kurs kontabiliteti dhe familja mbuloi përsëri koston pasi, as trajnimi dhe, as mbështetja financiare nuk u mbuluan nga agjencia e punësimit. Ankimuesja deklaroi se agjencia e punësimit vendosi në një situatë disavantazhi personat me aftësi të kufizuar dhe pas disa vitesh papunësie, ata nuk ishin më në gjendje të ofronin asgjë në tregun e punës që më pas, të mund të shkonin në workshop-e të posaçme për personat me aftësi të kufizuar.³⁵⁰

Data e komunikimit: 25 qershor 2010.

Data e miratimit të pikëpamjeve: 4 Prill 2014.

Subjekti: Dështimi për të promovuar të drejtën për të punuar, duke mos ndihmuar në përfshirjen e një personi me aftësi të kufizuara në tregun e punës.

³⁴⁹ “Diskriminimi ndaj personave me aftësi të kufizuar”, Përmbledhje e pikëpamjeve dhe vendimeve të Komitetit për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar dhe të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut Tiranë, Mars 2021,

https://adrf.al/images/publications/permbledhja_web.pdf aksesuar më 05.02.2024

³⁵⁰ Po aty³⁵⁰ “Diskriminimi ndaj personave me aftësi të kufizuar”, Përmbledhje e pikëpamjeve dhe vendimeve të Komitetit për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar dhe të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut Tiranë, Mars 2021, https://adrf.al/images/publications/permbledhja_web.pdf aksesuar më 05.02.2024

Çështjet e trajtuara: Parimet, detyrimet e përgjithshme, barazia dhe mosdiskriminimi; ndërgjegjësimi; puna dhe punësimi. Nenet: 3, 4, 5, 8 dhe 2; nenet e Protokollit Opsional: 2 (d) dhe (e) Ankimuesja pohon se çdo masë që merr agjencia e punësimit dështon, sepse sipas ligjit, djali i saj ka të drejtë për një subvencion integrimi vetëm nëse aftësia e tij e plotë e punës mund të rikthehet brenda tre vjetësh. Ajo deklaron se është pikërisht, legjislacioni social, që parandalon përfshirjen në tregun e punës. Ankimuesja faton se djali i saj ka ndjekur një kopsht dhe shkollë të zakonshme dhe, se ajo i kishte siguruar edhe terapi shtesë. Gjithashtu, ankimuesja pohon se djali arriti të diplomahej nga një shkollë e mesme e zakonshme (Fachoberschulreife) përkundër pengesave të shumta.³⁵¹ Më tej, përshkruan problemet që djali i saj hasi gjatë trajnimit të tij profesional dhe pohon se agjencia e punësimit e caktoi atë në një program trajnimi, i cili nuk ishte i autorizuar për të trajnuar persona me aftësi të kufizuar. Si pasojë, se praktika e tij nuk do të njihej, edhe nëse ai do ta kishte kaluar me sukses provimin përfundimtar. Në këto kushte, ai ndryshoi ofruesin e trajnimit dhe arriti të finalizonte trajnimin e tij profesional, pavarësisht se sërish nuk iu dha asnjë ndihmë. Ankimuesja pohon se djali i saj nuk ka marrë ndonjë ndihmë, nga asnjë prej agjencive të punësimit ku ishte regjistruar, për të fituar përvojë pune ose për të lehtësuar përfshirjen e tij në tregun e punës.

Pengesat kryesore me të cilat përballen agjencitë e punësimit janë legjislacioni shoqëror në fuqi dhe ndarja e përgjegjësiwe ndërmjet institucioneve të ndryshme për përfshirjen e personave me aftësi të kufizuar në tregun e punës. Ajo i kërkoi vlerësim një eksperti ligjor, t'i shpjegonte mundësitë ligjore të agjencive të punësimit, për të promovuar përfshirjen e personave me aftësi të kufizuar në tregun e punës dhe sipas tij. Përfshirja në tregun e punës, është praktikisht e pamundur për të interesuarit. Kjo, pasi për personat me aftësi të kufizuar të përhershme, përfshirja në tregun e punës nuk bëhet përmes mbështetjes, që ofrohet

³⁵¹ “Diskriminimi ndaj personave me aftësi të kufizuar”, Përmbledhje e pikëpamjeve dhe vendimeve të Komitetit për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar dhe të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut Tiranë, Mars 2021, https://adrf.al/images/publications/permbledhja_web.pdf, aksesuar më 05.02.2024

me të ashtuquajturat “pagesa integrimi” pasi një përfitim i tillë nuk përputhet me objektivin e ligjit.³⁵² Kjo mangësi, si një problem i ligjit në zbatimin e pagesave të integrit, ka një ndikim negativ tek të interesuarit pasi nuk ka një formë tjetër mbështetjeje për ta në tregun e punës. Ankimuesja parashtroi se, kur i biri aplikon për punë, mund të prezantohet vetëm tek një menaxher dyqani dhe të paraqesë kërkesën e tij.³⁵³ Pas kësaj, “fati i tij” qëndron në duart e agjencisë së punësimit. Meqenëse sipas legjisllacionit social, djali i saj nuk është i përshtatshëm për një pagesë integrimi, punëdhënësit potencialë tërheqin ofertat e tyre. Ankimuesja pretendon se personat me aftësi të kufizuar nuk trajtohen në mënyrë të barabartë në krahasim me personat pa aftësi të kufizuar, kur ata aplikojnë për një vend pune, dhe se qeveria federale fsheh faktin që legjisllacioni social, pengon integrimin e tyre në tregun e punës. Pagesat e integrit janë të vetmet masa pozitive në dispozicion për të ndihmuar djalin e saj me përfshirjen e tij në tregun e punës. Ajo përsërit se ai ka një numër të konsiderueshëm kualifikimesh, por integrimi i tij në tregun e punës ka dështuar për shkak të legjisllacionit në fuqi.³⁵⁴

Shkelje

Ankimuesja pretendon se djali i saj është viktimë e shkeljeve të të drejtave të tij nga shteti gjerman, sipas neneve 3, 4, 8 dhe 27 të Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar (Konventa). Megjithatë autori nuk ka vendosur nenin 5 në mënyrë specifike,

³⁵² “Diskriminimi ndaj personave me aftësi të kufizuar”, Përmbledhje e pikëpamjeve dhe vendimeve të Komitetit për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar dhe të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut Tiranë, Mars 2021, https://adrf.al/images/publications/permbledhja_web.pdf, aksesuar më 05.02.2024

³⁵³ “Diskriminimi ndaj personave me aftësi të kufizuar”, Përmbledhje e pikëpamjeve dhe vendimeve të Komitetit për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar dhe të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut Tiranë, Mars 2021, https://adrf.al/images/publications/permbledhja_web.pdf, aksesuar më 05.02.2024

³⁵⁴ “Diskriminimi ndaj personave me aftësi të kufizuar”, Përmbledhje e pikëpamjeve dhe vendimeve të Komitetit për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar dhe të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut Tiranë, Mars 2021, https://adrf.al/images/publications/permbledhja_web.pdf, aksesuar më 05.02.2024

komunikimi gjithashtu, duket se përmban në thelb edhe çështje që kanë të bëjnë me këtë nen.

Vlerësimi i Komitetit

Komiteti vëren pretendimet e ankimueses se dispozitat e legjislationit social në lidhje me dhënien e një pagese integrimi, janë diskriminuese pasi ato janë të zbatueshme vetëm për personat me aftësi të kufizuar. Aftësia e plotë e punës së mund të rikthehet brenda 36 muajve. Këto subvencione faktikisht, nuk krijojnë të drejta për personat me aftësi të kufizuar, pasi e drejta për të kërkuar një subvencion të tillë, i përket ekskluzivisht punëdhënësit dhe diskrecioni, që kanë agjencitë e punësimit në zbatimin e tyre, çon në diskriminim të mëtejshëm. Komiteti gjithashtu, vëren parashtrimin e shtetit palë se djali i ankimueses është i përshtatshëm për një pagesë të tillë integrimi nëse plotësohen kriteret ligjore. Sipas tyre, një punëdhënës duhet të bëjë një ofertë punësimi për djalin e ankimueses dhe të aplikojë për pagesën e integrit. Agjencia e punësimit vetëm pas kësaj procedure vlerëson rastin dhe merr një vendim për kohëzgjatjen dhe shumën e pagesës së integrit. Në çdo rast, sipas parashtrimit të shtetit palë, subvencioni do të arrijë në një maksimum prej 70 % të pages për një periudhë maksimale prej 60 muajsh. Komiteti vëren se qëllimi pas skemës së sipërpërmendur të pagesave të integrit, duket të jetë nxitja e punëdhënësve privatë për të punësuar persona me aftësi të kufizuar.³⁵⁵ Megjithatë, Komiteti vëren se skema e përmendur në praktikë, kërkon që punëdhënësit të kalojnë nëpër një proces shtesë, kohëzgjatja dhe rezultati i të cilit nuk janë të sigurt dhe, se personi me aftësi të kufizuar nuk ka mundësi të marrë pjesë në proces.

Politika duket se është në përputhje me modelin mjekësor të aftësisë së kufizuar sepse ajo tenton ta konsiderojë aftësinë e kufizuar si diçka, që është kalimtare dhe që, si pasojë, mund të “tejkalohe

³⁵⁵ “Diskriminimi ndaj personave me aftësi të kufizuar”, Përmbledhje e pikëpamjeve dhe vendimeve të Komitetit për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar dhe të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut Tiranë, Mars 2021, https://adrf.al/images/publications/permbledhja_web.pdf, aksesuar më 05.02.2024

kurohet” me kalimin e kohës. Politika nuk është në përputhje me parimet e përgjithshme të përcaktuara në nenin 3 të Konventës, të lexuara së bashku me paragrafët (i) dhe (j) të preambulës. Komiteti gjithashtu, vëren se në rastin e djalit të ankimueses, skema e mësipërme duket se ka shërbyer më shumë si një “frenues”, sesa si një nxitje për punëdhënësit. Komiteti vëren se neni 27 i Konventës nënkupton një detyrim nga ana e shteteve pale, për të krijuar një mjedis të përshtatshëm për punësimin, përfshirë në sektorin privat. Komiteti më tej, vëren se neni 4, paragrafi 1 (a), i Konventës i imponon shtetit palë detyrimin e përgjithshëm për të miratuar të gjitha masat e duhura legjislative, administrative dhe masa të tjera për zbatimin e të drejtave të njohura në Konventë, në lidhje me punësimin. Ai gjithashtu, vëren se neni 3 përcakton që në legjislacionin, politikat dhe në praktikën e tij, shteti palë duhet të udhëhiqet nga respektimi i dinjitetit, autonomisë individuale, duke përfshirë lirinë për të bërë zgjedhjet dhe pavarësinë e personave, mosdiskriminimin, pjesëmarrjen, përfshirjen e plotë dhe efektive në shoqëri, dhe barazinë e mundësive.

Në rastin në fjalë, Komiteti është i mendimit se modeli ekzistues për sigurimin e pagesave të integritetit, nuk promovon në mënyrë efektive punësimin e personave me aftësi të kufizuara. Komiteti konstaton në veçanti se ka vështirësi të dukshme, me të cilat përballen punëdhënësit e mundshëm kur përpiqen të marrin pjesë në skemën e pagesave të integritetit për punësimin e një personi me aftësi të kufizuara. Ky proces ndikon në efektivitetin e kësaj skeme ³⁵⁶. Procedurat komplekse administrative i vënë aplikantët në një pozitë të pafavorshme, që nga ana tjetër mund të rezultojë në diskriminim të tërthortë. Prandaj, Komiteti vëren se skema e pagesave të integritetit siç zbatohet në rastin e djalit të ankimueses, nuk është në përputhje me detyrimet e shtetit palë sipas nenit 27, paragrafi 1 (h), lexuar së bashku me nenin 3 (a), (b), (c) dhe (e), neni 4, paragrafi 1 (a) dhe neni 5, paragrafi 1, i Konventës.

³⁵⁶ “Diskriminimi ndaj personave me aftësi të kufizuara”, Përmbledhje e pikëpamjeve dhe vendimeve të Komitetit për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara dhe të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut Tiranë, Mars 2021, https://adrf.al/images/publications/permbledhja_web.pdf, aksesuar më 05.02.2024

Komiteti vëren pretendimin e ankimueses se pagesa e integritet është e vetmja masë pozitive në dispozicion për të ndihmuar djalit e saj për përfshirjen në tregun e punës. Komiteti më tej, vëren se në realitet, masat e aplikuara nga autoritetet e shtetit pale, për të ndihmuar integritetin e tij në tregun e punës përfshinin: *dhënien e pagesave të papunësisë për periudha të paspecifikuara kohore, takime këshilluese dhe kontrole*, për të parë nëse djali ndodhej në zonën në të cilën ishte caktuar dhe, nëse ai paraqitej rregullisht për takime. Autoritetet gjithashtu, i kishin propozuar vende të lira pune, disa prej të cilave ishin joaktuale. Komiteti më tej, vëren se përfaqësuesit e shtetit pale, duhet të jenë të mendimit se përpjekjet e djalit të ankimueses për të rritur kualifikimet e tij përmes arsimit të vazhdueshëm dhe fakti që ai kishte pranuar disa herë punë me kohë të pjesshme, përbëjnë një pengesë për përpjekjet e agjencive të punës për ta ndihmuar atë. Në fund, Komiteti vëren se masa e zbatuar për rastin e djalit të ankimueses, ishte e kufizuar në krahasim me listën e gjerë të masave në dispozicion të përshkruara nga shteti palë. Komiteti vëren se neni 27, paragrafi 1 (d) dhe (e), i Konventës parashikon të drejtat për të përfutur nga masat e duhura të promovimit të mundësive të punësimit, të tilla, si: akses efektiv në shërbimet e përgjithshme të punësimit dhe punësimi.

Komiteti është i mendimit se masat e marra nga autoritetet përgjegjëse të shtetit palë, për të ndihmuar integritetin e djalit të ankimueses në tregun e punës, nuk plotësonin standardin e detyrimeve të shtetit pale, sipas nenit 27, paragrafi 1 (d) dhe (e), lexojmë së bashku me nenin 3 (a), (b), (c) dhe (e), nenin 4, paragrafi 1 (a) dhe (b) dhe nenin 5, paragrafi 1, të Konventës³⁵⁷. Komiteti është i mendimit se shteti palë ka dështuar të përmbushë detyrimet e tij sipas nenit 27, paragrafi 1 (d), (e) dhe (h), lexuar së bashku me nenin 3 (a), (b), (c) dhe (e), neni 4, paragrafi 1 (a) dhe (b), dhe neni 5, paragrafi 1, i Konventës.

³⁵⁷ “Diskriminimi ndaj personave me aftësi të kufizuar”, Përmbledhje e pikëpamjeve dhe vendimeve të Komitetit për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar dhe të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut Tiranë, Mars 2021, https://adrf.al/images/publications/permbledhja_web.pdf, aksesuar më 05.02.2024

Rekomandime

Shteti palë është i detyruar të rregullojë situatën, duke përmbushur detyrimet e tij sipas Konventës ndaj djalit të autorit, duke rivlerësuar çështjen e tij dhe, duke zbatuar të gjitha masat në dispozicion sipas legjislacionit vendas me qëllim që të promovojë në mënyrë efektive mundësitë e punësimit nën dritën e KDPAK. Shteti palë duhet gjithashtu, të sigurojë kompensim adekuat për djalën e ankimeses, duke përfshirë kompensimin për shpenzimet e bëra për këtë komunikim. Duke marrë parasysh që legjislacioni i shtetit palë për këtë çështje, është miratuar para ratifikimit të Konventës, shteti palë është i detyruar të marrë hapa për të parandaluar shkelje të ngjashme në të ardhmen, duke rishikuar përmbajtjen dhe funksionimin e skemës për sigurimin e pagesave të integritetit për personat me aftësi të kufizuar të përhershme, për të siguruar përputhjen e plotë të saj me parimet e Konventës dhe duke siguruar që punëdhënësit e aktualë të mund të përfitojnë në mënyrë efektive nga skema kur është e përshtatshme.³⁵⁸

6.7 Gjuha e urrejtjes për persona të komunitetit LGBTI

Gjuha e urrejtjes i referohet nxitjes dhe inkurajimit të urrejtjes, diskriminimit ose armiqësisë ndaj një individi, që është i motivuar nga paragjykimi ndaj atij personi për shkak të një karakteristike të veçantë, p.sh.: *orientimit të tyre seksual ose identitetit gjinor*.³⁵⁹ “Krimi i urrejtjes” i referohet një sulmi fizik ose verbal ndaj një individi, që është i motivuar nga paragjykimi ndaj këtij personi për shkak të një karakteristike të veçantë, për shembull, *orientimit të tyre seksual ose*

³⁵⁸ “Diskriminimi ndaj personave me aftësi të kufizuar”, Përmbledhje e pikëpamjeve dhe vendimeve të Komitetit për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar dhe të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut Tiranë, Mars 2021, https://adrf.al/images/publications/permbledhja_web.pdf, aksesuar më 05.02.2024

³⁵⁹ Hate Speech and Hate Crimes against LGBT Persons, FRA, https://fra.europa.eu/sites/default/files/fra_uploads/1226-Factsheet-homophobia-hate-speech-crime_EN.pdf, aksesuar, më 10.4.2024

*identitetit gjinor. “Homofobia”, është frikë irracionale ndaj një personi sepse ai person është lezbik, gay ose biseksual. “Transfobia”, është frikë irracionale ndaj një personi sepse ata shprehen: se janë të një gjinie të ndryshme përkundrejt gjinisë ë caktuar në lindje, nëpërmjet p.sh.: trajtimit hormonal, kirurgjisë, veshjes ose kozmetikës. Frika dhe frikësimi që vjen nga krimet e urrejtjes dhe gjuha e urrejtjes, parandalojnë lezbiket, homoseksualët, biseksualët, të shfaqin hapur orientimin vetjak seksual.*³⁶⁰

CG (2021) 40-18 2/28 REZOLUCION 470 (2021)3

1. Çështjet që lidhen me orientimin seksual, identitetin gjinor, shprehjen gjinore, karakteristikat seksuale dhe të drejtat e personave LGBTI, kanë qenë të dukshme në agjendën e Këshillit të Evropës (KE) gjatë dekadës së fundit. Prej atëherë, janë ndërmarrë hapa pozitivë në shumë shtete anëtare për të përmirësuar situatën.³⁶¹ Gjithsesi, vihet re rritja e zërave konservatorë dhe fundamentalistë në Evropë, politizimi gjithnjë e më shumë i çështjeve gjinore, përcaktimi i personave LGBTI si koka turku, vënia në pikëpyetje e diversitetit në përgjithësi, dhe të drejtat e personave LGBTI, legjitimiteti i identitetit të tyre, në veçanti.

2. Rekomandimi i Komitetit të Ministrave CM/Rec(2010)5 për masat, për të luftuar diskriminimin në bazë të orientimit seksual dhe identitetit gjinor, udhëzime dhe standarde të përcaktuara në këtë fushë për autoritetet publike në shtetet anëtare. Po atë vit, Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës (PACE) miratoi Rezolutën 1728 dhe Rekomandimin 1915, duke adresuar diskriminimin në bazë të orientimit

³⁶⁰ Hate Speech and Hate Crimes against LGBT Persons, FRA, https://fra.europa.eu/sites/default/files/fra_uploads/1226-Factsheet-homophobia-hate-speech-crime_EN.pdf, aksesuar më 10.4.2024

³⁶¹ Report CG (2021)40-18, 17 June 2021, Protecting LGBTI people in the context of rising anti-LGBTI hate speech and discrimination: The role of local and regional authorities Le Congrès Conseil DE L Europe pg31, <https://rm.coe.int/protecting-lgbti-people-in-the-context-of-rising-anti-lgbti-hate-speech/1680a28860>, aksesuar më 10.4.2024

seksual dhe identitetit gjinor, thirrjen e shteteve anëtare për të zhvilluar politika për përmirësimin dhe sigurimin e barazisë LGBTI. Komisioneri për të Drejtat e Njeriut, Komisioni Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës (ECRI), Orientimi Seksual dhe Gjinia, Njësia e Identitetit të KIE (SOGI), Komisionit të Venecias dhe Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ) në dokumentet e tyre përkatëse, kanë prekur aspekte të ndryshme të të drejtave dhe barazisë për personat LGBTI³⁶²

Reagimi ndaj gjuhës së urrejtjes kundër personave LGBTI

ARTICLE 19. Në këtë dokument politikash, Neni 19, propozon përgjigjen ndaj shënjestrimit të “*gjuhës së urrejtjes*” për njerëzit për shkak të orientimit të tyre seksual ose identitetit gjinor.³⁶³ Propozimi është i bazuar mirë mbi rishikimin e standardeve ndërkombëtare dhe tendencave të brendshme, që kundërshtojnë evokimin e urrejtjes, që përbën nxitje për armiqësi, diskriminim ose dhunë (“nxitje”) në mënyrë specifike, dhe “gjuhë urrejtjeje” në përgjithësi, mbi këto arsye. Article 19 synon t’i përgjigjet kërkesave në rritje nga avokatët e të drejtave të njeriut, politikëbërësit dhe publiku i gjerë, për të përcaktuar “gjuhën e urrejtjes”, që synon: *lezbiket, homoseksualët, biseksualët, personat transgjinorë dhe interseksualë* (LGBTI) dhe rekomandojnë përgjigje brenda një kuadri, që mbron dhe promovon të drejtën e lirisë së shprehjes për të gjithë.³⁶⁴

³⁶² Report CG, (2021)40-18, 17 June 2021, Protecting LGBTI people in the context of rising anti-LGBTI hate speech and discrimination: The role of local and regional authorities Le Congres Consil DE L Europe pg31 <https://rm.coe.int/protecting-lgbti-people-in-the-context-of-rising-anti-lgbti-hate-speech/1680a28860>, aksesuar më 10.4.2024

³⁶³ Responding to Hate Speech against LGBTI people October 2013, Article 19, pg.2, https://www.ilga-europe.org/sites/default/files/responding_to_hate_speech_against_lgbti_people.pdf, aksesuar më 10.4.2024

³⁶⁴ Responding to Hate Speech against LGBTI people October 2013, Article 19, pg.2, https://www.ilga-europe.org/sites/default/files/responding_to_hate_speech_against_lgbti_people.pdf, aksesuar më 10.4.2024

Kombet e Bashkuara janë shperhur për gjuhën e urrejtjes. Gjuha e urrejtjes përdoret shpesh, për të dehumanizuar grupet dhe individët, tashmë të marginalizuar duke përkeqësuar diskriminimin dhe, duke nxitur dhunën.³⁶⁵ Është një sulm mbi thelbin e të drejtave të njeriut dhe një fyerje për të gjithë ne. Urrejtja kundër komunitetit LGBTI kryhet nga njerëz të të gjitha llojeve, përfshirë liderët fetarë, politikë dhe përforcohet si përmes mediave tradicionale, ashtu edhe atyre sociale. Shumë shpesh, nuk ka mbrojtje të vërtetë. Në të kundërt, në shumë vende, personat LGBTI përballen me ndjekje penale dhe ndëshkim për orientimin e tyre seksual ose identitetin gjinor. Platformat dhe algoritmet e mediave sociale, që përforcojnë opinionet shpesh, lehtësojnë përhapjen e gjuhës së urrejtjes. Por të njëjtat mjete mund të përdoren për të monitoruar rritjen e një diskursi të tillë dhe për të krijuar mbështetje për përfshirjen e diversitetit.

Kjo është arsyeja pse ndërmorëm Strategjinë dhe Planin e Veprimit të Kombeve të Bashkuara, për gjuhën e urrejtjes në fillim të këtij viti. Për sa kohë që njerëzit përballen me diskriminim dhe dhunë për shkak të orientimit të tyre seksual ose identitetit gjinor, Kombet e Bashkuara do të mbrojnë të drejtat e tyre.³⁶⁶ Krimet e urrejtjes ndaj personave *lezbike, homoseksualë, biseksualë, transgjinorë dhe interseks (LGBTI)* motivohen nga një paragjykim i bazuar në orientimin seksual, identitetin gjinor dhe/ose në karakteristikat seksuale të një personi.³⁶⁷ Në disa raste, personat LGBTI janë portretizuar nga media dhe politikanët

³⁶⁵ A. Guterres, Secretary-General United Nations Secretary-General's, message to the UN Core Group Meeting: Ending, Hate Speech against LGBT, People in Social and Traditional Media - Freedom of Speech vs. License to Hate, <https://www.un.org/sg/en/content/sg/statement/2019-09-24/secretary-generals-message-the-un-core-group-meeting->, aksesuar më 10.4.2024

³⁶⁶ A. Guterres, Secretary-General United Nations Secretary-General's, message to the UN Core Group Meeting: Ending, Hate Speech against LGBT, People in Social and Traditional Media - Freedom of Speech vs. License to Hate, <https://www.un.org/sg/en/content/sg/statement/2019-09-24/secretary-generals-message-the-un-core-group-meeting-> aksesuar më 10.4.2024

³⁶⁷ OSCE ODIR, Anti-LGBTI, hate crime, <https://hatecrime.osce.org/anti-lgbti-hate-crime> 2022, aksesuar më 10.4.2024

si një grup kërcënues dhe inferior, duke paraqitur rrezik për shëndetin publik dhe strukturat “*tradicionale*”, si martesë dhe familja. Personat LGBTI vazhdojnë të përjetojnë stigmatizimin dhe mungesën e mbrojtjes ligjore nga diskriminimi dhe krimi i urrejtjes. Raportimi vjetor i ODIHR-it mbi krimin e urrejtjes ka përfshirë raporte për sulme fizike dhe vrasje ku personat transgjinorë janë veçanërisht të rrezikuar. Sulmet e rënda fizike, të kryera nga grupe, veçanërisht rreth paradave të krenarisë, janë gjithashtu, tipare të zakonshme të krimeve të urrejtjes kundër personave LGBTI.³⁶⁸

Gjuha e urrejtjes dhe nxitja për dhunë kundër lezbikeve, homoseksualëve (gayit), biseksualitetit, transgjinorëve dhe personave interseks në Amerikë

Komisioni Ndëramerikan ka marrë informacion, që tregon se dhuna kundër personave lezbike, homoseksualë, biseksualë, transgjinorë dhe interseks (LGBTI) në rajon, nxitet nga shpërndarja e “gjuhës së urrejtjes”, duke përfshirë debatin publik, manifestime kundër ngjarjeve të organizuara nga personat LGBTI, si paradat e krenarisë, media dhe interneti.³⁶⁹ Edhe pse ka nevojë për studim të mëtejshëm të këtij fenomeni, dëshmitë tregojnë se, kur ndodhin krimet kundër LGBTI, këta persona paraprihen nga një kontekst dehumanizimi dhe diskriminimi të shtuar. Në një shoqëri demokratike shtetet duhet të mbrojnë lirinë e shprehjes, duke garantuar njëkohësisht, barazinë dhe sigurinë e të tjerëve. Në këtë detyrë komplekse, nga njëra anë shtetet thirren që të identifikojnë dhe t’u përgjigjen në mënyrë adekuate këtyre

³⁶⁸ OSCE ODIR, Anti-LGBTI, hate crime, <https://hatecrime.osce.org/anti-lgbti-hate-crime-2022>, aksesuar më 10.4.2024

³⁶⁹ CHAPTER IV1, HATE SPEECH AND INCITEMENT TO VIOLENCE AGAINST LESBIAN, GAY, BISEXUAL, TRANS AND INTERSEX PERSONS IN THE AMERICAS, http://www.oas.org/en/iachr/expression/docs/reports/hate/hate_speech_incitement_violence_against_lgbti.pdf, aksesuar më 10.4.2024

incidenteve, me synimin për të garantuar efektivisht të drejtat për integritet personal dhe siguri të personave LGBTI.³⁷⁰

Gjuha e urrejtjes është fenomen shqetësues dhe në rritje në Shqipëri. Personat LGBTI janë një nga grupet më të viktimizuara nga gjuha e urrejtjes.³⁷¹ Disa persona të komunitetit LGBTI si: *personat transgjinorë, interseks dhe azilkërkuessit* LGBTI janë më të diskriminuarit. Viktimizimi në median online është shqetësues. Është kjo arsyeja që Plani Kombëtar i Veprimit për personat LGBTI (2021-2027) adreson masa për garantimin e mbrojtjes dhe sigurinë për personat LGBTI+ dhe kategori të veçanta të tyre. Mbledhja e të dhënave, raportimi, hetimi dhe dënimi i krimeve të urrejtjes, përfshirë zbatimin e masave penale adresohen në këtë plan. Krimet e urrejtjes parashikohen nga Kodi Penal (KP), i cili është ndërtuar sipas modelit hibrid. Motivi i urrejtjes, përfshirë orientimin seksual dhe identitetin gjinor (OSIGJ), përmbledhet në përmbajtjen e pak neneve si: në nenin 253 (shkelja e barazisë së shtetasve), orientimi seksual pa identitetin gjinor parashikohet në nenin 265 (nxitja e urrejtjes ose ngrindjeve), neni 266 (thirrje për urrejtje nacionale) nuk përmend OSIGJ. Veprat penale të parashikuara në Kodin Penal, që kryen për shkak të OSIGJ, cilësohen si vepra penale të kryera në rrethana rënduese.

Kodi Penal nuk përmban ndonjë përkufizim të krimeve të urrejtjes. Përkufizimi i tyre, përfshirë krimet e urrejtjes kundër personave LGBTI, gjendet në udhëzuesit e hartuar për policinë, prokurorinë dhe gjykatat. Manuali: *“Hetimi i krimeve të urrejtjes kundër*

³⁷⁰ CHAPTER IV1, HATE SPEECH AND INCITEMENT TO VIOLENCE AGAINST LESBIAN, GAY, BISEXUAL, TRANS AND INTERSEX PERSONS IN THE AMERICAS,

http://www.oas.org/en/iachr/expression/docs/reports/hate/hate_speech_incitement_violence_against_lgbti.pdf aksesuar më 10.4.2024

³⁷¹ “Raporti kombëtar, krimet e urrejtjes dhe incidente të tjera me motivim të urrejtjes kundër personave LGBTI në Shqipëri”, Analiza tematike të zbatimit të Rekomandimit, CM/Rec(2010)5, të Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare të Këshillit të Evropës, mbi masat për të luftuar diskriminimin në bazë të orientimit seksual ose identitetit gjinor., mars 2023, f.14.

personave LGBTI”, e përkufizon krimin e urrejtjes si akt kriminal me motiv paragjykses. Dy janë elementet thelbësore të krimeve të urrejtjes: a) ka ndodhur një vepër penale dhe b) autori i veprës kriminale e ka kryer atë bazuar në një motiv paragjykses. Sipas manualit të sipërcituar, “krimet e urrejtjes kundër personave LGBTI janë akte kriminale për motive paragjykses”.³⁷² Komisioni i Venecias miraton opinione, përmbledhje *amicus curiae*, studime dhe udhëzime në fushën e mbrojtjes së të drejtave themelore, duke përfshirë në veçanti lirinë e organizimit, ndalimin e diskriminimit, lirinë e tubimit, lirinë e shprehjes dhe lirinë e ndërgjegjes dhe fesë.³⁷³

6.8 Rregullimi sipas legjislacionit Shqiptar për mosdiskriminimin e “klientit në nevojë”

Parimi i mosdiskriminimit vlen dhe për klientët në nevojë. Rregullimi sipas legjislacionit Shqiptar për “klientin në nevojë”, Kushtetuta e Shqipërisë nuk e parashikon të drejtën për strehim në katalogun e të drejtave, por në nenin 59 të saj nën rubrikën:³⁷⁴ “*Objektivat socialë*”, duke parashikuar që shteti, brenda kompetencave kushtetuese dhe mjeteve që disponon, si dhe në plotësim të nismës dhe të përgjegjësisë private, synon “*plotësimin e nevojave të shtetasve për strehim*”, si dhe “*standardin më të lartë shëndetësor, fizik e mendor, të mundshëm*”.³⁷⁵ Gjithashtu, po e njëjta dispozitë parashikon që “*Ligji përcakton kushtet dhe masën në të cilat mund të kërkohet realizimi i*

³⁷² Po aty, f.14

³⁷³ Venicie Kommission

https://www.venice.coe.int/WebForms/pages/?p=02_Rights&lang=EN aksesuar më 8.7.2024

³⁷⁴ *Mbrojtja e përmirësuar ndaj diskriminimit e konsumatorëve në nevojë, përmes zbatimit të kuadrit ligjor dhe rregullator*., Tiranë 2021, UDNP KMD, f. 9, Embassy Nowegian

³⁷⁵ “*Mbrojtja e përmirësuar ndaj diskriminimit e konsumatorëve në nevojë, përmes zbatimit të kuadrit ligjor dhe rregullator*.”, Tiranë 2021, UDNP KMD, f. 9, Embassy Nowegian

këtyre objektivave". Në këtë kuptim, objektivat socialë për t'u realizuar kanë nevojë për miratimin e ligjeve të posaçme, të cilat në parashikimet e tyre njohin njëkohësisht edhe të drejta, që bëhen të detyrueshme për zbatim. Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar Ligjin nr. 22/2018 "*Për strehimin social*", i cili ka përkufizuar konceptin "*strehim i përshtatshëm*", që duhet të garantojë jetën private, një jetesë të sigurt, të qetë dhe me dinjitet. Si një nga kushtet thelbësore, sipas këtij ligji për një strehim të përshtatshëm, është qasja "*në shërbimet publike, si: furnizimi me ujë të pijshëm dhe energji elektrike, largimi i ujërave të ndotura dhe menazhimi i mbetjeve*". Në vitin 2015, Kuvendi me propozim të Këshillit të Ministrave miratoi Ligjin nr. 43/2015 "*Për Sektorin e Energjisë Elektrike*"¹), i ndryshuar, që për herë të parë parashikon rregullimin e kësaj situate me një term, që quhet "*klienti në nevojë*"²). Ky ligj është përafëruar plotësisht me Direktivën 2009/72/KE të Parlamentit Europian dhe Këshillit, datë 13 korrik 2009, "*Mbi rregullat e përbashkëta për tregun e brendshëm të energjisë elektrike*".³⁷⁶ Sipas Ligjit, me këtë term kuptohet "*çdo klient familjar, i cili për shkak të gjendjes sociale, gëzon disa të drejta të veçanta lidhur me furnizimin me energji elektrike, të siguruar në raste përjashtimore, sipas përcaktimeve të këtij ligji*".

Ligji parashikon detyrimin e Këshillit të Ministrave për të disponuar në vendimmarrje lidhur me mënyrat, kriteret dhe procedurat sesi kategoritë që përfshihen në klientin në nevojë, do të marrin këtë përfitim.³⁷⁷ Ligji nr. 43/2015 "*Për Sektorin e Energjisë Elektrike*" e ka rregulluar këtë marrëdhënie në nenet përkatëse 95 e 96 të tij. Sipas parashikimeve të nenit 95, Ministria përgjegjëse për të hartuar kriteret, procedurat për përfitimin e statusit të klientit në nevojë dhe mënyrën e trajtimit të tyre, të cilat miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, është Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, si ministria

³⁷⁶ "*Mbrojtja e përmirësuar ndaj diskriminimit e konsumatorëve në nevojë përmes zbatimit të kuadrit ligjor dhe rregullator*"., Tiranë 2021, UDNP KMD f.10

³⁷⁷ "*Mbrojtja e përmirësuar ndaj diskriminimit e konsumatorëve në nevojë përmes zbatimit të kuadrit ligjor dhe rregullator*"., Tiranë 2021, UDNP KMD, f.10

përgjegjëse për çështjet sociale.³⁷⁸ Ligji vendos detyrimin që hartimi i këtyre kriterëve dhe procedurave, nga ana e kësaj ministrie duhet të bëhen në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për energjinë (Ministra e Infrastrukturës dhe Energjisë) dhe Ministrinë Financave, si dhe në konsultim me Entin Rregullator të Energjisë (ERE) dhe grupet e interesit. Kriteret thelbësore për të përfutur këtë status përcaktohen nga ligji, ku një ndër to, është ai i të ardhurave të ulëta të klientëve që mund të përfitojnë. Por, për të materializuar të drejtën që ligji ka garantuar për personat me të ardhura të ulëta, pra për ata që ligji i emërtion “*klientë në nevojë*”, ligji ka parashikuar nxjerrjen e një akti nënligjor, i cili do të përcaktojë modalitetet. Por, çfarë përfitojnë kategoritë në nevojë, që janë përfutues dhe gëzojnë statusin e “*klientit në nevojë*”? Përgjigjen e kësaj pyetjeje e gjejmë tek neni 96 i ligjit, në të cilin parashikohet se klientët familjarë, të cilët kanë përfutur statusin e klientëve në nevojë, në përputhje me kushtet e përcaktuara në nenin 95 të këtij ligji, kanë të drejtën e përfitimit të shërbimit të furnizimit universal, sipas parashikimeve të këtij ligji.

“*Shërbimin universal të furnizimit*”, ligji (neni 2, pika 76) e përkufizon: si një shërbim publik për furnizimin e klientëve fundorë, i cili siguron të drejtën e tyre për t’u furnizuar me energji elektrike të një cilësie të caktuar, brenda gjithë territorit të Republikës së Shqipërisë, me çmime të rregulluara, lehtësisht dhe qartësisht të krahasueshme, transparente dhe jodiskriminuese. Me Vendimin nr. 246, datë 11.12.2018, të Bordit të Entit Rregullator të Energjisë, është miratuar Rregullorja: “*Mbi kushtet specifike për ndërprerjen e furnizimit me energji elektrike të klientëve në nevojë*”³⁷⁹. Si bazë ligjore për miratimin e saj kanë shërbyer nenet 95 dhe 96 të Ligjit nr. 43/2015, që rregullojnë situatën e klientit në nevojë. KMD ka dërguar, me shkresë Nr. 1080, prot., datë 21.07.2022, “*Rekomandim për përfitimin e kompensimit të*

^{378 378} *Mbrojtja e përmirësuar ndaj diskriminimit e konsumatorëve në nevojë përmes zbatimit të kuadrit ligjor dhe rregullator*., Tiranë 2021, UDNP KMD, f.10

^{379 379} *Mbrojtja e përmirësuar ndaj diskriminimit e konsumatorëve në nevojë përmes zbatimit të kuadrit ligjor dhe rregullator*., Tiranë 2021, UDNP KMD, f.10

diferencës së çmimit të energjisë elektrike, për efekt të heqjes së fashës së konsumit deri në 300 Kwh në muaj, për gratë me aftësi të kufizuar, që nuk janë kryefamiljare”, drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Institutit të Sigurimeve Shoqërore, Shërbimit Social Shtetëror, Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile. Nëpërmjet tij, KMD ka rekomanduar:

- rishikimin e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 8/2015, të ndryshuar dhe Udhëzimit nr.1/2015 të MF-së, MEI dhe MMSR, duke përcaktuar përfitimin e kompensimit të diferencës së çmimit të energjisë elektrike nëse njëri nga bashkëshortët është me aftësi të kufizuar pavarësisht, nëse është kryefamiljar apo jo.³⁸⁰

Mosdiskriminimi në çështjet tregtare

Mosdiskriminimi është një koncept kyç në ligjin dhe politikën e OBT-së.³⁸¹ Siç u përmend tashmë në Kapitullin 1, ekzistojnë dy parime kryesore të mosdiskriminimit në ligjin e OBT-së: detyrimi i trajtimit të kombit më të favorizuar (MFN) dhe detyrimi i trajtimit kombëtar. Me fjalë të thjeshta, detyrimi i trajtimit kombëtar MFN e ndalon një vend të diskriminojë vendet e tjera. Diskriminimi midis/dhe ndaj vendeve të tjera, ishte një karakteristikë e rëndësishme e politikave tregtare proteksioniste, ndjekur nga shumë vende gjatë krizës ekonomike të viteve 1930. Historianët tani i konsiderojnë këto politika diskriminuese si një shkak të rëndësishëm kontribues të krizave ekonomike dhe politike, që rezultuan në Luftën e Dytë Botërore. Diskriminimi në çështjet tregtare ngjall pakënaqësi midis vendeve, prodhuesve, tregtarëve dhe punëtorëve të diskriminuar. Një pakënaqësi e tillë helmon marrëdhëniet ndërkombëtare dhe mund të çojë në konfrontime e konflikte ekonomike dhe politike. Për më tepër, diskriminimi ka pak kuptim ekonomik në përgjithësi, pasi shtrembëron tregun në favor të produkteve dhe shërbimeve, që janë më të shtrenjta dhe/ose me cilësi më

³⁸⁰ “Mbrojtja e përmirësuar ndaj diskriminimit e konsumatorëve në nevojë përmes zbatimit të kuadrit ligjor dhe rregullator”. Tiranë 2021, UDNP KMD, f.10

³⁸¹ <https://www.cambridge.org/core/books/abs/law-and-policy-of-the-world-trade-organization/principles-of->

të ulët. Përfundimisht, janë qytetarët e vendit diskriminues ata që përfundojnë duke “paguar faturën” për politikën e ndjekur, diskriminuese e tregtare.³⁸²

Marrëveshja e Përgjithshme mbi Tarifat dhe Tregtinë (GATT 1947), ka parashikuar:

Neni XIII Administrimi jodiskriminues i kufizimeve sasiore

Asnjë ndalim ose kufizim nuk do të zbatohet nga asnjë palë kontraktuese për importimin e ndonjë produkti të territorit të ndonjë pale tjetër kontraktuese ose për eksportimin e ndonjë produkti të destinuar për territorin e ndonjë pale tjetër kontraktuese, përveç nëse importimi i produktit të ngjashëm i të gjitha vendeve të treta ose eksportimi i produktit të ngjashëm në të gjitha vendet e treta, është në mënyrë të ngjashme i ndaluar ose i kufizuar.³⁸³ Negociatat për GATT, në të cilat kryesuan edhe delegacionet e Shteteve të Bashkuara dhe Mbretërisë së Bashkuar, përfunduan në më pak se një vit pavarësisht, dallimeve mjaft thelbësore midis pikëpamjeve amerikane dhe britanike. Shqetësimi i përbashkët i Shteteve të Bashkuara dhe Mbretërisë së Bashkuar ishte shmangia e diskriminimit në tregti megjithëse ata kishin pikëpamje të ndryshme se si duhej arritur kjo.³⁸⁴ GATT ishte një marrëveshje me objektiva ekonomike. Negociatorët kryesorë ishin kryesisht, ekonomistë dhe marrëveshja e tyre përfundimtare pasqyrore supozimet e kohës për përfitimet ekonomike të tregtisë. Teksti, i cili u hartua nga një anëtar i delegacionit amerikan, gjithashtu një ekonomist, u përfundua në tetor 1947 dhe GATT hyri në fuqi, në baza provizore, më 01 janar 1948. Fillimisht, ishin 23 nënshkrues të GATT. Në kohën kur GATT u përfshi

³⁸² <https://www.cambridge.org/core/books/abs/law-and-policy-of-the-world-trade-organization/principles-of>

³⁸³ The General Agreement on Tariffs and Trade (GATT 1947), https://www.wto.org/english/docs_e/legal_e/gatt47_01_e.htmhttps://www.wto.org/english/docs_e/legal_e/gatt47_01e.htm, aksesuar më 10.4.2024

³⁸⁴ **D. M. McRae**, *Emeritus Professor Faculty of Law University of Ottawa General Agreement on Tariffs and Trade, Geneva, 30 October 1947*, <https://legal.un.org/avl/ha/gatt/gatt.html>

në Organizatën Botërore të Tregtisë (në tekstin e mëtejshëm “OBT”), kishte 128 palë kontraktuese GATT. Anëtarësimi në GATT ishte i hapur jo vetëm për shtetet plotësisht sovranë, por edhe për qeveritë që “*po vepronin në emër të një territori të veçantë doganor që zotëronte autonomi të plotë në kryerjen e marrëdhënieve të jashtme tregtare*”.³⁸⁵ Administrata doganore shqiptare udhëhiqet nga ligji dhe bazohet në parimin e shanseve të barabarta, mosdiskriminimit, meritës, transparencës, profesionalizmit dhe paanësisë politike, që ndrueshmërisë në detyrë dhe vazhdimësisë në karrierë, integritetit, përgjegjësisë dhe korrektësisë në zbatimin e ligjit.³⁸⁶ Mosdiskriminimi është në qendër të ligjit të OBT-së dhe ligjit të BE-së. Të dyja shtresat e qeverisjes kanë të përbashkëta në duke trajtuar funksionimin e parimit, duke ndaluar në thelb dallimet e bazuara në origjinën e produkteve dhe kombësia e personave. Të dyja ndajnë funksionet bazë të parandalimit dhe korrigjimit të dështimeve të shtetit në dhënien e dhënies privilegje dhe mbrojtje të padrejtë ndaj produkteve vendase dhe shtetasve. Megjithatë, një analizë më e afërt tregon rëndësinë dallime të cilat ne i caktojmë për funksione të ndryshme kushtetuese të OBT-së dhe për një shumë më të gjerë e më shumë fushëveprimi ambicioz i ligjit të BE-së, duke përfshirë ndjekjen e qartë të qëllimeve të tjera politike dhe mbrojtjen e njeriut të drejtat. Dallimet funksionale do të mbeten. Ata kanë nevojë për njohje. Megjithatë, nevojat globale rregullatore e tregojnë këtë OBT-së do t'i duhet të zgjerohet për të njohur një gamë më të gjerë të qëllimeve legjitime të politikave. Duke vepruar kështu, ajo do të afrohet më shumë në matricën që përcakton mosdiskriminimin në nivel rajonal të BE-së. Theksim më i fortë në ndër- vlerat dhe proporcionaliteti ofron një urë për të kapërcyer disa nga divergjencat,

³⁸⁵ **D. M. McRae**, *Emeritus Professor Faculty of Law University of Ottawa General Agreement on Tariffs and Trade*, Geneva, 30 October 1947, <https://legal.un.org/avl/ha/gatt/gatt.html>

³⁸⁶ Kodi Doganor neni 12

duke kontribuar në koherencën e përgjithshme ecenca e qeverisjes shumëshiresore.³⁸⁷

6.9 Praktika e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD), në ushtrim të kompetencave të tij, ka sjellë në vëmendje një problematikë të tillë ndër vite.³⁸⁸ Me vendimmarrje vijuese ka kërkuar nga autoritetet përgjegjëse, të hartojë aktin nënligjor përkatës, për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave të përfitimit të statusit të klientit në nevojë dhe mënyrës së trajtimit të tyre, sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 43/2015, “*Për Sektorin e Energjisë Elektrike*”, i ndryshuar. Konkretisht, me vendimet nr. 92 dhe 97, datë 05.04.2018, Komisioneri ka konstatuar diskriminimin për shkak të gjendjes sociale dhe ekonomike të shkaktuar si pasojë e mosnxjerrjes së aktit nënligjor në zbatim të parashikimeve të Ligjit nr. 43/2015. Këto dy vendime janë bërë objekt i kontrollit gjyqësor nga gjykata administrative, e cila është shprehur se e vlerëson në përputhje me ligjin, përfundimin e arritur nga KMD, se mungesa e daljes së akteve nënligjore në zbatim të nenit 95 të Ligjit nr. 43/2015, ka cenuar jetesën dhe dinjitetin e ankuesve. Parë në këtë këndvështrim, ankuesit vendosen në pozita të disfavorshme pikërisht për shkak të gjendjes së tyre ekonomike.³⁸⁹ Gjatë procedurës administrative të realizuar nga Komisioneri, nga korrespondenca me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, Ministrinë e Infrastrukturës dhe të Energjisë, si dhe Entin

³⁸⁷ Thomas Cottier¹ and Matthias Oesch Direct and Indirect Discrimination in WTO Law and EU Law Working Paper No 2011/16 | April 2011
https://www.wti.org/media/filer_public/48/a9/48a96a1d-c754-4961-820c-8fa012587411/cottieroeschnccrwp16.pdf

³⁸⁸ “*Mbrojtja e përmirësuar ndaj diskriminimit të konsumatorëve në nevojë përmes zbatimit të kuadrit ligjor dhe rregullator*”, Tiranë 2021, UDNP KMD, f.13

³⁸⁹ ³⁸⁹ “*Mbrojtja e përmirësuar ndaj diskriminimit të konsumatorëve në nevojë përmes zbatimit të kuadrit ligjor dhe rregullator*”, Tiranë 2021, UDNP KMD, f.13

Rregullator të Energjisë rezultoi se këta aktorë shprehën vullnetin e tyre për të bashkëpunuar në hartimin e aktit nënligjor, por ata ishin në pritje të marrjes së nismës propozuese nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, si institucioni përgjegjës, përcaktuar nga neni 95/1 i Ligjit nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar. Ndërkohë KMD ka konstatuar edhe aspekte të tjera në lidhje me qasjen në energjinë elektrike. Konkretisht, me vendimet nr. 33 dhe 34, datë 07.04.2020, KMD ka konstatuar diskriminimin e tërthortë, për shkak të “gjendjes ekonomike”,³⁹⁰ të kategorisë së klientëve në nevojë, nga ana e Entit Rregullator të Energjisë (ERE).

KMD kërkoi nga ERE marrjen e masave për ndryshimin e Rregullores “Për Lidhjet e Reja në Sistemin e Shpërndarjes”, për lidhjen e Kontratës për Furnizimin me Energji Elektrike, duke çliruar nga barra e pagesës së tarifës së lidhjes së re, aplikantët që hyjnë në parashikimet ligjore të “klientit në nevojë”, të cilët ndodhen në pamundësi financiare për ta realizuar atë. Rezulton se, për shkak të gjendjes ekonomike, personat vendosen në situatë diskriminuese përballë pamundësisë për të siguruar furnizimin me energji elektrike, pasi lidhja e kontratës shoqërohet me kushtin për të paguar një shumë të konsiderueshme të hollash, e cila nuk mund të përballohet nga familjet e pamundura ekonomikisht. Kjo kategori ka si burim të vetëm jetese ndihmën ekonomike apo forma të tjera të mbështetjes shtetërore si: *pagesa e aftësisë së kufizuar, përfitimin e pensioneve të ndryshme, apo edhe pagesa e papunësisë*. Këto familje për shkak të pamundësisë ekonomike ose nuk kanë qasje në energjinë elektrike, ose e kanë të vështirë e shpesh, të pamundur efektivisht qasjen në energji elektrike. Në disa raste, ka rezultuar se masat lehtësuese, që autoritetet përgjegjëse kanë marrë për të gjithë klientët, që furnizohen me energji elektrike, nuk kanë adresuar nevojat e veçanta, që kategoritë në nevojë mund të kenë. Si pasojë kemi vendosjen në kushte të pafavorshme të tyre për të përfituar nga këto

³⁹⁰ “Raporti për mbrojtjen nga diskriminimi”, 2022 Komisioneri për Mbrojtjen Nga Diskriminimi, f.67, 68, https://www.kmd.al/wp-content/uploads/2023/03/Raporti-KMD-2022_compressed.pdf, aksesuar më 05.02.2024

lehtësi. Problematikat e konstatuara nga KMD tregojnë se legjislacioni de jure ka marrë masa për të eliminuar qasjen në informacion, ruajtjen e shëndetit, arsimin, garantimin e jetës private, familjare etj.³⁹¹

KMD ka rekomanduar:

- rishikimin e Vendimit të Këshillit të Ministrave, nr. 8/2015, të ndryshuar dhe Udhëzimit, nr.1/2015, të MF-së, MEI dhe MMSR, duke përcaktuar përfitimin e kompensimit të diferencës së çmimit të energjisë elektrike, nëse njëri nga bashkëshortët është me aftësi të kufizuar, pavarësisht nëse është kryefamiljar apo jo.³⁹²

6.10 Pasojat e gjuhës së urrejtjes

Gjuha e urrejtjes ka pasoja sociale dhe psikologjike, ngjall frikë, dhunë psikologjike, pasiguri, ankth, dëm emocional, përjashtim social. Mosgëzimin e të drejtave të njeriut. Të gjitha këto i shkaktohen një individ, që ka qenë objekt i gjuhës së urrejtjes për një kohë të gjatë . Pasojat mund të jenë me dëme afatgjata për viktimat e gjuhës së urrejtjes. Prandaj, ekspozimi dhe përvoja e urrejtjes në internet kanë një ndikim negativ në nivelet e depresionit, ankthit, vetëdysimit dhe/ose besimit.³⁹³ Çfarë është gjuha e urrejtjes dhe pse është problem? Gjuha e urrejtjes është një fenomen kompleks dhe shumëdimensional, që ka pasoja të mëdha dhe të rrezikshme për të drejtat e njeriut, sundimin e

³⁹¹ “Mbrotjtja e përmirësuar ndaj diskriminimit e konsumatorëve në nevojë përmes zbatimit të kuadrit ligjor dhe rregullator”, Tiranë 2021, UDNP KMD, f.13

³⁹² “Raporti për mbrojtjen nga diskriminimi”, 2022 Komisioneri për Mbrojtjen Nga Diskriminimi, f.67, 68,
https://www.kmd.al/wp-content/uploads/2023/03/Raporti-KMD-2022_compressed.pdf, aksesuar më 05.02.2024

³⁹³A. Dreißigacker, P. Mülle, A. Isenhardt, J. Schemmel, Criminological Research Institute of Lower Saxony (KFN e.V.), Lützerodestr. 9, 30161, Hannover, Germany
Online, hate speech victimization: consequences for victims’ feelings of insecurity
Article number: 04 2024
<https://crimesciencejournal.biomedcentral.com/articles/10.1186/s40163-024-00204-y>,
aksesuar 18.02.2024

ligjit në shoqëritë demokratike.³⁹⁴ Parandalimi dhe luftimi i gjuhës së urrejtjes në internet paraqet sfida specifike. Qëndrueshmëria dhe ndikimi janë dokumentuar nga organet monitoruese të Këshillit të Evropës dhe agjenci të tjera ndërkombëtare. Gjuha e urrejtjes jo vetëm që prek dinjitetin dhe të drejtat e njeriut të individit të shënjestruar drejtpërdrejt, por edhe të personave që i përkasin të njëjtës pakice ose grupi si ata të shënjestruar drejtpërdrejt. Gjuha e urrejtjes çon në ndarje të rrezikshme në shoqërinë në tërësi, ndikon në pjesëmarrjen dhe përfshirjen e të gjithë atyre, që janë në shënjestër prej saj dhe kërcënon demokracinë. Individët e prekur nga gjuha e urrejtjes, që përjashtohen gjithnjë e më shumë nga shoqëria, detyrohen të largohen nga debati publik dhe heshtin. Historia tregon se gjuha e urrejtjes është përdorur gjithashtu, qëllimisht për të mobilizuar grupe dhe shoqëri kundër njëra-tjetrës me qëllim që të provokojë përshkallëzim të dhunshëm, krim të urrejtjes, luftë dhe gjenocid. Vitet e fundit, gjuha e urrejtjes është përhapur gjithnjë e më shumë përmes internetit.

Parandalimi dhe luftimi i gjuhës së urrejtjes në internet paraqet sfida specifike pasi ajo mund të shpërndahet si kurrë më parë në të gjithë botën brenda pak sekondash.³⁹⁵ Këmbëngulja dhe rritja shqetësuese e gjuhës së urrejtjes, veçanërisht në internet, dhe ndikimi i saj në gëzimin e të drejtave të njeriut e demokracisë në Evropë, janë dokumentuar nga organet monitoruese të Këshillit të Evropës, Agjencia e Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore (FRA) të ndryshme, organizata të tjera ndërqeveritare, organizata të shoqërisë civile, ndërmjetësues të internetit, dhe organe të tjera. Në monitorimin e tij të fundit të vendit dhe raporteve vjetore, **Komisioni Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës (ECRI)** përshkruan, bazuar në statistika dhe studime të hollësishme, këmbënguljen dhe rritjen e gjuhës së urrejtjes ultranacionaliste, ksenofobike, raciste dhe LGBTI-fobike në anëtarë të ndryshëm. Për të shmangur një përshkallëzim të tillë, të rrezikshëm dhe

³⁹⁴ COUNCIL OF EUROPE, What is hate speech and why is it a problem?

<https://www.coe.int/en/web/combating-hate-speech/what-is-hate-speech-and-why-is-it-a-problem->, aksesuar më 07.03.2024

³⁹⁵ Po aty

për të krijuar e mbajtur shoqëri gjithëpërfshirëse, është e rëndësishme që shtetet anëtare të marrin masa efektive, dhe të qëndrueshme për të parandaluar dhe luftuar gjuhën e urrejtjes.³⁹⁶ Gjuha e urrejtjes jo vetëm që shkakton dëm në nivel personal dhe mund të nxisë dhunë, por është një sulm ndaj përfshirjes, diversitetit dhe të drejtave të njeriut. Ajo minon kohezionin social dhe gërryen vlerat e përbashkëta, duke penguar *paqen, stabilitetin, zhvillimin e qëndrueshëm dhe përmbushjen e të drejtave të njeriut për të gjithë*.³⁹⁷

Në përputhje me parimet e shpallura në Kartën e Kombeve të Bashkuara, njohja e dinjitetit të qenësishëm dhe e të drejtave të barabarta, të patjetërsueshme të të gjithë anëtarëve të familjes njerëzore, është themeli i lirisë, drejtësisë dhe paqes në botë.³⁹⁸ Gjuha e urrejtjes shkel të drejtat themelore të njeriut/të njerëzve që janë në shënjestër. Ne perputhje me Marreveshjen e Stabilizim Asocimit, ne perputhje me aktet e tjera nderkombetare me Kushtetuten e Republikës së Shqipërisë që ne preambulen e sa ka theksuar dinjitetin e njeriut dhe te nenit 3 të Kushtetutës ku dinjiteti i njeriut drejtësia shoqërore, të drejtat dhe liritë e njeriut janë në themel të shtetit dhe ai ka për detyrë ti mbrojë dhe ti respektojë.³⁹⁹ Opinione mund të ofendojnë, tronditin ose shqetësojnë, por ato nuk mund të nxisin dhunë, armiqësi dhe diskriminim. Është e patërlueshme që në ambjentet akademike ku është tempulli i dijes të ketë diskriminim, gjuhë urrejtje ,perjashtim social, të individëve të paisur me dije.

³⁹⁶ COUNCIL OF EUROPE What is hate speech and why is it a problem?

<https://www.coe.int/en/web/combating-hate-speech/what-is-hate-speech-and-why-is-it-a-problem->,

aksesuar më 07.03.2024

³⁹⁷ <https://www.unesco.org/en/countering-hate-speech/need-know>, aksesuar më 19.01.2023

³⁹⁸ Po aty

³⁹⁹ ³⁹⁹ <https://www.unesco.org/en/countering-hate-speech/need-know>, aksesuar më 19.01.2023

Nëpërmjet edukimit, nxënësit zbulojnë se si të vendosin kufirin midis fyerjeve dhe gjuhës së urrejtjes, si dhe të kuptojnë pasojat dhe ndikimin e fjalëve dhe veprimeve të tyre te njerëzit e tjerë.⁴⁰⁰ Dekurajimi i përhapjes së akteve të urrejtjes nuk pengon lirinë e fjalës së nxënësve dhe as shprehjen e mendimeve të tyre. Përkundrazi, arsimi mund të ndihmojë në mbrojtjen e kësaj të drejte themelore duke promovuar respektin, mirëkuptimin e ndërsjellë dhe ndjenjën e përbashkët të humanizmit.⁴⁰¹ Së fundi, ekspozimi i tepërt ndaj agresionit (në media) dhe vuajtja e të tjerëve mund t'i desensibilizojë njerëzit ndaj dhunës, si dhe ndaj dhimbjes së të tjerëve, duke çuar në kolaps të dhembshurisë një gjendje, e cila karakterizohet nga: *lodhje psikike, reduktim i ndjeshmërisë dhe ndjenjës së shkëputjes nga të tjerët*.⁴⁰² Duke e zbatuar këtë model për gjuhën e urrejtjes, mund të pritet gjithashtu, që ekspozimi ndaj formave të tilla të dhunës verbale mund të përkeqësojë aftësinë e njerëzve për të empatizuar dhe/ose mentalizuar, duke rezultuar në një mpirje më të përgjithshme empatike, një gjendje shterimi në të cilën dhembshuria nuk mund të gjenerohet ndaj njerëzve të tjerë.⁴⁰³

6.11 Cili është roli i edukimit mediatik dhe informacionit?

Në “*ekonominë e vëmendjes*”, narrativat e gjuhës së urrejtjes janë ato që shpesh, joshin më shumë, duke ofruar një ndjenjë lehtësisht të arritshme të komunitetit dhe shtrirje maksimale të mesazheve të tilla.

⁴⁰⁰ ⁴⁰⁰ <https://www.unesco.org/en/countering-hate-speech/need-know>, aksesuar më 19.01.2023

⁴⁰¹ What you need to know about the new guide on addressing hate speech through education, UNESCO <https://www.unesco.org/en/articles/what-you-need-know-about-new-guide-addressing-hate-speech-through-education>

⁴⁰² A. Pluta, J. Mazurek, J. Wojciechowski, T. WolakWiktor, S. Michał Bilewicz, Exposure to hate speech deteriorates neurocognitive mechanisms of the ability to understand others', Article number: 4127 (2023)

⁴⁰³ A. Pluta, J. Mazurek, J. Wojciechowski, T. WolakWiktor, S. Michał Bilewicz, Exposure to hate speech deteriorates neurocognitive mechanisms of the ability to understand others', Article number: 4127 (2023)

Individët duhet të fuqizohen për të kuptuar mekanizmat, që mbështesin funksionimin e mediave dhe platformave dixhitale dhe të dallojnë taktikat bindëse, që përdoren zakonisht, për të përhapur teori konspirative, forma të tjera dezinformimi me përmbajtje të dëmshme.⁴⁰⁴ Provat tregojnë se zhvillimi i aftësive të shkrim-leximit në media dhe informacion, i bën ata më pak të prirur ndaj ideve ekstremiste përjashtuese dhe të dhunshme. Mësuesit, nga ana tjetër, përfitojnë nga këto diskutime për të kuptuar dhe reflektuar më mirë mbi përvojat e nxënësve nga bota dixhitale ku përmbajtja e urrejtjes është virulente si kurrë më parë. Cilat janë mënyrat për të dalluar dhe luftuar narrativat e urrejtjes brenda kurrikulave? Tregime të njëanshme, që nxisin gjuhën e urrejtjes dhe justifikojnë përjashtimin, mund të gjenden nëpër lëndë dhe programe të ndryshme arsimore. Diskutimi i këtyre tregimeve me nxënësit e shkollave dhe pranimi i natyrës së tyre problematike, është pjesë përbërëse e zgjidhjes. Kjo përfshin lehtësimin e bisedave të pakëndshme për pabarazinë sociale dhe dinamikën e pushtetit, dekodimin dhe zhbërjen e stereotipeve, të paragjykimeve, dhe trajtimin e traumës, stigmatizimit të shkaktuar nga e kaluara e dhunshme. Mësimdhënia si dhe të mësuarit rreth këtyre çështjeve, rishikimi i kurrikulave dhe materialeve edukative mund të sensibilizojnë nxënësit ndaj formave bashkëkohore të diskriminimit dhe të rrisin kuptimin e tyre për proceset, që i çojnë shoqëritë drejt dhunës. Si mund të krijojnë mësuesit një ndjenjë alternative të përkatësisë?⁴⁰⁵

Për të plotësuar ndërhyrjet kurrikulare, është e nevojshme një klimë e sigurt, e kujdesshme, gjithëpërfshirëse dhe bashkëpunuese në klasë. Urrejtja mund të japë një ndjenjë qëllimi dhe përkatësie. Prandaj, është thelbësore të investohet në ndërtimin e ndjenjës së komunitetit

⁴⁰⁴ What you need to know about the new guide on addressing hate speech through education UNESCO <https://www.unesco.org/en/articles/what-you-need-know-about-new-guide-addressing-hate-speech-through-education>

⁴⁰⁵ What you need to know about the new guide on addressing hate speech through education UNESCO <https://www.unesco.org/en/articles/what-you-need-know-about-new-guide-addressing-hate-speech-through-education>

brenda dhe jashtë shkollave, dhe të integrohen perspektivat, që mungojnë në procesin arsimor. Programet që mbështesin edukimin global të qytetarisë, promovimi i praktikave bashkëpunuese, të përgjegjshme nga ana kulturore e gjithëpërfshirëse, mund të ndihmojnë në zhvillimin e njohurive dhe kompetencës së nevojshme për të përqaftuar dallimet, dhe për t'u angazhuar me respekt në një shoqëri të larmishme. Të mësuarit social dhe emocional (SEL) ofron mjete dhe teknika praktike, që mësuesit mund t'i ndihmojnë t'i përdorin për të nxitur ndjenjën e përkatësisë midis nxënësve. Duke përdorur raste studimore dhe skenarë të jetës reale për të trajtuar situata të diskutueshme dhe këndvështrime të ndryshme, nxënësit janë në gjendje të menazhojnë stresin dhe emocionet negative, të pranojnë pikat e forta dhe të dobëta të tyre dhe të zgjidhin konfliktet. Si duket një qasje gjithëpërfshirëse? ⁴⁰⁶Për të luftuar në mënyrë efektive gjuhën e urrejtjes në internet dhe jashtë linje, për të nxitur një mjedis të sigurt dhe gjithëpërfshirës, pa të gjitha format e urrejtjes e diskriminimit, përpjekjet e bëra nga edukatorët në klasë duhet të reflektohen në të gjitha aspektet e jetës shkollore, duke përfshirë: *politikat, aktivitetet jashtëshkollore, sportet dhe ngjarje sociale dhe kulturore*. Angazhimi aktiv i mësuesve, administratës dhe prindërve është një përcaktues kritik i suksesit. Sektori privat ka gjithashtu, një rol për të luajtur. Kompanitë e internetit mund të kontribuojnë, duke kushtuar kohë dhe burime në mekanizmat e vlerësimit të rrezikut si dhe duke realizuar auditime të pavarura të mjeteve të automatizuara, që mundësojnë amplifikimin e gjuhës së urrejtjes. Ata duhet të konsiderojnë përfshirjen e viktimave, shoqërisë civile dhe/ose organizatave ndërqeveritare në këto procese, dhe në vlerësimin e zbatimit të kushteve të tyre të shërbimit. Investimi në mjete edukative, që u mundëson përdoruesve të njohin dhe t'u përgjigjen

⁴⁰⁶ What you need to know about the new guide on addressing hate speech through education UNESCO <https://www.unesco.org/en/articles/what-you-need-know-about-new-guide-addressing-hate-speech-through-education>

dezinformatave, është gjithashtu, ndër masat, që mund të ndërmerren për të adresuar gjuhën e urrejtjes.⁴⁰⁷

6.12 Si funksionon UNESCO për të luftuar gjuhën e urrejtjes?

UNESCO bashkëpunon me shumë partnerë të ndryshëm për të adresuar dhe luftuar gjuhën e urrejtjes brenda kornizës së Strategjisë dhe Planit të Veprimit të Kombeve të Bashkuara për gjuhën e urrejtjes, e cila u lançua nga Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së në vitin 2019.⁴⁰⁸ Në çdo kohë, UNESCO thekson rëndësinë e një qasjeje, bazuar në të drejtat e njeriut për trajtimin e gjuhës së urrejtjes, duke përfshirë mbrojtjen e lirisë së shprehjes. Arsimi është një mjet i fuqishëm për të luftuar dezinformimin, dhe gjuhën e urrejtjes. UNESCO përkrah vendet për të mbështetur rregullatorë dhe operatorë gjyqësorë, për të zhvilluar përgjigjet arsimore, politikat dhe legjislacionin, që promovojnë, mbrojnë dhe mbështesin të drejtat ndërkombëtare të njeriut. Si e trajton UNESCO gjuhën e urrejtjes në internet? Gjuha e urrejtjes përhapet me shpejtësi dhe shtrirje të paparë përmes mjeteve dixhitale veçanërisht, platformave të mediave sociale.⁴⁰⁹ UNESCO punon për të adresuar gjuhën e urrejtjes në internet, duke i pajisur nxënësit me aftësi të qytetarisë dixhitale, në mënyrë që njerëzit e të gjitha moshave të mësojnë të lundrojnë në internet në mënyrë të sigurt dhe me përgjegjësi. Shkrimleximi në media dhe informacion mund të forcojë qëndrueshmërinë e nxënësve ndaj gjuhës së urrejtjes dhe të ndërtojë kapacitetin e tyre për

⁴⁰⁷ What you need to know about the new guide on addressing hate speech through education UNESCO [https://www.unesco.org/en/articles/what-you-need-know-about-new-guide-addressing-hate-speech-through education](https://www.unesco.org/en/articles/what-you-need-know-about-new-guide-addressing-hate-speech-through-education)

⁴⁰⁸ <https://www.unesco.org/en/countering-hate-speech/need-know> aksesuar me 19.01.2023

⁴⁰⁹ ⁴⁰⁹ What you need to know about the new guide on addressing hate speech through education UNESCO [https://www.unesco.org/en/articles/what-you-need-know-about-new-guide-addressing-hate-speech-through education](https://www.unesco.org/en/articles/what-you-need-know-about-new-guide-addressing-hate-speech-through-education)

të njohur dhe luftuar keqinformimin, dezinformimin, narrativat e dhunshme ekstremiste dhe teoritë e konspiracionit.

UNESCO mbron rritjen e transparencës dhe llogaridhënies për platformat dixhitale për të kundërshtuar dezinformimin dhe fjalimin në internet që nxisin urrejtje dhe diskriminim. Kjo përfshin thirrjen ndaj kompanive të mediave sociale për të raportuar mbi gjuhën e urrejtjes, sesi algoritmet e tyre mund të ndikojnë në përhapjen e saj dhe politikat që ato zbatojnë për ta kundërshtuar atë. UNESCO ka nxjerrë një grup prej 26 parimesh të nivelit të lartë për të rritur transparencën midis kompanive të platformës së internetit. UNESCO gjithashtu, mbështet mundësinë e një sektori mediatik të lirë, të larmishëm, pluralist, duke përfshirë vetërregullimin profesional të medias, si dhe përhapjen e praktikave të mira kundër gjuhës së urrejtjes dhe trajnimin e aktorëve gjyqësorë dhe të zbatimit të ligjit mbi standardet ndërkombëtare për lirinë e shprehjes.⁴¹⁰ Udhëzues i UNESCO-s për politikëbërësit për të luftuar gjuhën e urrejtjes, UNESCO dhe Zyra e Kombeve të Bashkuara për Parandalimin e Gjenocidit dhe Përgjegjësinë për Mbrojtjen (UNOSAPG) kanë zhvilluar së bashku udhëzuesin e parë për politikëbërësit dhe mësuesit, për të eksploruar përgjigjet arsimore ndaj këtij fenomeni, dhe për të dhënë rekomandime praktike për forcimin e sistemeve arsimore. Udhëzuesi është pjesë e zbatimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit të OKB-së për gjuhën e urrejtjes.⁴¹¹ Qoftë si shtete anëtare sektori privat, media dhe korporatat e internetit, liderët e besimit, edukatorët, aktorët e shoqërisë civile, ata që preken nga gjuha e urrejtjes, rinia, apo thjesht si individ, ne të gjithë kemi detyrën morale të flasim me vendosmëri kundër rasteve të gjuhës së urrejtjes dhe të luajë një rol vendimtar për të luftuar këtë plagë.⁴¹²

Fuqia e të rinjve për të luftuar dhe adresuar gjuhën e urrejtjes fuqizimi i të rinjve për të luftuar gjuhën e urrejtjes është thelbësor në

⁴¹⁰ ⁴¹⁰ What you need to know about the new guide on addressing hate speech through education UNESCO <https://www.unesco.org/en/articles/what-you-need-know-about-new-guide-addressing-hate-speech-through-education>

⁴¹¹ <https://www.unesco.org/en/countering-hate-speech/need-know>

⁴¹² United Nations <https://www.un.org/en/observances/countering-hate-speech>

botën e sotme, ku ata nuk janë vetëm objektiva, por edhe zëra me ndikim në komunitetet e tyre⁴¹³. Me 1.2 miliardë të rinj në mbarë botën, roli i tyre në njohjen, rritjen e ndërgjegjësimin dhe kundërshtimin e narrativave të urrejtjes nuk mund të mbivlerësohet. Si bashkëmoshatarë, ata kanë ndikim të rëndësishëm mbi njëri-tjetrin dhe mund të nxisin ndryshime domethënëse duke folur kundër gjuhës së urrejtjes. Duke angazhuar udhëheqës të rinj dhe duke u ofruar atyre burimet dhe platformat që u nevojiten, ne mund të shfrytëzojmë energjinë dhe kreativitetin e tyre për të nxitur shoqëri më gjithëpërfshirëse dhe tolerante. Ka shembuj të shumtë të iniciativave të suksesshme të udhëhequra nga të rinjtë në këtë drejtim, që tregojnë potencialin për ndryshime pozitive kur të rinjtë fuqizohen për të ndërmarrë veprime kundër gjuhës së urrejtjes. Ndikimi i gjuhës së urrejtjes shtrihet në shumë fusha të fokusit të OKB-së, nga mbrojtja e të drejtave të njeriut dhe parandalimi i mizorive deri te ruajtja e paqes, arritja e barazisë gjinore dhe mbështetja e fëmijëve dhe të rinjve. Dita e 3-të Ndërkombëtare për Kundër Gjuhën e Urrejtjes shërben si një kujtesë për nevojën e vazhdueshme për të adresuar këtë çështje. Ajo përkon me shënimin pesë-vjeçar që nga fillimi i Strategjisë dhe Planit të Veprimit të Kombeve të Bashkuara për gjuhën e urrejtjes, duke theksuar angazhimin e vazhdueshëm për këtë kauzë.⁴¹⁴ Si në internet ashtu edhe jashtë linje, të rinjtë janë në krye të përpjekjeve për të luftuar gjuhën e urrejtjes. Qasjet e tyre novatore dhe gatishmëria për t'u përballur me çështje të vështira i bëjnë ata agjentë të paçmuar të ndryshimit.

Gjuha e urrejtjes: Kthimi i valës efekti shkatërrues i urrejtjes nuk është fatkeqësisht asgjë e re. Megjithatë, shkalla dhe ndikimi i saj janë përforcuar sot nga teknologjitë e reja të komunikimit, aq sa gjuha e urrejtjes është bërë një nga metodat më të shpeshta për përhapjen e retorikës dhe ideologjive përçarëse në shkallë globale. Nëse lihet e pakontrolluar, gjuha e urrejtjes mund të dëmtojë madje paqen dhe

⁴¹³ ⁴¹³ United Nations <https://www.un.org/en/observances/countering-hate-speech>

⁴¹⁴ ⁴¹⁴ ⁴¹⁴ United Nations <https://www.un.org/en/observances/countering-hate-speech>

ENTRY INTO FORCE: 07/18/78, IN ACCORDANCE WITH ARTICLE 74.2, OF THE CONVENTION,
DEPOSITORY: GENERAL SECRETARIAT, OAS (ORIGINAL INSTRUMENT AND RATIFICATIONS)
TEXT: OAS, TREATY SERIES, NO. 36, UN REGISTRATION: 08/27/79 No. 17955 Vol.
http://www.oas.org/dil/treaties_B-32_American_Convention_on_Human_Rights_sign.htm, aksesuar më 07.03.2024

Konventa Për Diskriminimin Në (Punësim dhe Profesione), 1958 (Nr. 111)

Konventa e Diskriminimit (Nr. 111) u miratua zyrtarisht në 1958 dhe hyri në fuqi në qershor 1960.⁴⁷¹ Konventa parashtron një përkufizim për diskriminimin në nenin 1 dhe ndalon dallimin, përjashtimin ose preferencën në bazë të *racës, ngjyrës, seksit, fesë, opinionit politik, kombëtar, nxjerrjes, ose origjinës sociale*. Palëve në Konventë, u kërkohet të krijojnë dhe harmonizojnë politikat kombëtare për të garantuar barazinë e trajtimit dhe mundësive. Kjo përfshin, ndër të tjera, bashkëpunim të fortë me organizatat e punëtorëve dhe punëdhënësve, si dhe promovimin e programeve arsimore. Zbatimi i Konventës mbikëqyret nga Komiteti i Ekspertëve të ILO-s. Komiteti gjithashtu, shqyrton dhe vlerëson raportet e *shteteve palë*, të cilat duhet të dorëzohen çdo tre vjet. Konventa e Diskriminimit është pjesë e 15 konventave thelbësore, të mbuluara nga rregullorja e GSP-së.⁴⁷²

Konventa Kundër Diskriminimit në Fushën e Arsimit

Kjo Konventë është miratuar më 14 dhjetor të vitit 1960 nga Konferenca e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Arsim, Shkencë dhe Kulturë. Konventa ka hyrë në fuqi në 22 maj të vitit 1962. Me termin *diskriminim*, konventa nënkupton çdo dallim, përjashtim, kufizim ose favorizim, që është i bazuar në *racën, ngjyrën,*

⁴⁷¹ Discrimination (Employment and Occupation) Convention, 1958 (No. 111) The Discrimination Convention is an anti-discrimination convention which addresses discrimination based on race, sex, political opinion, or religion. It is one of eight fundamental ILO conventions on the protection of labour standards, [https://gsphub.eu/conventions/Discrimination%20\(Employment%20and%20Occupation\)%20Convention,%201958%20\(No.%20111\)](https://gsphub.eu/conventions/Discrimination%20(Employment%20and%20Occupation)%20Convention,%201958%20(No.%20111)), aksesuar më 07.03.2024

⁴⁷² Discrimination (Employment and Occupation) Convention, 1958 (No. 111) The Discrimination Convention is an anti-discrimination convention which addresses discrimination based on race, sex, political opinion, or religion. It is one of eight fundamental ILO conventions on the protection of labour standards, [https://gsphub.eu/conventions/Discrimination%20\(Employment%20and%20Occupation\)%20Convention,%201958%20\(No.%20111\)](https://gsphub.eu/conventions/Discrimination%20(Employment%20and%20Occupation)%20Convention,%201958%20(No.%20111)), aksesuar më 07.03.2024

seksin, gjuhën, fenë, bindjen politike, prejardhjen kombëtare ose shoqërore, pozitën ekonomike ose lindjen. Si pasojë, e gjithë sa pohuam më sipër, Konventa ka për qëllim zhdukjen ose cenimin e barazisë në trajtimin e fushës së arsimit.⁴⁷³

Karta e të Drejtave Fundamentale të Bashkimit Evropian

Kjo Kartë, *barazinë* e ka parashikuar në një nen me vete dhe mosdiskriminimin në një nen të posaçëm.

Neni 20

*Barazia para ligjit. Të gjithë janë të barabartë para ligjit.*⁴⁷⁴

Neni 21

Jo diskriminimi

1. *Ndalohet çdo lloj diskriminimi, që bazohet në: gjini, racë, ngjyrë, origjinë etnike apo sociale, karakteristika gjenetike, gjuhë, fe apo besim, politikë, ose ndonjë lloj opiniononi tjetër, anëtarësi të një pakice nacionale, pronë, lindje, paaftësi moshe ose orientim seksual.*

2. *Ndalohet çdo lloj diskriminimi në baza nacionaliteti, në suaza të zbatimit të Traktatit që themelon Komunitetin Evropian, Traktatit të Bashkimit Evropian dhe pa paragjykime.*⁴⁷⁵

Kartën Afrikane Për të Drejtat e Njeriut dhe Popujt

Kjo kartë ka parashikuar ndalimin e diskriminimit në nenin 18 paragrafi 3.⁴⁷⁶

⁴⁷³ Zejnulla Gruda Mbrojtja Nderkombetare e të Drejtave të Njeriut libri I III Universiteti Fama 2007 fq.108

⁴⁷⁴ “Karta e të Drejtave Fundamentale të Bashkimit Evropian”, <https://op.europa.eu/en/publication-detail/-/publication/fc583291-b51a-445f-987a-ee24ad1d8f3e>, aksesuar më 7.3.2024

⁴⁷⁵ Po aty

⁴⁷⁶ A Guide to the African Charter on Human and Peoples’ Rights, <https://www.amnesty.org/en/wp-content/uploads/2021/08/ior630052006en.pdf>, aksesuar më 07.03.2024

Konventa Mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara

Neni 2

*“Diskriminim për shkak të aftësisë së kufizuar”, ka kuptimin e çdo dallimi, përjashtimi apo kufizimi për shkak të aftësisë së kufizuar, që ka si qëllim ose ndikon në pengimin, mohimin e njohjes, gëzimit apo ushtrimit, njësoj si gjithë të tjerët, të të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në fushën politike, ekonomike, shoqërore, kulturore, civile apo në ndonjë fushë tjetër. Në këtë përkufizim përfshihen të gjitha format e diskriminimit, duke përfshirë edhe mohimin e përshtatjes brenda logjikës.*⁴⁷⁷

Konventa Për të Drejtat e Fëmijës

Neni 29

1. *Shtetet palë u morën vesh që arsimimi i fëmijës të ketë për synim:*

(a) zhvillimin e potencialit të plotë të personalitetit, të dhuntive dhe të aftësive mendore e fizike të fëmijës;

(b) zhvillimin e respektit për të drejtat e liritë themelore të njeriut dhe për parimet e mishëruara në Kartën e Kombeve të Bashkuara;

(c) zhvillimin e respektit për prindërit e fëmijës, për identitetin e tij kulturor, për gjuhën dhe vlerat kulturore, për vlerat kombëtare të vendit ku fëmija jeton, për vendin e origjinës dhe të qytetërimeve të ndryshme nga i veti;

*(ç) përgatitjen e fëmijës për një jetë të përgjegjshme në një shoqëri të lirë, në frymën e mirëkuptimit, paqes, tolerimit, barazisë midis sekseve dhe miqësisë midis të gjithë popujve, grupeve etnike, grupeve kombëtare e fetare dhe personave me origjinë autoktone.*⁴⁷⁸

⁴⁷⁷ “Konventa për të Drejtat e personave me Aftësi të Kufizuar dhe Protokolli Opsional”, Materiali u përgatit në gjuhën shqipe nga Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e personave me Aftësi të Kufizuar, New York, dhjetor 2006

⁴⁷⁸ “Konventa për të Drejtat e fëmijëve”, Miratuar dhe hapur për nënshkrim, për ratifikim dhe për aderim nga Asambleja e Përgjithshme me Rezolutën e saj, 44/25, të datës 20 nëntor 1989. Hyrë në fuqi: 02.09.1990

Konventa e Këshillit të Europës për Parandalimin, Luftimin e Dhunës Kundër Grave dhe Dhunës në Familje

Neni 4

Të drejtat themelore, barazia dhe mosdiskriminimi. ⁴⁷⁹

1. Palët marrin masat e nevojshme legjislative dhe masa të tjera për të promovuar dhe mbrojtur të drejtën për çdokënd, veçanërisht gratë, për të jetuar pa dhunë në sferën publike si dhe në atë private.

2 Palët dënojnë të gjitha format e diskriminimit kundër grave, marrin pa vonesë masat legjislative dhe masa të tjera të nevojshme për t'i parandaluar, veçanërisht me anë të:

-shprehjes së parimit të barazisë midis burrave dhe grave në kushtetutat e tyre kombëtare ose në ndonjë legjislacion tjetër përkatës, duke garantuar realizimin praktik të këtij parimi;

-ndalimit të diskriminimit kundër grave, veçanërisht nëpërmjet ushtrimit të sanksioneve sipas rastit;

-shfuqizimit të ligjeve dhe praktikave, që diskriminojnë gratë. ⁴⁸⁰

Konventa Ndërkombëtare për Shtypjen dhe Dënimin e Krimit të Aparteidit

Neni 1

Shtetet Palë të kësaj Konvente deklarojnë se *aparteidi* është një krim kundër njerëzimit. Aktet çnjerëzore, që rezultojnë nga politikat, praktikat e aparteidit dhe politika e praktika të ngjashme të ndarjes dhe diskriminimit racor, siç përcaktohet në nenin II të Konventës, janë krime që shkelin parimet e së drejtës ndërkombëtare në veçanti, parimet e

⁴⁷⁹ “Konventa e Këshillit të Europës për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje” Stamboll, 11.05.2011, Council of Europe Treaty Series, №210, <https://rm.coe.int/168046246b>, aksesuar më 07.03.2024

⁴⁸⁰ Po aty

Kartës së Kombeve të Bashkuara. Ato përbëjnë një kërcënim serioz për paqen dhe sigurinë ndërkombëtare.⁴⁸¹

Konventa Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare

Neni 4

*1. Palët angazhohen t'iu garantojnë personave që iu përkasin pakicave kombëtare të drejtën e barazisë para ligjit dhe të mbrojtjes së barabartë nga ligji. Lidhur me këtë, do tëndalohet çdo diskriminim, bazuar në përkatësinë e një pakice kombëtare.*⁴⁸²

2. Palët angazhohen që të miratojnë, kurdoherë që është e nevojshme, masa të përshtatshme me qëllim që të nxisin në të gjitha sferat e jetës ekonomike, shoqërore, politike dhe kulturore, barazi të plotë dhe efektive ndërmjet personave, që i përkasin një pakice kombëtare dhe atyre që i përkasin shumicës. Lidhur me këtë, ata do të marrin parasysh në mënyrën e duhur kushtet e veçanta të personave, që u përkasin pakicave kombëtare.

*3. Masat e miratuara në përputhje me paragrafin 2 nuk do të konsiderohen se janë një akt diskriminimi.*⁴⁸³

⁴⁸¹ International Convention on the Suppression and Punishment of the Crime of Apartheid G.A. res. 3068 (XXVIII)), 28 U.N. GAOR Supp. (No. 30) at 75, U.N. Doc. A/9030 (1974), 1015 U.N.T.S. 243, entered into force July 18, 1976
https://www.un.org/en/genocideprevention/documents/atrocitycrimes/Doc.10_International%20Convention%20on%20the%20Suppression%20and%20Punishment%20of%20the%20Crime%20of%20Apartheid.pdf, Aksesuar më 07.03.2024

⁴⁸² “Konventa në kuadër për mbrojtjen e pakicave kombëtare dhe raporti shpjegues”,
https://www.kmd.al/wp-content/uploads/2018/05/1306486683-konventa_minoriteteve.pdf, aksesuar më 07.03.2024

⁴⁸³ Po aty

Direktiva 2006/54 KE e Parlamentit Evropian, Këshillit të 5 korrikut 2006, mbi zbatimin e parimit të mundësive, dhe trajtimit të barabartë të burrave dhe grave në çështjet e punësimit, dhe profesionit (reformuar)

Në këtë Direktivë theksohet, ndër të tjera se:

(2) Barazia ndërmjet burrave dhe grave është thelbësore, parimi i së drejtës komunitare sipas nenit 2 dhe nenit 3 (2) të Traktatit dhe praktikës gjyqësore të Gjykatës së Drejtësisë. Dispozitat e Traktatit shpallin barazinë ndërmjet burrave dhe grave, si “detyrë” dhe “qëllim” i Komunitetit. Ato imponojnë një detyrim pozitiv për ta promovuar atë në të gjithë aktivitetet.

(3) Gjykata e Drejtësisë ka konstatuar se qëllimi i parimit pra, trajtimi i barabartë për burrat dhe gratë, nuk mund të kufizohet për ndalimin e diskriminimit, bazuar në faktin se personi është i një seksi ose i një tjetri. Në funksion të qëllimit të parimit dhe natyrën e të drejtave, të cilat gjykata kërkon të mbrojë, vlen gjithashtu, edhe për diskriminimin që vjen nga ndryshimi i gjinisë- mendja e një personi.⁴⁸⁴

Dokumenti Përfundimtar i Mbledhjes së Vjenës 1986, të përfaqësuesve të shteteve pjesëmarrëse të Konferencës për Sigurinë dhe Bashkëpunimin në Evropë, i mbajtur në bazë të dispozitave të aktit përfundimtar

(11) Përfaqësuesit e shteteve për sigurinë dhe bashkëpunimin në Evropë, konfirmojnë se do të respektojnë të drejtat e njeriut dhe liritë themelore, duke përfshirë lirinë e mendimit, ndërgjegjes, fesë ose besimit, për të gjithë pa dallim kombësie, race, seksi, gjuhe ose feje. Ata gjithashtu, konfirmojnë universalen, rëndësinë e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, respektimi i të cilave është një faktor thelbësor për

⁴⁸⁴ DIRECTIVE, 2006/54/, EC OF THE EUROPEAN PARLIAMENT AND OF THE COUNCIL, of 5 July 2006,

on the implementation of the principle of equal opportunities and equal treatment of men and women in matters of employment and occupation,
(recast <https://www.kmd.al/wp-content/uploads/2018/05/1306486866-Directive-of-the-European-Parliament-and-of-the-Council>, aksesuar më 07.03.2024

*paqen, drejtësinë dhe sigurinë e nevojshme për të siguruar zhvillimin e marrëdhënieve miqësore dhe të bashkëpunimit ndërmjet tyre, si mes të gjithë shteteteve.*⁴⁸⁵

Dokument i Takimit të Kopenhagës, të Konferencës mbi dimensionin njerëzor të KSBE

Personat që u përkasin pakicave kombëtare, kanë të drejtë të ushtrojnë plotësisht dhe në mënyrë efektive të drejtat e tyre njerëzore, liritë themelore pa asnjë formë diskriminimi dhe në barazi të plotë para ligjit⁴⁸⁶. Shtetet pjesëmarrëse do të miratojnë, kur është e nevojshme, masat e veçanta me qëllim sigurimin e personave, që u përkasin pakicave, në barazi të plotë me qytetarët e tjerë në ushtrimin dhe gëzimin e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore. T'i përkasësh një pakice kombëtare, është çështje e një personi, zgjedhje individuale dhe asnjë disavantazh nuk mund të lindë nga ushtrimi i zgjedhjes së bërë individualisht. Personat që u përkasin pakicave kombëtare kanë të drejtë të shprehen lirisht, të ruajnë, zhvillojnë etninë e tyre, kulturore, gjuhësore, fetare, të ruajnë identitetin dhe të zhvillojnë kulturën e tyre në të gjitha aspektet e saj, pa asnjë tentativë asimilimi kundër vullnetit të tyre. Në veçanti, ata kanë të drejtë të përdorin lirshëm gjuhën e tyre amtare si privatisht ashtu edhe brenda sferës publike.⁴⁸⁷

⁴⁸⁵ CONCLUDING DOCUMENT OF THE VIENNA MEETING 1986 OF REPRESENTATIVES OF THE PARTICIPATING STATES OF THE CONFERENCE ON SECURITY AND CO-OPERATION IN EUROPE, HELD ON THE BASIS OF THE PROVISIONS OF THE FINAL ACT RELATING TO THE FOLLOW-UP TO THE CONFERENCE, <https://www.osce.org/files/f/documents/a/7/40881.pdf>, aksesuar më 09.03.2024

⁴⁸⁶ DOCUMENT OF THE COPENHAGEN MEETING OF THE CONFERENCE ON THE HUMAN DIMENSION OF THE CSCE, <https://www.osce.org/files/f/documents/9/c/14304.pdf>, aksesuar më 09.03.2024

⁴⁸⁷ Po aty

Direktiva e Këshillit 2000/43/KE, e datës 29.06.2000, për zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë ndërmjet personave, pavarësisht nga origjina racore ose etnike

Qëllimi i kësaj Direktive është të përcaktojë një kornizë, për të luftuar diskriminimin në bazë të origjinës racore ose etnike, me synimin për të vënë në fuqi tek Shtetet Anëtare parimin e trajtimit të barabartë.

488

Neni 2 Koncepti i diskriminimit

Për qëllimet e kësaj direktive, parimi i trajtimit të barabartë do të thotë se nuk do të ketë diskriminim të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, bazuar në origjinën racore ose etnike. Për qëllimet e paragrafit 1: (a) diskriminim i drejtpërdrejtë do të konsiderohet kur një person trajtohet në mënyrë më pak të favorshme sesa një tjetër trajtohet, është trajtuar ose do të trajtohej në një situatë të krahasueshme për shkak të origjinës racore, ose etnike; (b) diskriminimi indirekt do të konsiderohet kur një dispozitë, kriter ose praktikë në dukje neutrale do t'i vendoste personat me origjinë racore ose etnike në një disavantazh të veçantë në krahasim me personat e tjerë, përveç rasteve kur kjo dispozitë, kriter ose praktikë justifikohet objektivisht nga një qëllim legjitim. Gjithashtu, mjetet për arritjen e qëllimit janë të përshtatshme dhe të nevojshme. ⁴⁸⁹

DIREKTIVA E KËSHILLIT 2000/78/KE, 27.11.2000, mbi vendosjen e një kuadri të përgjithshëm për trajtim të barabartë në punësim dhe profesion

Në përputhje me nenin 6 të Traktatit të Bashkimit Evropian, Bashkimi Evropian është i themeluar mbi: *parimet e lirisë, demokracisë, respektimit të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, sundimit të*

⁴⁸⁸ Council Directive, 2000/43/EC of 29 June 2000 implementing the principle of equal treatment between persons irrespective of racial or ethnic origin, <https://translate.google.al/?hl=sq&sl=en&tl=sq&text=Council%20Directive%202000%20F43%20of%2029%20June%202000%20implementing%20the%20principle%20of%20equal%20treatment%20between%20persons%20irrespective%20of%20racial%20or%20ethnic%20origin%20-%20&op=translate>, aksesuar më 09.03.2024

⁴⁸⁹ Po aty

*ligjit, parime, të cilat janë të përbashkëta për të gjitha Shtetet Anëtare dhe respektimi i të drejtave themelore, të garantuara nga Bashkimi Evropian.*⁴⁹⁰

(2) *Parimi i trajtimit të barabartë ndërmjet grave dhe meshkujve,* është themeluar mirë nga një trup i rëndësishëm i Ligjit komunitar, veçanërisht në Direktivën e Këshillit 76/ 207/KEE, e 09 shkurtit 1976, mbi zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë për burrat dhe gratë gjithashtu, në lidhje me: *aksesin në punësim, trajnimin profesional, promovimin dhe kushtet e punës.* Në zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë Komuniteti, në përputhje me *nenin 3(2) të Traktatit të KE-së,* synon eliminimin e pabarazive, për të promovuar barazinë midis burrave dhe grave veçanërisht, duke qenë se gratë janë shpesh viktimat të shumëfishta të diskriminimit. E drejta e të gjithë personave për barazi para ligjit dhe mbrojtja nga diskriminimi përbën një të drejtë universale, e drejtë e njohur nga Deklarata Universale e Njeriut. Të drejtat themelore synohen e përcaktohen nga Konventa e Kombeve të Bashkuara për Eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit kundër grave, Paktet e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat Civile dhe Politike mbi të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore si edhe nga Konventa Evropiane për Mbrojtjen të Drejtave dhe Lirive të Njeriut, të për të cilat të gjitha shtetet anëtare janë nënshkruese. Konventa Nr. 111, Organizata Ndërkombëtare e Punës (ILO) ndalon diskriminimin, angazhimin në fushën e punësimit dhe profesionit.⁴⁹¹

Propozim. Direktivë

Këshillit, mbi zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë ndërmjet personave, pavarësisht nga feja ose besimi, paaftësia, mosha, ose orientimi seksual (prezantuar nga Komisioni) {SEC(2008) 2180} {SEC(2008) 2181}

⁴⁹⁰ COUNCIL DIRECTIVE, 2000/78/EC of, 27 November 2000, establishing a general framework for equal treatment in employment and occupation, <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:32000L0078> aksesuar më 09.03.2024

⁴⁹¹ Po aty

Konteksti i propozimit

Arsyet dhe objektivat e propozimit. Qëllimi i këtij propozimi është zbatimi i parimit të trajtimit të barabartë ndërmjet personave, pavarësisht nga: *feja ose besimi, paaftësia, moshë, ose orientimi seksual* jashtë tregut të punës. Ai përcakton një kornizë për ndalimin e diskriminimit mbi këto baza dhe vendos një nivel minimal uniform mbrojtjes brenda Bashkimit Evropian për njerëzit, që kanë pësuar një diskriminim të tillë. Ky propozim plotëson kuadrin ligjor ekzistues të KE-së sipas të cilit, ndalimi i diskriminimit zbatohet në bazë të fesë ose besimit, paaftësisë, moshës ose orientimit seksual vetëm për punësimin, profesionin dhe formimin profesional.

1. *Konteksti i përgjithshëm.* Komisioni njoftoi në programin e tij legjislativ dhe të punës së miratuar më 23 tetor 2007 se do të propozonte nisma të reja, për të plotësuar ligjin e BE-së kundër diskriminimit kornizë. Propozimi aktual paraqitet si pjesë e “Agjendës së Përtërirë Sociale”: Mundësitë, aksesit, solidariteti në Evropën e shekullit XXI dhe shoqëron Komunikimin: “Jo- Diskriminimi dhe mundësitë e barabarta, një angazhim i rinovuar”. Konventa e OKB-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar është nënshkruar nga Shtetet Anëtare dhe Komuniteti Evropian. Ai bazohet në parimet e jo-diskriminimit, pjesëmarrja dhe përfshirja në shoqëri, mundësitë e barabarta dhe aksesit. Propozimi për përfundimin e Konventës nga Komuniteti Evropian ka qenë paraqitur në Këshill. Ky propozim bazohet në direktivat 2000/43/KE, 2000/78/KE dhe 2004/113/EC6, të cilat ndalojnë diskriminimin për shkak të *seksit, origjinës racore ose etnike, moshës, paaftësisë, orientimit seksual, fesë ose besimit*.⁴⁹²

⁴⁹² Proposal for a COUNCIL DIRECTIVE, on implementing the principle of equal treatment between persons irrespective of religion or belief, disability, age or sexual orientation (presented by the Commission), EN EN COMMISSION OF THE EUROPEAN COMMUNITIES, Brussels, 2.7.2008, COM (2008), 426 final, 2008/0140 (CNS), <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:52008PC0426>, aksesuar më 09.03.2024

8.2 Kodi i Sjelljes së BE për të luftuar gjuhën e paligjshme të urrejtjes në internet

Progresi në luftën kundër gjuhës së urrejtjes në internet përmes Kodit të Sjelljes së BE-së 2016-2019.⁴⁹³ Kodi i Sjelljes për të luftuar gjuhën e paligjshme të urrejtjes në internet, u nënshkrua më 31.05.2016 nga Komisioni dhe Google (YouTube), Facebook, Twitter dhe Microsoft, pritën shërbimet e konsumatorëve (p.sh.: shërbimet e lojërave Xbox ose LinkedIn).⁴⁹⁴ Në 2018 dhe 2019, Instagram, Google+, Dailymotion, Snap dhe Jeuxvideo.com janë bashkuar. Kjo do të thotë se Kodi tani mbulon 96% të tregut të BE-së pjesa e platformave online që mund të ndikohen nga përmbajtja e urrejtjes. Ky dokument ofron një vlerësim të progresit të bërë që nga viti 2016, duke ndjekur strukturën dhe angazhimet e përcaktuara në Kodin e Sjelljes. Ai bazohet në të dhënat e mbledhura nga Komisioni, gjatë monitorimit të rregullt të ushtrimeve si dhe mbi informacionin e përzgjedhur të marrë nga kompanitë e IT-së në intervale të rregullta.⁴⁹⁵ Si përmbledhje, Kodi i Sjelljes ka kontribuar në arritjen e përparimit të shpejtë, duke përfshirë këtu veçanërisht, shqyrtimin dhe heqjen e shpejtë të përmbajtjes së gjuhës së urrejtjes (28% e përmbajtjes u hoq në 2016, kundrejt 72% në 2019; 40% e njoftimeve të rishikuara brenda 24 orëve në 2016, 89% në 2019). Parë në këtë aspekt, vihet re rritja e besimit dhe bashkëpunimit

⁴⁹³ Vlerësimi i Gruda Kodit të Sjelljes për gjuhën e urrejtjes në internet, Kodi i Sjelljes së BE-së, 2016-2019, Kodi i sjelljes për të luftuar gjuhën e paligjshme të urrejtjes në internet, European Commission Brussels, 27 September 2019, (OR. en) 12522/19, https://commission.europa.eu/document/download/a5c92394-8e76-434a-9f3a3a4977d399bb_en?filename=assess, aksesuar më 02.02.2024

⁴⁹⁴ Vlerësimi i Kodit të Sjelljes për gjuhën e urrejtjes në internet, Kodi i Sjelljes së BE-së 2016-2019, Kodi i sjelljes për të luftuar gjuhën e paligjshme të urrejtjes në internet, European Commission, Brussels, 27 September 2019, (OR. en) 12522/19, https://commission.europa.eu/document/download/a5c92394-8e76-434a-9f3a3a4977d399bb_en?filename=assess, aksesuar më 02.02.2024

⁴⁹⁵ https://commission.europa.eu/document/download/a5c92394-8e76-434a-9f3a3a4977d399bb_en?filename=assess, aksesuar më 02.02.2024

ndërmjet kompanive të IT-së, anëtarëve të organizatave të shoqërisë civile si dhe autoritetetve e shtetërore, në formën e një procesi të strukturuar të të mësuarit dhe shkëmbimit të ndërsjellë të njohurive. Kjo punë është plotësuese me zbatimin efektiv të legjislacionit ekzistues (Vendimi Kuadër i Këshillit 2008/913/JHA), që ndalon krimet raciste dhe ksenofobike të urrejtjes, gjuhën e urrejtjes dhe përpjekjet e nevojshme nga autoritetet kompetente kombëtare për të hetuar dhe ndjekur penalisht urrejtjen e shkeljet e motivuara, si offline ashtu edhe online. Kodi i Sjelljes u kërkon kompanive të IT-së që: - të ketë rregulla dhe standarde të komunitetit, që ndalojnë gjuhën e urrejtjes, që vendosin sisteme dhe ekupe për të shqyrtuar përmbajtjen, që raportohet se shkel këto standarde. Të gjitha kompanitë e IT-së që nënshkruan Kodin, tani kanë dhe rishikojnë vazhdimisht kushtet e shërbimit, rregullat ose standardet e komunitetit që ndalojnë përdoruesit të postojnë përmbajtje, që nxisin dhunë ose urrejtje.⁴⁹⁶

Moderimi njerëzor i gjuhës së urrejtjes në biseda dhe forume, çoi në identifikimin dhe bllokimin e 20 milionë lloj përmbajtjesh në 2019, përfshirë gjuhën e urrejtjes.⁴⁹⁷ Për pasojë, u ofruan trajnime të rregullta për stafin e shërbimeve të sistemit të IT-së. Të gjitha kompanitë e këtij sistemi raportojnë se janë duke mbajtur trajnime të rregullta dhe të shpeshta dhe ofrojnë trajnime e mbështetje për ekipet e tyre të rishikuesve të përmbajtjes, duke përfshirë specifikat e gjuhës së urrejtjes. Dailymotion, po zhvillon trajnime dyjavore mbi materialet e urrejtjes për stafin e tyre. Facebook, themeloi një Forum të Politikave të

⁴⁹⁶ Vlerësimi i Kodit të Sjelljes për gjuhën e urrejtjes në internet, Kodi i Sjelljes së BE-së, 2016-2019, Kodi i sjelljes për të luftuar gjuhën e paligjshme të urrejtjes në internet European, Commission Brussels, 27 September 2019, (OR. en) 12522/19,

https://commission.europa.eu/document/download/a5c92394-8e76-434a-9f3a,3a4977d399bb_en?filename=assess aksesuar më 02.02.2024

⁴⁹⁷ ⁴⁹⁷ Vlerësimi i Kodit të Sjelljes për gjuhën e urrejtjes në internet, Kodi i Sjelljes së BE-së, 2016-2019, Kodi i sjelljes për të luftuar gjuhën e paligjshme të urrejtjes në internet European, Commission Brussels, 27 September 2019, (OR.

Produkteve, që mbledh të gjithë ekspertët e tij në mbarë botën çdo dy javë, për të diskutuar ndryshimet e mundshme në standardet e komunitetit dhe trajnuar çështje të reja, në lidhje me tendencat dhe zhvillimet progresive të këtij sistemi. Procesverbalet e këtyre takimeve janë në dispozicion të publikut. Këto stafe angazhohen në partneritete dhe aktivitete trajnuese me shoqërinë civile për të zgjeruar rrjetin e tyre të gazetarëve të besuar. Kompanitë e IT-së raportuan një shtrirje të konsiderueshme të rrjetit të tyre të *“flamuruesve të besuar”*. Ata po angazhohen në baza të rregullta për të rritur kuptimin e specifikat kombëtare të gjuhës së urrejtjes. Prej atëherë, Twitter ka regjistruar 73 organizata të reja, të besuara nënshkrimi i Kodit. YouTube ka një rrjet katër herë më të madh të flamuruesve të besuar, të specializuar në urrejtjen. Facebook ka rritur rrjetin e tij me 82% (nga 9 partnerë në 2016, në 51 sot). Që nga nënshkrimi i Kodit, Facebook/Instagram kanë organizuar gjithsej 51 seanca trajnimi mbi standardet e komunitetit në lidhje me gjuhën e urrejtjes, për deri në 130 organizata të shoqërisë civile, duke vepruar si flamurtarë të besuar. Nga 38 sesione trajnimi të ofruara në 2018 nga YouTube, për OJQ-të në politikat e tyre të përmbytjes dhe programi i besuar i flamurit, 18 ishin të fokusuar në gjuhën e urrejtjes dhe përmbytjen abuzive.⁴⁹⁸ Në vitin 2019, YouTube kreu një raund shtesë trajnimesh me 15 OJQ, në 8 vende. YouTube raporton gjithashtu, për ndikimin e rëndësishëm të këtij rrjeti të zgjeruar në numrin e njoftimeve nga flamuruesit e besuar: këto janë dyfishuar nga tremujori tetor-dhjetor 2017 dhe prill-qershor 2019. Në Facebook, nga tremujori i katërt 2017 deri në tremujorin e parë të 2019, veprimet e ndërmarra për shkeljet e gjuhës së urrejtjes u rritën nga 1,6 milionë në 4 milionë (150% rritje).⁴⁹⁹

⁴⁹⁸ ⁴⁹⁸ Vlerësimi i Kodit të Sjelljes për gjuhën e urrejtjes në internet, Kodi i Sjelljes së BE-së, 2016-2019, Kodi i sjelljes për të luftuar gjuhën e paligjshme të urrejtjes në internet European, Commission Brussels, 27 September 2019, (OR.

⁴⁹⁹ Vlerësimi i Kodit të Sjelljes për gjuhën e urrejtjes në internet, Kodi të Sjelljes së BE-së, 2016-2019, Kodi i sjelljes për të luftuar gjuhën e paligjshme të urrejtjes në internet, European Commission Brussels, 27 September 2019, (OR. en) 12522/19,

8.3 Standardet e Bashkimit Evropian

Standardet më gjithëpërfshirëse në lidhje me mosdiskriminimin janë zhvilluar në nivelin e Bashkimit Evropian. Ato përbëhen nga një sërë burimesh të ndryshme ligjore, që përcaktojnë format e ndryshme të diskriminimit dhe i detyrojnë shtetet anëtare t'i zbatojnë këto standarde në kornizën e tyre legjislative, si dhe në praktikën gjyqësore. Këto njohje kanë çuar në zhvillimin e disa standardeve legjislative për mbrojtjen nga diskriminimi, me vëmendje të veçantë tek ata persona dhe grupe, që konsiderohen të jenë më të prekshëm sesa të tjerët.⁵⁰⁰

Karta e të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian (Karta) ka dedikuar një kapitull të tërë barazisë ka theksuar dy nene për barazine dhe mosdiskriminimin⁵⁰¹. Ne ndryshim nga Kushtetuta Shqiptare që barazine dhe mosdiskriminimin I ka parashikuar në një nenë të vetëm. *Neni 20* parashikon barazinë përpara ligjit dhe *neni 21* i saj, kërkon ndalimin e çdo diskriminimi për çdo shkak të tillë, si: *gjinia, raca, ngjyra, origjina etnike ose shoqërore, karakteristikat gjenetike, gjuha, feja ose besimi, opinionin politik, apo ndonjë mendim tjetër, anëtarësia e një pakice kombëtare, pasuria, lindja, mosha, ose orientimi seksual*. Të drejtat dhe parimet e sanksionuara në Kartë duhet të zbatohen në praktikën ligjore kombëtare në rastet kur:

-legjislacioni që zbaton të drejtën e BE-së ka rëndësi (si instrument interpretimi),

https://commission.europa.eu/document/download/a5c92394-8e76-434a-9f3a3a4977d399bb_en?filename=assess aksesuar më 2.2.2024

⁵⁰⁰ “*Rapoti për mbrojtjen nga diskriminimi*”, 2022, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

https://www.kmd.al/wp-content/uploads/2023/03/Raporti-KMD-2022_compressed.pdf, f., 9,10

⁵⁰¹ *Rapoti për mbrojtjen nga diskriminimi*”, 2022, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

https://www.kmd.al/wp-content/uploads/2023/03/Raporti-KMD-2022_compressed.pdf, f., 9,10

-legjislacioni kombëtar konsiderohet se ndërhyt me të drejtën e BE-së,
-Autoritetet e BE-së kanë vepruar në zbatim të së drejtës së BE-së.

Neni 19, i Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian (TFEU) i ka mundësuar Bashkimit Evropian të marrë veprimet e duhura për të luftuar diskriminimin në bazë: të gjinisë, origjinës racore ose etnike, fesë ose besimit, aftësisë së kufizuar, moshës, ose orientimit seksual. Kjo kompetencë ka çuar në miratimin e:

-Direktivës 2000/43/KE, “Për zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë ndërmjet personave, pavarësisht prejardhjes racore apo etnike” (Direktiva për racën),

-direktivës 2000/78/KE, “Për përcaktimin e një kuadri të përgjithshëm për trajtimin e barabartë në punësim dhe në marrëdhëniet gjatë punës” (Direktivën për barazinë në punësim),⁵⁰²

-Direktivës 2004/113/KE, “Për zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë ndërmjet burrave dhe grave në mundësinë për të pasur dhe për t’u furnizuar me mallra dhe shërbime”,⁵⁰³

-Direktivës 2006/54/KE, “Për zbatimin e parimit të mundësive të barabarta dhe të trajtimit të barabartë të burrave dhe grave në çështjet e punësimit dhe marrëdhëniet gjatë punës”, 2010/41/BE.

Direktivat Për Barazinë Gjinore

Direktivat për trajtim të barabartë në Bashkimin Evropian përcaktojnë standardet minimale në legjislacionin për trajtimin e barabartë. Ato ndalojnë: *diskriminimin, ngacmimet dhe ngacmimet seksuale, viktimizimin në punësim, profesion për shkak të përkatësisë gjinore, origjinës racore ose etnike, orientimit seksual, fees, ose besimit, aftësisë së kufizuar; në sigurimin e mallrave dhe shërbimeve të tjera për shkak të përkatësisë gjinore dhe origjinës racore ose etnike.*

⁵⁰² Rapoti për mbrojtjen nga diskriminimi”, 2022, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,
https://www.kmd.al/wp-content/uploads/2023/03/Raporti-KMD-2022_compressed.pdf, f., 9,10

⁵⁰³503

Direktiva për Racën, ndalon diskriminimin në bazë të përkatësisë racore ose etnike në fushën e punësimit, arsimin, aksesin, furnizimit me mallra dhe shërbimeve, që janë në dispozicion të publikut, duke përfshirë: *strehimin, mbrojtjen sociale, përfshirë sigurimin social, kujdesin shëndetësor, avantazhet sociale* etj.

Direktiva për Barazinë në Punësim ndalon diskriminimin në bazë: *të fesë dhe besimit, orientimit seksual, moshës, aftësisë së kufizuar në fushën e punësimit* etj.

Direktivat për Barazinë Gjinore synojnë eliminimin e diskriminimit në fushën e punës, duke përfshirë vetëpunësimin dhe aksesin në mallra dhe shërbime në bazë të gjinisë. Praktika gjyqësore e GJED-së tregon se këtu përfshihet edhe identiteti gjinor⁵⁰⁴.

8.4 Legjislacioni Shqiptar për mbrojtjen nga diskriminimi

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë
 - Ligji Nr. 10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar
 - Ligji Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”
 - Ligji Nr. 7961/1995 “Kodi i Punës i Republikës të Shqipërisë”, i ndryshuar
 - Ligji Nr. 96/2017 “Për mbrojtjen e Pakicave Kombëtare në Republikën e Shqipërisë”
 - Ligji Nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e Personave me Aftësi të Kufizuar”
 - Ligji Nr. 9970/2008 “Për Barazinë Gjinore në shoqëri”⁵⁰⁵

⁵⁰⁴ *Rapoti për mbrojtjen nga diskriminimi*, 2022, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, https://www.kmd.al/wp-content/uploads/2023/03/Raporti-KMD-2022_compressed.pdf, f., 9,10

⁵⁰⁵ *Rapoti për mbrojtjen nga diskriminimi*, 2022, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

- Ligji Nr. 9669/2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar
- Ligji Nr. 125/2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9669, datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar
- Ligji Nr. 45/2016 “Për vullnetarizmin”
- Ligji Nr. 65/2016 “Për ndërmarrjet sociale në Republikën e Shqipërisë”
- Ligji Nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”
- Ligji Nr. 22/2018 “Për strehimin social”
- Ligji Nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”
- Ligji Nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”
- Kodin Penal, Kodi i Procedurës Civile, Kodi i Drejtësisë Penale për të mitur⁵⁰⁶
- Ligji Nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”,
- Kodi i Etikës së Gazetarëve 2018
- Kodi i Trasmetimit
- Ligji për statusin e nëpunësit civil
- Ligji për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë
- Ligji Nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Shqipëri
- Ligji Nr. 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”
- Ligji Nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”

https://www.kmd.al/wp-content/uploads/2023/03/Raporti-KMD-2022_compressed.pdf, f., 9,10

⁵⁰⁶ A. Llano, “*Shteti i së Drejtës në Shqipëri*”, Accent Graphics Publishing and Communication 2023. Hamilton Kanada, f.53

- Ligji Nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë
- Ligji Nr. 8626, datë 22.06.2000 “Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, i ndryshuar
- Ligji Nr. 8098, datë 28.03.1996 “Për statusin e të verbrit”, i ndryshuar
- Ligji Nr. 7889/1994 “Për statusin e invalidit të punës”, i ndryshuar
- Ligji Nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuar”
- Ligji Nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”
- Ligji Nr. 129/2021 “Për statusin, “Fëmijë në përkujdesje të Republikës
- Ligji Nr. 108/2014 “Për policinë e shtetit”, i ndryshuar
- Ligji Nr. 75/2019 “Për rininë”
- Ligji Nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë (I ndryshuar me Ligj nr. 79/2023, datë 12.10.2023) (i përditësuar)
- Ligji Nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, (I ndryshuar me ligjin nr, 178/2014, datë 18.12.2014, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 211)
- Ligji Nr.10 107, Datë 30.3.2009 (I ndryshuar) “Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”
- LIGJ Nr. 13/2016PËR MËNYRËN E OFRIMIT TË SHËRBIMEVE PUBLIKE NË SPORTELE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË
- Kodet e Etikës së institucioneve
- Kodet Nderkombetare të Etikës
- KODI I Etikës në Media Per personat me aftesi te Kufizuara Albanian Insitut Media
- Kodi i Etikës Ministrove
- Kodi i Sjelljes së Deputetëve në Republikën e Shqipërisë

- Vendim “Për integrimin gjinor në programin buxhetor afatmesëm”⁵⁰⁷
- Kodi Doganor
- Ligji për ratifikimin e Marreveshjes së Stabilizimit Asocimit të Evropian 2006
- Rregullorja e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë Botim i Kuvendit të Republikës së Shqipërisë Tiranë, 2024
- KODI I TRANSMETIMIT PËR MEDIAN AUDIOVIZIVE
- (Miratuar me Vendimin e AMA-s, nr. 228, datë 11.12.2017)

Ligji nr. 10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, (i ndryshuar) është ligji bazë për mbrojtjen nga diskriminimi dhe gjuha e urrejtjes. Edhe pse ky ligj është i përafëruar me legjislacionin e Bashkimit Evropian, ai mbart problematika, pasi ka vakume në dispozita dhe duhet ndryshuar që t’u vijë në ndihmë individëve të diskriminuar, pasi nuk mbrohen të gjitha subjektet e diskriminuara, por vetëm ato që diskriminohen nga organizata publike apo private. Kryesisht, ata persona, që diskriminohen nga komuniteti ku jetojnë, nuk mbrohen nga ligji pasi ka vakum të dispozitave ligjore. P.sh.: një grua e cila diskriminohet nga komuniteti ku jeton e përndiqet me gjuhën e urrejtjes, nuk mund të mbrohet pasi nuk i njeh personat, që e poshtërojnë me gjuhën e urrejtjes. Sipas ligjit duhet të identifikosh subjektin, që e shkakton diskriminimin dhe gjuhën e urrejtjes, si dhe pamundësinë e identifikimit të tij. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi në rastet tilla duhet të referohet akteve ndërkombetare për mbrojtjen nga diskriminimi dhe parimeve të përgjithshme të ligjit ndërkombëtar dhe jo vetëm dispozitave të ligjit Shqiptar. Ky institucion mund të bëjë propozime konkrete për shtesa të dispozitave ku ka vakume. Referencat në traktatet e OKB-së mund të gjenden edhe në jurisprudencë të GJEDNJ. GJEDNJ theksoi se GJEDNJ nuk mund të interpretohet në një vakum, por duhet të interpretojë në harmoni me parimet e përgjithshme

⁵⁰⁷ https://www.mod.gov.al/images/PDF/vkm_buxhetimi_shanset.pdf, aksesuar më 20.02.2024,

të ligjit nderkombëtar.⁵⁰⁸ Duhet pasur parasysh çdo rregull përkatës ndërkombëtar ligji i zbatueshëm në marrëdhëniet ndërmjet palëve, veçanërisht rregullat në lidhje me mbrojtjen ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. Tradicionalisht, vetëm shtetet mund të bëhen anëtare të traktateve të të drejtave të njeriut. Megjithatë, shtetet bashkëpunojnë më shumë përmes organizatave ndërkombëtare, ndaj të cilave ata delegojnë kompetenca dhe përgjegjësi të rëndësishme. Ekziston një nevojë urgjente për të bërë të sigurt që këto organizata angazhohen gjithashtu, për t'i dhënë efektet e të drejtave e detyrimeve të njeriut, shteteve të tyre anëtare.⁵⁰⁹

⁵⁰⁸ Handbook on European non-discrimination law 2018, edition Luxembourg: Publications Office of the European Union, 2018, pg.27

⁵⁰⁹ Handbook on European non-discrimination law 2018, edition Luxembourg: Publications Office of the European Union, 2018, pg.27

KREU IX

ORGANET PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

9.1 Organi Kombëtar për Mbrojtjen nga Diskriminimi

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe struktura organizative Kuvendi i Republikës së Shqipërisë miratoi Ligjin Nr. 10 221, më datë 04.02.2010, “*Për mbrojtjen nga diskriminimi*”,⁵¹⁰ (i ndryshuar), i cili hyri në fuqi më datë 13.03.2010, pas Dekretimit nga Presidenti i Republikës me Dekretin Nr. 6433, datë 24.2.2010 dhe botimit në Fletoren Zyrtare Nr. 15, datë 25. 02. 2010. Në datë 15.10.2020, me Ligjin Nr. 124/2020, “*Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 10 221, datë 04.02.2010*”, “*Për mbrojtjen nga diskriminimi*”, botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 191 datë 03.11.2020, u miratuan ndryshimet ligjore në Ligjin “*Për mbrojtjen nga diskriminimi*”, të cilat hynë në fuqi më 18 Nëntor 2020.⁵¹¹ Bazuar në këtë ligj, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, është i vetmi autoritet përgjegjës, që siguron mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje, që nxit diskriminimin. KMD ushtron kompetencat në tri sfera kryesore: (I) *ofrimin e ndihmës për viktimat e diskriminimit përmes shqyrtimit të ankesave, kryerjes së hetimeve administrative, vendosjes së sanksioneve administrative dhe përfaqësimit në gjykatë për çështjet civile*; (II) *monitorimin e zbatimit të ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi dhe* (III) *rritjen e ndërgjegjësisë*. Komisioneri e mbështet punën e tij në zbatimin

⁵¹⁰ https://www.kmd.al/wp-content/uploads/2023/03/Raporti-KMD-2022_compressed.pdf.

⁵¹¹ *Raporti vjetor*” Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, 2022, f.25, https://www.kmd.al/wp-content/uploads/2023/03/Raporti-KMD-2022_compressed.pdf.

e të gjithë mekanizmave ligjorë kombëtarë dhe ndërkombëtarë për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, të ratifikuar nga Republika e Shqipërisë.⁵¹²

2) Zyra e KMD-së

Bazuar në nenin 22, pika 2, të Ligjit Nr. 10 221/2010, “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar, Komisioneri mbështetet nga Zyra e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.⁵¹³ Zyra ka personelin dhe pajisjet e nevojshme për të mbështetur Komisionerin në përmbushjen e detyrave të ngarkuara me ligj. Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, me vendimin Nr. 34, datë 20.05.2010 “*Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, miratoi strukturën organizative të Zyrës së Komisionerit. Me këtë strukturë organizative, Zyra e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka funksionuar me 4 drejtori dhe 1 sektor, nga viti 2010 kur është themeluar si institucion, deri në vitin 2018. Me vendimin Nr. 88, datë 23.07.2018, të Kuvendit të Shqipërisë, është vendosur ndryshimi i strukturës dhe organikës së Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Në bazë të këtyre ndryshimeve është rritur numri i stafit të Zyrës nga 23 punonjës, që ishin me strukturën e vjetër në 34 punonjës me strukturën e re. Në kuadër të projektit të përbashkët të BE/KIE: “*Rritja e efektivitetit të sistemit Shqiptar të Mbrojtjes së të Drejtave të Njeriut dhe antidiskriminimit*”, KMD pilotoi 3(tri) zyra rajonale në qytetet Korçë, Gjirokastër dhe Shkodër. Me Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi 2022 26, në strukturën e re, tri zyrat rajonale të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në qytetet Korçë, Fier, Shkodër, bëhen zyra të

⁵¹² “*Raporti vjetor*” Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, 2022, f.25, https://www.kmd.al/wp-content/uploads/2023/03/Raporti-KMD-2022_compressed.pdf.

⁵¹³ https://www.kmd.al/wp-content/uploads/2023/03/Raporti-KMD-2022_compressed.pdf.

përhershme⁵¹⁴. Në bazë të strukturës së re, me qëllim forcimin e kapaciteteve monitoruese të KMD, janë parashikuar specialistë të posaçëm për monitorim dhe raportim.⁵¹⁵

9.2 Kompetencat e Komisionerit

*Direktiva e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit Evropian, 2006/54/KE, në nenin 20 të saj, lidhur me organet e barazisë, parashikon detyrimin për vendet anëtare të ngritjes së organeve të posaçme në nivel kombëtar për promovimin, analizën, monitorimin dhe mbështetjen e trajtimit të barabartë të individëve.*⁵¹⁶ Në këtë nen parashikohen gjithashtu, edhe kompetencat kryesore, që duhet të gëzojnë këto organe të barazisë dhe, konkretisht:

- të ofrojnë ndihmë të pavarur për viktimat e diskriminimit në ndjekjen e ankesave të tyre në lidhje me diskriminimin;
- të kryejnë sondazhe të pavarura në lidhje me diskriminimin;
- të publikojnë raporte dhe të japin rekomandime për çdo çështje, që lidhet me diskriminimin.

Kompetencat e KMD-së janë parashikuar në nenin 32 të Ligjit: “*Për mbrojtjen nga diskriminimi*”, i ndryshuar. Sipas parashikimeve të këtij neni, KMD-ja gëzon një numër kompetencash, që shkojnë përtej parashikimeve të Direktivës 2006/54/KE. Kompetenca të KMD-së, të parashikuara në ligjin përkatës dhe që kanë për qëllim ofrimin e ndihmës për viktimat e diskriminimit në ndjekjen e ankesave të tyre për diskriminim, përfshijnë:

- shqyrtimin e ankesave nga personat ose grupet e personave, që pretendojnë se janë diskriminuar, siç parashikohet në këtë ligj;

⁵¹⁴ Po aty

⁵¹⁵ “*Raporti vjetor*” Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, 2022, f.25, https://www.kmd.al/wp-content/uploads/2023/03/Raporti-KMD-2022_compressed.pdf.

⁵¹⁶ https://www.kmd.al/wp-content/uploads/2023/03/Raporti-KMD-2022_compressed.pdf.

-shqyrtimin e ankesave nga organizatat, që kanë një interes të ligjshëm për të vepruar në emër dhe me pëlqimin me shkrim të individëve ose grupeve të individëve, që Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi pretendon se ka ndodhur diskriminimi, ose në emër të tyre për çështje që lidhen me interesa kolektive;

-kryerjen e hetimeve administrative pas marrjes së informacionit të besueshëm për shkelje të këtij ligji;⁵¹⁷

-vendosjen e sanksioneve administrative sipas përcaktimit të këtij ligji;

-të paraqesë padi në mbrojtje të parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit për çështje, që lidhen me interesa kolektive;

-të vërë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese në rastet, kur gjatë veprimtarisë së tij, konstaton se ligji

ose akti normativ cenon të drejtat dhe liritë themelore të individëve.⁵¹⁸

Kompetenca të KMD-së të parashikuara në nenin 32 të Ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar dhe që kanë për qëllim kryerjen e sondazheve të pavarura në lidhje me diskriminimin, përfshijnë:

-kryerjen e sondazheve në lidhje me diskriminimin;

-monitorimin e zbatimit të këtij ligji dhe Ligjit “Për Barazi Gjimore në Shoqëri”.

Kompetenca të KMD-së, që kanë për qëllim publikimin e raporteve dhe dhënien e rekomandimeve për çdo çështje, që lidhet me diskriminimin, përfshijnë:

-adresimin e rekomandimeve të autoriteteve kompetente, sidomos duke propozuar miratimin e legjislacionit të ri, ndryshimin apo reformimin e legjislacionit ekzistues;

-publikimin e raporteve dhe përgatitjen e rekomandimeve për çfarëdolloj çështjeje, që lidhet me diskriminimin;

⁵¹⁷ https://www.kmd.al/wp-content/uploads/2023/03/Raporti-KMD-2022_compressed.pdf.

⁵¹⁸ “*Raporti vjetor*” Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, 2022, f.27, https://www.kmd.al/wp-content/uploads/2023/03/Raporti-KMD-2022_compressed.pdf.

-kontribuimin në raportimet sipas rastit, prezantimin e raporteve para organizmave ndërkombëtarë dhe rajonalë.

Kompetenca të KMD-së, të parashikuara në ligjin e mësipërm dhe, që kanë për qëllim rritjen e ndërgjegjësimit, përfshijnë:

-nxitjen e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit veçanërisht, duke sensibilizuar dhe informuar për këto çështje, përfshirë edhe ofrimin e informacioneve të shkruara, ndër të tjera për këtë ligj në gjuhën shqipe, në gjuhët e pakicave, si dhe në formate të përdorshme nga persona me aftësi të kufizuar;⁵¹⁹

-adresimin e drejtpërdrejtë të opinionit publik për çfarëdolloj çështjeje, që lidhet me diskriminimin;

-informimin për të drejtën e mbrojtjes nga diskriminimi dhe për mjetet ligjore të disponueshme për këtë mbrojtje;

-zhvillimin e dialogut të rregullt për çështjet e diskriminimit me grupet përkatëse sociale, duke përfshirë organizatat joqeveritare;

-zhvillimin e aktiviteteve ndërgjegjësuere dhe edukuese, që ndihmojnë në zbatimin e këtij ligji.⁵²⁰

Gjatë vitit 2022, janë depozituar 100 ankesa, në raport me 102 ankesa të paraqitura gjatë 2021, në të cilat ankuesit kanë pretenduar më shumë se një shkak diskriminimi. Gjatë vitit 2022 vazhdojnë të mbeten mbizotëruese pretendimet për diskriminim si pasojë e: *aftësisë së kufizuar, bindjeve politike, racës, përkatësisë në një grup të veçantë, gjendjes arsimore, moshës dhe gjendjes shëndetësore*.⁵²¹ Gjatë vitit 2022, Komisioneri ka shqyrtuar në total 6 çështje me objekt, përdorimin e gjuhës së urrejtjes, nga të cilat 4 ankesa dhe 2 çështje ex-officio. Në 3 (tre) raste është pretenduar përdorimi i gjuhës së urrejtjes për shkak të racës dhe etnisë, në 1 rast (ankesë dhe ex-officio) për shkak të gjinisë dhe në 1 (një) rast për shkak të besimit fetar. Po gjatë vitit 2022,

⁵¹⁹ https://www.kmd.al/wp-content/uploads/2023/03/Raporti-KMD-2022_compressed.pdf.

⁵²⁰ “Raporti vjetor” Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, 2022, f.27, https://www.kmd.al/wp-content/uploads/2023/03/Raporti-KMD-2022_compressed.pdf.

⁵²¹ Po aty, f.35

të Zgjedhjeve të BdheH në lidhje me zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2022, vendosën një gjobë në vlerë prej 3000 BAM për partinë politike “Lëvizja e veprimit demokratik” të BdheH (PDA) dhe një gjobë në vlerë prej 5000 BAM për kandidaten e PDA-së, për përdorimin e gjuhës së urrejtjes në një tubim politik në Aljkoviqi-Komuna e Banoviqit.

Gjithashtu ato kanë një rol të madh në vendosjen e barazisë gjinore. Kështu në Shqipëri KQZ ka nxjerrë këto probleme Shkeljet të kritereve gjinore, 2013

Të dhëna për saksionet administrative të vendosura nga KQZ, për shkeljen e

kritereve gjinore nga partitë politike në zgjedhjet për Kuvendin 2013.⁵⁷³

□ KQZ me vendimin nr.337, datë 11.05.2013, vendosi sanksione administrative për Partinë Socialiste, për shkeljen e kritereve gjinore për gjashtë zona zgjedhore:

1. Qarku Tiranë
2. Qarku Durrës
3. Qarku Elbasan
4. Qarku Kukës
5. Qarku Dibër
6. Qarku Gjirokastrë

□ KQZ me vendimin nr.340, datë 11.05.2013, vendosi sanksione administrative për Partinë Demokratike, për shkeljen e kritereve gjinore për katër zonat zgjedhore:

1. Qarku Elbasan
2. Qarku Kukës
3. Qarku Dibër
4. Qarku Berat

□ KQZ me vendimin nr.341, datë 11.05.2013, vendosi sanksione administrative për Partinë Lëvizja Socialiste për Integrim, për shkeljen e kritereve gjinore për katër zonat zgjedhore:

⁵⁷³KQZhttps://cec.org.al/Portals/0/Documents/CEC%202013/Barazia_gjinore/Shkeljet%20t%C3%AB%20kritereve%20gjinore,%202013.pdf aksesuar me 11.7.2024
https://cec.org.al/Portals/0/Documents/CEC%202013/Barazia_gjinore/Shkeljet%20t%C3%AB%20kritereve%20gjinore,%202013.pdf

1. Qarku Berat
2. Qarku Kukës
3. Qarku Durrës
4. Qarku Gjirokastrë⁵⁷⁴

10.6 Roli aktual i OSHC-ve

Roli aktual i OSHC-ve në luftimin e gjuhës së urrejtjes është kryesisht, në parandalimin dhe zbulimin, ndërsa shumica e aktorëve institucionalë punojnë në reagimet formale dhe sanksionimin. Prandaj, kombinimi i këtyre angazhimeve mund të përmirësojë përpjekjet aktuale në luftimin e gjuhës së urrejtjes nëpër vendet e BP-së. Aktualisht, OSHC-të janë të përfshira kryesisht, në aktivitetet e mëposhtme:

-monitorimin, regjistrimin, mbledhjen dhe raportimin e të dhënave, organizata më e spikatur në këtë fushë është *Zyra e Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë për Institucionet Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (OSBE/ODIHR)*, që mbledh të dhëna zyrtare dhe të dhënat e raportuara nga OSHC të ndryshme në vendet e synuara.⁵⁷⁵

10.7 Roli i OSCE ODIHRIT në gjuhën e urrejtjes

Në një vit historik, 2021 ishte një tjetër rekord për ODIHR-in: 15 vjet që nga publikimi i parë i raportit vjetor të krimit të urrejtjes. Përditësimi vjetor përbën bazën më të madhe të të dhënave për krimin e urrejtjes në botë dhe kombinon të dhëna statistikore, informacione dhe

⁵⁷⁴https://cec.org.al/Portals/0/Documents/CEC%202013/Barazia_gjinore/Shkeljet%20t%C3%AB%20kriterëve%20gjinore,%202013.pdf

⁵⁷⁵ M. Çatiq, Eksperte e jashtme e RNR-së, “*Përmbledhje e qasjeve për të luftuar gjuhën e urrejtjes në Ballkanin Perëndimor*”, Rrjeti i Ndërgjegjësimit për Radikalizimin, Luksemburg: Zyra e publikimeve e Bashkimit Evropian, 2023, https://homeaffairs.ec.europa.eu/system/files/2023/10/ran_wb_taking_stock_of_approaches_to_counter_hate_speech, aksesuar, më 01.02.2024

analiza rreth krimeve të urrejtjes nga i gjithë rajoni i OSBE-së⁵⁷⁶. Çdo vit, stafi i ODIHR shqyrton *statistikat e krimit të urrejtjes, të dhënat dhe informacionet e paraqitura nga shtetet, shoqëria civile dhe organizatat ndërqeveritare*. Informacioni dhe të dhënat, të ndara sipas paragjyqimeve të krimit të urrejtjes, llojit të krimit dhe vendit, publikohen më pas, në faqen e dedikuar të ODIHR për Raportimin e Krimit të Urrejtjes më 16 nëntor, Ditën Ndërkombëtare të Tolerancës. Procesi i raportimit vazhdon gjatë gjithë vitit dhe varet nga kontributet e pikave kombëtare të kontaktit, të emëruara nga shteti dhe organizatat e shoqërisë civile, që punojnë për mbledhjen dhe raportimin e të dhënave në ODIHR. Të dhënat zyrtare përfshijnë statistika të regjistruara nga policia, si dhe informacione specifike të vendit në lidhje me legjislacionin për krimet e urrejtjes, mbledhjen e të dhënave dhe nismat për mbështetjen e viktimave. Incidentet e urrejtjes të paraqitura nga shoqëria civile dhe organizatat ndërqeveritare përfshijnë përshtatje të mijëra incidenteve të urrejtjes, shumë prej të cilave përndryshe nuk do të raportoheshin. Për më tepër, raporti paraqet rekomandimet e lëshuara nga organizatat ndërqeveritare, së bashku me vëzhgimet kryesore të ODIHR-it mbi respektimin e shteteve ndaj angazhimeve të tyre në OSBE në fushën e krimit të urrejtjes. Mbledhja e të dhënave është vetëm hapi i parë, megjithatë puna për të trajtuar krimin e urrejtjes nuk përfundon në ditën e publikimit. Të dhënat dhe informacioni ndihmojnë politikëbërësit, policinë, prokurorët, aktorët e shoqërisë civile dhe të tjerët për të gjurmuar krimet e urrejtjes dhe për të identifikuar tendencat në zhvillim, duke lehtësuar përgjigjet e synuara dhe mbështetjen e duhur për viktimat. Të dhënat udhëzojnë gjithashtu, punën e ODIHR-it për të trajtuar krimin e urrejtjes, duke i mundësuar Zyrës të përshtatë programet dhe burimet e saj të trajnimit në përputhje me rrethanat.⁵⁷⁷

⁵⁷⁶ OSCE ODIHRI hate crime, Reporting <https://hatecrime.osce.org/infocus/odihrs-impact-2021-marking-15-years-reporting-hate-crimes>, aksesuar më 01.02.2024

⁵⁷⁷ OSCE ODIHRI, hate crime, Reporting <https://hatecrime.osce.org/infocus/odihrs-impact-2021-marking-15-years-reporting-hate-crimes>, aksesuar më 01.02.2024

10.8 Rregullimi i medias dhe “gjuha e urrejtjes”

Kuadri i rregullimit të medias është një aspekt i rëndësishëm i detyrimit pozitiv të shteteve, përmes së cilit ato krijojnë një mjedis të favorshëm për lirinë e shprehjes dhe barazinë. Në pjesën më të madhe të këtij kuadri, shtetet duhet të ndërmarrin hapa pozitivë për të promovuar diversitetin dhe pluralizmin në shoqëri.⁵⁷⁸ Ato gjithashtu, duhet të mundësojnë zhvillimin e një peizazhi mediatik, që përfaqëson e pasqyron shoqërinë në tërësi, dhe paraqet një larmi maksimale zërash, pikëpamjesh dhe gjuhësh.⁵⁷⁹ Për sa u përket përgjigjeve ndaj këtyre detyrimeve, vendet në shqyrtim zakonisht, mund të bëjnë dallimin midis llojeve të mediave në kuadrin e tyre ligjor dhe rregullator. Në mënyrë tipike, ekziston një legjislacion i veçantë, që rregullon median elektronike dhe median e shkruar. Të vetmin përjashtim e gjejmë në Hungari, vend i cili ofron një lloj legjislacioni për të mbuluar të gjitha “shërbimet mediatike dhe produktet e shtypit”, (dy akte trajtojnë aspekte të ndryshme të rregullimit të medias); dhe MB, e cila nuk ka ndonjë legjislacion ligjor për shtypin e shkruar. Për më tepër, legjislacioni i dedikuar në çdo vend u jep mediave të shërbimit publik, kompetencën për të shërbyer interesin publik, promovimin e diversitetit e pluralizmit, dhe kërkesave të veçanta në lidhje me pakicat. Duhet theksuar se në disa vende kufizimet e përmbajtjes të gjendura në legjislacionin e medias, shkojnë përtej asaj që është e lejueshme sipas ligjit ndërkombëtar. E rëndësishmja, korniza mediatike në çdo vend duhet parë në kontekstin e situatës aktuale politike për çdo shtet. Kjo, në disa vende përfshin përpjekjet për të kufizuar pavarësinë e autoriteteve rregullatore, për të

⁵⁷⁸ Responding to, ‘hate speech’: Comparative overview of six EU countries, 2017, pg.28,

https://www.article19.org/wp-content/uploads/2018/03/ECA-hate-speech-compilation-report_March-2018.pdf,

⁵⁷⁹ ⁵⁷⁹ Responding to, ‘hate speech’: Comparative overview of six EU countries, 2017, pg.28, https://www.article19.org/wp-content/uploads/2018/03/ECA-hate-speech-compilation-report_March-2018.pdf.

kontrolluar mediat e shërbimit publik dhe për të kufizuar lirinë e medias.⁵⁸⁰

⁵⁸⁰ Responding to, 'hate speech': Comparative overview of six EU countries, 2017, pg.28, https://www.article19.org/wp-content/uploads/2018/03/ECA-hate-speech-compilation-report_March-2018.pdf.

KREU XI

MASAT QË KA MARRË BASHKIMI EVROPIAN DHE ATO QË DUHET TË MERREN PËR LUFTËN KUNDËR GJUHËS SË URREJTJES

11.1 Statistikat me të dhënat për gjuhën e urrejtjes nga media

Raporti bazohet në monitorimin e mediave të kryer gjatë periudhës Janar 2021-Prill 2022. Incidentet u identifikuan nëpërmjet përdorimit të fjalëve kyç dhe monitorimit ditor të kanaleve të ndryshme mediatike.⁵⁸¹ Gjuha e urrejtjes dhe diskriminuese ka qenë më e përhapur ndaj grupeve, individëve dhe komuniteteve për shkak të përkatësisë etnike (38.5%), gjinisë (20.5%) dhe orientimit seksual (12%). Prej vitesh, situata paraqitet e njëjtë për këto kategori dhe pavarësisht përpjekjeve të bëra nga organizatat mediatike dhe autoritetet e medias, gjendja vazhdon të jetë problematike.⁵⁸² Një raport i monitorimit të medias, i publikuar në vitin 2021 ka nxjerrë se gratë dhe vajzat janë grupi më i prekur sa i përket gjuhës së urrejtjes dhe diskriminuese në internet, konstatim i cili konfirmohet edhe nga monitorimi që Instituti Shqiptar i

⁵⁸¹ D. Hysa, K. Lani, “*Raport Monitorimi për gjuhën e urrejtjes në Shqipëri*”, Instituti Shqiptar i Medias European Union Norway Project German, Projekti financohet nga Bashkimi Evropian, Trusti Ballkanik për Demokraci, projekt i Fondit Gjerman Marshall të Shteteve të Bashkuara dhe Ministrisë së Punëve të Jashtme të Norvegjisë, f.5, <https://www.institutemedia.org/wp-content/uploads/2022/07/Raport-Monitorimi-pe%CC%88r-gjuhe%CC%88n-e-urrejtjes->, aksesuar më 03.02.2024

⁵⁸² D. Hysa, K. Lani, “*Raport Monitorimi për gjuhën e urrejtjes në Shqipëri*”, Instituti Shqiptar i Medias European Union Norway Project German, Projekti financohet nga Bashkimi Evropian, Trusti Ballkanik për Demokraci, projekt i Fondit Gjerman Marshall të Shteteve të Bashkuara dhe Ministrisë së Punëve të Jashtme të Norvegjisë, f.5, <https://www.institutemedia.org/wp-content/uploads/2022/07/Raport-Monitorimi-pe%CC%88r-gjuhe%CC%88n-e-urrejtjes->

Medias (ISHM) ka bërë në vitin 2022, ku 81.8% e incidenteve preknin këtë grup.⁵⁸³ Është hera e parë që gjuha e urrejtjes dhe diskriminuese me sfond etnik mbizotëron, gjetje kjo në kundërshtim me raportet e tjera të monitorimit të publikuara më parë. Megjithatë, mund të shpjegohet me kontekstin e zhvillimeve të fundit brenda vendit, si pritja e refugjatëve afganë dhe sirianë në Shqipëri, teoritë e konspiracionit lidhur me COVID-19, ndikimi i tyre në qëndrimet ndaj popullit kinez dhe hebrenjve, si edhe zhvillimet politike mes Shqipërisë dhe vendeve të tjera. Një faktor tjetër kontribues është se në këtë kategori përfshihen edhe pakicat etnike në Shqipëri përkatësisht, komuniteti Rom dhe Egjiptian. Media kontribuon në diskursin e dëmshëm përmes përforcimit të paragjytimeve me bazë etnike, shkrimit të titujve që prekin një grup të tërë etnik edhe, kur është vetëm një individ i përfshirë në ngjarje, si edhe duke lejuar përdoruesit në internet të postojnë komentet e tyre përçmuese, me gjuhë urrejtjeje, pa i filtruar ato.

Sa i përket komunitetit LGBTQ+, ata bëhen subjekt i gjuhës së urrejtjes dhe diskriminuese, që ushqehet nga media përmes titujve sensacionalë, publikimit të informacioneve të paverifikuara, të cilat nxisin përdorimin e kësaj gjuhe nga ana e audiencës online.⁵⁸⁴ Raportimet mediatike lidhen me zhvillimet në vend, siç ishin diskutimet e vazhdueshme për familjen, të cilat prodhuan diskurs diskriminues dhe gjuhë urrejtjeje ndërmjet mbështetësve të komuniteteve LGBTQ+ dhe atyre që mbështesin familjen tradicionale kryesisht, komuniteteve fetare. Megjithatë, bazuar në matjen e intensitetit të gjuhës së urrejtjes dhe diskriminuese ndaj këtij minoriteti, vlera mesatare mbetet relativisht e ulët (2.1). Pavarësisht pranisë shqetësuese të diskursit të gjuhës së urrejtjes dhe diskriminuese në median shqiptare dhe komunikimin

⁵⁸³ D. Hysa, K. Lani, “Raport Monitorimi për gjuhën e urrejtjes në Shqipëri”, Instituti Shqiptar i Medias European Union Norway Project German, Projekti financohet nga Bashkimi Evropian, Trusti Ballkanik për Demokraci, projekt i Fondit Gjerman Marshall të Shteteve të Bashkuara dhe Ministrisë së Punëve të Jashtme të Norvegjisë, f.5, <https://www.institutemedia.org/wp-content/uploads/2022/07/Raport-Monitorimi-pe%CC%88r-gjuhe%CC%88n-e-urrejtjes->, aksesuar më 03.02.2024

⁵⁸⁴ Po aty

publik, klasifikimi sipas analizës sentimentale tregon një rezultat mesatar të nivelit 3. Kjo do të thotë se ashpërsia e diskursit është e ndërmjetme dhe karakterizohet nga narrativa fyese, ofenduese, por jo të dhunshme.⁵⁸⁵

11.2 Masat që ka marrë Bashkimi Evropian kundër gjuhës së urrejtjes

Vendim Kuadër për luftimin e formave dhe shprehjeve të caktuara të racizmit dhe ksenofobisë me anë të ligjit penal. Qëllimi i këtij vendimi kuadër është të sigurojë që disa manifestime serioze të racizmit dhe ksenofobisë të dënohen me dënime penale efektive, proporcionale dhe bindëse në të gjithë Bashkimin Evropian (BE)⁵⁸⁶. Për më tepër, ai synon të përmirësojë dhe inkurajojë bashkëpunimin gjyqësor në këtë fushë.

AKT, Vendimi Kornizë i Këshillit 2008/913/JHA, i 28 nëntorit 2008, për luftimin e formave dhe shprehjeve të caktuara të racizmit dhe ksenofobisë me anë të ligjit penal. Si vazhdim i Veprimit të Përbashkët 96/443/JHA ky Vendim Kuadër parashikon përafrimin e ligjeve dhe rregulloreve të vendeve të BE-së, për veprat penale që përfshijnë manifestime të caktuara të racizmit dhe ksenofobisë.⁵⁸⁷ Disa

⁵⁸⁵ D. Hysa, K. Lani, “*Raport Monitorimi për gjuhën e urrejtjes në Shqipëri*”, Instituti Shqiptar i Medias European Union Norway Project German, Projekti financohet nga Bashkimi Evropian, Trusti Ballkanik për Demokraci, projekt i Fondit Gjerman Marshall të Shteteve të Bashkuara dhe Ministrisë së Punëve të Jashtme të Norvegjisë, f.5, <https://www.institutemedia.org/wp-content/uploads/2022/07/Raport-Monitorimi-pe%CC%88r-gjuhe%CC%88n-e-urrejtjes->, aksesuar më 03.02.2024

⁵⁸⁶ EUR LEX, Access to European Union Law Council Framework Decision, 2008/913/JHA .of 28 November, 2008 on combating certain forms and expressions of racism and xenophobia by means of criminal law, <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=LEGISSUM:l33178>, aksesuar më 03.02.2024

⁵⁸⁷ ⁵⁸⁷ EUR LEX, Access to European Union Law Council Framework Decision, 2008/913/JHA .of 28 November, 2008 on combating certain forms and expressions of racism and xenophobia by means of criminal law,

manifestime serioze të racizmit dhe ksenofobisë duhet të përbëjnë një shkëlqje në të gjitha vendet e BE-së dhe të dënohen me dënime efektive, proporcionale dhe bindëse. Ky Vendim Kuadër zbatohet për të gjitha veprat e kryera, brenda territorit të Bashkimit Evropian (BE), duke përfshirë një sistem informacioni, nga një shtetas i një vendi të BE-së ose për të mirën e një personi juridik të vendosur në një vend të BE-së. Për këtë qëllim, Vendimi Kornizë parashikon kritere se si të përcaktohet përgjegjësia e personave juridikë.

“*Gjuha e urrejtjes*”. Forma të caktuara të sjelljes, të përshkruara më poshtë janë të dënueshme si vepra penale: *nxitje publike për dhunë ose urrejtje të drejtuar kundër një grupi personash ose një anëtar i një grupi të tillë, të përcaktuar në bazë të racës, ngjyrës, prejardhjes, fesë ose besimit, origjinës kombëtare, etnike; veprës penale të lartpërmendur kur kryhet nga shpërndarja publike e trakteve, fotografive ose materialeve të tjera; falja publike, mohimi, banalizimi i rëndë i krimeve të gjenocidit, krimeve kundër njerëzimit dhe krimeve të luftës siç përcaktohet në Statutin e Gjykatës Penale Ndërkombëtare (nenet 6, 7 dhe 8) dhe krimet e përcaktuara në nenin 6 të Kartës së Tribunalit Ushtarak Ndërkombëtar, kur sjellja kryhet në një mënyrë, që ka gjasa të nxisë dhunë ose urrejtje kundër një grupi të tillë, ose një anëtar i një grupi të tillë. Dënohet edhe ndihma ose nxitja në kryerjen e veprave të mësipërme. Në lidhje me këto vepra të listuara, vendet e BE-së duhet të sigurojnë që ato të dënohen me: dënime efektive, proporcionale dhe bindëse; dënim me burg maksimumi të paktën një vit. Në lidhje me personat juridikë, dënimet duhet të jenë: efektive, proporcionale, bindëse dhe duhet të përbëhen nga gjoba penale ose jopenale. Gjithashtu, personat juridikë mund të dënohen me: përjashtimin nga e drejta për përfitime ose ndihmë publike; skualifikimin e përkohshëm ose të përhershëm nga praktika si dhe aktivitetet tregtare; vendosja nën mbikëqyrje gjyqësore; një urdhër për mbyllje gjyqësore. Fillimi i*

<https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=LEGISSUM:l33178>, aksesuar më 03.02.2024

hetimeve ose ndjekjeve penale të veprave raciste dhe ksenofobike nuk duhet të varet nga raportimi, ose akuza e viktimës. “*Krimi i urrejtjes*” Në të gjitha rastet, motivimi racist ose ksenofobik do të konsiderohet si një rrethanë rënduese përndryshe, gjykatat duhet të autorizohen për të marrë në konsideratë një motivim të tillë kur të përcaktojnë dënimet, që do të zbatohen.⁵⁸⁸

11.3 Masat që duhen ndërmarrë kundër gjuhës së urrejtjes dhe diskriminimit

Ideologjitë çnjerëzore përfaqësojnë një gjendje shpirtërore dhe kërkojnë qasje ndërkombëtare.⁵⁸⁹ Për të arritur një qasje të tillë, duhet të shkëmbehen praktikat më të mira. Ky proces kërkon formatet dhe variantet për shkëmbim ndërkombëtar, për praktikuesit dhe aktivistët, që merren me gjuhën e urrejtjes në internet çdo ditë.⁵⁹⁰ Të gjithë duhet të ushtrojmë autokritikë në lidhje me paragjykimet dhe racizmin.⁵⁹¹ Ky është një proces, që kërkon të mësuarit gjatë gjithë jetës. Viktimat kanë nevojë për solidaritet a deklaratë pozitive për ta, qofshin këto, ndihmë konkrete, donacione apo bashkëpunim. Ndjenja se është jo vetëm thjesht

⁵⁸⁸ EUR LEX, Access to European Union Law Council Framework Decision, 2008/913/JHA, of 28 November 2008, on combating certain forms and expressions of racism and xenophobia by means of criminal law., <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=LEGISSUM:l33178>, aksesuar më 03.02.2024

⁵⁸⁹ Po aty

⁵⁹⁰ EUR LEX, Access to European Union Law Council Framework Decision, 2008/913/JHA, of 28 November 2008, on combating certain forms and expressions of racism and xenophobia by means of criminal law., <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=LEGISSUM:l33178>, aksesuar më 03.02.2024

⁵⁹¹ H. Gleiß & S. Laubenstein, Measures and strategies for combating hate speech at the European level-an overview Briefing Paper /Measures and strategies for combating hate speech at the European level-an overview, <https://library.fes.de/pdf-files/dialog/17431.pdf>, aksesuar më 01.02.2024

një proces, por dhe tërësia e provave praktike të tij, përbëjnë një fakt thelbësor.⁵⁹²

-Mjeti i koordinuar evropian (dhe ndërkombëtarisht) nevojitet për siguri.⁵⁹³ Interneti nuk është hapësirë kombëtare, kështu zgjidhjet kombëtare mund të jenë efektive vetëm deri në një pikë. Kodi i Sjelljes së BE-së mbi gjuhën e urrejtjes, mund të japë frymëzim. Por pikat e kritikës dhe mësimet e nxjerra duhet të jenë marrë, ndër të tjera në lidhje me angazhimet vullnetare të kompanive sepse, për shembull: disa kompani dhe platforma nuk marrin pjesë, kështu nuk vlerësohen.

-Mbrojtja e të prekurve: Shumë qasje dhe masa janë duke u zbatuar, mendohet për hir të njerëzve të prekur nga: *fjalimet e urrejtjes, përjashtimi dhe dhuna verbale*, por shpesh ata neglizhojnë nevojat e tyre dhe realitetin e jetës së tyre. Prandaj nevojiten sa më poshtë:

-përfshirja e vazhdueshme e të prekurve në *zhvillimin, zbatimin dhe vlerësimin* e të gjitha masave;

-një politikë konkrete kundër racizmit/antidiskriminimit, si dhe masat e koordinuara dhe vlerësimi gjithëpërfshirës i dispozitave të reja dhe ekzistuese;

-një qendër drejtuese, këshilluese për viktimat e dhunës dixhitale.⁵⁹⁴ Për të zbutur më shumë kërcënimet akute në mënyrë efektive, autoritetet qendrore duhet të zgjerohen dhe t'u jepet mbështetje afatgjatë në vendet përkatëse. Ata duhet të organizojnë lehtësisht akt-kontakte të mundshme ndërmjet atyre që kërkojnë zbatim të ligjit si dhe të kërkojnë ndihmë e vende pune organizatave të ndihmës. Policia dhe agjencitë e tjera të zbatimit të ligjit, duhet të vënë në dijeni këto organe.

⁵⁹² ⁵⁹² H. Gleiß & S. Laubenstein, Measures and strategies for combating hate speech at the European level-an overview Briefing Paper /Measures and strategies for combating hate speech at the European level-an overview,

⁵⁹³ H. Gleiß & S. Laubenstein, Measures and strategies for combating hate speech at the European level-an overview Briefing Paper /Measures and strategies for combating hate speech at the European level-an overview,
<https://library.fes.de/pdf-files/dialog/17431.pdf>, aksesuar më 01.02.2024

⁵⁹⁴ PO aty

-Duhet të vendosen mekanizma të pavarur gjyqësorë, ngritur ose përforcuar për t'u siguruar viktimave mbështetje të mirë dhe efektive.

-Duhet të krijohen autoritete të pavarura brenda institucioneve si *policia*, tek të cilat mund të dorëzohen ankesa ose këshilla anonime për shembull., për idetë ekstremiste brenda institucionit.

-Në veçanti, përfshirjes (vullnetare) të komunitetit duhet t'i jepet mbrojtje më e madhe. Njerëz që janë të përfshirë politikisht dhe palët e tjera të interesuara, kanë nevojë për akses të shpejtë tek autoritetet.⁵⁹⁵

Zbatimi i kuadrit ligjor, që mundëson pjesëmarrjen dhe përfshirjen e barabartë të grave, të rejave dhe vajzave nga të gjitha grupet në vendimmarrjen politike e publike, në nivel vendor.⁵⁹⁶

Studimi dhe monitorimi i fenomenit të dhunës ndaj grave, të rejave e vajzave në zgjedhje dhe politikë në nivelin vendor. Përmirësimi i kuadrit ligjor për adresimin në mënyrën e duhur të seksizimit dhe dhunës ndaj grave, të rejave dhe vajzave në zgjedhje dhe politikë. Fuqizimi i kapaciteteve të Aleancave të grave këshilltare dhe Komisioneve të Barazisë Gjimore për të zbatuar iniciativa, që zvogëlojnë seksizmin dhe dhunën ndaj grave, të rejave dhe vajzave në politikë dhe gjatë proceseve zgjedhore, në bashkëpunim me mbështetjen edhe të Aleancës së grave deputete.

Fuqizimi i kapaciteteteve të medias, për të paraqitur modele pozitive të grave, të rejave dhe vajzave nga të gjitha grupet, lidere në politikë dhe vendimmarrjen publike vendore⁵⁹⁷.

11.4 Masat dhe strategjitë për luftimin e gjuhës së urrejtjes në nivel evropian, (një pasqyrë e ngjashme) dhe në platforma (për shembull.), ekipet ndërgjegjësuere për mbështetje të shpejtë në këtë

⁵⁹⁵ Vendim Nr. 400, datë 30.6.2021, Për miratimin e Strategjisë kombëtare për barazinë gjinore, 2021-2030 dhe të planit të saj të veprimit., f.30,31

⁵⁹⁶ Vendim Nr. 400, datë 30.6.2021, Për miratimin e Strategjisë kombëtare për barazinë gjinore, 2021-2030 dhe të planit të saj të veprimit., f.30,31

⁵⁹⁷ Vendim Nr. 400, datë 30.6.2021, Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjimore, 2021-2030 dhe të planit të saj të veprimit., f.30,31

ngjarje të hakimeve).⁵⁹⁸ Më shumë dispozita për fuqizim, pjesëmarrje dhe hapësira të mbrojtura për grupet e marginalizuara. Puna arsimore dhe edukimi politik:

Si lundrojmë në internet? Si mund të veprojmë që të ndihmojmë realisht, për të formuar shoqërinë dhe demokracinë në internet? Si manifestohet guximi i qytetarit dixhital? Të tilla çështje duhet të jenë pjesë kyçe e punës edukative. Për këtë qëllim, duhet të bëjmë sa vijon:

- të marrim seriozisht internetin si hapësirë publike dhe të ofrojmë trajnime të mëtejshme për të gjitha grupmoshat,

- të trajtojmë aftësitë mediatike si pjesë integrale të qasjes në trajnime (të mëtejshme) dhe t'i përfshijmë ato në planet mësimore,

- të sigurojmë opsione edukative mbi vlera si, p.sh.: *toleranca, të drejtat e njeriut, dallimet kulturore dhe barazi për të gjitha grupmoshat.*

Vetëm në këtë mënyrë është e mundur të ndërtohet elasticiteti brenda shoqërisë kundër gjuhës së urrejtjes dhe ekstremizmit, si:

- rimendojmë edukimin politik dhe e përshtatim atë në përputhje me kontekstet e reja dhe realitetet e përditshme. Interneti është dinamik dhe i shpejtë,

- vendosim opsione të disponueshme, që rrisin ndërgjegjësimin, largojmë sfidat dhe rreziqet në internet, duke përfshirë fjalimin me gjuhën e urrejtjes, por edhe teoritë konspirative. Ndërgjegjësimi, ngritja është gjithashtu, e nevojshme, por dhe e rëndësishme, (dhe gjithashtu, të rejtat) aktorët online dhe strategjitë e tyre (si, p.sh.: “Qanon”),⁵⁹⁹

- sigurojmë dhe nxisim arsyetimin dhe fuqizimin,

- zhvillojmë trajnime në mënyrë që njerëzit të kenë mjetet në dispozicion të tyre kundër fjalimit të urrejtjes,⁶⁰⁰

⁵⁹⁸ H. Gleiß & S. Laubenstein, Measures and strategies for combating hate speech at the European level-an overview Briefing Paper /Measures and strategies for combating hate speech at the European level-an overview, <https://library.fes.de/pdf-files/dialog/17431.pdf>, aksesuar më 01.02.2024

⁵⁹⁹ Po aty

⁶⁰⁰ <https://library.fes.de/pdf-files/dialog/17431.pdf>, aksesuar më 01.02.2024

-zbatimi i ligjit në internet: Shumë njerëz vazhdojnë ta konsiderojnë internetin si një vakum ligjor. Ky supozim është i përforcuar veçanërisht, nga fakti se gjuha e urrejtjes shpesh, nuk vuan pasoja. Kjo jo vetëm i kurajon autorët, por edhe u jep atyre një sens të shfajësimit. Prandaj nevojiten burime për të sanksionuar në mënyrë adekuate armiqësinë dhe urrejtjen kriminale në fjalim:

-urrejtja, nxitja dhe armiqësia ekzistojnë dhe jashtë internet, por ato gjenden në shkallë të veçantë.

Nevojiten burime adekuate në terma të personelit, financimit, pajisjeve teknike dhe ekspertizë, (trajnim i mëtejshëm) për të trajtuar fenomenin dixhital, siç duhet. Ligji aktual (i paraparë fillimisht, vetëm në lidhje me dukuritë analoge). Nevojat duhet të përshtaten sipas rastit me qëllim që të jenë në gjendje të kundërshtojnë dinamikën e përshkallëzimit dixhital, në mënyrë adekuate.

-Duhet më shumë burime përse u përket avokatëve, policisë dhe gjykatave, si dhe të vazhdojnë më tej, trajnime për dukuritë dixhitale, por edhe për forma të diskriminimit në përgjithësi, duke përfshirë: *seksizmin, diskriminimin dhe racizmi anti-rom*, ndër të tjera.

-Në rregull duhet prokurorë publikë të specializuar për të ekspozuar shtrirjen dhe karakteristikat e gjuhës së urrejtjes online dhe të jenë në gjendje të njohin koordinimin e fushatave të urrejtjes.

-Rregullimi i ofruesve të shërbimeve të mediave sociale: Krahas masave në nivel politik dhe juridik, rrjetet sociale duhet të detyrohen të marrin më shumë përgjegjësi.⁶⁰¹

-Kanalet e komunikimit duhet të jenë të lehtësisht të gjetur dhe të përdorur.⁶⁰²

Informacion mbi mbështetjen për personat e prekur. Në pikat kombëtare të kontaktit duhet të jenë të shfaqura dukshëm (shembull: pikat e kontaktit për personat në rrezik të vetëvrasjes nga gjuha e

⁶⁰¹ <https://library.fes.de/pdf-files/dialog/17431.pdf>, aksesuar më 01.02.2024

⁶⁰² <https://library.fes.de/pdf-files/dialog/17431.pdf>, aksesuar më 01.02.2024

urrejtjes).⁶⁰³ Përveç kësaj, kompanitë duhet të lidhin masat e tyre, të drejtat ndërkombëtare të njeriut, të vlerësojnë dhe përditësojnë rregullisht, zbatimin e standardet të veta.⁶⁰⁴

-Rregullimi i reklamave në platforma. Nuk mund të reklamohet përmbajtje ekstremiste ose përmbajtje nga aktorë ekstremistë. Një lloj rregulli mund të vërehet në lidhje me reklamat politike në shumë platforma, duke përfshirë Twitter.

-Duhet të jetë teknikisht e mundur, të çaktivizohet funksioni i komentit. Nëse nuk është e mundur të moderohet, në komente një opsion për të çaktivizuar komentet. Duhet të vihet në dispozicion faqet e mëdha të internetit për mediat sociale.

-Aktorët ekstremistë duhet të deplatformohen, në konsultime me ekspertë të pavarur. Për ta, duhet të vendosen standarde të verifikueshme, për të mbrojtur lirinë e shprehjes. Për më tepër, platformat e internetit duhet të prezantojnë masat për të kufizuar shtrirjen e aktorëve ekstremistë. Askush nuk ka të drejtën themelore për mbulim të gjerë.

-Kompanitë e internetit, politikëbërësit dhe shoqëria civile duhet të përballen me ekstremistët, ekosistemet për të menduar dhe vepruar përtej platformatve. *Urrejtja, përjashtimi dhe dhuna verbale*, nuk janë të organizuara në platformat kryesore dhe për pasojë është më e rëndësishme dhe e nevojshme që të shikojmë përtej rrjeteve ekzistuese.

-Duhet komunikim transparent nga ana e kompanive të internetit, në lidhje me fshirjen e komenteve, për të demonstruar nëse platforma ka marrë masat për të trajtuar urrejtjen, përjashtimin dhe dhunën verbale.⁶⁰⁵

⁶⁰³ H. Gleiß & S. Laubenstein, Measures and strategies for combating hate speech at the European level-an overview Briefing Paper /Measures and strategies for combating hate speech at the European level-an overview, <https://library.fes.de/pdf-files/dialog/17431.pdf>, aksesuar më 01.02.2024

⁶⁰⁴ H. Gleiß & S. Laubenstein, Measures and strategies for combating hate speech at the European level-an overview Briefing Paper /Measures and strategies for combating hate speech at the European level-an overview, <https://library.fes.de/pdf-files/dialog/17431.pdf>, aksesuar më 01.02.2024

⁶⁰⁵ <https://library.fes.de/pdf-files/dialog/17431.pdf>, aksesuar më 01.02.2024

Është e qartë se këto kompani nuk duan të transmetojnë informacione të brendshme ndaj palëve të jashtme. Kjo nuk mund dhe nuk duhet të lejohet të ndodhë për shkak të rrezikut se aktorët e këqij mund të jenë në gjendje të shfrytëzojnë një informacion të tillë. Megjithatë, ekspertët dhe akademikët duhet të kenë akses për t'i mundësuar të bëjnë krahasime dhe të vlerësojnë në mënyrë gjithëpërfshirëse se si masat janë duke u marrë. Kjo është mënyra e vetme e zhvillimit për masat efektive rregullatore.⁶⁰⁶

Bashkëpunimi ndërmjet organeve të ndjekjes penale dhe ofruesit të shërbimeve, duhet të jetë i përshtatshëm. Deri më sot, forcat e rendit shpesh, kanë konstatuar hezitim të shërbimeve për të përmbushur kërkesat për informacion. Në vend të kësaj, investohen autoritetet, pasi personat u referohen agjencive të huaja me arsyetimin se të dhënat në fjalë ruhen jashtë vendit.

-Mbrojtja e të dhënave të përdoruesit duhet të jetë thelbësore për të gjithë dhe të posedojë masa dhe kërkesa të duhura. Shoqëria civile do të qëndrojë në bord vetëm nëse ushtrohet ndjeshmëri, në lidhje me liritë civile dhe mbrojtjen e të dhënave.

-Menazhimi dhe moderimi i komunitetit: Vlen dhe është tejet i rëndësishëm, për sa kohë që gjuha e urrejtjes mbetet e pakundërshtueshme në seksione, që autorët e saj e konsiderojnë veten të shfajësuar dhe vazhdojnë të përhapin urrejtje.⁶⁰⁷ Analiza dhe studime të shumta tregojnë atë koment moderimi si funksionon.

-Angazhimi vullnetar për moderimin e komenteve: Operatorët e faqeve të internetit me një shtrirje të gjerë kanë nevojë për të pranuar përgjegjësitë e tyre, me të paktën një vullnetar për përkushtimin e vazhdueshëm, për moderimin e komenteve.⁶⁰⁸ Stafi dhe trajnime të

⁶⁰⁶ Hanna Gleiß & Sina Laubenstein Measures and strategies for combating hate speech at the European level-an overview Briefing Paper/Measures and strategies for combating hate speech at the European level-an overview <https://library.fes.de/pdf-files/dialog/17431.pdf>, aksesuar më 01.2.2024

⁶⁰⁷ Po aty

⁶⁰⁸ <https://library.fes.de/pdf-files/dialog/17431.pdf>, aksesuar më 01.02.2024

rregullta mbi format e ndryshme të diskriminimit dhe opsionet për kundër-fjalim, janë nevojshme për këtë. Për më tepër, interneti dhe media që në kompani kanë mbulim të gjerë, duhet të mbështesin punonjësit e tyre me pika kontakti dhe këshilltarë në vendin e punës.

-Mediat duhet të promovojnë shumëllojshmëri të përmbajtjes, duke raportuar për një sërë grupesh ose komunikimesh, duke pasqyruar këndvështrimet e tyre të ndryshme. Ata duhet të kujdesen të raportojnë në kontekst dhe me ndjeshmërinë e duhur përsa i përket përmbajtjes. Duhet të shmangin nxitjen e padashur të paragjyqimeve me stereotipet negative të individëve dhe grupeve.⁶⁰⁹

Gjyqësori, agjencitë e zbatimit të ligjit dhe organet publike duhet të pajisen me trajnime gjithëpërfshirëse dhe të rregullta mbi standardet përkatëse ndërkombëtare të të drejtave të njeriut i zbatueshëm për “*gjuhën e urrejtjes*”. Udhëzime për ndjekjen penale të rasteve të nxitjes dhe

vlerësimi i rasteve, bazuar në të drejtën ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, duhet të jetë zhvilluar. Shtetet duhet të sigurojnë që të gjitha agjencitë e zbatimit të ligjit të ndërjegjësohen udhëzimet gjatë trajnimeve dhe punës së tyre;

- Shtetet duhet të dekriminalizojnë plotësisht: *shpifjen, fyerjen, krimet e kujtesës dhe fjalime të tjera* vepra, që mund të zbatohen në mënyrë të papërshtatshme në rastet e “*gjuhës së urrejtjes*”, të cilat dështojnë për të përmbushur standardet ndërkombëtare të lirisë së shprehjes.

- Shtetet duhet të sigurojnë që procedurat dhe sanksionet e së drejtës civile të parashikojnë më shumë qasje të përqendruar te viktimat në ofrimin e kompensimit, në rastet e “*gjuhës së urrejtjes*”. Mjetet juridike të disponueshme, duhet të përfshijë kompensimin në formën e dëmeve materiale e jomateriale, të drejtën e korrigjimit dhe përgjigjes (sipas standardeve ndërkombëtare) në rast se nxitja ka ndodhur përmes mjeteve

⁶⁰⁹ Hanna Gleiß & Sina Laubenstein Measures and strategies for combating hate speech at the European level-an overview Briefing Paper/Measures and strategies for combating hate speech at the European level-an overview <https://library.fes.de/pdf-files/dialog/17431.pdf>, aksesuar më 01.2.2024

të informimit masiv. Shtetet gjithashtu, duhet të lejojnë OJQ-të të ngrenë padi civile në rastet përkatëse dhe duhet të parashikojë mundësinë e ngritjes së padive në grup për rastet e diskriminimit. Kjo duhet të jetë pjesë e një antidiskriminimi gjithëpërfshirës kornizë.⁶¹⁰

• Shtetet duhet të sigurojnë një kuadër rregullator për një media të larmishme dhe pluraliste në vend. Në veçanti, korniza të tilla duhet të parashikojnë që çdo rregullore e mediave, duhet të ndërmerret vetëm nga organe, që janë të pavarura nga qeveria, janë publikisht të përgjegjshme dhe veprojnë në mënyrë transparente.

• Rregullatorët e medias dhe organet vetërregulluese duhet të zhvillojnë dhe publikojnë politika të qarta, udhëzime për “*gjuhën e urrejtjes*” dhe t’i zbatojnë këto udhëzime politikash të qarta në vendimet e tyre. Ata duhet të promovojnë në mënyrë aktive një procedurë ankese, lehtësisht të aksesueshme dhe të ftojnë publikun të përdorë zgjidhjet alternative të mosmarrëveshjeve në “*gjuhën e urrejtjes*” lidhur me rastet e medias;

• Zyrtarët publikë, përfshirë politikanët, duhet të kuptojnë se luajnë një rol udhëheqës në njohjen dhe shprehjen e menjëhershme kundër intolerancës dhe diskriminimit, duke përfshirë “*gjuhën e urrejtjes*”.⁶¹¹ Kjo kërkon njohjen dhe refuzimin e vetë sjelljes, si dhe paragjykimet për të cilat është simptomatike, duke shprehur simpatinë dhe mbështetjen për individët ose grupet e synuara, dhe inkadrimin e incidenteve të “*gjuhës së urrejtjes*” si të dëmshme për të gjithë shoqërinë. Këto ndërhyrje janë veçanërisht të rëndësishme, kur ndërtensionet komunale janë të larta, ose janë të prirura për t’u

⁶¹⁰Hanna Gleiß & Sina Laubenstein Measures and strategies for combating hate speech at the European level-an overview Briefing Paper/Measures and strategies for combating hate speech at the European level-an overview <https://library.fes.de/pdf-files/dialog/17431.pdf>, aksesuar më 01.2.2024

⁶¹¹ Responding to ‘hate speech’: Comparative overview of six EU countries 2018 ARTICLE 19, Free Word Centre 60 Farringdon Road London, https://www.article19.org/wp-content/uploads/2018/03/ECA-hate-speech-compilation-report_March-2018.pdf, aksesuar më 18.02.2024

përshkallëzuar si dhe, kur aksionet politike janë të larta konkretisht, në prag zgjedhjesh.⁶¹²

11.5 Nismat kombëtare për luftën kundër gjuhës së urrejtjes në media

Në nivel kombëtar, veprimet e ndërmarra kundër gjuhës së urrejtjes nuk janë as të përhapura, as të qëndrueshme.⁶¹³ Megjithatë, ka disa nisma të ndërmarra nga aktorë të ndryshëm, duke përfshirë: *institucionet publike, autoritetet mediatike, organizatat e medias dhe organizatat e shoqërisë civile*. Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA) përmes Këshillit të Ankesave synon t'i përgjigjet *gjuhës së urrejtjes* dhe përmbajtjes joetike të publikuar nga mediat audiovizive. Gjithsesi, ndikimi i një veprimi të tillë mbetet ende për t'u parë, sepse *seksizmi, mezojinia dhe gjuha e urrejtjes dhe diskriminuese* janë ende të pranishme në programe të ndryshme televizive, megjithëse jo aq shumë, krahasuar me mediat online dhe ato sociale.

Në vitin 2019, Avokati i Popullit, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Autoriteti i (AMA)-s dhe Këshilli Shqiptar i Medias krijuan Aleancën kundër gjuhës së urrejtjes, me synimin për të trajtuar *gjuhën e urrejtjes* “në të gjitha dimensionet” në të cilat ajo shfaqet në shoqëri, me një fokus të veçantë përqendrimi tek gjuha e urrejtjes në internet. Përsëri, përkundër këtyre përpjekjeve të përbashkëta, situata nuk është përmirësuar dukshëm vitet e fundit. Nga ana tjetër, ka disa organizata mediatike dhe OSHC, që përpiqen të adresojnë gjuhën e

⁶¹² Responding to ‘hate speech’: Comparative overview of six EU countries 2018 ARTICLE 19, Free Word Centre 60 Farringdon Road London, https://www.article19.org/wp-content/uploads/2018/03/ECA-hate-speech-compilation-report_March-2018.pdf, aksesuar më 18.02.2024

⁶¹³ D. Hysa, K. Lani, “*Raport Monitorimi për gjuhën e urrejtjes në Shqipëri*”, Instituti Shqiptar i Medias European Union Norway Project German, Projekti financohet nga Bashkimi Evropian, Trusti Ballkanik për Demokraci, projekt i Fondit Gjerman Marshall të Shteteve të Bashkuara dhe Ministrisë së Punëve të Jashtme të Norvegjisë, f.15

urrejtjes përmes projekteve dhe nismave të ndryshme, si p.sh.: përmes trajnimit të gazetarëve, por këto përpjekje janë sporadike, afatshkurtra dhe kanë pak ndikim ose shtrirje të kufizuar.⁶¹⁴

11.6 Masat që duhen marrë nga ana e shtetit

- Analizimi i të dhënave të disponueshme në tërësinë e tyre në mënyrë që të arrihet në përfundime për qëllimin, natyrën dhe zhvillimin e problemit të krimit të urrejtjes, si dhe informimin e veprimeve të mëtejshme.⁶¹⁵
- Publikimi i të dhënave për krimet e urrejtjes, të paktën një herë në vit, për të informuar publikun. Kjo mundëson shqyrtimin dhe rrit besimin e publikut në punën e sistemit të drejtësisë penale. Raporti mbi të dhënave mund të identifikojë gjithashtu, *tendencat, mësimet e nxjerra dhe prioritetet* për veprimin e qeverisë.
- Informimi i publikut për iniciativa të tjera, për të përmirësuar regjistrimin dhe mbledhjen e të dhënave për urrejtjen ndaj krimit, si dhe politikat sektoriale dhe puna e mekanizmit të koordinimit të qeverisë.⁶¹⁶

⁶¹⁴ D. Hysa, K. Lani, “Raport Monitorimi për gjuhën e urrejtjes në Shqipëri”, Instituti Shqiptar i Medias European Union Norway Project German, Projekti financohet nga Bashkimi Evropian, Trusti Ballkanik për Demokraci, projekt i Fondit Gjerman Marshall të Shteteve të Bashkuara dhe Ministrisë së Punëve të Jashtme të Norvegjisë, f.15

⁶¹⁵ Bojana Netkova, LLM and Joanna Perry Data collection analysis on hate speech and hate crime pg.82Skopje, 2022HORIZONTAL FACILITY FOR THE WESTERN BALKANS AND TURKEY II “Promotion of diversity and equality in North Macedonia”<https://rm.coe.int/data-collection-analysis-on-hate-speech-nm-eng/1680a9485a>

⁶¹⁶ ⁶¹⁶ Bojana Netkova, LLM and Joanna Perry Data collection analysis on hate speech and hate crime pg.82Skopje, 2022HORIZONTAL FACILITY FOR THE WESTERN BALKANS AND TURKEY II “Promotion of diversity and equality in North Macedonia”<https://rm.coe.int/data-collection-analysis-on-hate-speech-nm-eng/1680a9485a>

- Zhvillimi i një faqeje interneti të dedikuar, për të raportuar statistikat e krimit të urrejtjes dhe informacione të tjera të lidhura me to.
- Të sigurohet që publiku i gjerë të ndërgjegjësohet për legjislacionin, që lufton racizmin, ksenofobinë, antisemitizmin dhe intolerancën.
- Të sigurohet që të jepet ndjekja penale e veprave të natyrës raciste ose ksenofobike me prioritet të lartë dhe të ndërmerret në mënyrë aktive dhe të vazhdueshme.
- Të sigurohet që të dhënat dhe statistikat e sakta, të mbledhen dhe publikohen për numrin e veprave raciste dhe ksenofobike, që raportohen në polici, për numrin e rasteve, që ndiqen penalisht, për arsyet e mosndjekjes dhe për përfundimin e çështjeve të ndjekura penalisht.
- Të sigurohet që mjetet juridike të përshtatshme të jenë në dispozicion për viktimat e diskriminimit, qoftë në të drejtën penale ose në të drejtën administrative dhe civile ku mund të sigurohet kompensimi në të holla ose në formë tjetër.
- Të sigurohet që viktimat e diskriminimit të kenë në dispozicion ndihma ligjore adekuate kur kërkohet një mjet juridik.⁶¹⁷
- Rishikimin ekzistues. Të sigurohet legjislacioni i propozuar, për politikat, për praktikën gjyqësore, për mekanizmat, për adresimin, kundërvënien e gjuhës së urrejtjes dhe nxitjen e diskriminimit, armiqësisë ose dhunës, në përputhje me normat ndërkombëtare, ligjin dhe standardet e të drejtave të njeriut (RCO/operacion paqeruajtës ose mision i posaçëm politik, /

⁶¹⁷ B. Netkova, J. Perry, Data collection analysis on hate speech and hate crime pg.79, Skopje 2022, HORIZONTAL FACILITY FOR THE WESTERN BALKANS AND TURKEY II, “Promotion of diversity and equality in North Macedonia”, <https://rm.coe.int/data-collection-analysis-on-hate-speech-nm-eng/1680a9485a>

OHCHR/, Zyra për Parandalimin e Gjenocidit dhe Përgjegjësia për Mbrojtjen /UNESCO).⁶¹⁸.

- Promovimi i krijimit dhe zbatimi i një kuadri ligjor kombëtar, që mbështet viktimat e gjuhës së urrejtjes, e cila përfshin ligje për ndalimin e nxitjes së diskriminimit, armiqësisë ose dhunës, dhe legjislacioni kundër diskriminimit, në përputhje me të drejtën ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, teksa paralajmërohet kundër miratimit të çdo legjislacioni të propozuar për gjuhën e urrejtjes, që rrezikon të minojë lirinë e shprehjes.⁶¹⁹

11.7 Rekomandime:

1- Të bëhen ndryshime në ligjin për barazinë gjinore në përputhje me aktet e Bashkimit Evropian.

2- Të bëhen disa ndryshime në ligjin për mbrojtjen nga diskriminimi. Ligji është në përputhje me aktet e Bashkimit Evropian, por duhen shtuar disa dispozita në përputhje me rekomandimet e bëra nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

3- Të ndërmerren fushata sensibilizuese në shoqëri kundër diskriminimit dhe gjuhës së urrejtjes.

4- Edukimi kundër diskriminimit dhe gjuhës së urrejtjes të futet në kurikulat e universiteteve dhe të shkollave të mesme.

5- Të ndërmerren trajnime për gazetarët për diskriminimin, gjuhën e urrejtjes dhe dezinformimin.

⁶¹⁸ United Nations Strategy and Plan of Action on Hate Speech Detailed Guidance on Implementation for United Nations Field Presences, September 2020, https://www.un.org/en/genocideprevention/documents/UN%20Strategy%20and%20PoA%20on%20Hate%20Speech_Guidance%20on%20Addressing%20in%20field

⁶¹⁹

- 6- Të merren masa nga AMA për mediat, që nuk respektojnë Kodin e Etikës në Media, Kodin e Transmetimit dhe ligjin për mediat audiovizive.
- 7- Të merren masa mbrojtëse nga shteti për viktimat e gjuhës së urrejtjes dhe diskriminimit.
- 8- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi të marrë një rol aktiv dhe funksional ndaj individëve, që janë objekte të gjuhës së urrejtjes dhe diskriminimit.
- 9- Të bëhen ndryshime në Rregulloren e Kuvendit, të vendosen sanksione për deputetet, që përdorin gjuhën e urrejtjes dhe ndërmarrin veprime të dhunshme në Parlament.
- 10- Të merren masa konkrete për ndalimin e gjuhës së urrejtjes dhe diskriminimit në media.
- 11- Politikanët të ndërpresin gjuhën e urrejtjes në Parlament , në media dhe gjatë fushatave zgjedhore.
- 12- Operatorët mediatikë shtetërorë të publikojnë përmbledhësen e vendimeve të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi me objekt gjuhën e urrejtjes.
- 13- Të merren masa ndaj dezinformimeve, që synojnë të prishin nderin e reputacionin e individëve ose organizatave që iu drejtohen.
- 14- Të nxirren aktet nënligjore në bazë të ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi dhe ligjit për barazinë gjinore.
- 15- Të hartohen Strategji Kombëtare kundër Diskriminimit dhe Gjuhës së Urrejtjes në përputhje me Strategjitë e Bashkimit Evropian.
- 16- Të hartohen Raporte me statistika për të gjitha format e gjuhës së urrejtjes dhe të publikohen në faqen zyrtare të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe individët të kenë akses.
- 17- Nxjerrja e Rekomandimeve për të siguruar barazinë gjinore në shoqëri.
- 18- Të hartohen politika gjithpërfshirëse për punësimin e personave me aftësi të kufizuara, LGBT dhe personave të komunitetit rom dhe egjiptian.
- 19- Të ndalohet diskriminimi, gjuha e urrejtjes ,seksizmi në mediat audiovizuale , mediave të shkruara dhe mediave sociale. Të merren masa jo vetëm në rang kombëtar dhe ndërkombëtarë

Bibliografia

- E. Mihajlova, J. Bačovska, T. Shekerxhiev, “*Liria e shprehjes dhe gjuha e urrejtjes*” Shkup, 2013 OSCE f.6
- A. Mandro, (Neni 2, 3, 3/1, 4, 9, 11, 13, 15, 18) A. Anastasi, (Neni 1, 10, 12, 13/1, 20, 21, 22, 23, 24) M. Semini, (Neni 5, 6, 7, 7/1, 8, 14, 16, 17, 19), “*Komentari i ligjit për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare*”, Botuar në Tiranë, Dhjetor 2021
- Handbook on European non-discrimination law 2018, edition European Union FRA Agency for Fundamental Rights and Council of Europe, 2018 Luxembourg: Publications Office of the European Union ISBN 978-92-871-9851-8 pg,86,87,88
- Marija Luçiq-Çatiq, Eksperte e jashtme e RNR-së, “*Përmbledhje e qasjeve për të luftuar gjuhën e urrejtjes në Ballkanin Perëndimor*”, Komisioni Evropian, Rrjeti i Ndërgjegjësimit për Radikalizimin Luksemburg: Zyra e publikimeve të Bashkimit Evropian 2023, Komisioni Evropian
